Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLIX nr. 115 / 2019

Boton: **Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës**

Kryeredaktor:
Sabri Bajgora

Redaksia:
Dr. Abdulla Hamiti, Mr. Adnan Simnica, Ahmet Sadriu,
Dr. Fahrush Rexhepi, Kasim Gërguri, Dr. Sadik Mehmeti, Vedat Sahiti

email: **edukataislame@bislame.net**

Përkthimi i rezymeve:
Gjuhë angleze: Fisnik Gruda
Gjuhë arabe: Besim Mehmeti

Ballina:
Bashkim Mehani

Redaktor teknik & Operator kompjuterik:
Nuhi Simnica

Shtypi:
"ViPrint" - Mitrovicë

Tirazhi: 600

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLIX nr. 115 / 2019

Prishtinë
2019

NË KUJTIM TË DY KOLEGËVE
Prof. Qemajl Morina dhe Prof. Kasim Gërguri
(Allahu i pastë mëshiruar)

Gjatë jetës sonë në këtë botë, na rastis të ballafaqohemi me momente të ndryshme, që mund të jenë çaste gëzimi dhe pikëllimi. Disa prej këtyre çasteve na përballin me dhimbje, por të cilat megjithatë na kthejnë në një realitet, se asgjë nuk ndodh pa dijen, vullnetin dhe caktimin e Allahut fuqiplotë. E ndër këto çaste të dhimbshme e pikëlluese qenka edhe ndarja me miq, shokë dhe kolegë, me të cilët për disa dekada ke punuar dhe ndarë një pjesë të konsiderueshme të kohës dhe jetës tënde.

Pikërisht për këtë arsye qenka bukur e vështirë t'i shkruaj këta rreshta për dy kolegët tanë që në harkun kohor prej një muaji, u ndanë nga ne, për t'u shpërngulur pranë mëshirës së Allahut, prof. Qemajl ef. Morinën dhe prof. Kasim ef. Gërgurin. Këta të dy, punuan me shumë zell e përkushtim, për vite me radhë në institucionet e BIK-ut, andaj e lus Fuqiplotin t'i ketë mëshiruar me rahmetin e Tij të pakufishëm, dhe t'ua bëjë nasip Xhenetet më të larta të Firdevsit.

Njerëzit, gjatë jetës në këtë botë, lënë lloj-lloj gjurmësh, me të cilat përkujtohen edhe pas vdekjes, por ata që lënë pas vete gjurmë të mira, sidomos në lëmin e fjalës së shkruar, ata janë të pavdekshëm dhe të gjallë te Zoti i tyre. Prof. Qemajl ef. Morina, ishte një penë islame që fuqishëm e ngriti vetëdijen islame tek masat intelektuale në këto dekadat e fundit. Ishte kryeredaktor i dy revistave më prestigjioze ndër shqiptarët, *Dituria Islame* dhe *Edukata Islame,* të cilat i ngriti në nivelet më të larta fetare e

shkencore. Ai la pas vetes një opus të madh shkrimesh e studimesh, duke i bërë vetes një vend meritor në analet e historisë së BIK-ut, sepse e zbatoi në praktikë urdhëresën e parë hyjnore drejtuar njerëzimit: *"Lexo!"*

Ai ishte zëri i së vërtetës edhe në kohët më të vështira, i urtë, modest dhe vizionar. Falë kontributit dhe afërsisë të tij, sot kemi me dhjetëra pena të reja, që në shumë lëmenj fetarë, pothuajse kanë prekur majat, duke bërë emër në arealin e trojeve tona shqiptare. Edhe unë kisha fatin ta përjetoja këtë afërsi të tij, sepse me inkurajimin e tij, fillova të merrem intensivisht me shkrime në revistat tona fetare, e pastaj kisha fatin që ta trashëgoja atë edhe si kryeredaktor, në të dyja revistat tona, *Diturinë Islame* dhe *Edukatën Islame.*

Në anën tjetër, edhe vdekja e kolegut tonë të nderuar prof. Kasim ef. Gërguri, la një boshllëk të madh në zemrat tona, sepse si anëtar i redaksisë aktuale të revistës *Edukata Islame*, kemi diskutuar gjerë e gjatë, për të ardhmen e saj. Madje, një ditë para se të shtrihej në spital, m'i kishte dërguar dy punime të redaktuara nga ana e tij, me disa vërejtje dhe sugjerime përmbajtjesore. Ishte shumë ambicioz dhe i përkushtuar në punë.

Prof. Kasim ef. Gërguri, ishte aktiv në fushën e apologjetikës islame, në të cilën, përveç disa studimeve të mirëfillta shkencore, shkroi edhe një vepër shumë të vlefshme për Ne, *"Akaidi islam sipas Maturidiut"*. Përveç kësaj, ai na e la në dorëshkrim edhe një vepër në sferën e *Thirrjes Islame*, e cila shpresoj se do të botohet para muajit të bekuar të Ramazanit.

E lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm, që vepra e këtyre dy profesorëve të nderuar të mësimeve islame, të jetë dritë dhe shpërblim për ta në Ahiret. Kujtimi për ta do të mbetet i paharruar, e takimi i ardhshëm me ta, qoftë në kopshtet e Xhenetit. Amin!

Sabri Bajgora
prill, 2019

Sabri BAJGORA

MUHAMED MUTEVEL-LI ESH-SHA'RAVI dhe tefsiri i tij "Havatiri havle-l Kurani-l Kerim"

Abstrakt

Përgjatë historisë njerëzore, të rrallë janë ata mendjendritur që në kërkim të kënaqësisë së Allahut, lanë gjurmë drite nëpër të cilat do të shtegtojnë njerëzit. Një nga këta kandila ndriçues, padyshim ishte edhe dijetari i madh Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi, i cili Ymetit islam i la një thesar të çmuar në lëmin e fjalës së shkruar. Ky punim kryesisht përqendrohet në jetën dhe veprën e tij, dhe për impaktin që pati ky dijetar në zhvillimin e mendimit islam gjatë shekullit XX. Në pjesën e dytë të këtij punimi, shqyrtohet dhe analizohet metodologjia e Imam Sha'ravit në tefsirin e tij të mirënjohur *"Havatiri havle-l Kurani-l Kerim",* si dhe qëndrimet e tij rreth shumë çështjeve, nga aspekti i apologjetikës, jurisprudencës, da'ves etj.. Në saje të opusit të tij të madh të veprave dhe produktivitetit të tij të shumanshëm në sferën e Thirrjes islame, shumë dijetarë bashkëkohorë nuk kanë hezituar ta quajnë ripërtëritës të mësimeve islame, të cilin Allahu e dërgon te Ymeti islam, në çdo 100 vjet.

Fjalët kyçe: *Imam Sha'ravi, tefsir, përsiatje, ripërtëritës i fesë, Universiteti i Az'harit, Egjipt, etj.*

Biografia e tij

Thirrësi më i madh islam i shek. XX, Muhamed Mutevel-li Sha'ravi u lind më 15 prill të vitit 1911 (15 Rebiul Evvel 1329 h.), në fshatin Dakadus, provinca Mejt Gamr, afër qytetit Dakahlije të Egjiptit. Rrjedh prej një familjeje të ndershme dhe fetare, por mbi të gjitha arsimdashëse. Nëpër shumë libra, që flasin për biografinë e tij, është shënuar se Imam Sha'ravi, si nga ana e babait ashtu edhe nga ajo e nënës, rrjedh nga loza e Husejnit r.a..[1] Qysh në moshën 11 vjeçare, e mësoi përmendësh Kuranin fisnik, të cilit më pas ia kushtoi tërë jetën.

Që nga lindja, atë e kanë përcjellë disa shenja hyjnore, që linin të kuptohej se do të bëhej dijetar i madh islam. Ndër to ishte edhe ëndrra (ru'ja) e Imamit të fshatit Dakadus, i cili kishte parë në ëndërr se në shtëpinë e Sejjid Mutevel-lit, kishte lindur një fëmijë, i cili në formë të zogut, ishte ndalur në minberin e xhamisë, duke u ligjëruar (cicëruar) besimtarëve.[2] Kjo ëndërr, e kishte shtyrë babanë e tij, që të nxiste djalin e tij, Muhamedin, të orientohej në mësimet e fesë. Është e regjistruar nëpër libra, thënia e babait të tij, të cilën e ka përmendur edhe vetë Imam Sha'ravi, kur si të vogël ia kishte dorëzuar hoxhës Abdurrahman esh-Shihabit, në Mejtep (Kuttab), duke i thënë: *"Thyeja krahun, se unë do t'ia shëroj!"*[3] Kjo ishte një shenjë, që ai ta mësonte mirë dhe të mos kursente mundin për edukimin e tij të mirëfilltë fetar.

Në vitin 1916, Sha'raviu u regjistrua në shkollën fillore të Az'harit, të cilën etapë të shkollimit e përfundoi në vitin 1923. Pas përfundimit të fillores, vazhdoi shkollimin e mesëm të ulët (I'dadije) dhe atë të mesëm, të cilat po ashtu i përfundoi në Institucionet shkollore të Az'harit në Zakazik, në vitin 1936.

Duke qenë ende nxënës në etapën e shkollimit të mesëm, u shqua për poezitë e tij, saqë u zgjodh kryetar i Unionit të nxënësve, e më vonë edhe kryetar i Shoqatës së letrarëve të rinj. Së bashku me të, në këtë shoqatë

---

[1] Maxhid Ibrahim Hamdan, *Mevkif esh-shejh esh-Sha'ravi min kadaja el akideti-ardun ve nakdun*, Gazë-Palestinë, 2002, f. 17.

[2] Fatime es-Sahravi, *Esh-Sha'ravi - Mishvar hajati, araun ve efkarun*, Kajro, 1988, ff. 16-17. (Kjo është vajza e shejh Sha'ravit, S.B.)

[3] Muhamed Zajid, *Er-Rravi huve-sh-Sha'ravi - Mudhekkerat Imamu-d-duati*, Kajro, 1998, f.25.

ishin edhe Dr. Abdul Mun'im el Hafaxhi, poeti Tahir Ebu Basha, Halid Muhamed Halid, Dr. Ahmed Hejkel, Dr. Hasen Xhad, etj, të cilët më vonë, lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë më të re të Egjiptit, në shumë sfera.

Pas përfundimit të shkollimit të mesëm, babai i Imam Sha'ravit, insistonte me ngulm që i biri të vazhdonte shkollimin në Universitetin e famshëm të Az'harit në Kajro. Pas shumë peripecive, në vitin 1937, ai e regjistron Fakultetin e gjuhës arabe në këtë Universitet, të cilin e kreu me sukses në vitin 1941.[4]

Dy vite pas përfundimit të studimeve, në vitin 1943, merr gradën e lartë të Ixhazetit për mësimdhënie, e cila ia mundësoi që për disa vite me radhë të punonte si mësimdhënës, në Institutin e fesë në Tanta, pastaj në Zakazik dhe së fundmi në Aleksandri.

Në vitin 1950, me ftesë të Arabisë Saudite, për vite me radhë, ligjëroi në fakultetin e Sheriatit, në Universitetin *Ummul Kura*, në Mekë.

Pas kthimit nga Arabia Saudite, në vitin 1960, u emërua zëvendësdrejtor i Institutit të Az'harit në Tanta.

Më 1961 emërohet drejtor i Misionit të Thirrjes islame në Ministrinë e Vakfit në Egjipt.

Në vitin 1962, u emërua mbikëqyrës në procesin e avancimit të shkencave të gjuhës arabe në Universitetin e Az'harit,

Në vitin 1964 emërohet Drejtor i përgjithshëm i Zyrës së kryeplakut-rektorit të Az'harit, Hasan Me'munit.

Në vitin 1966 emërohet Kryetar i Delegacionit të Az'harit, që shkoi në Algjeri, e që për synim kishte t'u mësonte dhe t'u përmirësonte algjerianëve rishtazi gjuhën arabe, ngase ata, nën zgjedhën franceze, gjatë robërisë kolonialiste, në një masë të madhe e kishin harruar atë.

Në vitin 1970, shkoi profesor vizitues në Universitetin *Melik Abdulaziz* në Mekë, ndërsa në vitin 1972, u zgjodh përgjegjës i Katedrës për studime postdiplomike, në po këtë Universitet.

Me insistimin e kryetarit të Egjiptit, Enver es Sadat, në nëntor të vitit 1976, emërohet Ministër i Vakfit dhe i Çështjeve të Az'harit, në qeverinë

[4] Dr. Abdul Basit Emin, *El-Imam esh-Sha'ravi ve xhuhuduhu fi-d-difai ani-l Islam*, f. 20; http://www.al-eman.com/Monwat/Ozamaa/Shaarawy.asp#93#93

e Kryeministrit të atëhershëm Memduh Salim, post të cilin e mbajti për afro 2 vite, sepse në tetor të viti 1978, ai me vetë dëshirë jep dorëheqje nga ky post. Derisa ishte ministër i Vakfit, Imam Sha'ravi me një urdhër ministror, themeloi bankën e parë islame në Egjipt (Bank Fejsal). Ky vendim, në realitet ishte kompetencë e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, atëbotë, dr. Hamid es-Sajih, por ai, në shenjë respekti, ia barti autorizimin dhe kompetencën shejh Sha'ravit, gjë të cilën e miratoi edhe Parlamenti i Egjiptit.[5]

Pas dorëheqjes nga posti ministror, shejh Sha'ravi sërish u angazhua mësimdhënës në Universitetin *Melik Abdulaziz* në Arabinë Saudite, ku qëndroi deri në vitin 1981.

Më 1980, emërohet delegat në Kolegjiumin për hulumtime islame në Universitetin e Az'harit në Kajro.

Po këtë vit, zgjidhet edhe delegat në Parlamentin Konsultativ (Këshillëdhënës) të Egjiptit (Mexhlis-esh-Shura).

Disa herë i qe ofruar edhe posti i Kryeplakut të Az'harit (Shejhu-l Az'har), por e kishte refuzuar, ngase kishte dëshirë të merrej vetëm me çështje të Thirrjes dhe të komentimit të Kuranit, i pandikuar nga rrjedhat e politikës. Derisa ishte Ministër i Vakfit, arriti, që postin e *Shejhut të Az'harit* ta ngrente deri në nivel të pozitës së Kryeministrit të vendit, ndonëse kishte kërkuar që ky post fetar, të ishte i barabartë për nga rëndësia me postin e kryetarit të shtetit.

Ekselenca e tij ishte një vizionar dhe largpamës dhe gjithnjë i përkushtuar për të qenë në shërbim të fesë. Ishte ndër misionarët më të mëdhenj të botës islame e njëherësh edhe njëri ndër komentatorët më të njohur të Kuranit, në shekullin XX.[6]

---

[5] https://alwafd.news/دنيا-ودين/٤٩٨٧٣١-اليوم-ذكرى-وفاة-الإمام-محمد-متولي-الشعراوي

[6] Unë personalisht së bashku me disa kolegë nga Bashkësia Islame e Kosovës, në vitin 1996, kemi pasur fatin të ishim mysafir nderi në shtëpinë e tij, në Giza, me ç'rast patëm biseduar rreth gjendjes së tensionuar që mbretëronte atëbotë në Kosovë, në kohën e okupimit serb. Ai ishte lutur për Kosovën dhe për popullin e saj, që Allahu sa më shpejt të na ndihmonte në realizmin e aspiratave tona, sepse thoshte që Kosova është pjesë e pandashme e trungut islam, dhe se vuajtjet tona, ishin edhe vuajtje të tij po edhe të mbarë Ymetit islam. Me këtë rast, ia pata dhuruar dy librat e tij të përkthyera nga unë, në gjuhën shqipe: *"Jeta dhe vdekja"* dhe *"Argumentet lëndore mbi ekzistimin e Zotit"*, të cilat e patën emocionuar jashtëzakonisht shumë.

Gjatë jetës së tij, mori pjesë në shumë Kongrese, Konferenca Ndërkombëtare dhe evenimente të tjera në sferën e Thirrjes islame, si në Egjipt, ashtu edhe nëpër botë. Përveç në botën arabe-islame, ka marrë pjesë edhe në Konferencën e OKB-së, në Nju Jork, në selinë e së cilës Organizatë, pati mbajtur një fjalim historik në lidhje me qëndrimet e fesë islame, karshi krizave ne botë, sidomos rreth çështjes palestineze. Ai po ashtu ka mbajtur ligjërata nëpër shumicën e qyteteve të mëdha në SHBA, Kanada, dhe pothuajse në të gjitha metropolet evropiane, duke filluar nga Roma, Parisi, Londra, Vjena, Gjeneva, etj..

Imam Sha'ravi pas vetes la pesë fëmijë, tre djem e dy vajza dhe shumë nipër e mbesa. Sipas tij, familja është e shenjtë dhe bazë e çdo suksesi në jetë, andaj gjithmonë u përpoq që ata t'i shkollonte e edukonte ashtu siç duhej, por gjithnjë duke i mbajtur larg syve të mediave dhe opinionit publik, me qëllim që të ruante privatësinë dhe qetësinë e tij familjare.

Shejh Sha'ravi vdiq në Kajro në qershor të vitit 1998, ndërsa, sipas amanetit të tij, u varros në vendlindjen e tij, Dakadus. Në përcjellje të xhenazes së tij ishin të pranishëm mbi një milion njerëz nga e tërë bota islame.[7]

Mësuesit e Imam Sha'ravit

Meqë Imam Sha'ravi, kaloi nëpër të gjitha etapat e shkollimit bashkëkohor, është e natyrshme që të jetë pajisur me dituri nga mësues të shumtë, të cilët në një formë apo tjetër, kanë ndikuar në formimin e tij intelektual dhe fetar. Këtu do të përmenden vetëm disa prej tyre:

1. Shejh Abdurrahman esh-Shihabi, është mësuesi i parë i tij në "Kuttab" (Mejtep) nga i cili mësoi hifzin e Kuranit dhe shkencën e texhvidit. Vetë Sha'ravi, e kujton me pietet hoxhën e tij të parë, i cili nganjëherë dinte të ishte shumë më i ashpër me të, sesa me nxënësit e tjerë. Në etapat më të vonshme të shkollimit, ai mori mësime në Kuran edhe nga shejh Abdul-letif el Xhevde.

[7] Bedevi Taha Bedevi & Abdul Mun'im Hafaxhi, *Kalu ani-sh-Sha'ravi*, Kajro, 1999, ff. 5-13; https://vb.almstba.com/t139066.htm; http://www.sis.gov.eg/Story/142577/?lang=ar; محمد–متولي–الشعراوي

2. Mësimet e para të fesë i kishte marrë edhe nga këta dijetarë të Egjiptit: shejh Ahmed et-Tavil, shejh Muhamed Ebi Amare, dhe shejh Hasen ez-Zagluli.
3. Nga shejh Ebu Abdurrahman el Bejadi, mësoi poezinë dhe letërsinë arabe.
4. Në shkencën e Fikhut, mësime mori edhe nga shejh Kefafi el Xhevde.[8]
5. Ibrahim Hamrush, *ish shejh i Azharit*, ishte mësues i tij në Institutin e Az'harit në Zakazik. Nga ky dijetar i madh i kohës, Imam Sha'ravi mësoi gjuhën arabe dhe shkencat përcjellëse të saj, e cila e katapultoi më pas, në orbitën e dijetarëve më të mëdhenj që pati ndonjëherë bota islame.
6. Muhamed Muhjiddin Abdulhamid - Edhe ky ishte mësues i tij në Institutin e Zakazikut, nga i cili mësoi artin e redaktimit të dorëshkrimeve-manuskripteve. Ky dijetar, njihet si njëri prej hulumtuesve dhe redaktuesve më të njohur të trashëgimisë së shkruar islame në Egjipt.[9]
7. Ndikim në formimin e tij si imam i kohës, patën edhe shejh Muhamed esh-Sherkabani, shejh Ahmed Jusuf en-Nexhati, shejh Ahmed Amare dhe shejh Sulejman Amare.[10]
8. Shejh Muhamed bin Mustafa el Meragij - Ky është dijetari dhe mufessiri i madh Meragiu, autor i tefsirit të mirënjohur 30 vëllimësh *"Tefsirul Meragij"*, dhe ish *shejhu-l Az'har* nga i cili Imam Sha'ravi mësoi shkencën e tefsirit dhe bazat e tij, etj..[11]

Këta ishin disa nga mësuesit dhe profesorët e tij, që në një mënyrë apo tjetër ndikuan në formimin e tij intelektual, nëpër etapa të ndryshme të jetës dhe shkollimit të tij.

---

[8] Muhamed Siddik el Menshavi, *Esh-Sha'ravi ve hadithu-dh-dhikrajat,* Kajro 1998, ff. 16-17.

[9] Ibrahim Isa Ibrahim Sajdem, *Menhexh esh-Sha'ravi fi-t-tefsir*, Gaza-Palestinë, 2000. f. 45.

[10] Muhamed Mahxhub Hasen, *Mine-l karjeti ile-l alemijjeti*,Kajro, 1990, ff. 17-18.

[11] *Esh-Shejh esh-Sha'ravi ve hadithu-dh-dhikrajat*, f. 7; Shih edhe: *Mevkif esh-shejh esh-Sha'ravi min kadaja el akideti-ardun ve nakdun*, ff. 20-22.

Nxënësit e Imam Sha'ravit

Imam Sha'ravi, punoi si mësimdhënës, nëpër Institucione të shumta arsimore të botës islame, dhe me mësimet e tij la gjurmë të pashlyeshme në zemrat e shumë nxënëseve dhe të studentëve të tij, në Egjipt, në Arabinë Saudite, në Algjeri apo gjetiu. Sidoqoftë, janë disa nga nxënësit, të cilët i qëndruan afër gjatë gjithë jetës së tij, e ndër ta do të veçonim:

1. Shejh Jusuf el Kardavi - Njëri ndër thirrësit më të mëdhenj islam të shekullit XX, i cili vetë e ka pohuar me shumë krenari, se ka pasur nderin të ishte nxënës i Imam Sha'ravit në Tanta, e më vonë edhe kolegë në rrugën e Thirrjes islame.[12]
2. Es-Sejjid el Xhumejli, një mjek i njohur i Egjiptit, i cili për një kohë ishte redaktor në revistën *"El-Hilal",* e pastaj edhe kryeredaktor i revistës prestigjioze *"Minberu-l Islam"*. Ky ia ka përgatitur për botim librin *"El-Fetava li-sh-Sha'ravi"*, të cilin pastaj ia kishte paraqitur për redaktim dhe e kishte botuar.
3. Muhamed Siddik el Menshavi, njëri prej lexuesve më të njohur të Kuranit të kohës sonë, i cili vdiq në vitin 1969. Ai është autor i librit: *"Esh-Shejh esh-Sha'ravi ve hadithu-dh-dhikrajat"*
4. Sami Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi, djali i Imam Sha'ravit, i cili ka punuar në *Mexhmea-l Buhuth el Islamije* pranë Universitetit të Az'-harit.[13]

Duke pasur parasysh se ai ligjëroi nëpër shumë Universitete të botës arabe, natyrisht që numri i nxënësve të tij është shumë më i madh, por mjaftojnë të përmenden vetëm me këta, ngase pothuajse shumica e dijetarëve aktualë të Egjiptit, e konsiderojnë veten nxënës të Imam Sha'ravit.

[12] https://www.al-qaradawi.net/node/2201

[13] Dr. Firas Meddullah Mexhid, *Esh-Shejh esh-Sha'ravi ve xhuhuduhu el fikrijjeh min hilal kitabihi "Shubuhat ve ebatil husumul Islami ve er-rredu alejha",* Revista *"Samerra'ë"*, botim i Universitetit të Samerrasë, 2018, vëll, 14, nr. 52, ff. 173-175; Shih edhe: *Esh-Shejh esh-Sha'ravi ve hadithu-dh-dhikrajat*, f. 6.

Veprat e shkruara të tij

Imam Sha'ravi është autor i shumë veprave të çmueshme, të cilat në fakt, dashamirët dhe nxënësit e tij i tubuan dhe i botuan në formë librash, gjatë jetës së tij. Paraprakisht, ato që i fliste ai nëpër ligjërata, në radio dhe TV, këta i shkruanin në letër, dhe vetëm pasi ai i redaktonte, e jepte pëlqimin për botim. Librat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës, e disa prej tyre edhe në shqip.

Modestia, thjeshtësia, afërsia dhe, mbi të gjitha dashuria e tij ndaj Librit të Allahut, bëri që veprat e panumërta të tij, të lexohen me ëndje nga shumë islamdashës. Ishte gjithmonë i pranishëm në mjetet Radio-difuzive dhe TV, pastaj në gazeta dhe revista të ndryshme islame në Egjipt dhe pothuajse çdo kund në botën islame. Madje, qasjet e tij ndaj Librit të Allahut, të cilat ai i quajti *"havatir"-"përsiatje-meditime",* u botuan si komentim i Kuranit. Deri më sot janë botuar 25 vëllime të këtij tefsiri madhështor, përfshirë këtu edhe xhuz'in *"Amme"*.

Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi, është autor i mbi 70 veprave, në shkenca të ndryshme fetare, ndër të cilat veçohen:

Në shkencën e tefsirit

1. Havatiri havle-l Kurani-l kerim (24+1) vëllime,
2. El-Muntehab fi tefsiri-l Kurani-l Kerim
3. El-Muhtar mine-t-tefsiri-l Kurani-l Kerim (3 vëllime)
4. Tefsir xhuz'u Amme
5. Suretu-l Kehf
6. Ajetu-l Kursij
7. Tefsir Esmaullahi-l Husna,
8. Advaun ala ismullahi-l A'ëdham
9. Esrar Bismil-lahi Rrahmani Rrahim
10. El-Mer'etu fi-l Kuran
11. Kisasu-l hajvan fi-l Kuran.

Në shkencat kuranore

1. Mu'xhizetu-l Kur'an" (10 vëllime)
2. Nedharat fi-l Kur'an
3. Min fejadi-r-Rrahman
4. Et-Tarik ile-l Kuran.

Në shkencën e Akaidit

1. El-Ba'thu ve-l Mizanu ve-l Xhezau
2. El-Gajbu
3. Meshahid jevmu-l kijame", (5 vëllime)
4. El Hajatu ve-l mevtu
5. Allah ve-n-nefsu-l besherijjeti
6. El-Edil-letu-l maddije ala vuxhudil-lah
7. El Insanu ve shejtanu
8. El-Israë ve-l Mi'raxh
9. El-Hajatu-l berzehije ve adhabul kabri
10. El-Kada ve-l Kadr
11. Nihajetu-l alem
12. El-Hasedu
13. Es-Sihru ve-l hasedu
14.El Hajru ve-sh-sherru
15. Inkaru-sh-shefa'ati
16. Merjem ve-l Mesihu
17. El Islamu ve-l mer'etu - akide ve menhexh
18. Ashabu-l Xhehim
19. Evsaf Ehlu-l Xhenneti
20. El-Insu ve-l Xhinnu
21. Mu'xhizatu-r-Rresul.

Në shkencën e Hadithit

1. El-Ehadith el-kudsijje.

Në shkencën e Historisë dhe të Sires

1. El-Insan el kamil – Muhamedun sal-la Allahu alejhi ve sel-lem
2. Men huve Muhamed
3. El-Hixhretu-n-nebevijje
4. Hafavetu-l muslimine bi miladi sejjidi-l murseline
5. Kisasu-l Enbija'ë
6. Vesaja-r-Rresul.

Në shkencën e Fikhut

1. El-Fetava, (3 vëllime)
2. Mietu sualin ve xhevabin fi-l fikhi-l islami
3. El Mer'etu kema eradeha Allah
4. El-Haxh-xhu-l ekber-ahkam ve esrar
5. El-Haxh-xhu-l mebrur
6. Esh-Shura ve-t-teshriu fi-l Islam
7. Es-Salatu ve erkanu-l Islam
8. Es'iletun harixhe ve exhvibetun sariha
9. Lebbejke Allahumme lebbejk
10. El-Halalu ve-l haramu
11. Ente tes'el ve-l Islamu juxhib
12. El-Hisnu-l hasin
13. Salatu-l hashi'ine
14. El-Xhihadu fi-l Islam
15. Ed-Dua el mustexhab.

Libra me tematika bashkëkohore

1. El Islamu ve-l fikru-l muasir
2. Ala maideti-l fikri-l islami
3. Et-Tarik ila Allah
4. Hadha dinuna
5. El-Islamu hadathe ve hadare
6. Fi terbijjeti-l insanu-l muslimi
7. Hadha huve-l Islam[14]

[14] *Menhexh esh-Sha'ravi fi-t-tefsir*, ff. 67-79.

dhe disa dhjetëra libra të tjerë, që vazhdojnë të botohen edhe pas vdekjes së tij. Shumë prej veprave të tij, janë botuar në dhjetëra gjuhë të botës, ndërsa në gjuhën shqipe, deri më sot janë botuar këto libra: *"Jeta dhe vdekja", "Argumentet lëndore mbi ekzistimin e Zotit", "E mira dhe e keqja", "Njeriu dhe shejtani", "Hallalli dhe Harami", "Israja dhe Miraxhi", "Mrekullia e Kuranit", "Dita e Kiametit"* etj..

Mirënjohjet, çmimet dhe dekoratat

Jeta dhe vepra e këtij dijetari dhe reformatori të madh të mësimeve islame, bëri që ai të vlerësohej lartë nga autoritetet fetare të kohës, nga ato shtetërore të Egjiptit e po ashtu edhe nga ato ndërkombëtare. Për hir të kontributit të tij të madh, atij iu ndanë çmime, mirënjohje dhe dekorata të shumta:

- Kryetari i Egjiptit e dekoroi me *"Medaljen e Meritave"* të Shkallës së Parë, me rastin e pensionimit të tij në vitin 1976.
- *"Dekorata e Republikës"* e Shkallës së Parë iu nda në vitet 1983 dhe 1988, kurse një dekoratë tjetër iu nda po ashtu në vitin 1988 në *Ditën e Thirrësve*.[15]
- Në vitin 1988, u shpall *"Doktor nderi-Honoris Causa"* nga dy Universitete, ai i Menufijes dhe i Mensures.
- Nga Rabita (Lidhja Botërore Islame) me seli në Mekë u zgjodh anëtar i Komisioni për themelimin e Institucionit të Lartë rreth *Mrekullisë shkencore në Kuran dhe Sunet*.
- Në vitin 1989, nga qyteza Dakahlije, në shenjë mirënjohjeje e kujdesi nga vendlindja e tij, u zgjodh personaliteti kryesor i Festivalit kulturor. Me këta rast, komuna e Dakahlijes organizoi edhe gara publike për qytetarët, rreth jetës dhe veprës së Imam Sha'ravit dhe kontributin e tij të kolosal në sferën e Thirrjes islame, duke ndarë shpërblime të ndryshme fituesve.
- Në vitin 1998, Institucioni i Çmimit Ndërkombëtar të Dubait për Kuranin e shenjtë, e zgjodhi personalitet islam të vitit.[16]

---

[15] Abdul Muizz Abdul Hamid el Xhezzar, *Esh-Sha'ravi Imamu-d-duati - muxheddidu hadhe-l karn*, 1998. ff. 25.

[16] El-Id Al-lavi, *Et-Tefkir el-lugavij inde-sh-shejh Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi-dirasetun fi tefsirihi*, pa vend botimi, 2015, f.10.

Vlerësimet e dijetarëve për Imam Sha'ravin

Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi, ishte dijetari më autoritativ në fundshekullin XX, në tërë arealin e botës islame. Vdekja e tij u konsiderua si një humbje e madhe për mbarë ymetin islam. Për veprën dhe kontributin e tij në lëmin e Da'ves dhe të komentimit të Kuranit, dijetarët kanë folur me pietetet më të larta.

Shumë prej tyre shprehën haptazi admirimin për punën dhe përkushtimin e Imam Sha'ravit, sidomos më lëmin e tefsirit. Madje disa, duke u bazuar në thënien profetike se Allahu xh.sh. në çdo njëqind vjet dërgon një njeri-dijetar për t'i ripërtërirë mësimet islame, thanë se Imam Sha'ravi është ai, të cilin Allahu e ka fisnikëruar me këtë nder, për ta lartësuar fjalën e Tij në shekullin XX.

Ja disa prej prononcimeve të dijetarëve dhe figurave më eminente të kohës, në lidhje me të, gjatë jetës dhe pas vdekjes së tij:

Dr. Jusuf el Kardavi: *"Me vdekjen e shejh Sha'ravit, Ymeti islam humbi njërin prej yjeve të udhëzimit në nënqiellin e tij. E humbëm një njeri, i cili tërë jetën ia kushtoi diturisë, duke qenë në shërbim të Kuranit fisnik dhe Islamit. Imam Sha'ravi ka qenë një prej mufessirëve më të mëdhenj të Kuranit fisnik, gjurmët e të cilit do të mbesin gjatë në kujtesën tonë si Ymet..."*

Dr. Muhamed Sejjid Tantavi - Shejhul Az'har: *"Muhamed Mutevel-li Sha'ravi i ofroi fesë, Ymetit islam dhe njerëzimit në përgjithësi, vepra të mira, të cilat do ta bëjnë shembull për thirrësit e tjerë në rrugën e Allahut, me urtësi dhe këshillë të mirë."*

Dr. Ahmed Omer Hashim - Ish rektor i Universitetit të Az'harit: *"Imam Sha'ravi ishte njëri prej dijetarëve më të shquar të Ymetit islam, nëpërmjet të cilëve Allahu e ripërtërinë fenë ë Tij ashtu siç ka thënë edhe i Dërguari i Allahut: "Allahu e dërgon te ky Ymet në krye të çdo 100 vjetëve një dijetar që rifreskon dhe ripërtërin çështjet fetare".*

Dr. Abdus Sabur Shahin: *"Ishte i rrallë në kohën e tij. Fjalët që thuhen për të janë të pafuqishme të shprehin madhështinë e dijes me të cilën Allahu e kishte pajisur. Pozita dhe respekti i tij prej dijetari në zemrat e myslimanëve në Egjipt dhe kudo në botë është shumë e madhe..."*

Shejh Ahmed Keftaro - Myfti i Sirisë: *"Imam Sha'ravi ishte njëri prej yjeve më të shndritshëm të Islamit, i cili dha tërë mundin nga vetja në shërbim të Islamit dhe të Ymetit"*

Shejh Abdulfettah Ebu Guddeh - *"Shejh Sha'ravi, është padyshim një ndër komentuesit më të mëdhenj të Kuranit. Jo secili që e lexon Kuranin, e kupton atë, dhe jo secili që e kupton Kuranin, ka pasur guximin të thellohet në fshehtësitë, për të gjetur margaritarët dhe xhevahiret e tij, dhe jo secili që i ka gjetur këto xhevahire e margaritarë, ka ditur dhe arritur t'i përshkruajë ato me shprehjet e duhura. Ndërsa në dallim nga ata, shejh Sha'ravi ishte prej atyre që iu dhurua të kuptuarit e Kuranit. Allahu ia mundësoi të kuptonte shumë prej fshehtësive dhe njohurive të Kuranit, të cilat diti t'i plasonte tek masa, duke lënë gjurmë të pashlyeshme tek njerëzit me sqarimet e tij."*

Dr. Mahmud Hamdi Zakzuk - ish-Ministër i Vakfit të Egjiptit: *"Shejh Sha'ravi nuk ishte thjesht vetëm një mësues i fesë, që jepte fetva dhe komentonte Kuranin, sepse ka edhe shumë dijetarë që e bëjnë këtë gjë, anekënd botës islame. Ai ishte një dukuri e rrallë në sferën e Thirrjes islame, që vështirë se do të përsëritet më për një kohë të gjatë. Me vdekjen e tij, Ymeti islam humbi njërin prej dijetarëve më të mëdhenj, i cili la gjurmë të pashlyeshme në ngritjen e vetëdijes së shëndoshë islame. Këto gjurmë të tij më së miri vërehen në komentimin e Kuranit, me një metodë të rrallë e tërheqëse, e cila i bashkonte njerëzit nga shtresa të ndryshme kulturore."*[17]

Ahmed Behxhet - Publicist: *"Vdekja e dijetarëve është humbje e madhe njerëzore. Vetëm atëherë njerëzit e ndjejnë se një dritë që deri atëherë ishte e ndezur, tashmë është fikur, dhe shkëlqimi i cili deri atëherë i shndriste, tashmë është venitur. Këto ishin përafërsisht ndjenjat tona me vdekjen e Muhamed Mutevel-li Sha'ravit, Allahu e pastë mëshiruar. Ai u thellua në komentimin e Librit të Allahut, duke iu përkushtuar më tërë qenien vetëm këtij misioni të shenjtë. Afiniteti tij i dhuruar nga Allahu në sqarimin e shkëlqyeshëm të kuptimeve të Kuranit, bëri që zemrat e njerëzve të tubohen rreth këtij dijetari me dashuri e respekt të thellë. Ai i*

[17] *Er-Rravi huve-sh-Sha'ravi - Mudhekkerat Imamu-d-duati,* f. 12.

ngjante një qiriu i cili digjej ngadalë në vete, për të ndriçuar mendjet tona, derisa Allahu nuk e mori në fqinjësinë e Tij."

Dr. Muhamed Amare: - *"Imam Sha'ravi, Allahu e pastë mëshiruar, ishte njëri prej thirrësve më të mëdhenj të Islamit në kohën tonë. Ai kishte dhunti të rralla, me anë të të cilave arriti t'ua përcillte masës së popullit disa fshehtësi të reja nga Kurani fisnik. Ishte një thesar kulturor, dhe me ndihmën e Allahut arriti të kuptonte disa nga fshehtësitë e mrekullisë kuranore, të cilat të tjerët nuk arritën t'i kuptonin."*

Dr. Ahmed Hejkel - ish Ministër i Kulturës: *"S'ka dyshim, se vdekja e Imamit të nderuar Sha'ravit, është humbje e madhe për kulturën, thirrjen dhe botën islame në përgjithësi. Ai ishte simbol madhështor i Islamit, me shpirtdëlirësinë, sjelljen dhe diapazonin e tij në fushën e diturisë, të mendimit dhe thirrjes islame. Të pikëlluar, i drejtojmë lutjet te Allahu, që ta shpërblejë me Xhenet."*

Dr. Abdul Halim Uvejs - Profesor i Historisë Islame: *"Nuk duhet ta humbim shpresën te mëshira e Allahut, i Cili i dhuroi këtij Ymeti, njerëz kaq të mirë e madhështorë si Imam Sha'ravin. Vdekjen e tij e konsiderojmë humbje të madhe, ashtu siç i humbëm në vitet e kaluara dijetarët e tjerë të mëdhenj: Gazaliun, Xhadil Hakun, Halid Muhamed Halidin etj., por kam frikë se kjo është një vërejtje se Dita e Kiametit është afruar, ashtu siç na ka paralajmëruar Pejgamberi a.s., se prej shenjave të kësaj Dite, është vdekja e dijetarëve dhe e njerëzve të mirë, e do të mbesin injorantët dhe disa pseudo-dijetarë, të cilët japin fetva, pa ndonjë dije paraprake, nën presionin e liderëve politikë, dhe feja praktikisht mbetet pa busullën orientuese."*[18]

Dr. Abdullah Shehate, një prej mufessirëve bashkëkohorë, Imam Sha'ravin e përshkroi me këto fjalë. *"Ai ishte shtylla e mufessirëve në shekullin e XX-të. Ai çdo etapë të jetës së tij, e jetoi me Librin e Allahut, duke iu qasur atij me mendime dhe sqarime, sikur të ishte i frymëzuar".*

Ndërsa **Dr. Shevki Dajf**, njëri prej letrarëve më të mëdhenj arabë, po ashtu autor i një tefsiri: *"Et-Tefsiru-l Vexhiz",* rreth Imam Sha'ravit ka thënë: *"Ai, na i ka ndriçuar rrugët e të kuptuarit, mënyrën e të sqaruarit,*

[18] *El-Imam esh-Sha'ravi ve xhuhuduhu fi-d-difai ani-l Islam*, ff. 33-72; Shih edhe: https://www.masress.com/elfagr/39843; https://vb.almstba.com/t139066.html

të logjikuarit dhe të filozofuarit, duke na ofruar edhe më shumë rreth oazës së Kuranit. Madje, kishim përshtypjen, sikur ky Kuran po na zbriste pas 15 shekujsh, pikërisht neve. Ishte një njeri i rrallë dhe i dalluar për nga zgjuarsia, ndërsa thellësia e tij në të kuptuarit e Kuranit ishte e pashoqe. Atij sikur i hapeshin zbulesa shpirtërore gjatë komentimit, derisa debatonte rreth një çështjeje, qoftë me dijetarët e fesë, qoftë me ata të shkencave ekzakte"[19]

Librat e shkruara për Imam Sha'ravin rreth jetës dhe veprës së tij

Për njerëzit dhe dijetarët e mëdhenj që shënuan epokat në të cilat jetuan, janë shkruar e do të shkruhen në vazhdimësi libra e vepra, të cilat sqarojnë shumëçka nga jeta e tyre, po edhe nga mendimet dhe gjurmët intelektuale që lanë pas. E kur bëhet fjalë për dijetarin më të madh që pati bota islame në shekullin XX, Muhamed Mutevel-li Sha'ravin, atëherë është e kuptueshme, që njerëz të profileve të ndryshme, të merren e të shkruajnë për të.

Përveç dijetarëve të mëdhenj që ishin bashkëkohanikë të tij, të cilët shkruan për të, me jetën dhe veprën e shejh Sha'ravit vazhdojnë të merren studiuesit e shumtë anekënd botës islame, sidomos studentët nëpër nivelet master dhe doktoraturë, të cilët me preferencat e profesorëve të tyre, po japin një kontribut të jashtëzakonshëm, në ndriçimin e kësaj figure emblematike të epokës më të re në botën islame.

Ja disa nga titujt e veprave apo hulumtimeve, që në fokus e kanë figurën dhe veprën e dijetarit të madh Imam Sha'ravit:

- Bel'alem Fedile, *El-Menhexh el hixhaxhi fi-l Kuran inde-sh-Sha'ravi,* Algjer, 2014.
- Mahmud Fevzi, *Esh-Shejh esh-Sha'ravi ve fetava el Asr*, Kajro, 1992
- Dr. Firas Meddullah Mexhid, *Esh-Shejh esh-Sha'ravi ve xhuhuduhu el fikrijjeh min hilal kitabihi "Shubuhat ve ebatil husumu-l Islami ve erredu alejha",* Studim i botuar në revistën *"Samerra'ë"*, botim i Universitetit të Samerrasë, 2018.

[19] http://www.alhayat.com/article/694773 مكانة–تفسير–الشعراوي–بين– المفسرين

- Nura bin Shakir esh-Shehri, *Ara'ë esh-Sha'ravi el akaidijeh*, Mekë, 1430 h.
- El-Id Al-lavi, *Et-Tefkir el-lugavij inde-sh-shejh Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi-dirasetun fi tefsirihi*, Pescara, 2015.
- Muhamed Emin et-Tindi, *Advaun ala Havatir esh-shejh esh-Sha'ravi ve menhexhuhu fi tefsiri-l Kuran*, Kajro, 1990.
- Jahja Veziri, *Havatir esh-shejh esh-Sha'ravi, havle imran el-muxhtema'ë el islami*, Kajro, pa vit botimi.
- Ibrahim Hasen el-Eshkar, *Fediletu-sh-shejh Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi-dauni ve rabbi, el ejjamu-l ehire fi hajat esh-Sha'ravi*, Kajro, pa vit botimi.
- Muhamed Kamil Abdu-s-Samed, *Esh-Sha'ravi ve edevatu-l bejan*, Kajro 1998.
- Ferid Ibrahim, *El-Muhtar min tefsir esh-Sha'ravi li-l Kurani-l Adhim,* Kajro 2009.
- Sabir Abdu-d-Daim, *Divan esh-Sha'ravi.* Pa vend dhe vit botimi.
- Revli Muhamed Ahmed, *Menhexh esh-shejh Muhamed esh-Sha'ravi fi tefsiri-l Kuran*, Jordani, pa vit botimi.
- Ibrahim Isa Ibrahim Sajdem, *Menhexh esh-Sha'ravi fi-t-tefsir*, Gaza-Palestinë, 2000.
- Ibrahim Mensur, *Esh-Shejh esh-Sha'ravi ve medhhebihi fi-t-tefsir*, Shibin el Kum, Egjipt, pa vit botimi.
- Umer Ja'kub es-Salihi, *Medresetu-sh-shejh esh-Sha'ravi fi-t-tefsir.* Pa vend dhe vit botimi.
- Umer Rexheb Mahmud, *El-Ilahijatu fi fikri esh-shejh esh-Sha'ravi.* Pa vend dhe vit botimi.
- Muhamed Ahmed et- Tixhani, *Menhexh esh-shejh esh-Sha'ravi fi tefsirihi ve mukarenetuhu bi menahixhi-l mufessirine el muasirine.* Pa vend dhe vit botimi.
- Maxhid Ibrahim Hamdan, *Mevkif esh-shejh esh-Sha'ravi min kadaja el akideti-ardun ve nakdun*, Gaza-Palestinë, 2012.
- Irshadu-l Hakk Bamjani, *Mukavvimat menhexhi-t-tefsir inde-sh-shejh Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi,* Kuala Lumpur, Malajzi, 2013.

- Muhamed el-Baz, *Muhakemetu esh-Sha'ravi- Esh-Sha'ravi, ma lehu ve ma alejhi*, Kajro, 1997.
- Muhamed Zajid, *Mudhekkeratu Imamu-d-duati*, Kajro, 1998.
- Ibrahim Abdul Aziz, *Esh-Sha'ravi fi rihabi-l Ka'beti*. Kajro 1997.
- Muhamed El-Bejjumi, *Muhamed esh-Sha'ravi, xhevletun fi fikrihi el mevsuijj el fesih*, Kajro 1999.
- Seid Ebul Ajnejn, *Esh-Sha'ravi el-ledhi la na'rifuhu*, Kajro 1995
- Me'mun Garib, *El-Imam esh-Sha'ravi ve hakaikul Islam*. Kajro 1990.
- Muhamed Jasin Xhezr, *Muhamed Mutevel-li esh-Sha'ravi alimu asrihi fi ujuni-l muasirihi*, Kajro 1990.
- Ahmed Omer Hashim, *El Imam esh-Sha'ravi mufessiren ve daijen*, Kajro, 1998.
- Muhamed Ibrahim, *Esh-Sha'ravi ve xhuhuduhu fi neshri-th-thekafeti-l islamijeti*, Kajro, 2001.
- Muhamed Mahxhub, *Esh-Sha'ravi mine-l karjeti ile-l alemijjeti*, Kajro, 1990.
- Mahmud Fevzi, *Esh-Sha'ravi mine-l karjeti ile-l kimmeti*, Kajro, 1992.
- Ahmed Mursi, *Esh-Sha'ravi, Imamu-l asr.* Pa vend dhe vit botimi.
- Muhamed Siddik el Menshavi, *Esh-Sha'ravi ve hadithu-dh-dhikrajat*, Kajro 1998.
- Dr. Fatime es-Sahravi, *Esh-Sha'ravi-Mishvar hajati, araun ve efkarun.* Kajro, 1988.
- Sena'ë es-Seid, *Esh-Sha'ravi bejne-s-sijaseti ve-d-din*, Kajro, 1997.
- Ibrahim Abdul Aziz, *Esh Sh'aravi, ed-daijetu-l muxhed-did*, Kajro, 1992.
- Bedevi Taha Bedevi & Abdulmun'im Hafaxhi, *Kalu ani-sh-Sha'ravi ba'de rehilihi*, Kajro, 1999.
- Es-Sejjid el Xhumejli, *Esh-Shejh Sha'ravi hajatuhu ve fikhuhu*, Kajro 1980.[20]

[20] http://majles.alukah.net/t3901-3/

Ka edhe shumë vepra të tjera të shkruara për jetën, veprat dhe metodologjinë e tij në tefsir, apologjetikë, da've dhe fikh, të cilat për shkak të hapësirës së kufizuar, nuk kemi mundësi t'i përmendim, sepse për çdo vit, botohen me dhjetëra libra në lidhje me punën dhe aktivitetin e tij fetar.

- vijon -

Sabri BAJGORA

MUHAMED MUTEVEL-LI ESH-SHA'RAVI AND HIS "HAVATIRI HAVLE-L KURANI-L KERIM" TAFSEER

(Summary)

Throughout history, very few are the people, who have paved the road, which is to be followed by those who want to attain the pleasure of Allah. One of them, is without any doubt, Muhamed Mutevel-li Sha'ravi, a great scholar, who gave a lot to the Islamic Ummah.

The first part of this paper will mainly focus on his life and work as well as his influence on the development of Islamic thought in the XX century. In the second part we will analyze Sharawi's methodology in his well-known "Havatiri havlel Kuranin Kerim" tafseer and his views on many contemporary issues.

Due to the large volume of his works many distinguished contemporary scholars did not hesitate to call him a reviver of Islamic teachings, who is sent to the Islamic Ummah once in every 100 years.

صبري بايغورا

محمد متولي الشعراوي وتفسيره "خواطر حول القرآن الكريم"

(خلاصة البحث)

نادراً ما يكون هناك أشخاص قد تركوا آثارًا مضيئة عبر التاريخ ،التي يتم من خلالها سير الأشخاص الذين يرغبون في تحقيق رضوان الله. وكان أحد هذه الشموع المضيئة بالتأكيد هو العالم الجليل محمد متولي الشعراوي، الذي قدم للأمة الإسلامية الكثير من التأليف في مجال الكلمة المكتوبة.

سيركز الجزء الأول من هذه الورقة بشكل أساسي على حياته وعمله وكذلك تأثير هذا العالم الجليل على تطور الفكر الإسلامي في القرن العشرين. في الجزء الثاني من هذه الورقة سيتم فحص وتحليل منهجية الإمام الشعراوي في كتابه التفسير الشهير "خواطر حول القرآن الكريم" ، وكذلك آراء الشعراوي في العديد من القضايا المعاصرة.

بسبب عمله الكبير في التأليف والإنتاجية المثمرة في مجال الدعوة الإسلامية ، لم يتردد الكثير من كبار العلماء المعاصرين ، في تسمية الإمام الشعراوي مجددا للتعاليم الإسلامية الذي يرسله الله إلى الأمة الإسلامية ، كل ١٠٠ عام.

Ejup HAZIRI

AGJËRIMI DHE DISPOZITAT E TIJ

Abstrakt

Ky punim tenton të sjellë një pasqyrë të shkurtuar rreth agjërimit, duke filluar nga përkufizimi i tij, për të vazhduar me urtësitë e ligjshmërisë së tij, me një analizë rreth ajeteve të agjërimit, në mënyrë që të nxirren urtësitë e secilit ajet, për shkak të përmbajtjes së tyre dhe porosive që sjellin. Punimi ka një përqendrim të theksuar rreth nijetit të agjërimit dhe kohës kur juridikisht është i mundur fillimi i nijetit për agjërim dhe kohës kur nijetit i skadon koha nga aspekti juridik-sheriatik. Gjithashtu, objekt trajtimi në këtë punim do të jenë edhe çështje të tjera të kësaj natyre, në të cilat nuk do të mungojë as shtjellimi për kategoritë e ndryshme që lirohen nga agjërimi, normat e agjërimit, gjërat që e prishin agjërimin etj.

Fjalët kyçe: *Ramazan, agjërim, nijet, syfyr, iftar.*

Përkufizimi i agjërimit

Agjërimi në kuptimin etimologjik nënkupton përmbajtje, abstenim, heqje dorë prej diçkaje, ashtu siç ka ardhur në kaptinën *Merjem,* ku thuhet:

إِنِّي نَذَرْتُ لِلرَّحْمَٰنِ صَوْمًا فَلَنْ أُكَلِّمَ الْيَوْمَ إِنسِيًّا

"Unë kam vendosur heshtje për hir të Gjithëmëshirshmit, andaj asnjë njeriu sot nuk i flas!" *(Merjem, 26).*

Ndërsa në kuptimin terminologjik nënkupton: *"abstenim nga gjërat që e prishin atë, brenda një periudhe të caktuar (nga koha e imsakut e deri në aksham), nga një person i caktuar, duke i paraprirë atij me nijet."*[1]

Ndonëse rreth kuptimit terminologjik të agjërimit jepen përkufizime të ndryshme, e ndër më të spikaturat kohëve të fundit janë ato përkufizime që agjërimin e ndërlidhin me braktisjen e ushqimit, pirjes dhe marrëdhënieve intime, mendoj që përkundër popullaritetit, janë përkufizime që lënë diskrepanca dhe që nuk përkojnë me qëllimin sublim që ka agjërimi, ngase tentativa e përkufizimit të agjërimit në tri elemente thelbësore, e ngushton tej mase konceptin e tij.

Prandaj, qëllimisht kam përzgjedhur përkufizimin e sipërm që përkon me shkollën hanefite, e që është më gjithëpërfshirës dhe më i qartë në vetë qëllimin e konceptit të agjërimit, si adhurim. Si rrjedhojë e kësaj, ky përkufizim nuk lë hapësirë për mëdyshje, ngase nocioni *"gjërat që e prishin"* nuk veçohet me tri sosh, por me tërë ato që e prishin. Përmendja e tri gjërave që në shikim të parë duken gjithëpërfshirëse, ndonëse ato janë kryesore, ia humb konceptin real të agjërimit, sepse agjërimi më i lehtë është braktisja e ushqimit dhe ujit.

"Brenda periudhës së caktuar" është për qëllim koha dhe limiti që përfshin koha nga imsaku e deri në kohën kur fillon namazi i akshamit, ndërsa *"nga një person i caktuar"* është për qëllim i moshërrituri që i përket besimit islam dhe që nuk ka ndonjë pengesë juridike për kryerjen e

[1] Ibën Nuxhejm, Zejnudin ibën Ibrahim ibën Muhamed, *El-Bahru-rr Rraik sherh kenzu-d dekaik*, bot. II-të, Daru-l kitab el-Islamij, Bejrut 1997, v.II, f. 278.

adhurimeve, si fjala vjen jomyslimani, gruaja në të përmuajshmet apo gruaja që është në periudhën e lehonisë.

Kushtëzimi i nijetit bëhet kryesisht për të dalluar adhurimin (ibadetin) nga zakoni-tradita (adeti), ngase ka mundësi që ndokush të ketë bërë shprehi, që në orët e vona të natës të hajë diçka, kështu që kushtëzohet nijeti, për t'u dalluar ibadeti nga adeti.

Vlera dhe dobitë e agjërimit

Agjërimi është një nga shtyllat bazike të Islamit. Islami ngrihet mbi pesë shtylla, e njëra prej tyre është edhe agjërimi. Ai është një adhurim vjetor, për dallim nga shtylla tjetër, namazi, që është adhurim ditor dhe javor. Ndërsa haxhi e përmbyll këtë, ngase konsiderohet adhurim jetësor.

Agjërimi ndikon në përmirësimin e individit dhe e ngrit njeriun në shkallën e devocionit. Për këtë, Allahu i Madhëruar tek ajeti i agjërimit tha:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim, sikur që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." *(El-Bekare, 183).*

Ky është qëllimi primar i Ramazanit, që njëkohësisht llogaritet si revolucion në vete, ngase nëse njeriu agjëron si duhet, ai gjithsesi do të jetë më i mirë se që ishte, më i dobishëm dhe më efektiv.

Agjërimi, i cili çdo vjet përsëritet nga një muaj, në kohë të ndryshme,[2] çdo ditë që nga agimi e deri në mbrëmje e privon njeriun nga shijimet epshore, nga kënaqësia e ushqimit, e pijes dhe e marrëdhënieve intime, e edukon njeriun, e stërvit në devocion, në përkryerjen e adhurimit ndaj Allahut etj. Në një hadith kudsij thuhet: *"Agjërimi është për Mua dhe Unë e jap shpërblimin për të...!"*

Gjatë agjërimit, ne në çdo moment, i frenojmë epshet dhe dëshirat tona, dhe me sjelljen tonë vërtetojmë superioritetin e ligjit të Zotit. Kjo ve-

[2] Për shkak të dallimit në mes muajve lunarë dhe atyre solar. (Sqarim yni E.H)

tëdije mbi obligimin dhe durimin, të cilin agjërimi njëmujor e mbjell në ne, na ndihmon që të forcojmë fenë tonë. Përmbajtja dhe disiplina e ashpër gjatë këtij muaji na vendosin sy më sy me realitetin e jetës dhe na ndihmojnë të bëjmë jetën tonë, një jetë me nënshtrim të sinqertë ndaj dëshirës së Tij edhe gjatë muajve të tjerë.[3]

Agjërimi është një adhurim i cili i pastron ndjenjat e njeriut, e ngritë atë shpirtërisht, e njëkohësisht, është edhe shëndet për organizmin.[4]

Kurani filloi të zbresë pikërisht në këtë muaj, e për këtë Allahu i Madhëruar tha:

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَىٰ وَالْفُرْقَانِ...

"(Ato ditë të numëruara janë) ***Muaji i Ramazanit që në të*** *(filloi të)* ***shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues*** *(i së vërtetës nga gënjeshtra)..." (El-Bekare, 185)*

S'ka dyshim se agjërimi si njëra ndër veprat më të mira që mund ta bëjë robi për Krijuesin e tij, ka një vlerë të jashtëzakonshme. Ai e mbron njeriun nga zjarri i skëterrës, e pastron zemrën dhe shpirtin e tij duke e lartësuar te i Madhërishmi. I Dërguari i Allahut për vlerën e madhe të agjërimit ka thënë: *"Agjërimi është mburojë nga zjarri i xhehenemit... Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, era e agjëruesit është më e këndshme tek Allahu sesa era e miskut (parfumit)..."*[5] Për agjëruesit, do të ketë një shpërblim të dedikuar enkas për ta, sepse në xhenet, do ta kenë edhe hyrjen e veçantë. Në lidhje me këtë i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Me të vërtetë në xhenet është një portë e cila quhet 'Rejjan', në të hyjnë vetëm agjëruesit, e përpos tyre askush nuk mund të hyjë në të. U thuhet: "Ku janë agjëruesit, e ata ngritën, e pos tyre s'mund të hyjë askush, e kur ata të hyjnë, ajo derë mbyllet dhe askush s'mund të hyj më në të."*[6] Ai i

[3] Mevdudi, Ebu-l A'la, *Të kuptuarit e drejt të islamit*, fq.107.

[4] Ebibi, Fahrudin; Bislimi, Taxhedin; Abazi, Irfan; Zimeri, Jusuf, *Pesë shtyllat e fesë Islame*, fq. 43.

[5] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 1761.

[6] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 1763.

cili e agjëron muajin e Ramazanit me bindje të plotë dhe pa hezitim, i falen mëkatet e kaluara. I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Kush agjëron muajin e Ramazanit me bindje të plotë dhe duke llogaritur në shpërblim, atij i falen mëkatet e kaluara."*[7]

Agjërimi është adhurim për hir të Allahut, prej të cilit ka shumë dobi për vetë njeriun:

- Agjërimi qetëson aparatin tretës dhe stomakun nga lodhja e punës së tyre të vazhdueshme, shkrin mbetjet e dëmshme (në aparatin tretës, zorrë etj.) dhe forcon trupin. Ai është po ashtu i dobishëm, sepse shëron shumë sëmundje.
- Agjërimi edukon shpirtin tonë dhe është një mjet i fuqishëm që na çon në veprime të mira dhe na kultivon ndjenjën e ibadetit (të adhurojmë Allahun sinqerisht), të kemi durim (në përballimin e vështirësive) dhe sinqeritet (në sjelljen tonë).
- Agjëruesi ndien barazinë midis vëllezërve të tij agjërues. Kështu agjëron bashkë me ta dhe ha në një kohë me ta. Kupton gjithashtu unitetin e përgjithshëm islamik, e ndien edhe urinë, dhe ua kupton hallet vëllezërve të tij të uritur dhe nevojtarë.

Nga ana tjetër, agjërimi ka ndikim të madh në shoqëri, sepse të gjithë myslimanët, pa marrë parasysh pozitën e tyre, duhet të agjërojnë gjatë të njëjtit muaj. Kjo shpreh bashkimin e vërtetë të njerëzve dhe krijon në ta ndjenjën e thellë të dashurisë dhe vëllazërimit. Gjatë Ramazanit e keqja humbet, kurse e mira vjen në plan të parë dhe e tërë atmosfera është e mbushur me devotshmëri dhe pastërti.[8]

Urtësia e agjërimit

Agjërimi është adhurim diskret mes robit e Zotit dhe si i tillë ngërthen në vete një mori urtësish, të cilat i kanë elaboruar dijetarët myslimanë.

Përveç urtësisë që agjërimi e ka, si një obligim i veçantë dhe adhurim diskret, prapa urdhrit për agjërim fshihet përmbajta e nefsit dhe distanci-

[7] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 1768.

[8] Mevdudi, Ebu-l A'la, *Të kuptuarit e drejt të Islamit*, fq.107.

mi i tij ndaj të këqijave, epsheve dhe të gjitha atyre veprimeve që urrehen nga Zoti. Andaj, nuk është e rastësishme përse tek ajeti i agjërimit, në fund ka ardhur shprehja ***"kështu që të bëheni të devotshëm".*** *(El-Bekare,183).* Pra, agjërimi synon që individi ta përmbajë vetveten dhe të bëhet mburojë ndaj të këqijave. Përndryshe, nëse besimtari synon që të bëjë një shkëputje dhe distancim nga ushqimet e pirjet, atëherë agjërimi i tij mund të jetë i pavlerë, ngase i Dërguari i Allahut tha:

"Ndoshta ndonjë agjërues nuk do të përfitojë asgjë nga agjërimi i tij, përveç urisë, e ndoshta edhe ndonjë namazfalës nuk do të përfitojë asgjë nga qëndrimi në namaz, përveç lodhjes."[9]

Hadithi është indikacioni më i qartë se, nëse përkushtimi dhe përqendrimi maksimal në namaz mungon, atëherë vlera e namazit është në pikëpyetje, gjithashtu nëse agjëruesi largohet vetëm nga ushqimi dhe pirja, por jo nga veprat e këqija e të liga, atëherë agjërimi i tij është në pikëpyetje. Prandaj, është shumë e rëndësishme që agjëruesi t'i braktisë edhe veprat e liga, fjalët e këqija dhe veset e turpshme, ashtu siç e braktisë ushqimin dhe pijen.

Përmes agjërimit synohet dhembshuria ndaj të varfërve dhe ndaj atyre që ndiejnë uri të vazhdueshme. Kjo nënkupton që besimtari e ndien në zemër e në shpirt varfërinë e tjetrit dhe vuan nga gjendja e tij. Kjo ndikon në socializimin e shtresave të ndryshme të shoqërisë dhe në vetëdijesimin e jashtëzakonshëm të masës, ku secili ndien vuajtjen e tjetrit. Në këtë kontekst i Dërguari i Allahut tha:

"Besimtari për besimtarin është sikur një godinë, ku pjesët e saj janë (ngjitur) për ta përforcuar njëra-tjetrën..."[10]

Agjërimi është edukim i vullnetit të njeriut në durim dhe në ballafaqim me mundimet, është edukatë e të ndierit dhembjet e tjetrit dhe përpjekje për barazi. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut këtë muaj e ka quajtur 'Muaji i durimit' dhe 'Muaji i barazisë.'[11]

[9] Ebu Davudi në Sunen, v.I, f.539, nr. i hadithit 1690.

[10] Ahmedi në Musned, v.32, f.399, nr. i hadithit 19624.

[11] Ibën Maxheh në Sunen, nr. i hadithit 1731.

AJETET E AGJËRIMIT

Në kaptinën "El-Bekare", në lidhje me agjërimin janë pesë ajete që flasin për të, njëri pas tjetrit (kam fjalën në renditje, sepse ajete për agjërimin ka edhe më tepër). Po që se studiohen mirë, atëherë del në pah një element tepër i rëndësishëm, që mund të quhet mrekulli në vete. Ai i cili i shqyrton mirë këto ajete, njërin prej tjetrit, lehtë mund të vjen në përfundim se këto ajete shpërfaqin këto segmente:

Ajeti i parë: Platforma e agjërimit

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikur që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." *(El-Bekare, 183).*

Në këtë ajet, Allahu shfaq platformën e agjërimit në tre hapa: 1. dedikimi (besimtarëve); 2. kontinuiteti dhe kronologjia e agjërimit (thuajse te të gjithë popujt); dhe 3. synimi i agjërimit (devotshmëria-kalimi në një stad më të mirë dhe më të kënaqshëm, gjegjësisht ndryshimi i vetvetes).

Ajeti i dytë: Toleranca

أَيَّامًا مَّعْدُودَاتٍ ۚ فَمَن كَانَ مِنكُم مَّرِيضًا أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِّنْ أَيَّامٍ أُخَرَ ۚ وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ ۖ فَمَن تَطَوَّعَ خَيْرًا فَهُوَ خَيْرٌ لَّهُ ۚ وَأَن تَصُومُوا خَيْرٌ لَّكُمْ ۖ إِن كُنتُمْ تَعْلَمُونَ

"(jeni të obliguar për) ***Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim*** *(e nuk agjëroi),* ***atëherë ai*** *(le të agjërojë)* ***më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai*** *(nuk mund të agjërojnë),* ***janë të obliguar për kompensim, ushqim*** *(ditor),* ***i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është më mirë për të. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju."*** *(El-Bekare, 184).*

Në këtë ajet, Allahu shfaq mëshirën e Tij që përfshinë çdo gjë, duke dëftuar se bëhet fjalë vetëm për disa ditë të caktuara dhe për (disa nga)

grupet e liruara nga agjërimi. Me fjalë të tjera, ky ajet shpërfaq tolerancën dhe madhështinë e agjërimit.

Ajeti i tretë: Privilegjet

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَىٰ وَالْفُرْقَانِ ۚ فَمَن شَهِدَ مِنكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ ۖ وَمَن كَانَ مَرِيضًا أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِّنْ أَيَّامٍ أُخَرَ ۗ يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمُ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمُ الْعُسْرَ وَلِتُكْمِلُوا الْعِدَّةَ وَلِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَاكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

"(ato ditë të numëruara janë) ***Muaji i Ramazanit që në të*** *(filloi të)* ***shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues*** *(i së vërtetës nga gënjeshtra).* ***E kush prej jush e arrin këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju.*** *(të agjëroni ditët e lëshuara më vonë)* ***Që të plotësoni numrin, të madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni."*** *(El-Bekare, 185).*

Ky ajet flet për mirësitë dhe privilegjet e mëdha të agjërimit, andaj shtrohet pyetja: a mund të ketë privilegj më të madh se ta përjetosh me zemër, trup dhe shpirt, takimin mes qiellit dhe tokës, ngjarje që ndodhi pikërisht në këtë muaj të Ramazanit, me zbritjen e Kuranit, ku shkëndijat hyjnore nga qielli larguan errësirën e kufrit në tokë?!

Ajeti i katërt: Rezultati

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ ۖ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ ۖ فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ

"E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua." *(El-Bekare, 186).*

Përmes këtij ajeti tregohet se lutja e robit është e pranuar dhe se Zoti është përherë afër robit të Vet. Ai është në gjendje që përherë t'i përgjigjet robit të Tij. A thua, si mund të ndihet robi i anashkaluar, përderisa qëndron pranë portës së Tij? Si mund të jetë i vetmuar, gjersa shoqërohet me fjalët e Tij? Ndonëse ky ajet në mënyrë decidive nuk flet për agjërimin, ai ka hyrë në mes të ajeteve të agjërimit dhe tërthorazi ndërlidhet me agjërimin si adhurim diskret, ashtu siç është edhe lutja.

Ajeti i pestë: Normativat

أُحِلَّ لَكُمْ لَيْلَةَ الصِّيَامِ الرَّفَثُ إِلَىٰ نِسَائِكُمْ ۚ هُنَّ لِبَاسٌ لَّكُمْ وَأَنتُمْ لِبَاسٌ لَّهُنَّ ۗ عَلِمَ اللَّهُ أَنَّكُمْ كُنتُمْ تَخْتَانُونَ أَنفُسَكُمْ فَتَابَ عَلَيْكُمْ وَعَفَا عَنكُمْ ۖ فَالْآنَ بَاشِرُوهُنَّ وَابْتَغُوا مَا كَتَبَ اللَّهُ لَكُمْ ۚ وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَكُمُ الْخَيْطُ الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ الْأَسْوَدِ مِنَ الْفَجْرِ ۖ ثُمَّ أَتِمُّوا الصِّيَامَ إِلَى اللَّيْلِ ۚ وَلَا تُبَاشِرُوهُنَّ وَأَنتُمْ عَاكِفُونَ فِي الْمَسَاجِدِ ۗ تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ فَلَا تَقْرَبُوهَا ۗ كَذَٰلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ آيَاتِهِ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ

"Natën e agjërimit u është lejuar afrimi të gratë tuaja, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato. Allahu e di se ju e keni mashtruar vetveten, andaj ua pranoi pendimin tuaj dhe ua fali gabimin. Tash e tutje bashkohuni me to dhe kërkoni atë që ua ka caktuar Allahu dhe hani e pinin derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje. E kur jeni të izoluar *(në itikaf)* ***në xhamia, mos t'u afroheni atyre*** *(për marrëdhënie intime).* ***Këto janë dispozitat e Allahut, pra mos i kundërshtoni. Ja kështu, në këtë mënyrë Allahu ua sqaron njerëzve argumentet e veta që ata të ruhen."*** *(El-Bekare, 187).*

Ky ajet flet për rregulla, dispozita dhe norma, dhe natyrshëm ato vijnë krejtësisht në fund, pasi që të jenë arritur hapat tjerë. Jo rastësisht, në këtë rast, por edhe në rastet e tjera, normat, gjithnjë kanë ardhur në fund, në dallim nga e tashmja, kur njerëzit së pari vendosin normat, e pastaj elementet tjera shpeshherë mbesin të pa kuptimta. Kjo tregon se predikimi

nuk po bëhet nga hapat e parë, por është filluar nga fundi, prandaj është vështirë të presim rezultate pozitive.

Dispozita të ndryshme rreth agjërimit

Agjërimi si adhurim diskret ka rregulla, dispozita dhe norma të caktuara, të cilat një pjesë e masës nuk i njohin e as nuk kanë njohuri të mjaftueshme rreth tyre, andaj e shoh të arsyeshme që t'i shpjegoj disa prej tyre.

Nijeti të bëhet gjatë natës

Meqë muaji i Ramazanit është një adhurim i veçantë dhe shumë i rëndësishëm, është me rëndësi që nijeti të bëhet patjetër. Juristët kur flasin për agjërimin, shprehen se ai patjetër duhet të shoqërohet me nijet, ngase veprat llogariten në bazë të nijetit, respektivisht qëllimit të njeriut. Në këtë kontekst i Dërguari i Allahut kishte thënë:

"Veprat shpërblehen sipas qëllimeve, e secilit njeri i takon ajo që ka pasur për qëllim (që e ka synuar)..."[12]

Andaj për t'u dalluar adeti nga ibadeti, gjegjësisht shprehia nga adhurimi, është kushtëzuar nijeti, ngase siç shprehet edhe autori i *"Bahru-rr Rraik-it"*, ka disa njerëz që ia kanë bërë vetes shprehi të hanë gjatë natës, e kjo shprehi tek ata është e vazhdueshme, prandaj nijeti është ai që bën dallimin në vepër, qëllim dhe shpërblim.[13]

Nga kjo rezulton se agjërimi duhet të shoqërohet me nijet dhe kjo është e kushtëzuar, mirëpo dikush mund të shtrojë pyetjen: "Po nijeti kur duhet të bëhet?"

Ulemaja e shkollës hanefite kur e trajtojnë çështjen e nijetit të Ramazanit, e shpjegojnë detajisht se nijeti duhet të bëhet gjatë natës dhe kjo është çështje e unifikuar mes dijetarëve brenda shkollës sonë. Mirëpo, cila është ajo pjesë e natës dhe kur është koha kur mund të bëhet nijeti?

---

[12] Buhari në Sahih, v.I, f.6, numri i hadithit 1.

[13] Ibën Nuxhejm, *El-Bahru-rr Rraik sherh kenzu-d dekaik*, v.II, f.279.

Koha e natës fillon nga koha e akshamit e mbaron me lindjen e diellit, andaj nijeti për agjërimin e ditës së Ramazanit lejohet të bëhet pas kohës së akshamit, e jo assesi para kohës së akshamit, madje nuk lejohet as në kohën kur dielli është duke perënduar, sepse llogaritet nijet para kohe. Pra, namazi i akshamit, është koha përcaktuese që e bën të lejuar nijetin për agjërim.

E nëse akshami është vija përcaktuese dhe nga aty fillon lejimi i vendosjes së qëllimit për agjërim, atëherë domosdo lind pyetja tjetër: "Deri kur mund të bëhet nijet?" apo: "Kur përfundon koha e nijetit për agjërimin e ditës së nesërme?

Koha më e vlefshme dhe ajo që rekomandohet gjatë muajit të Ramazanit është që nijeti për agjërim të bëhet gjatë natës, respektivisht deri në kohën e namazit të sabahut, mirëpo për shkaqe të ndryshme dhe duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme që mund të shfaqen, ulemaja e kanë lejuar që deri në kohën e zenitit ka mundësi të bëhet nijeti për agjërim, por jo edhe më vonë. Me fjalë tjera, zeniti nënkupton kur dielli arrin në pikën më të lartë në kupën qiellore, e që është koha para namazit të drekës.

Përfundimisht, koha kur lejohet të bëhet nijeti për agjërim, fillon nga koha e namazit të akshamit e mbaron para namazit të drekës. Me hyrjen e namazit të drekës, edhe praktikisht nijeti konsiderohet i pavlefshëm. Mirëpo, ajo që rekomandohet dhe pëlqehet është që nijeti të bëhet gjatë natës, e jo pas namazit të sabahut. Mirëpo, kur merren shkaqet e ndryshme, si harresa e disa elemente tjera, atëherë agjëruesit i jepet edhe një mundësi më e gjerë sa i përket nijetit, e që zgjatet deri në kohën e zenitit, respektivisht koha pak para namazit të drekës.

E nëse harrohet tërësisht dhe agjëruesit nuk i kujtohet që nuk e ka bërë nijet, ose i kujtohet pasi të ketë kaluar dita e agjërimit, agjërimi i tij është në rregull, sepse qëllimi i tij nuk ka qenë të vazhdojë agjërimin pa nijet, por nijeti i ka munguar si pasojë e harresës.

Një dukuri jo e mirë që haset në shoqëri është edhe ajo që disa zgjohen në syfyr, mirëpo nuk e bëjnë nijet, me arsyetimin se ndoshta s'mund ta agjërojmë, e presin pasditen që nëse deri atëherë nuk kanë pengesa, atëherë e vazhdojnë agjërimin, por nëse kanë pengesa, e prishin. Faktiki-

sht, një gjë e tillë nuk lejohet. Nijeti duhet bërë, ngase nijeti shpërfaqë vendosmërinë dhe vullnetin për vazhdimin e adhurimit në fjalë, e mos shprehja e nijetit, dobëson vendosmërinë dhe rritë luhatshmërinë për prishjen e agjërimit.

Nëse agjërimi është vullnetar, por jo obligativ, siç është muaji i Ramazanit, atëherë nijeti për të mund të bëhet edhe më vonë, duke u bazuar në hadithet kur i Dërguari i Allahut pyeste në shtëpinë e tij se a ka diçka për të ngrënë, e kur atij i thoshin se nuk ka asgjë, atëherë i Dërguari i Allahut thoshte: *"Atëherë unë po agjëroj!"*[14]

Si të bëhet nijeti?

Nijeti për agjërim mjafton të bëhet me zemër, mirëpo nëse shprehet edhe me gjuhë, nuk ka asgjë të keqe. Madje, ka dijetarë që thonë se vetë zgjimi në syfyr, është një lloj nijeti, pa marr parasysh a shprehet me gojë apo jo. Autori i "Dhahirijeh" e mbron këtë mendim, sepse zgjimi gjatë kohës së përcaktuar gjatë Ramazanit, është indikacioni më i qartë se ai është zgjuar për agjërim. Sidoqoftë, nijeti me zemër apo me gjuhë është i domosdoshëm, për shkak të specifikave të veçanta që ka nijeti (qëllimi) në adhurimet e kërkuara. Sem'ani kur flet për nijetin, thotë: "Veprat, të cilat nuk konsiderohen adhurime (ibadete), nuk mund të kenë shpërblim përveç nëse kryesi i tyre e bën nijet afrimin tek Allahu me to."

A mjafton një nijet për tërë Ramazanin?

Thamë më parë se nijeti për agjërimin e Ramazanit është i kushtëzuar dhe duhet të aplikohet gjatë agjërimit. Por, ulemaja kanë debatuar nëse duhet bërë nijet çdo ditë apo mjafton një nijet për tërë muajin e Ramazanit?

Opinioni zyrtar i shkollës hanefite parasheh që, për secilën ditë të Ramazanit të bëhet nijet, e jo vetëm një herë të vetme gjatë atij muaji, ndonëse edhe brenda shkollës hanefite ka mendime se mjafton një nijet i

[14] Ebu Ja'la el-Mevsilij në Musned, v.VIII, f.46, nr. 4563.

vetëm, siç është Zuferi,[15] por zyrtare mbetet qëndrimi i shumicës së dijetarëve që parashohin nijet për çdo ditë të muajit të Ramazanit. Mendimi i Zuferit është i njëjtë me mendimin e Malikut, i cili mendon se mjafton të bëhet një nijet në fillim, dhe nuk ka nevojë për përsëritje, ndonëse përsëritja e nijetit edhe tek ta është më e rekomanduar.

Ibën Abidini kur flet për këtë çështje, shtjellon në detaje se Ebu Hanife dhe dy nxënësit e tij më të spikatur, mendojnë se nijeti për agjërimin e ditëve të Ramazanit duhet të përsëritet çdo ditë, e jo vetëm një herë.[16]

Kush lirohet nga agjërimi?

Ndonëse Allahu i Madhëruar e obligoi agjërimin e muajit të Ramazanit për mbarë myslimanët, megjithatë, ai liroi disa kategori prej tyre, si shenjë e mirësisë dhe mëshirës së Tij. Prej kategorive që lejohen të mos agjërojnë janë:

I sëmuri- kjo kategori është e lejuar nga agjërimi, por jo secili që është i sëmurë ka të drejtë të mos agjërojë. Në jurisprudencën islame sëmundja është e definuar kështu: "Çdo sëmundje që e dëmton personin që agjëron, apo ekziston frika se agjërimi ndikon në rritjen e sëmundjes apo edhe në vdekjen e personit, atëherë i lejohet të mos agjërojë. Ndërsa për sëmundjet e lehta, të cilat nuk paraqesin ndonjë vështirësi të madhe nëse agjërohet, nuk ka ndonjë lejim për mos-agjërim."[17]

Ditët e lëna nga i sëmuri, i cili shpreson të shërohet, kompensohen më vonë. Allahu i Madhëruar thotë:

أَيَّامًا مَّعْدُودَاتٍ ۚ فَمَن كَانَ مِنكُم مَّرِيضًا أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِّنْ أَيَّامٍ أُخَرَ

"(jeni të obliguar për) ***Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim*** *(e nuk agjëroi),* ***atëherë ai*** *(le të agjërojë)* ***më vonë aq ditë..."*** *(El-Bekare, 184).*

---

[15] Ibën Abidin, *Reddul muhtar ale-d durril muhtar*. Bot.II-të, Daru-l Fikr, Bejrut. 1992, v.II, f.379.

[16] Po aty, v.II, f.380.

[17] Bedrudin el-Ajni, *El-Benajeh Sherhu-l Hidajeh*, bot.I-rë, daru-l kutub el-Ilmijeh. Bejrut-Liban, 2000, v.IV, f.76.

Udhëtari (mysafiri) - kjo është kategoria tjetër të cilit i lejohet prishja e agjërimit. Megjithatë, udhëtimi i lehtë i cili nuk ndikon në lodhjen e individit, (sidomos në kohën tonë udhëtimet me aeroplan brenda dy orëve) nuk kanë ndonjë vështirësi të madhe, ulemaja kanë debatuar nëse është më mirë të agjërohet apo të mos agjërohet?

Sipas dijetarëve të shkollës hanefite, agjërimi në kësi lloj udhëtimi, përkundër lejimit për mos agjërim, është më i mirë dhe më i dobishëm. E nëse udhëtimi sjell vështirësi, atëherë mos agjërimi është më primar dhe më i arsyeshëm. Edhe Shafiu në njërin prej opinioneve të tij, ka të njëjtin mendim, ndërsa Ahmedi thotë se nuk është mirë të agjërohet gjatë udhëtimit.[18]

Gruaja në të përmuajshmet- kategoria tjetër që lirohet nga agjërimi janë femrat gjatë ciklit të tyre menstrual, të përmuajshëm. Atyre assesi nuk u lejohet të agjërojnë, ndërsa pas muajit të Ramazanit ato kompensojnë po aq ditë sa kanë humbur nga Ramazani.

Gruaja pas lindjes- kjo është kategoria tjetër që u lejohet mos agjërimi, si mëshirë për to dhe për gjendjen e tyre.

Gruaja që është shtatzënë- Islami ua ka lejuar grave që janë shtatzëna, të mos agjërojnë, po ashtu në shenjë mëshire për gjendjen e tyre. Mirëpo, nëse shtatzënia është e lehtë, dhe nuk ka ndonjë komplikim, atëherë ato mund të agjërojnë. Nëse agjërimi nuk u sjell ndonjë vështirësi apo telashe, është më mirë për to të agjërojnë. Mirëpo, nëse agjërimi sjell komplikime apo vështirësi në shtatzëninë e tyre, atëherë e kanë të ndaluar agjërimin.

Gjidhënësja- Në parim, gratë që kanë fëmijët për gjiri, janë të liruara nga agjërimi, mirëpo këtu duhet të kihen parasysh dy gjëra. E para: Nëse agjërimi nuk ndikon fare në shëndetin e saj dhe nuk ka frikë për fëmijën e saj, atëherë i obligohet të agjërojë. E dyta: Nëse ajo ka frikë për veten e saj dhe për fëmijën e saj, atëherë mos-agjërimi është më i arsyeshëm dhe më primar.

[18] Bedrudin el-Ajni, *El-Benajeh Sherhu-l Hidajeh*, v.IV, f.77-78.

Gjërat që e prishin agjërimin

Ushqimi dhe pirja e qëllimshme e prishin agjërimin, ndërsa nëse agjëruesi ha ose pi nga harresa, atëherë ai nuk ka nevojë për kompensimin e asaj dite. E nëse ha ose pi pa e ditur se është agjërueshëm, por gjatë ngrënies apo pirjes i kujtohet se është agjërueshëm, duhet ta ndërpresë menjëherë, e nëse ka ushqim në gojën e tij, duhet ta braktisë atë menjëherë, dhe në këta rast nuk ka nevojë që ajo ditë të kompensohet me agjërimin e një dite tjetër.

I Dërguari i Allahut tha:

"Ai i cili ha apo pi nga harresa dhe është duke agjëruar, të mos e prish agjërimin e tij, ngase ajo që ka ngrënë apo pirë, është furnizim me të cilin e ka furnizuar Allahu."[19]

Duhet pasur parasysh, që nëse pjesët e ushqimit që mbesin brenda dhëmbëve apo në fyt depërtojnë brenda, atëherë agjërimi prishet, me përjashtim kur ato janë thërrmija shumë të vogla. Gjithashtu edhe pikat e veshit dhe hundës e prishin agjërimin, ndërsa pikat e syrit, nuk e prishin.

Agjërimi prishet edhe kur një person kryen marrëdhënie seksuale gjatë ditës së Ramazanit apo masturbon. Ndërsa puthja, nuk e prish agjërimin, por megjithatë, ulemaja kanë sugjeruar që të evitohet edhe ajo gjatë ditëve të agjërimit, me theks të veçantë për moshën e re.

Vjellja e qëllimshme e prish agjërimin ashtu siç e prish atë edhe vjellja e paqëllimshme, por që është vjellje e madhe. Ebu Jusufi në këtë kontekst thoshte: "Nëse të vjellët është në sasi të madhe (pa qëllimshëm) sa tërë goja, atëherë agjërimi prishet."[20] E për atë ditë e agjëron një ditë më vonë, si plotësim apo zëvendësim.

[19] Tirmidhiu në Sunen. V.III, f.91, numri i hadithit 721.

[20] El-Haxheh Nexhah el-Halebij, Fikhu-l ibadat ala medhhebi-l hanefij, v.I, f.129.

Institucioni fetar dhe agjërimi

Institucioni fetar është përgjegjës kryesor për çështjet që ndërlidhen me myslimanët. Personat përgjegjës brenda këtij institucioni, janë përgjegjësit kryesorë për të gjitha gjërat që janë në interesin e besimtarit. Çështjet madhore si kjo e Ramazanit, Bajramit, haxhit dhe të tjera, Zoti nuk ua la përgjegjësinë e tyre secilit njeri, por i ngarkoi zotët e dijes dhe përgjegjësit. Masa e gjerë duhet t'i pasojë udhëheqësit e tyre dhe njerëzit kompetentë, e jo në çështje të tilla, secili të japë opinion në vete, e pastaj të bëhet katrahurë e vërtetë. Zakonisht, në çdo fillim të Ramazanit dhe në mbarim të tij, bëhet zhurmë nga disa njerëz, duke krijuar polarizime të panevojshme në mesin e shoqërisë sonë. Ata të cilët fillojnë agjërimin sipas njoftimit të institucionit që i përfaqëson dhe që është kompetent për ta dhe pjesës tjetër që e injoron plotësisht dhe e shpërfill autoritetin fetar.

Çudia më e madhe në këtë çështje është se, ata shpërfillin një institucion të tërë për të pasuar një individ apo një grupacion. E për të qenë kjo situatë edhe më e çuditshme dhe më qesharake, ata injorojnë institucionin fetar që është kompetent në vendin e tyre, dhe pasojnë një dijetar apo një institucion nga një vend tjetër. Këta nuk kanë ndonjë përgatitje fetare, e as që janë njohës të këtyre çështjeve fetare të sferës së fikhut. "Në emër të sunetit", është motoja e tyre, me të cilën e kundërshtojnë pjesën dërmuese. Në emër të sunetit, por në realitet as që e kuptojnë sunetin. Të tillët injorojnë pjesën më të madhe të literaturës islame, madje edhe e djegin atë në emër të luftimit të "bidatit" dhe "të keqes". Le ta ilustrojmë këtë konstatim me një shembull praktik: Në Ramazanet e viteve të fundit, Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, si zakonisht kishte paraparë që muaji i Ramazanit të fillojë me filan datën... Një grup personash të caktuar, për çdo vit me radhë, shpërndanin mesazhe që të mos fillohet me agjërim, gjithnjë në emër të sunetit, ngase në Arabinë Saudite *"X"* dijetari, ka konfirmuar se ende nuk është parë hëna atje. Mund të paramendoni një situatë të tillë, ku shpërfillet institucioni më i lartë islam në vend, ndërkohë që merret për bazë një individ apo një grup njerëzish dhe pasohen ata, përkundër që distanca mes neve dhe atyre është mijëra kilometra dhe po ashtu ne jetojmë në një kontinent tjetër, e ata në një kontinent tjetër. Shto kësaj se mundësia e pamjes së hënës është një çështje jo e lehtë,

pasi që hëna e re fillon të shfaqet përafërsisht 4 orë para namazit të akshamit, sipas kohës së Mekës. Problemi tjetër është se hëna e re gjatë ditës-natës së parë mund të shihet vetëm dy minuta, jo më gjatë se kaq, prandaj kjo çështje në esencë është mjaft komplekse.

Në kohën e Omerit r.a., një njeri erdhi tek ai dhe i tha: "E pash hënën!" Askush përveç tij nuk kishte thënë se e ka parë hënën. Omeri urdhëroi që t'i lahen sytë me ujë, e më pas i tha: "Ku është hëna?" Njeriu shikoi dhe kur nuk pa asgjë, tha: "E humba atë. Nuk po e shoh!" Omeri r.a. ia ktheu: "Një qime të kishte rënë mes vetullave dhe syrit, e ti mendove se ishte hënë!"[21]

Dëshmia e pamjes së hënës mes kohës së lavdishme dhe dekadencës

I Dërguari i Allahut në një hadith tha:

"Agjëroni kur ta shihni hënën dhe ndërpriteni agjërimin kur ta shihni përsëri. Në rast të pamundësisë së pamjes së saj, atëherë plotësoni tridhjetë ditë nga muaji Shaban."[22]

Ky hadith është bazë për fillimin e muajit të Ramazanit dhe përfundimit të tij, atëherë kur hëna shihet nga një individ apo nga disa besimtarë, të cilët shquhen për besueshmëri. Kështu ishte në kohën e të Dërguarit të Allahut, me ç 'rast pranohej dëshmia e të besueshmit.

Përfundim

Në këtë punim, u përpoqëm që sado pak të hedhim dritë mbi vlerën dhe rëndësinë që ka agjërimi, si adhurim diskret mes robit dhe Zotit. Agjërimi ka disa rregulla dhe norma të veçanta, por mbi të gjitha, ai është një adhurim, i cili njeriun e ngre në lartësitë dhe çiltërsisë e paimagjinueshme shpirtërore.

Punimi mëton të merret edhe me një dukuri shoqërore, tejet negative, që disa të rinj, të pashkolluar e pa kualifikim fetar, kanë marrë mbi supet

[21] Ibën Abidin, *Reddul muhtar ale-d durril muhtar*, v.II, f.385.

[22] Buhariu në Sahih. V.III, f.27, nr.1909.

e tyre drejtimin (lexo: devijimin) e masës, me direktiva nga vendet e tjera duke bërë propagandë që vjen në kundërshtim me thirrjet e institucionit fetar të vendit tonë.

Literatura e shfrytëzuar:

- Ibn Nuxhejm, Zejnudin ibn Ibrahim ibn Muhamed, *El-Bahru-rr Rraik sherh kenzu-d dekaik*, Bejrut, 1997.
- Ebu-l A'la el Mevdudi, *Të kuptuarit e drejt të Islamit*, , Logos-A, Shkup, 1999-1420.
- Fahrudin Ebibi; Taxhedin Bislimi; Irfan Abazi, Jusuf Zimeri, *Pesë shtyllat e fesë Islame*, Shkup, 2003.
- Buhari, Muhamed ibën Ismail. *Sahihu-l Buhari*. recenzent: Muhamed Zuhejr ibën Nasr. Dar Tavku Nexhat. Bot.I-rë, Damask, 1422h.
-Ebu Davud, Sulejman ibën el-Eshath, *Sunen,* recenzent: Muhamed Muhjidin Abdulhamid, Bejrut, el-Mektebeh el-Asrijeh, Bejrut, 2010.
- *Musnedi* i Imam Ahmedit, Rijad, 2013.
- Ibën Maxheh, Ebu Abdullah Muhamed ibën Jezid, *Sunen,* recenzent: Shuajb Arnauti. Bot.I-rë, Dar err-Rrisaleh el-Alemijeh, Bejrut, 2009.
- Tirmidhi, Muhamed ibën Isa ibën Sevreh, *Sunen,* recenzent: Ahmed Muhamed Shakir. Bot.II-të, Matbeatu Mustafa el-Halebij, Egjipt, 1975.
- Ebu Ja'la, Ahmed ibën Alij ibën elMuthna, *Musned,* recenzent: Husejn Selim Esed. Bot.I-rë, darul Me'mun lit-turath, Damask, 1984.
- Ibën Abidin, *Reddul muhtar ale-d durril muhtar,* Bejrut. 1992.
- Bedrudin el-Ajni, *El-Benajeh Sherhu-l Hidajeh*, Bejrut-Liban, 2000.
- El-Haxheh Nexhah el-Halebij, *Fikhu-l ibadat ala medhhebi-l hanefij*, pa vend dhe vit botimi.

Ejup HAZIRI

FASTING AND ITS PROVISIONS

(Summary)

The aim of this paper is to discuss in brief the practice of fasting, its definition, and the rules of fasting, through an analysis of the ayats of the Qur'an, respectively, an analysis of their content and the messages they carry.

The paper focuses on the issue of the niyyat to fast, the last time for making niyyat to observe a fast or break it (from the legal aspects of the Shariah). Furthermore, this paper will deal with the categories exempted from fasting, the norms of fasting, things that break the fast, etc.

أيوب حزيري

الصيام وأحكامه

(خلاصة البحث)

يحاول هذا البحث تقديم نظرة عامة مختصرة عن الصيام ، بدءًا من تعريفه ، حكمة شرعيته ، مع تحليل وتفسير لآيات الصيام ، من أجل استخراج الحكم في كل آية، بالنظر إلى محتواها والرسائل التي توجهها تلك الآيات.

تركز الورقة بشكل واضح على نية الصوم وبداية وقت الصيام و وقت انتهائه من الناحية الشرعية. كما يتناول البحث قضايا وأحكام أخرى يتم معالجتها حول الصيام مثل: المرخص لهم الإفطار، أحكام الصيام المختلفة، مفسدات الصيام والخ.

Ramadan SHKODRA

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE - (II)

Gjendja politike-shoqërore në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore

Pas Luftës së Dytë Botërore, rrjedha objektive e ngjarjeve që çonte drejt zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës u ndërpre. Popullsia shqiptare e Kosovës u përball me presionet, mashtrimet dhe dhunën e udhëheqësve komunistë jugosllavë, sidomos të atyre serbë. Deklaratat e tyre premtuese për vetëvendosjen e popullit shqiptar pas luftës, u harruan. Derisa brigadat partizane shqiptaro-kosovare marshonin drejt veriut dhe luftonin përkrah popujve jugosllavë për çlirimin e plotë të Jugosllavisë, ndërkohë mbi popullsinë shqiptare në Kosovë. Maqedoni e Mal të Zi, u ushtrua një shtypje e egër, ku pati arrestime, terror e persekutime të shqiptarëve (kujtojmë këtu plojën e Tivarit, Luftën e Drenicës, masakrën e Gjilanit etj.), u ndalua përdorimi i flamurit kombëtar, nëpunësit shqiptarë u pushuan nga puna dhe u zëvendësuan me ata serbë etj.

Goditjet që u ndërmorën mbi popullsinë shqiptare menjëherë pas luftës dhe gjatë Administratës Ushtarake, ishin në përputhje me elaboratin e Vasa Çubrilloviqit - "Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re", dërguar

qeverisë së re jugosllave ende pa mbaruar lufta, më 3 nëntor të vitit 1944.[1]

Padrejtësitë që iu bënë popullit shqiptar në ish-Jugosllavi, i rëndonte edhe më tepër copëtimi i trevave në të cilat shqiptarët ishin popullatë e vetme, apo shumicë dërrmuese në tri republika jugosllave: në Republikën e Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi.

Përballë gjithë këtyre, popullata shqiptare nuk qëndroi duarkryq, por ajo u organizua kundër ri okupimit të Kosovës nga Serbia, përkatësisht Jugosllavia. Pas shtypjes së revoltave masive popullore nga ana e pushtetit komunist, qëndresa kundër pushtetit jugosllav vazhdoi në rrugë ilegale. U krijuan disa organizata të fshehta. Më e rëndësishmja ndër to ishte Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare (NDSH).

Viti 1945, për popullin shqiptar do të kujtohet si viti më i përgjakshëm në historinë e Kosovës, sepse do të pushkatoheshin disa dhjetëra mijëra veta; shumë të tjerë do të zhdukeshin pa gjurmë; mbi 30 mijë do të futen në burgje dhe do të vendoseshin në kampe; kurse qindra-mijëra të tjerë, do të shtrëngoheshin të merrnin marrin rrugët e ekzodit nëpër botë (në Turqi, Greqi, SHBA, e vende të tjera); e shumë të tjerë do të vriten jashtë Kosovës. Të gjitha këto do të bëheshin nën maskën e njëfarë "Vëllazërim-bashkimi" iluzor!

Kështu shqiptarët në Jugosllavi, jo vetëm se mbetën në statusin e paraluftës, të shkëputur nga shteti amë, por as nuk u bashkuan në një njësi të vetme federative. Ata u copëtuan administrativisht, midis tri republikave jugosllave, të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Qëllimi i kësaj ndarjeje, ishte çintegrimi dhe shkombëtarizimi i shqiptarëve...

[1] *Historia e popullit shqiptar IV (Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990,* redaktor shkencor, prof. dr. Xhelal Gjeçovi, Toena, Tiranë, 2008, f. 399.

Organizimi i Bashkësisë Islame të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore

Pas përfundimit të Luftës së II Botërore, organet e pushtetit të ri kishin ndaluar kthimin e mbretit dhe qeverisë mbretërore, edhe pse Britania e Madhe insistonte në këtë. Si formë transitore u pranua regjenca prej personaliteteve që ishin të pranueshëm për pushtetarët komunist. Menjëherë pas formimit të qeverisë së re proklamohet mobilizimi, me qëllim të çlirimit definitiv të vendit. Në pajtim me marrëveshjen Tito-Subashiq, qeveria obligohet për zgjerimin e lirive civile e politike, siç janë liritë personale, liria e ushtrimit të besimit dhe liria e shprehjes, liria e shtypit dhe e bashkimit në shoqata të ndryshme. Qeveria e re ishte organi më i lartë ekzekutiv i Jugosllavisë Federative Demokratike, prej marsit deri në fund të nëntorit të vitit 1945, kur bëhet edhe shpallja e shtetit të ri si republikë. Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë ishte organi më i lartë legjislativ, kurse në gusht të vitit 1945 shndërrohet në Kuvend Popullor-Provizorijum.[2]

Gjatë periudhës prej viteve 1944-1946, komunistët, si edhe në të gjitha vendet tjera socialiste, ballafaqohen me çështjen e përfshirjes edhe të Frontit Popullor në qeveri të koalicionit, krejt me qëllim të sigurimit të njohjes ndërkombëtare. Çështja e njohjes ndërkombëtare i pengonte pushtet−mbajtësit e rinj që në mënyrë më serioze të merreshin dhe të zbatoheshin masat drastike ndaj besimtarëve dhe bashkësive fetare.[3] Në kushtet e ndërlikuara të fazës së parë të ndërtimit të shtetit, politika ndaj bashkësive fetare, ka qenë identike si në ish-BRSS. Në këtë periudhë të zhvillimit historik, pranohej roli dhe ndikimi i kishave nacionale, të cilat shfrytëzoheshin për afirmimin politik të shtetit të ri. Njëkohësisht, në praktikë punohej në ndarjen e kishës nga shteti dhe nga shkolla, në forcimin e aktiviteteve propagandistike ateiste si dhe në restrikcionin e fushatave prozelitistike të Kishës Ortodokse Serbe dhe të Kishës Katolike. Arsyet kryesore të një politike të këtillë kanë qenë se kishat dhe bashkësitë e

[2] Dr. sc. Menduh Bamja, *Pozita kushtuese -juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi me vështrim të posaçëm të Bashkësisë Islame*, Prizren 2009, f. 308.

[3] Po aty, f. 311.

caktuara fetare, ishin pengesë për krijimin e kombit unik të shtetit të përbashkët dhe të qëndrimeve ideologjike. Në këtë drejtim dalloheshin Kisha Katolike dhe Bashkësia e Fesë Islame.[4]

Kështu, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe organizimit të Jugosllavisë në parimet federative, bashkësitë fetare nuk kanë pranuar organizimin e këtillë dhe janë munduar të ushtrojnë qeverisjen unike në tërë territorin shtetëror, përveç Bashkësisë së Fesë Islame e cila bëri një organizim specifik në parimet e decentralizimit.

Bashkësia më e madhe dhe me shtrirje më të gjerë në RSF të Jugosllavisë ka qenë Kisha Ortodokse Serbe. KOS-i është kishë peshkopate dhe ndarja kryesore e saj në hierarkinë administrative është nëpër peshkopate.[5]

Kisha Katolike është kishë universale internacionale, uniteti i së cilës bazohet në dogmën e përbashkët dhe organizatën e përcaktuar centraliste në krye të së cilës qëndron Papa (me seli në Vatikan R.SH.)[6]

Bashkësia Islame në Kosovë gjatë viteve 1945-1947

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova edhe njëherë padrejtësisht ndahet nga ëma e saj-Shqipëria dhe futet dhunshëm nën administrimin e sajesës artificiale të quajtur Jugosllavi.

Në këto rrethana, në viset shqiptare sidomos ato që u aneksuan nga Jugosllavia u bënë ndryshime të mëdha shoqërore dhe politike, të cilat ushtruan ndikim edhe në veprimtarinë e bashkësive fetare. Në vitet e para të pas luftës, puna e institucioneve fetare në këto vise ishte vështirësuar në masë të madhe, kjo për shkak të rrethanave që iu imponuan Kosovës e në këtë kontekst edhe Bashkësisë Islame, të cilës tani i pamundësohet veprimi i mëtutjeshëm në kuadër të KMSH ku ishte inkuadruar më 1941.[7] Andaj, aktiviteti i BI bëhej kryesish në nivel të Zyrave të Vakëfeve dhe nëpër xhematë ku vazhdonin aktivitetin, kryheshin ceremonitë dhe ritet

[4] Po aty, f. 311-312.

[5] Po aty. f. 311-312.

[6] Po aty, f. 311-312.

[7] Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011, f. 329-331.

fetare. Ndërsa, struktura organizative e Bashkësisë Islame (BI-së) e ndërtuar gjatë luftës pushoi së vepruari, dhe kështu praktikisht Bashkësia Islame ngeli pa organizim dhe udhëheqje qendrore.[8]

Mirëpo, paria fetare islame në vend, respektivisht myftinjtë e qendrave të mëdha, të vetëdijshëm për rrethanat e reja që u krijuan pas aneksimit të Kosovës nga Jugosllavia respektivisht Serbia, nuk qëndruan duarkryq, por u vetorganizuan dhe ndërmorën nisma e hapa për organizmin e mëvetësishëm e të pavarur të Bashkësisë Islame në Kosovë. Kështu, me gjithë qëndrimin jo të mirë të sistemit socialist e ideologjisë moniste që po instalohej ndaj fesë në vend, paria islame e Kosovës mbajti në Prizren dy kongrese në cilat hidhen hapat e parë dhe themelet e organizmit të BI në Kosovë në kushte e rrethana aspak të favorshëm për fenë.[9]

E veçanta e këtyre kongreseve është se kishin për synim organizimin, respektivisht riorganizimin e Bashkësisë Islame për territorin administrativë të Kosovës. Madje të dy kongreset mbahen ende pa e pasur të qartë se si do jetë organizimi i Bashkësisë Islame në nivel të Jugosllavisë së AVNOJ-të.

Duhet konstatuar se mbajta e këtyre kongreseve ka rëndësi dhe peshë të posaçme për historikun e BI në Kosovë, ngase realizohen në kohë të kthesave të mëdha për popullin shqiptar, Kosovën dhe Bashkësinë Islame, sepse janë përpjekje dhe angazhim konkret i parisë islame për organizim të pavarur në rrafshin fetar për territorin e Kosovës.

Strukturat e dala nga këto kongrese organizuan dhe udhëhoqën me BI në Kosovë deri më 1948 kur BI e Kosovë detyrimisht inkuadrohet në kuadër të RIJASET-it të ish-Jugosllavisë me seli në Sarajevë.

---

[8] Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë*, Prishtinë 1988, f. 13-14.

[9] Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në harkun kohor prej 15 muajsh, korrik 1945 - tetor 1946, në qytetin e Prizrenin nga paria islame me qëllim të riorganizimit të pavarur të BFI janë mbajtur dy Kongres. (Kongresi i parë korrik 1945, shih: Seit Lipa, vepra e cituar më lartë, f. 122, ndërsa Kongresi tjetër në tetor 1946 shih: dokumentin nr. 1, AR KBIK, Kutia nr. 46)

Kongresi I në Prizren, korrik 1945

Në rrethanat e krijuara pas LDB, organizatat politike-shoqërore shtronin domosdonë që edhe në pikëpamje të organizimit dhe funksionit të institucioneve fetare të ndërmerren masa përkatëse për riorganizim, duke iu përmbajtur parimit themelor se institucionet fetare mund të veprojnë lirisht, por ndaras nga shteti. Mbetet e drejta e çdo individi të besojë në fenë që do, e drejtë kjo që është garantuar edhe me Kushtetutën e parë të vendit të çliruar.[10]

Skema organizative dhe ajo e hierarkisë së organeve të bashkësive fetare në Kosovë deri pas Luftës II Botërore nuk ishin të përcaktuara për territorin e Kosovës si tërësi, meqë Kosova në pikëpamje administrative ishte e ndarë në tri banovina: në atë të Zetës, të Moravës dhe të Vardarit.[11] Edhe gjatë LDB (1941-1944), skema organizative e këtyre bashkësive fetare i ishte përshtatur ndarjes territoriale që e patën bërë italianët dhe gjermanët.[12]

Pas riokupimit të Kosovës nga Jugosllavia, Kosova dhunshëm detyrohet të konstituohet si Krahinë Autonome e Kosovës dhe Metohisë.[13] Në këtë rrafsh shtrohet nevoja që edhe në pikëpamje të organizimit institucional të bashkësive fetare të themelohen organet përkatëse të tyre.

Së këndejmi, në kuadër të aksionit të përgjithshëm gjoja për stabilizimin e jetës politiko-shoqërore në këtë periudhë, ndërmerren masat përkatëse edhe për rregullimin e çështjes së pozitës dhe rolit të bashkësive fetare në Kosovë. Kështu, pranë organeve partiake dhe organeve të pushtetit popullor formohen komisionet dhe këshillat e veçanta që merren me çështjen e bashkësive fetare.[14]

Në këto rrethana, paria islame e Kosovës, më 11 e 12 korrik 1945,[15] në Prizren mbajti Kongresin e parë të Bashkësisë Islame, në të cilin mo-

---

[10] Prof. dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi*, "Segmente të gërshetuara historike", Prishtinë 2011, f. 62.

[11] Seit Lipa, *Ndarja administrative dhe funksioni gjyqësor në Kosovë*, "Kosova", nr. 8, Prishtinë 1977, f. 345-357.

[12] Dr. sc. Menduh Bamja, vepra e cituar më lartë, f. 239.

[13] Krahina Autonome e Kosovës e Metohisë konstituohet më 7 e 8 korrik 1945.

[14] Dr. Seit Lipa, *Kosova në periudhën e rindërtimit*, Prishtinë 1982, f. 122,

[15] Po aty, f. 122.

rën vendim që organizimi i jetës fetare islame tani e tutje të bëhej për territorin administrativ të Kosovës. Kongresi zgjodhi Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës në këtë përbërjeje :

- Rexhep Remziu (kryemyfti i Prishtinës), kryetar;
- Fahri[16] Iliazi, (myfti i Gjakovës), nënkryetar;
- Sheh Hasan Hasani, nënkryetar;
- Jusuf Imami, anëtar;
- Hasan Islami, (kryemyfti i Prizrenit), anëtar;
- Haki Taibi (Sermaxhaj), anëtar;
- Mustafë Hoxha, anëtar;
- Avdurrahim Kuçani, sekretar.[17]

Siç shihet, në Kryesinë e re, u emëruan personalitete të shquara e të dëshmuara në institucionet pararendëse të Bashkësisë Islame, si f.v., kryetari Rexhep Remziu, myderriz i shquar në Medresenë e Isa Beut në Shkup, pastaj veprimtar i shquar i çështjes kombëtare dhe nga viti 1943 kryemyfti i Prishtinës, Haki Taibi,[18] veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, nxënës i Medresesë së Isa Beut në Shkup, Sheh Hasani pjesëmarrës Lidhjes së Dytë të Prizrenit e kështu me radhë.

Kjo strukturë udhëheqëse e Bashkësisë Islame të Kosovës, e vetëdijshme për përgjegjësinë që kishte, me gjithë rrethanat jo të favorshme për veprim, filluan riorganizimin e BI në qendrat kryesore, duke riorganizuar e riemëruar këshillat e vakëfit. Kryemyftinia e zonës së Prishtinës, më 7.XI.1945, miraton zgjedhjet në rajonin e Ferizajt dhe shkruan: *"Pëlqehet zgjedhja e Këshilli vakufnuer të përbërë prej personave sa vijon: 1. Rifal Sadiu nga Ferizaj; 2. Ramush Rizaj nga Ferizaj; 3. Selim Zajmi nga Ferizaj; 4. Hamit Bajrami nga fshati Jezercë; 5. Dërgut Izeti nga katundi Varosh; dhe 6. Idriz Ahmeti nga katundi Talinovc.[19]*

---

[16] Këtu është dhënë emri *Fehmi*, lëshim pa dashje apo gabim teknik, fjala këtu është për Fahri ef. Iljazin, ish- Myfti i Gjakovës (shih: Seit Lipa, vepra e cituar më lartë, f. 122).

[17] Po aty, f. 122.

[18] Fjala është për myderrizin e njohur dhe veprimtarin e çështje kombëtare, Myderrizin Haki ef. Sermaxhajn.

[19] AK, F. BFI, k. 51

Kongresi II në Prizren, tetor 1946

Paria islame e Kosovës, më 25 e 26 tetor 1946,[20] mblidhet në Kongres dyditor në Prizren, nga i cili dalin strukturat e reja drejtuese, emërtim i ri si dhe selia e përkohshme. Nga ky Kongres kemi në dispozicion një sërë dokumentesh që ruhen në Arkivin e Kryesisë së BI të Kosovës, e të cilat japin të dhëna të mjaftueshme për vendimet që ka marrë Kongresi dhe për aktivitetin që kanë zhvilluar më pas strukturat drejtuese të BI në Kosovë.[21]

Bazuar në Qarkoren që Ulema Mexhlisi u drejton zyrave të Vakëfit, zbardhen disa vendime që kishte marrë Kongresi.

"Përfaqsusat fetar Mysliman nga të gjithë vendet e Kosovës e Metohisë të mbledhun në kongresin, mbasi ndigjuan refereatet dhe diskutimeit që zhvilluan gjatë kohës së vazhdimit të kongresit më datë 25 dhe 26 X 1946, njëzanit shpallin rezulucionin e nevojshm edhe nikohsisht po nizanit e zgjelën një Këshill i saborit prej 24 vetë nga gjitha anavet, mbas zgjedhejs së saborit,..."[22].



ULEMA MEXHLIS PËR KOSMET

Nr. 1 Prizren me 28/X/1946.

QARKORE

Të gjith Zyrave të Vakfeve në Kos.e Metohi:

Përfaqsuesat fètar Mysliman nga të gjithë vendet e Kosovës e Metohisë të mledhun në kongresin,mbasi ndigjuen referatet dhe diskutimet që zhviluen gjat kohës së vazhdimit të kongresit me dat 25dhe 26-X-1946,nji zanit shpallin rezulucionin e nevojshme dhe nikohsisat po ni zanit e zgjelën nji Kshill i saborit prej 24 vetë nga gjitha anavet,mbas zgjeljes së saborit,Sabori në mledhjen e vet ka zgjel me ni zanit nji kshill prej 5 vetash qi dot qyhësh (Ulema Mexhlis) tuj i ngarkue me detyrë qi të kryejn organizatën fètar Mysliman për Kosov e Metohi.Personat ezgjelunn e qi përbajn "ULEMA MEXHLISIN" jan: Hafës Fahri Ilijazi,nga Gjakova, Hasan Islami nga gjakova, Hafës Ismail Hakija,nga Prizrendi,Sheh hasan Husejni;nga Prizrendi,dhe Mahmed Deda nga Mitrovica,.-

Ky Kshill Ka filluu punës me dat 26/X/1946. tye instilue Zyrat të Vetar përkohësisht në Zyrën e Vakfit së Prizrendit.

Pra tue ju njoftue me të sipërmen ju thrasim qi të gjithë së Bashku të pervishemi punës me nji bashkim të pllot të forcojm radhat të tona dhe me bashkpunim me pushtetit t'on Populluer tue forcue ketë pushtet pse àsht pushteti i yn Populluer Pushteti qi na i ruen të gjitha të drejtat t'on Fetar. Dxxxxxxx.

Vdekja Fashizmit Liri Popullit

Antari ULEMA MEXHLISIT

Hafës Ismail Hakiu

Nr. Faksimile e Qarkores së parë, datë 28.10.1946

---

[20] AKBIK, Kutia 46. *Qarkore e Ulema Mexhlisit*, numri 1 (datë atë 28 X 1946).

[21] *Ulema Mexhlis* - Organ drejtues e përfaqësues i Bashkësisë Islame i zgjedhuar në Kongresin e Prizrenit të mbajtur me 25 e 25 X 1946.

[22] Shih: Qarkore e *Ulema Mexhlisit*, numri 1 (datë atë 28 X 1946). AKBIK, Kutia 46.

Siç shihet nga Qarkorja që mban numri 1 (datë atë 28 X 1946), e që duhet të jetë edhe akti i parë i nxjerr nga Ulema Mexhlisi, bëhet e ditur se Kongresi ka zhvilluar punimet më 25 e 26 tetor 1946 në Prizren, në prani të përfaqësuesve nga të gjitha viset e Kosovës. Fillimisht Kongresi zgjodhi Kuvendin prej 24 anëtarëve, ndërsa Kuvendi zgjodhi Këshillin drejtues të Ulema Mexhlisit[23] në këtë përbërje:

-Hafëz Fahri Ilajzi nga Gjakova;
- Hasan Islami nga Gjakova;
-Hafëz Ismail Hakija nga Prizreni;
- Sheh Hasan Husejni nga Prizreni; dhe
- Mehmed Deda nga Mitrovica.

Kuvendi, Ulema Mexhlisin e kishte ngarkuar me organizmin e jetës fetare islame në Kosovë, *"Sabori në mbledhjen e vet ka zgjedh ni zanit një këshill prej 5 vetash qi do quhësh (Ulema Mexhlis), tuj i ngarkue me detyrë qi të kryejn organizimin fetar Mysliman në Kosov e Metohi".*[24]

Selia e Ulma Mexhlisit për mungesë të hapësirës qe vendosur përkohësisht në Zyrën e Vakëfit në Prizren.

Në Qarkore u kërkohet stukuarave të vakëfeve në nivel lokal që të mobilizohen e të bashkohen dhe t'i përvishen punës për organizmin e BI në Kosovë.

Ulema Mexhlisi, si organi ekzekutiv i dalë nga Kongresi ishte i autorizuar që të riorganizoj Bashkësinë Islame në Kosovë dhe të zhvilloj veprimtarinë si organizim i pavarur për territorin administrativ të Kosovës.

Bazuar në dokumentet që ruhen në Arkivin e Kryesisë së BIK, mund të shihen vendimet për riorganizimin e zyrave të vakëfeve, si aktvendime e dekrete për punësimin apo pensionimin e personelit fetar, pastaj autorizime e shkresa drejtuar organeve të pushtetit me të cilat vinin komunikim institucionet.[25]

[23] Po aty.
[24] Po aty
[25] Shih: AKBIK, kutia nr. 46, kutia 22.



Nr. 75
10/VII/47

Qarkore

Të Gjithë Zyrave Vakfnore

Asht·vue ré se shumica prej imamëve të xhmijave qefshin këte imam zyrtar ose jo zyrtar janë tue shërbue këtë detyrë pa marr kejen-dekretin e duhun nga autoriteteve përkatse.Për të ndal këtë Këshilli i Ulemave në mledhjen e tij datë 5.VII.1947 ka marr këtë vendim:

"Të ftohen të gjithë zyrat o Vakfeve që sa ma parë të kërkojn lishimin e dekretave për ato imamt të cilet akoma nuk zotnojn dekret për shërbimin që jan tue ushtrue."

Prandej tue ju komunikue vendimin e sipërm ju tharasim që të veproni pikrisht në baz të vendimit të sipërm.

V. F. L. P.

Sekretori
Ismail Hakiu

Nr. 3. Faksimile e Qarkores së datës 10.VII. 1947

Ndër vendime e para që mori Ulema Mexhlisi, është ai për riorganizimin e zyrave të vakëfeve.[26] Për riorganizimin e zyrave të vakëfeve, Ulema Mexhlisi kishte emëruar anëtarin e tij Hasan Islamin. Pastaj kemi një sërë vendimesh për pensionimin apo emërimin e imamëve.[27] Ulema Mexhlis i shkruan shkresë Komitet Shqiptar për Drenicë, të cilin e njofton se për çështje fetare për territorin e Drenicës kompetente është Zyra e Vakëfit në Mitrovicë,[28] pastaj i shkruan Komitetit Shqiptar të Podujevës, si dhe degës së punëve të brendshme në Prishtinë.

Me qëllim të funksionalizmit dhe krijimit të një baze të duhur institucionale, Ulema Mexhlisi kishte autorizuar hfz. Ismail Hakiun,[29] që të tërhiqte lëndën arkivore që kishte të bënte me Kosovën e që gjendej në Arkivin e Ulema Mexhlisit në Shkup.

[26] AKBIK (Kutia 46), Qarkore nr. 14 e datës 16. XII. 1947.

[27] Po aty, Vendimi nr. 8, datë 5. II. 1947.

[28] Po aty, shkresa nr. 31 e datës 20. II. 1947.

[29] Shih: Autorizimin nr. 54 të datës 7 maj 1947 (AKBIK, kutia 46).



KOMUNITETI FETAR MYSLIMAN
ULEMA MEXHLIS PËR KOSMET
PRIZREN.
Nr. 73

Prizren, me 10/VII/1947.

Q A R K O R E

Zyrës së Vakfit Mysliman

Në ras se nuk vërtetohet ndryshe, dita e parë e "RAMAZANIT" është me dat 19 korrik 1947, ditën e Shtund.-
Prandaj përsiteni me ja njoftue Popullit.

V.F. L.P.

Sekretari i Ulema Mexhlisit,

/Ismail Hakiu/

Nr. 4. Faksimile e Qarkores së datës 10.VII. 1947

Aktet zyrtare (vendimet, dekretet, shkresat, lajmërimet etj.) të Ulema Mexhlisit, në vitet e para pas përfundimit të LDB, i përkasin viteve 1945-1947, sidomos ato që kanë të bëjnë me zyrat e vakëfeve dhe shkresat që kanë të bëjnë me informimin e masës së gjerë, që të gjitha janë të shkruara në gjuhën shqipe,[30] ndërsa shkresat që u drejtohen organeve të pushtetit janë në gjuhën serbokroate.[31]

Bashkësia Islame në këtë formë të organizimit funksionoi deri më 1948, kur inkuadrohet në kuadër të organizimit të ri të Bashkësisë Islame në Jugosllavi.[32]

[30] Shih: Dokumentacion që ruhet në AKBIK (kutia 46).
[31] Po aty.
[32] *Po aty,* Procesverbali më 17. VIII. 1948.

Integrimi i Bashkësisë Islame të Kosovës në Bashkësinë e Fesë Islame të Jugosllavisë

Organizimi i Bashkësisë së Fesë Islame në RFP të Jugosllavisë bazohej në Kushtetutën e Bashkësisë së Fesë Islame të miratuar nga Kuvendi Suprem Vakufor i BFI-ve, nga territori i Bosnjës dhe Hercegovinës, RP të Serbisë, RP të Maqedonisë dhe RP të Malit të Zi, në mbledhjen e parë të mbajtur në Sarajevë më 26-27.08.1947.[33]Në këtë Kuvend bëhet edhe zgjedhja e Ibrahim ef. Fejiqit, për Reis-ul-ulema, kurse dorëzimi solemn i menshurës u bë më 12.09.1947 në Medresenë e Gazi Husrev Begut.[34]

Në këtë Kuvend miratohet edhe "Rezoluta e Kuvendit të Vakëfit Suprem të Bashkësisë së Fesë Islame në RPFJ", ku thuhet:

"Kuvendi Suprem i Vakëfit të Bashkësisë së Fesë Islame, në të cilin janë tubuar përfaqësuesit e Bashkësive së Fesë Islame nga territori i Bonjës dhe Hercegovinës, RP të Serbisë, RP të Maqedonisë dhe RP të Malit të Zi, në mbledhjen e tyre të parë të mbajtur në Sarajevë më 26-27 gusht 1947, e zgjodhi Kryesinë Supreme Islame me në krye Reis-ul- ulemanë, si organ më i lartë fetar i Bashkësisë së Fesë Islame në Jugosllavi. Në këtë orë historike të Bashkësisë së Fesë Islame në Jugosllavi, Kuvendi i Vakëfit Suprem, i prirë nga ndjenjat më të larta ndaj bashkësisë së vet, miraton këtë:

Rezolutë

1. Përpjekjet e kahershme të pjesëtarëve të BFI-së për liri dhe barazi të plotë përfundimisht u arritën me Kushtetutën e RFPJ-së dhe me kushtetutat e të gjitha republikave populllore, në saje të LNÇ- së, në të cilën morën pjesë të gjithë popujt e Jugosllavisë, të udhëhequr nga udhëheqësi i ynë mareshali Tito.

Nuk mund të harrohen vuajtjet e myslimanëve në ish- Jugosllavinë antipopullore, sidomos nuk mund të harrohen ndjekjet e tmerrshme të bëra ndaj shqiptarëve myslimanë, rrezikimi i liri-

[33] Muhamed Salkić, *Ustavi islamske Zajednice, (Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godine)* El-Kalam, Sarajevo 2001, f. 207.

[34] Dr. Fikret Karcic, *Drustveno-pravni aspekt islamskog reformizma*, Islamski teoloski fakultet, Sarajevo. 1990, f. 237-241.

së së tyre fetare e nacionale, edhe përkundër të gjitha rregullave kushtetuese dhe ligjore të shkruara për lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes. Sot në Jugosllavinë e re demokratike është arritur zhvillimi i papengueshëm i të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë sonë fetare në çdo pikëpamje, si me ligj, ashtu edhe në jetën praktike është siguruar liria e besimit dhe pacenueshmëria e ndjenjave fetare. Feja nuk është më si dukuri e mjet në duart e pushtetmbajtësve për të mbajtur qeveritë e tyre antipopullore, ajo (feja) është bërë bindje e lirë e të gjithë pjesëtarëve të të gjitha bashkësive fetare, të cilën askush nuk guxon ta pengojë me asgjë.

Kuvendi Suprem i Vakëfit konstaton se ndarja e bërë e organizatave fetare nga shteti, jo vetëm që nuk është e dëmshme për interesat e bashkësisë tonë fetare, por përkundrazi, në atë akt, i cili shumë më herët është zbatuar në vendet e përparuara, është siguruar jeta e lirë e bashkësisë sonë fetare në raport me shtetin. Kjo fitore demokratike është faktor pozitiv në zhvillimin dhe në forcimin e mëtejshëm të vëllazërim-bashkimit të gjithë popujve tanë, kjo paraqet një prej kushteve themelore të përparimit të shtetit tonë popullor. Me ndjenja të tilla për lirinë, si dhe në bazë të miratimit të lirë të Kushtetutës së BFI-së, Kuvendi Suprem i Vakëfit bëri zgjedhjen e kryesuesit suprem fetar Reisul-ulemasë, me të cilin akt shohim përfundimin e ndërtimit të organizatës fetare.

2. *Derisa sot në shumë vende koloniale islamike zhvillohet luftë për të drejtat elementare të njeriut dhe vdesin mundimshëm në flakën e përçarjes dhe të urrejtjes së përhapur fetare, pjesëtarët e BFI-së në RPFJ, në shtetin e tyre të lirë, i gëzojnë të gjitha liritë qytetare. Duke shijuar të gjitha frytet e lirisë së fituar me luftë, iu dërgojnë përshëndetje vëllazërore të gjitha vendeve të robëruara islamike, si dhe iu dëshirojmë sukses në luftën e tyre për liri kundër robërisë imperialiste.*
3. *Kuvendi Suprem i Vakëfit gjykon përpjekjet e atyre të cilët si pjesëtarë të BFI-së e më parë si funksionarë të saj, që me për-*

pjekjet e tyre prapanike dhe me veprimet e tyre armiqësore e keqpërdorin lirinë e punës dhe të jetës së institucioneve tona fetare, të cilët me fjalë të rrejshme kinse për mbrojtjen e fesë iu shërbejnë armiqve të përbetuar të atdheut tonë. Po ata njerëz të prapambetur përpiqen të shpifin të pavërteta të cilat përhapen në botën e jashtme për pozitën e BFI-së si dhe, në përgjithësi, për pozitën e rëndë të organizatave fetare në Jugosllavi. Në ato përpjekje shohim dorën e fshehur të armikut të përbetuar të shtetit tonë popullor, si dhe bashkëpunëtorëve fetarë, të cilët përpiqen të çrregullojnë lumturinë dhe ardhmërinë tonë. Jemi të bindur thellë se të gjitha ato përpjekje të të prapambeturve do të mbesin të pasuksesshme, në saje të ndërgjegjes së pjesëtarëve të bashkësisë tonë fetare, si dhe të qëndrimit patriotik të pjesës më të madhe të Ilmisë[35] tonë.

4. *Popujt e Jugosllavisë në luftën mbinjerëzore kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm e fituan lirinë dhe krijuan shtetin e ri. Sot në kushtet e lirisë po bëhen përpjekje të mëdha e të pashembullta për jetë më të mirë të secilit njeri të bashkësisë sonë dhe Kuvendi Suprem i Vakëfit parasheh se është detyrë patriotike e çdo pjesëtari të BFI-së që të ndihmojë çdo iniciativë, e cila është orientuar kundër zhdukjes së prapambeturisë dhe që shpie drejt përparimit më të shpejtë të masave të gjera popullore, e sidomos të pjesëtarëve të BFI-së. E kaluara e rëndë gjatë historisë është përplot shembuj, të cilët flasin për fatkeqësitë e myslimanëve, të cilat më së shpeshti i kushtëzonin prapambeturia dhe padituria.*

   Përgjegjësi dhe rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet lirimit të gruas myslimane nga zakonet prapanike, me të cilat është thyer personaliteti i saj dhe deri sot është frenuar zhvillimi i saj. Ne duhet t'i ofrojmë ndihmë gruas myslimane që të hyjë sa më shumë në jetën publike dhe me heqjen e çarçafit e të ferexhesë të bëhet anëtare e barabartë e bashkësisë sonë në kuptimin e

[35] Elitës së dijetarëve

plotë të fjalës, si dhe faktor e rëndësishëm në ndërtimin e Jugosllavisë së Re.

Nuk ka pengesa nga feja sa i përket heqjes së ferexhesë dhe të çarçafit. Kuvendi Suprem i Vakëfit konsideron se ajo është detyrë patriotike e çdo myslimani që deri në fund të kontribuojë për ngritjen e ndërgjegjes së gruas myslimane, se heqja e çarçafit dhe ferexhesë mundëson që me hapa të ecën drejt zhvillimit krah për krah me gratë e tjera të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Kuvendi Suprem i Vakëfit përshëndet të gjitha përpjekjet e të gjithë njerëzve tanë dhe të organizatave popullore, të cila me angazhimin e tyre patriotik dhe vëllazëror po kontribuojnë për zgjedhjen e çështjes së gruas myslimane. Është detyrë e të gjithë ulemave dhe pjesëtarëve të tjerë të BFI-së që myslimanen ta shpien në rrugën e lirisë dhe të përparimit, në të cilën është siguruar jo vetëm lumturia e saj individuale, por edhe lumturia e përgjithshme e bashkësisë sonë.

Jemi të bindur thellë se lumturia dhe përparimi i vendlindjes dhe i bashkësisë sonë fetare varet para se gjithash prej vetë nesh. Kuvendi Suprem i Vakëfit i fton të gjitha organet dhe të gjithë pjesëtarët e BFI-së që me tërë forcën të ndihmojnë përpjekjet e shtetit tonë popullor të të gjithë popujve në Jugosllavi. Me ruajtjen e barabarësisë së krijuar fetare do t'i ndihmojmë forcimit të vëllazërimit të popujve në Jugosllavi. Me ruajtjen e barazisë së krijuar fetare do t'i ndihmojmë forcimit të vëllazërimit të popujve tanë dhe nën udhëheqjen e Mareshalit Tito të ndërtojmë Republikën - Popullore Federative të Jugosllavisë të fortë, të përparuar dhe të pavarur".[36]

Kjo Kushtetutë ka një rëndësi të veçantë për BFI-në dhe për myslimanët në përgjithësi, ngase brenda BFI-së, mbisundon orientimi i qarqeve

[36] *Glasnik Vrhovnog islamskog starjesinstva,* (1950), nr. 1-3, Sarajevo, 1950, ff. 18-19. "'Rezolucija Vrhovnog vakufskog sabora IVZ u FNRJ", (Përkthimi jepet sipas Dr. Haki Kasumi. *Bashkësitë fetare në Kosovë 1945-1980*, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1988, ff. 30-33).

moderniste, të cilat si bartëse të vetme kanë mundur të ofrojnë interpretimet e pranueshme shoqërore për Islamin, në një shoqëri ku ndërtohej shoqëria socialiste. BFI me këtë rezolutë jep legjitimacionin e saj mbi proceset e caktuara shoqërore-politike të cilat kanë qenë në zhvillim e sipër në mjediset myslimane, e ndër to kryesore janë: ndarja e shtetit nga besimi, çështja e ferexhesë dhe çështja e kooperativave bujqësore.[37]

Me Kushtetutën e miratuar, Bashkësia Islame kishte këtë strukturë:

- Imami i xhematit;
- Këshillit të xhematit;
- Komisionet vakëfnore;
- Ulema Mexhlisit (më vonë, Kryesitë Republikane të BFI-së);
- Kuvendi Vakëfnor me këshilltarët e Kuvendit dhe Drejtorinë e Vakëfit (Kuvendet republikane);
- Kuvendit Suprem Vakëfnor;
- Kryesia Supreme Islame me Reis-ul-Ulemanë në krye.[38]

Secili prej këtyre organeve të BFI-së kishte detyrat dhe kompetencat e veta të përcaktuara me këtë kushtetutë.

Kuvendi Suprem Vakëfnor ishte organi më i lartë i BFI-së, i cili mblidhej rregullisht një herë në vit. Përbëhej prej përfaqësuesve të kuvendeve republikane vakëfnore, të cilat zgjidhnin nga një përfaqësues për 100.000 besimtarë. Më së paku një e treta e delegatëve të Kuvendit Suprem Vakëfnor duhet të kishte përgatitjen shkollore teologjike. Kompetencat e Kuvendit Suprem Vakëfnor janë:

- të zgjedhë Reis-ul-Ulemanë dhe anëtarët e Kryesisë Supreme Islame;
- t'i japë dekretin me shkrim (Menshurën) Reis-ul-Ulemasë për kryerjen e punëve fetare;
- të kujdeset për buxhetin e BFI-së;
- të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Kushtetutës së BFI-së në RFPJ;
- të ushtrojë pushtetin disiplinor ndaj anëtarëve të Kryesisë Supreme Islame; dhe

[37] Dr. Fikret Karcic, *Drustveno-pravni aspekt islamskog reformizma,* Islamski teoloski fakultet, Sarajevo, 1990, ff. 237-239.

[38] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 17.

- të bëjë mbikëqyrjen e përmbushjes dhe korrigjimin e Kushtetutës së BFI-së.

Mandati i anëtarëve të këtij organi zgjat deri në seancën e ardhshme, përkatësisht derisa të zgjidhen delegatët e rinj.[39]

Reis-ul-Ulemaja, ishte udhëheqësi suprem i BFI-së në RFPJ, i cili qëndronte në krye të Kryesisë Supreme Islame. Ai e përfaqësonte BFI-në në të gjitha punët me shtetin dhe me të gjitha organizatat e tjera fetare në vend dhe jashtë tij. Reis-ul-Ulemaja u lëshonte autorizime anëtarëve të Ulema Mexhlisit për kryerjen e punëve fetare.

Reisi kishte zëvendësin e vet, të cilin po ashtu e zgjidhte Kuvendi Suprem Vakëfnor nga anëtarët e Kryesisë Supreme Islame. Ai e zëvendësonte Reis-ul-Ulemanë në punët e tij ose kryente detyrat nëse mbetët vakant vendi i Reis-ul-Ulemasë deri në zgjedhjet e reja.[40]

Kryesia Supreme Islame, ishte organ suprem fetar i të gjithë pjesëtarëve të BFI-së në RFPJ. Përbëhej prej Reis-ul-Ulemasë dhe nga një përfaqësues të secilit Kuvend Republikan Vakëfnor. Anëtar i Kryesisë Supreme Islame mund të zgjidhej personi, i cili, sipas mundësisë, kishte arsim të lartë fetar dhe që në aspektin fetar e moral dhe sipas dispozitave qytetare ishte i përshtatshëm për këtë pozitë.

Kryesia Supreme Islame përfaqësonte unitetin fetar të pjesëtarëve të BFI-së në RFPJ dhe kryente këto punë:

- përcaktonte orientimet kryesore të jetës fetare në gjithë territorin e RFPJ-së dhe ushtronte mbikëqyrje të përgjithshme;
- jepte komentime të detyrueshme për çështje fetare;
- vendoste për mosmarrëveshjet e kompetencave dhe për çështjet kryesore kontestuese ndërmjet Ulema Mexhliseve;
- vendoste nëpunësit e Kryesisë Supreme Islame dhe ushtronte mbi ta pushtetin disiplinor;
- vendoste për ankesat e organeve fetare në instancë të fundit.

[39] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 28.

[40] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 29.

Kryesia Supreme Islame, po ashtu, nxirrte vendime në Këshill sipas rregullave dhe me shumicën e votave. Në rast se nuk arrihej shumica, vendoste vota e Reis-ul-Ulemasë.[41]

Kuvendi Vakëfnor Republikan ishte organi më i lartë drejtues legjislativ dhe urdhërdhënës i BFI-së në territorin përkatës. Në Jugosllavi ekzistonin katër Kuvende vakëfnore.

- Kuvendi Vakëfnor për Republikën Popullore të Bosnjës e Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë, me seli në Sarajevë;
- Kuvendit Vakëfnor për Republikën Popullore të Serbisë (ku bënte pjesë Kosova dhe Vojvodina), me seli në Prishtinë;
- Kuvendit Vakëfnor për Republikën Popullore të Maqedonisë, me seli në Shkup;
- Kuvendit Vakëfnor për Republikën Popullore të Malit të Zi në Podgoricë.

Territori i një Kuvendi vakëfnor mund të bashkohej me territorin e kuvendit tjetër në bazë të pëlqimit të dyanshëm.

Qendra e Kuvendit Vakëfnor caktohej me Statut të BFI-së.

Kompetencat e Kuvendit Vakëfnor ishin:

- të nxirrte vendime për organizimin, punën dhe emërimin e organeve të BFI-së në territorin e vet;
- të kujdesej për të gjitha kërkesat e BFI-së;
- të përcaktonte formën dhe të jepte direktiva për realizimin e tyre;
- të vendoste për ndërtimin e xhamive, shkollave fetare dhe institucioneve të tjera islame, pas konsultimeve me Ulema Mexhlisin përkatës;
- të përgatiste buxhetin;
- të lejonte buxhetin, llogaritë përfundimtare të organeve dhe të institucioneve të tjera të BFI-së në territorin e vet.
- të përgatiste raporte zyrtare për të gjithë nëpunësit e BFI-së, duke përfshirë edhe rregullat për pensionin;

[41] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 28.

- të ushtronte pushtetin disiplinor ndaj organeve dhe nëpunësve të BFI-së, nëse me Kushtetutë nuk u ishte vënë në kompetencë organeve të tjera;
- të vendoste për të gjitha çështjet financiare të BFI-së në territorin e vet.[42]

Për të kryer punët e veta Kuvendi Vakëfnor nga radhët e veta zgjidhte Këshillin e Kuvendit, kompetencat e të cilit ishin brenda suazave të kompetencave të Kuvendit. Këshilli i Kuvendit emëron drejtoratin e vakëfit, si organ ekzekutiv dhe teknik të Kuvendit Vakëfnor dhe të Këshillit të Vakëfit.

Ulema Mexhlisi (Kryesitë Republikane të BFI-së), ishte organi kryesor për çështjet fetare dhe fetare-arsimore të BFI-së në territorin e një Kuvendi Vakëfnor. Ky organ u suprimua me Kushtetutën e BFI-së të vitit 1969 e në vend të tij u formuan Kryesitë Republikane të BFI-së. Për anëtar të Ulema Mexhlisit, sipas mundësive, zgjidhej personi me arsimimin e caktuar teologjik dhe i përshtatshëm nga aspekti fetar, moral dhe qytetar.

Ulema Mexhlisi i kryente këto detyra:

- udhëhiqte të gjitha punët e BFI-së në territorin e vet, duke mbikëqyrë punën e organeve dhe të institucioneve të ulëta të BFI-së;
- jepte komentime rreth çështjeve të veçanta fetare;
- hartonte plan-programet mësimore për shkollat dhe kurset fetare, të cilat i lejonte Kryesia Supreme Islame;
- përcaktonte kualifikimet për nëpunësit fetarë dhe i emëronte-shkarkonte nga detyra, ushtronte mbi ta pushtetin disiplinor dhe kryente punë të tjera, të cilat për nga natyra binin në kompetencat e tij.[43]

Komisioni Vakëfnor, ishte organ fetar-arsimor dhe pronësor i BFI-së për territorin e dy apo më shumë xhematëve. Komisioni Vakëfnor kujdesej për kërkesat e BFI-së në territorin e vet, udhëhiqte dhe mbikëqyrte punën e këshillave të xhematëve, si edhe për të gjitha çështjet e tij; për gjërat të cilat nuk ishin nën kompetencën e tij, u jepte vetëm mendime

[42] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 23.

[43] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 22.

dhe propozime organeve më të larta. Imami i xhematit ishte anëtar i Komisionit Vakëfnor dhe njëkohësisht referent për punë fetare. Territorin dhe selinë e Komisionit Vakëfnor e caktonte Kuvendi Vakëfnor.[44]

Këshilli i Xhematit, ishte organi i pjesëtarëve të xhematit, i cili zgjidhej në çdo katër vjet. Imami i Xhematit ishte anëtar i Këshillit të Xhematit. Këshilli i Xhematit kujdesej për të gjitha çështjet e jetës fetare në territorin e vet, udhëhiqte çështjet pronësore brenda territorit të vet nën udhëheqjen e Komisionit të Vakëfit dhe kujdesej për të gjitha nevojat materiale të BFI-së në territorin e vet dhe jepte mendime vetëm para organeve më të larta.[45]

Imami i Xhematit, ishte organi përfaqësues i xhematit, organizonte mësimin fetar, kujdesej për edukimin fetar të xhematit të vet, udhëhiqte evidencën e pjesëtarëve të BFI-së në territorin e vet dhe ushtronte mbikëqyrjen ndaj nëpunësve të tjerë fetarë të xhematit të tij, nëse detyrën e mbikëqyrjes nuk e kishin organet më të larta fetare. Imami i xhematit bënte kurorëzimin sipas rregullave fetare (pas kurorëzimit të bërë para organeve të pushtetit civil).[46]

Organizimi i Bashkësisë Islame të Kosovës sipas Kushtetutës së BFI-së, së vitit 1947

Bashkësia Fetare Islame në Kosovë pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1947, të Bashkësisë Fetare Islame për RPFJ, me të cilin rregullohej funksionimi i BI, bëhej pjesë përbërëse-njësi e BFI-së në Jugosllavi.

Bazuar në këtë Kushtetutë, bëhej edhe organizimi i paraparë i Bashkësive Islame në nivel republikash. Kuvendi i Vakëfnor për RPS, ku përfshihej edhe territori i Kosovës e rrjedhimisht edhe Bashkësia Islame në Kosovë, ishte konstituuar-themeluar në Beograd më 20 gusht 1947.[47]

---

[44] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl.21.

[45] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 20.

[46] Ustav Islamske Zajednice u FNRJ iz 1947 godina, čl. 19.

[47] AKBIK, Kutia nr. 22. Raport për punën e Kryesisë supreme për RPS në Prishtinë për periudhën nga themelimi i saj 16 korrik deri më 23 maj 1951. f. 1.

Ndërsa, Kryesia Islame në Prishtinë ka nisur punën më 1 janar 1948, pasi ka siguruar mjete financiare për punë.[48]

Si aktivet i parë i saj ka qenë informimi i besimtarëve për rëndësinë e miratimit të Kushtetutës së BFI dhe për formimin e Bashkësisë Fetare Islame në Jugosllavi dhe nëpër republikat e saj.

Që nga themelimi i Kuvendit të Vakëfit më 20 gusht 1947, në Kryesi janë zgjedhur hfz. Bajram Agani - kryetar, Mustafë Hoxha dhe Eshef Çaviçi-anëtar.[49]

Meqenëse më 1951, Mustafë Hoxha kalon në detyre të re, Kuvendi i Vakëfit në vend të tij zgjodhi Hajrullah Zaimin - imam nga Prishtina dhe ish-myfti i Prishtinës.[50]

Ndërsa pjesëmarrës nga Kosova në Kuvendin e Vakëfit në nivel federate më 1951 ishin:[51]

- Hfz. Bajram Agani nga Prishtina;
- Mustafa Canhasi nga Gjakova;
- Xhevdet Pallaska nga Prishtina;
- Hivzi Sulejmani nga Prishtina;
- Ramadan Kurteshi nga Dragashi;
- Ismail Jakupi nga Gjilani;
- Jakup Hoxha nga Prishtina;
- Fahri Iljazi nga Gjakova;
- Ahmet Mustafa nga Mitrovica;
- Ilmi Ejupi nga Lipjani;
- Sheh Hasani nga Prizreni.

Rregullimi i brendshëm i këtyre bashkësive bëhej mbi bazën e statuteve. Kështu, Bashkësia Islame në Kosovë në vitin 1948, kishte miratuar statutin (Statuti i Komunitet të Fesë Islame të Republikës Populllore të Serbisë)[52] e saj, sipas të cilit (neni 17), kjo bashkësi kishte këtë organizim:

---

[48] Po aty f. 2.

[49] Po aty, f. 2. si dhe shih: Procesverbalin nga Mbledhja e V e Këshilli të Vakëfit për RPS në Prishtinë të mbajtur më 23 maj 1951.(AKBIK, Kutia, nr. 22. f. 3).

[50] Po aty, f. 2

[51] Po aty, f. 3

[52] AK. Fonti, Bashkësia e Fesë Islame, Zyra e Vakëfit, viti 1951, Kutia nr. 55. dok. nr. 1.

- Imami i xhematit;
- Këshilli i Vakëfit të Rrethit;
- Kryesia e Fesë Islame; dhe
- Kuvendi i Vakëfit me Këshillin e Kuvendit dhe Drejtorinë e Vakëfit.[53]

Ky statut shënon aktin e parë të organizimit të BFI-së së Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore. Ky dokument është i shkruar në gjuhën shqipe dhe përmban 13 faqe, i ndarë në 16 njësi me 43 artikuj, përkatësisht nene. Ky statut është aprovuar me vendimin e Vakëfit nr. 696/48, dt. 10 korrik 1948 dhe është i firmosur nga hfz. Bajram ef. Agani.[54]



S T A T U T I

I KOMUNITETIT TË FESË ISLAME TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SERBIS

Dispozitat e përgjitsëshme

Art.1

Pjestarët e Komunitetit të fesë Islame në Republiken Popullore të Sërbís përbajnë nji komunitet unik fetar.

Art.2

Qellimi i Komunitetit të fesë Islame âsht me ruejtë dhe zhvilluejeten fetare në radhët e pjestarëve t'Islamit. Komuniteti i fesë Islame mbërrinë qellimin e vet:

1) tue studjue fenë Islame,

2) tue u kujdesue për edukimin fetar dhe fetar-moral të pjestarëve të Komunitetit të fesë Islame,

3) tue mbajtë ligjërata fetare (vaze),

4) tue botue dhe përhapë libra dhe broshura fetare-morale,

5) tue formue dhe mbajtë xhamija, shkolla fetare dhe institute tjera fetare-arsimore dhe humane,

6) tue përgatitë nëpunësa fetarë dhe mesim-dhanësa fetare arsimore,

7) me çdo veprimtarí tjetër që ka për qellim ngritjen fetare dhe fetare-morale të pjestarëve të Komunitetit të fesë Islame në frymen e Islamit.

Art.3

Komuniteti i fesë islame predikon dhe mëson publikisht fene e vet, i kryen publikisht detyrat fetare dhe i udhëheqë e rregullon pamvarsisht punët e veta fetare, fetare-arsimore dhe të pasunís së vakfeve.

Art.4

Komuniteti i fesë Islame mbështetet në dispozitat e Islamit, në dispozitat e këtij Statuti dhe Statutit të Komunitetit të fesë Islame në Republiken Federative Popullore të Jugosllavís dhe në dispozitat tjera të prueme në bazë të Statutit, mbrenda kufijve të Kushtetutes së RFP të Jugosllavís dhe Kushtetutes së RP të Sërbís.

Art.5

Komuniteti i fesë Islame, organet dhe institutet e tij, çdo vakf veç e veç dhe qendrore e vakfit, si përsona juridike,

Nr. 5. Faksimile e Statutit të BFI të vitit 1948

[53] Statuti i Komunitet të Fesë Islame të Republikës Popullore të Serbisë, art.17.

[54] Shih: Statutin f. 13.

Pra, Bashkësia Fetare Islame në Kosovë integrohet dhe bëhet është pjesë përbërës-njësi e BFI-së në Jugosllavi. Territori i Kosovës për nga aspekti i organizimit administrativo-territorial të BFI-së, atëkohë përfshihej në kuadër të njësisë së ashtuquajtur Kuvendi i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës Populllore të Serbisë me seli në Prishtinë.

Në kuadër të këtij Kuvendi, në vitin 1959, u themeluan 13 Komisione Vakëfnore të kësaj Bashkësisë islame në Kosovë. Në 1959[55] u themeluan Komisionet Vakëfnore, në:

1. Prishtinë;
2. Vuçitërnë;
3. Podujevë;
4. Mitrovicë;
5. Pejë;
6. Gjakovë;
7. Prizren;
8. Ferizaj;
9. Gjilan;
10. Beograd;
11. Preshevë;
12. Novi Pazar; dhe
13. Prijepole.

Juridiksioni i këtyre komisioneve vakëfnore të BFI-së shtrihej në territorin e rrethit ose të kuvendit përkatës komunal. Shtrirja e komisioneve vakëfnore të BFI-së në territorin e kuvendit vakëfnor të RP të Serbisë ishte sa vijon[56]:

[55] Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë Fetare në Kosovë,* f. 53.

[56] Po aty. f. 53

Komisioni Vakëfnore	Shtirja
Kom. Vak. Prishtinë	Prishtinë, Lipjan, Drenas
Kom. Vak. Ferizaj	Ferizaj, Shtërpcë, Kaçanik
Kom. Vak. Podujevë	Podujevë, Orllan, Nish, Leskovc
Kom. Vak. Mitrovicë	Mitrovicë, Skenderaj, Leposavicë, Zubin Potok
Kom. Vak. Pejë	Pejë, Istog, Klinë
Kom. Vak. Gjakovë	Gjakovë, Deçan
Kom. Vak. Preshevë	Preshevë, Vranjë
Kom. Vak. Beograd	Serbia e ngushtë dhe Vojvodina

Ndërsa Komisionet Vakëfnore të Vuçitërnës, Prizrenit, Gjilanit, Novi Pazarit dhe Prijepoles, në këtë kohë, përfshinin vetëm territoret e rretheve të këtyre qendrave. Kuvendi Vakëfnor i BFI-së për RP të Serbisë në këtë kohë kishte bërë edhe emërimin e disa imamëve, kurse emërimi i imamëve të tjerë duhej të bëhej më vonë.[57]

Ndryshimet e lartpërmendura organizative e territoriale, si edhe emërimet e organeve të ndryshme bëheshin me qëllim përshtatjes së kushteve të reja të kohës. Ndryshimet e tilla vazhduan edhe në vitet pasuese.

Kështu, në kuadër të BFI-së të RS të Serbisë në territorin e Kosovës me kohë u formuan dhe ishin këto këshilla të BFI-së:

KBI Prishtinës, Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Kaçanikut, Ferizajt, Lipjanit, Suharekës, Prizrenit, Dragashit, Gjakovës, Istogut, Rahovecit, Skenderajt, Mitrovicës, Vushtrrisë, Podujevës dhe Gllogocit.[58]

Secili Këshill i BI-së shtrihej kryesisht brenda territorit të një komune. Këshilli i BI-së përbëhej nga një numër i pacaktuar i xhematëve, i cili varej nga xhamitë aktive, ngase çdo xhami ka xhematin e vet. Kështu Këshilli i BI-së së Prishtinës atëkohë kishte 37 xhemate, si më poshtë: "Sulltan Fatih", "Sulltan Murat", "Hatunije", "Jusuf Qelebi", "Mehmet Beg", "Ramadanie", "Sudi Efendi", "Kaderie", "Hasan Beg", "Alaudin", "Pirinaz", "Buzagi", si edhe xhematet e fshatrave Hajkobillë, Prapashticë, Keqekollë, Koliq, Grashticë, Makovc, Mramor-Suteskë, Raskovë, Marevc,

[57] Po aty, f. 54.

[58] Po aty, ff. 55-56.

Banja e Sjarinës, Kapit, Bellaqevc, Bellaqevc i Madh, Hamidie, Sllatinë, Miradie e Ulët, Miradie e Epërme, Barilevë, Milloshevë, Mazgit, Obiliq, Lismir dhe Hade.[59]

Këshilli i BI-së Gjilanit kishte 28 xhemate[60], ai i Prizrenit 60 këshilla të BI-së,[61] e kështu me radhë. Po shtojmë se në kuadër të Kuvendit të BI-së së RS të Serbisë me seli në Prishtinë bënin pjesë edhe Këshilli i BI-së së Preshevës, Bujanovcit, Nishit, Beogradit, Mali Zvornikut, Novi Pazarit, Tutinit, Prijepoles, Sjenicës, Pribojit dhe Këshilli i BI-së të Novi Varoshit e që nuk bëjnë pjesë në territorin e Kosovës.[62]

Në territorin e Kuvendit të Vakëfit RP të Serbisë, ku përfshihej edhe Kosova, vepronte Kryesia Islame me tre anëtarë, Drejtoria e Vakëfit me 30 këshilltarë nga gjithë territoret ku jetonin myslimanët, kurse selia e të gjitha organeve ishte në Prishtinë. Bashkësia e Fesë Islame, në pikëpamje administrative, ndahet në 26 Këshilla Vakëfnore të Qarkut dhe në 436 xhemate të imamëve.[63]

Jashtë Kosovës, ekzistonin 8 këshilla vakëfore dhe ato në: Beograd, Nish, Novi Pazar, Sjenicë, Priboj, Prijepole dhe në Nova Varosh.[64]

Përveç myslimanëve të shkollës juridike hanefite (sunite), myslimanët ishin të organizuar edhe në vëllazëritë mistike-tarikate të dervishëve. Në atë kohë në të gjithë territorin e Jugosllavisë vepronin 10 tarikate të regjistruara dhe atë kryesisht në Kosovë, në Maqedoni dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe ato ishin: Kaderi, Rifa'i, Sa'adi, Halveti, Nakshibendi, Bektashi dhe Noktaxhi (Melami). Si tarikate më me ndikim ishin tarikati Kaderi dhe Rufa'i. Sipas shënimeve. në Kosovë ishin 5400 myhib dhe 28 shehlerë.[65] Sipas vendimit të Ulema Mexhlisit në Sarajevë, gjatë vitit 1952 në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës janë mbyllur të gjitha teqetë aktive, kurse në Kosovë dhe Maqedoni ato kanë vazhduar punën.

---

[59] Po aty, ff. 54-55.

[60] Raport i Këshillit të Bl-së, në Gjilan, 1984.

[61] Raport i Këshillit të Bl-së, në Prizren, 1984.

[62] Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë Fetare në Kosovë,* ff. 54-55.

[63] Dr. Mendu Bamja, Pozita, vep. sit. f. 318

[64] Po aty, f. 318.

[65] Po aty, ff. 318-319.

Sipas regjistrimit të vitit 1950, në territorin e RP të Serbisë, kanë vepruar: 436 imamë, 25 vaizë (72 imamë kanë qenë pa punë) kanë vepruar 45 shehlerë, 92 myezinë, kurse në funksion kanë qenë 467 xhamia dhe 62 teqe. Sa i përket moshës, ajo ishte jashtëzakonisht jo e volitshme. Prej të gjithë hoxhallarëve dhe nëpunësve fetarë vetëm 37 % ishin në moshën prej 30-50 vjeçar, kurse të gjithë të tjerët ishin mbi moshën 50 vjeçare. Në grup-moshën prej 60-70 vjeçar kishte mbi 30% të hoxhallarëve dhe nëpunësve fetarë.[66]

- vijon -

[66] Po aty, f. 319.

Sulejman OSMANI

EDUKATA FETARE ISLAME DHE REFLEKTIMET E SAJ TEK INDIVIDI DHE SHOQËRIA

Abstrakt

Edukata fetare llogaritet si elementi përbërës që fisnikëron veprimet dhe sjelljet e besimtarit dhe i determinon ato. Ajo është tregues i masës së zbatimit të elementit edukativ, i cili bazohet mbi burimet bazë të Islamit, siç janë Kurani dhe Suneti i Muhamedit a.s. Shikuar nga aspekte të ndryshme, është e qartë se Islami ju qëndron besnik vlerave etike dhe në këtë është shumë konsistent. Në fakt, përkatësia islame nuk është e mjaftueshme nëse nuk respektohen kodet etike, pa të cilat besimi do të ishte një deklarim pasiv, i cili nuk reflekton në jetë dhe nuk i jep frytet e tij. Është e qartë se Islami nuk mund të realizojë synimet e ndikimit në jetë nëse edukata islame si një kod i vlerave universale nuk ka ndikimin e duhur në ecuritë e jetës. Edukata të cilën e synon Islami paraqet një ndikim të vazhdueshëm, i cili në mënyrë sistematike lëvizë drejt proceseve të cilat plotësojnë jetën duke realizuar ndikimin e duhur edhe në detajet më të imta.

Fjalët kyçe: *Edukata fetare, terbijje, shoqëri, edeb,* etj.

Islami i njeh vlerat edukative

Në parim, Islami ka njohur dhe i ka çmuar të gjitha vlerat ekzistuese të cilat nuk kanë ardhur në kundërshtim me mësimet e shpalljes. Si të tilla i ka konfirmuar dhe i ka vlerësuar, e madje edhe i ka lavdëruar duke ju dhënë ligjshmëri, me çka besimtarët e islamit me të drejtë mund t'i përvetësojnë ato. Parimet e Islamit nuk prihen nga urrejtjet, inatet e injorimi, përkundrazi ato e njohin të mirën dhe e stimulojnë atë. Ajo që është e mirë dhe e dobishme paraqet vlerë e cila çmohet pa marrë parasysh nga kush, ku dhe në çfarë periudhe kohore është bërë. Në periudhën e para shpalljes islame, Muhamedi a.s. kishte marrë pjesë në disa aktivitete të shoqërisë mekase e më pas duke e çmuar atë veprim kishte deklaruar se, edhe sot, në periudhën pas shpalljes, kur ishte Pejgamber me shumë dëshirë prapë do të merrte pjesë në aktivitete të tilla.[1]

Sipas logjikës së urrejtjes, të periudhës para islame, e njohur si injoranca, do të ishte e natyrshme të themi se Pejgamberi a.s. është dashur të distancohej nga veprimet e asaj kohe, çfarëdo qofshin ato, megjithatë ai nuk ishte i prirë nga botëkuptimet e tilla. Veprimet burrnore dhe vlerat e mirëfillta njerëzore janë mirësi të cilat i përvetëson Islami dhe janë pjesë e edukatës me përmasa simetrike.

Edukata islame si kod i sjelljeve

Edukata islame si një kod i sjelljeve dhe veprimeve, te ne është identifikuar me karakteristikat që reflekton në sjelljet e njerëzve qofshin ato të mira apo të këqija. Nëse dikush ka shprehur edukatë të mirë e kanë vlerësuar se ka "terbije", është me *terbije,* është *terbijeli* etj. Ndërsa në vlerësimin negativ e kanë mohuar dozën e edukatës duke thënë se nuk ka *terbije*, është pa *terbije* apo, nuk është *terbijeli*. Sigurisht që termi *"terbije"* në situata të tilla, në vlerësimin pozitiv apo negativ, ka bartur emërti-

[1] Është për qëllim pakti i lidhur në mes fiseve të Mekës, të cilat ngatërroheshin rreth Qabesë dhe më pas lidhën një pakt marrëveshjeje ku u zotuan se do të ndihmohen në mes veti për të mirën e të gjithëve. Do ta ndihmojnë të dëmtuarin dhe do të qëndrojnë përballë së keqes. Pakti i tyre kishte edhe pika të tjera obligative, të cilat duhet t'i respektonin të gjithë. Marrëveshjen e kishte dëshmuar edhe vet Muhamedi a.s., i cili atëbotë ishte në moshën 20 vjeçare. Shih: El Bejheki, *Es Sunen El Kubra*, nr. i hadithit (12110). Bejrut-Liban, 2003.

min e veprimeve të ndryshme, të cilat kanë një emër të përbashkët. Pra është një emër unik për shumë sjellje, karaktere e veprime. Mënyra se si sillemi, si flasim, si reagojmë, sa i respektojmë të tjerët, çfarë janë raportet tona me familjen dhe shoqërinë, sa jemi princip, sa jemi besnikë dhe kështu me radhë, të gjitha këto karaktere kanë të bëjnë me masën e ndikimit të edukatës islame te ne dhe së këndejmi paraqesin emëruesin e përbashkët të veprimeve të ndryshme.

Edukata islame si nocion dhe transformimi terminologjik

Termi التربية الإسلامية të cilin në gjuhën shqipe e përkthejmë si *edukatë islame* në funksionin e domethënies që përdoret në kohët e sotme, nuk ka qenë i njohur në periudhat e mëhershme. Si term, nuk e gjejmë të jetë përmendur as në Kuran e as në hadithet e Muhamedit a.s., e gjithashtu një terminologji të tillë nuk e gjejmë as te gjeneratat e para e as në periudhat e mëvonshme përgjatë shekujve të tërë. Andaj mund të konstatojmë se termi التربية që nënkupton edukatën është një terminologji e re e cila ka nisë të përdoret krejt vonë, në shekullin XX ,dhe ka ardhur si produkt i vendosjes së plan-programeve në institucionet arsimore.[2] Ky fakt, në asnjë rast nuk dëshmon mungesën e materies që trajton kjo fushë, ngase ajo ka qenë e pranishme dhe është zhvilluar në mënyrë sistematike, në të gjitha periudhat kohore, por këtu kemi të bëjmë vetëm me dallime terminologjike, që do të thotë se është njohur me emërtim ndryshe, ndërsa rrethanat kohore kanë ndikuar që në periudha të caktuara të transformohet në një emërtim tjetër.

Në Kuran dhe Sunet, procesi i edukimit është njohur me terma gjuhësor si يعلم – تعليم علم – që ka kuptimin e të mësuarit si proces e po ashtu edhe termi أدب – تأديب që nënkupton edukatën.

Allahu xh.sh. e ka dërguar Muhamedin a.s. për Pejgamber dhe e ka bërë të qartë misionin e tij shumëdimensional. Me urdhrin e Allahu, ai i ka kryer të gjitha detyrat e besimit, jo vetëm ato që kanë të bëjnë me obligimet personale si namazi, agjërimi e të tjera, por edhe interesa të tjera që

[2] Muhamed Munir Mursi, *Et Terbijetu-l islamijje-Usuluha ve tetavvuruha fil biladi-l arabijjetii*, botoi: Alemul Kutubi, Kajro, 2009, f. 48.

kanë të bëjnë me progresin jetësor dhe avancimin e të gjitha çështjeve. Kurrsesi nuk mund të thuhet se Islami angazhohet vetëm rreth realizimit të detyrave të fesë (ibadeteve) dhe se ky është i vetmi objektiv. Ajetet e Kuranit janë dëshmi e qartë se Muhamedi a.s. në kuadër të misionit të tij, gjithsesi ka pasur edhe qëllimet mësimore, aso që kanë të bëjnë me mësimin e gjërave të duhura rreth jetës, me theks të veçantë ato që kanë të bëjnë me mësimin dhe edukimin si dy çështje me interes jetik. Natyrisht, Islami çështjen e edukimit e sheh si një komponentë substanciale në gjithë veprimet e fesë dhe paraqet pigmentin i cili i jep ngjyrën e duhur si teorisë, ashtu edhe praktikës. Ky proces mësimi dhe edukimi ishte detyrë në misionin e të gjithë pejgamberëve dhe nisi që me Ademin, njeriun dhe pejgamberin e parë mbi faqen e dheut, me të cilin nisi procesi i mësimit duke identifikuar rrethin ku po jetonte dhe marrjen e njohurive të nevojshme, të cilat ia mësoi Allahu xh.sh.

Muhamedi a.s. dhe misioni i mësimit

Allahu duke sqaruar misionin e Muhamedit a.s. na tregon se ai ishte mësues dhe se të mësuarit si nevojë progresi ishte detyrë e tij. Këtë e gjejmë në shumë ajete të Kuranit ku në forma të ndryshme prezantohet qëllimi i dërgimit të tij.

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿١٦٤﴾

"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe ua mëson librin *(Kuranin)* ***e urtësinë*** *(diturinë e thellë fetare),* ***edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar."***[3]

[3] Al Imran, 164.

Allahu xh.sh na tregon se në kuadër të misionit të vahjit, Muhamedit a.s. i është dhënë detyra e mësimit të Kuranit e po ashtu edhe të njohurive të tjera.

Në lidhje me këtë, Kurtubiu thotë: "Detyra e mësimit (të mësuarit) i është vënë në përgjegjësi Muhamedit a.s., ngase ai i adreson çështjet pas shikimit të tyre dhe mëson metodën e trajtimit mbi bazën e asaj që ia ka mësuan Allahu nëpërmes shpalljes."[4]

Burimet e tjera të tefsirit sjellin komente edhe më të zgjeruara të cilat e bëjnë edhe më të qartë këtë domethënie të ajetit, veçanërisht pjesën وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ - ***dhe ua mëson librin*** *(Kuranin)* ***e urtësinë*** *(dituri-në e thellë fetare),* në të cilën konfirmohet misioni i tij edukativo-arsimor i Muhamedit a.s.

Në lidhje me këtë, imam Rraziu thotë se Allahu xh.sh e ka cilësuar Kuranin si udhëzues dhe ndriçues, ngase në të ka urtësi dhe fshehtësi, e pasi ka thënë se e ka dërguar Muhamedin a.s. që t'ua lexoj ajetet e Kur-anit, më pas ka përmendur detyrën e mësimit të fakteve dhe sekreteve të tij. Në vazhdim të komentit, Rraziu cek pjesën e ajetit ku Allahu thotë se Muhamedi a.s.: ***"i pastron nga gjynahet",*** ku sipas tij, ky pastrim ka dy kuptime:

1. Shkalla e pastrimit arrihet me leximin (e Kuranit) dhe mësimin e Islamit, pastaj me zbatimin e këshillave, urdhrave dhe ndalesave të cilat i bënte Pejgamberi a.s. Ai vetë bënte veprime të shumta në interes të besimtarëve, drejt realizimit të pastrimit nga mëkatet si dhe ndërmarrjen e veprimeve drejt kritereve të imanit dhe punëve të mira. Këtu qëndron arsyeja kur Allahu e ka lavdëruar atë se është në shkallë të lartë të moralit dhe se atij i janë dhënë vlerat më fisnike .
2. Pastrimi i cekur në ajet ka të bëjë me dëshminë që Muhamedi a.s. e bënë për besimtarët në ditën e daljes para Allahut, kue i Dërguari a.s. do të dëshmojë për pastërtinë e tyre ngase është në pozitën e dëshmitarit të veprave të tyre.

[4] El Kurtubi, *El Xhamiu li Ahkami-l Kuran,* Bejrut 2006, vëll. 2, f. 125.

Gjithnjë sipas Rraziut, mendimi i parë është më i arsyeshëm dhe më i saktë ngase të gjitha arrihen me procesin e leximit të ajeteve të Kuranit dhe mësimeve të tij, të cilat avancojnë në të gjitha fushat e jetës.[5]

Është me interes të cekim se teksti i këtij ajeti kuranor, konfirmon tre faktorët bazë për arritjen e dijes, të mësuarit dhe karakteret e edukatës, të cilët mbështeten në mësimet islame të bazuara në Kuran dhe Sunet. Edhe në ditët e sotme metodologjia shkencore e të mësuarit dhe arritjes së njohurive njeh këta faktorë bazë: 1. Leximin si fazë fillestare 2. Mësimin e njohurive 3. Mësuesin si autoritetin përgjegjës për udhëheqjen e ecurisë mësimore.

Në tekstet e Kuranit termi التربية është shprehur me termin التعليم, ngase ky i fundit detyrimisht ka nënkuptuar edukatën si proces të pandashëm me mësimin, ngase koncepti i edukimit nuk mund të ndahet nga ai i mësimit. Elementi edukativ gjithsesi duhet të jetë substancë e materies mësimore e cila duhet të reflektojë ndikime morale në karakterin e individit dhe të shoqërisë.

Të tillë, me këtë domethënie, e gjejmë në shumë thënie të Muhamedit a.s. si në hadithit ku siç tregon Othmani r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë: خيركم من تعلم القرآن وعلمه *"Më i miri nga ju është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve."*[6]

Hadithi në fjalë, në radhitjen tekstuale, është transmetuar me ndërtime të ndryshme si fjali, por domethënia unike ka të bëjë me lavdërimin e mësimit dhe të mësuarit, duke kërkuar transformimin nga niveli personal në atë shoqëror, nga njëri në tjetrin.

Kjo thënie e Muhamedit a.s. e përshkruan vlerën e mirësisë ndaj të gjithëve, atij që vetë e mëson Kuranin, pastaj atë dije ua mëson edhe të tjerëve. Pra, konfirmon mësimin dhe interpretimin e diturisë. Në këtë kuptim duke analizuar komentet e ndryshme rreth domethënies së hadithit, në lidhje me vlerën e epërsisë së shprehur, Ibën Haxheri thotë se kjo epërsi e cekur në hadith ka të bëjë me shpërndarjen e diturisë pas procesit të mësimit në nivelin individual. Kështu, ai që i mëson të tjerët, realizon

[5] Fahrudin Er Rrazi, *Et Tefsiru-l Kebir*, Bejrut, 1981, vëll. 1, f. 62.

[6] El Buhari, *El Xhamiu-s-Sahih* nr. (5027); Ahmedi në *Musned*, vëll. 1 ff. 385-386; Ebu Davudi nr. (1452); Tirmidhiu nr. (2907).

interes të përgjithshëm, andaj dobia është shumë më e madhe sesa në rastin e mësimit vetëm për nevoja personale. Nuk ka dyshim se dituria më fisnike është mësimi i të tjerëve e në këtë situatë kjo është dëshmi se personi ka arritur aftësimin personal, e në këtë rast janë bashkuar shumë faktorë për shkak të së cilëve ka merituar një vlerësim të tillë. Kjo ka të bëjë me faktin se objekt mësimi është Kurani, e dihet se sa vlerë ka leximi, mësimi dhe masivizimi i një diturie të tillë. Sipas hadithit, ai që mëson diturinë dhe atë ua mëson të tjerëve, veç e ka plotësuar vetveten me elementët më të mirë, andaj e ka merituar këtë vlerësim.[7]

Në anën tjetër termin الأدب (el edebu) në kuptim të edukatës e gjejmë në shumë hadithe të Muhamedit a.s., të cilat shprehin kujdesin ndaj karakterit dhe formimit moral. Në njërin nga ta, duke tërhequr vëmendjen e prindit ndaj edukatës së fëmijëve Pejgamberi a.s. thotë:

قال رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مَا نَحَلَ وَالِدٌ وَلَدًا مِنْ نَحْلٍ أَفْضَلَ مِنْ أَدَبٍ حَسَنٍ

"Prindi nuk mund t'i japë fëmijës dhuratë më të vlefshme sesa edukatën e mirë."[8]

Kjo thënie e të Dërguarit të Allahut, në plan të parë ka vendosur vlerat morale për të cilat duhet të kujdeset prindi për fëmijën e vet, pra ta edukoj mbi këto parime. Është e mundur që interesat e ndryshme të zhvendosin vëmendjen e prindërve te faktorët e tjerë, të cilët realizojnë synime të caktuara qofshin edhe afatshkurtra, e në anën tjetër të anashkalojnë vlerat afatgjate të cilat paraqesin garanci për formim të shëndosh në të gjitha sferat e jetës. Andaj edukata e mirë të cilën prindi duhet t'ia bëjë fëmijës është dhurata më e vlefshme që ai mund t'ia jap atij. Edukata e mirë është kurora e mirësive dhe është më e vlefshme se të gjitha interesat materiale apo përfitimet e ndryshme çfarëdo qofshin ato. Edukata është garanci e karakterit moral, njerëzisë, shembullit më të mirë, vlerave njerëzore, sinqeritetit, devotshmërisë dhe përgjegjësisë së duhur ndaj Allahut dhe krijesave të Tij.

---

[7] Ibën Haxher el Askalani, *Fet'hul Bari*, botoi: Daru-r-Rrejjan li-t-turath, Kajro, 1987, vëll. 8, f. 692, nr. (5027).

[8] Tirmidhiu, nr. 1952; Imam Ahmedi në *Musned* nr. 14977.

"El-Edebu" si term edukativ dhe letrar

Është me interes të sqarojmë se termi i gjuhës arabe الأدب bart dy domethënie, duke ju referuar fushave të ndryshme:

E para, ka të bëjë me edukatën morale الأدب المراد به الخلق, e cila përfshinë normat morale, karakterin dhe mirësjelljen, ashtu siç jemi duke e shtjelluar në këtë punim.

E dyta, ka të bëjë me letërsinë الأدب الذي يراد به الرواية që përfshinë të gjitha gjinitë letrare.

Një dyzim të tillë duhet hulumtuar nga konteksti kohor e që ka të bëjë me periudha shumë të hershme, kur kalifët dhe paria, përzgjidhnin mësues që t'ua mësonin fëmijët e tyre. Mësuesi quhej *"Mued-dib"* مؤدب, si emër i cili rrjedh nga lënda të cilën e mësonte: *"El-Edebu"* الأدب, ndërsa ai në rolin e pedagogut zotëronte aftësitë e të mësuarit të materies fetare si edukatë e po ashtu edhe gjinitë e ndryshme letrare. Këtë domethënie e kuptojmë edhe sot nga termi *"El-Edebu"* الأدب , andaj mund të jetë edukatë morale e mund të jetë edhe letërsi, varësisht cilës i referohemi dhe çka kemi për qëllim.[9]

Emërtimi i kësaj lënde, si një produkt i ri, duke u përshtatur me nevojat e kohës dhe ndryshimet e ndodhura në shoqëri, ka hapur një pikëpamje tjetër të saj, andaj edhe në këtë aspekt e gjejmë në dy shtrirje:

E para: Edukata islame si një proces edukimi me qëllim ndikimi në individin dhe shoqërinë, e që ka për qëllim vlerat morale dhe karakteret në sjellje e veprime, e gjithë kjo duke u bazuar në mësimet e Islamit të bazuara në Kuran dhe Sunet, gjithashtu duke ndjekur shembujt më të mirë nga gjeneratat më të vlefshme të umetit në të gjitha periudhat e tij. Në periudhat më të hershme ishte shprehur me terma të ndryshëm, të cilët nuk paraqisnin më tepër se dallime terminologjike, ngase të gjithë kishin domethënien e zhvillimit, shtimit, përkujdesjes, ruajtjes së resurseve njerëzore, kujdesit ndaj njeriut dhe shoqërisë, orientimit të politikave zhvillimore, veprimit

[9] Mikdad Jalxhin, *Et-Terbijjetu-l ahlakije el Islamije*, botoi: Daru-l Alemi-l kutubi, f. 22.

të shtuar për jetësimin e reformave, përmirësimin e kualitetit të jetës, kujdesit të shtuar për procesin mësimor e të tjera.[10]

E dyta: Studimi i *edukatës islame* si lëndë mësimore e cila zë vend të duhur në plan-programet shkollore në gjithë botën islame e edhe më gjerë. Kjo nevojë i ka dhënë një fizionomi të re kësaj lënde dhe e ka transformuar në emrin e ri: *"Et-Terbijjetul Islamijje"* التربية الإسلامية me të cilin e njohim sot. Natyrisht se nga kjo pikëpamje studiohet një rreth shumë më i ngushtë i materies së saj, sidomos në krahasim me shtrirjen që ka në botëkuptimin tradicional. Ndoshta në paraqitjen e re përpos qëllimit edukativ ka marrë edhe dimensione kulturore e historike të trashëgimisë islame.

Megjithatë, duhet të themi se edukatën islame edhe nëse e marrim si terminologji të hershme tradicionale *"El-Edebu"* الأدب apo sipas përdorimit të ri *"Et-Terbijjetu"* التربية, në parim nuk ka ndryshuar asgjë dhe materia e saj është po e njëjta. Natyrisht duke cekur avancimet ka bërë në trajtimin e saj si pjesë e plan-programeve mësimore në nivele të ndryshme mësimi e studimi.

Edukata islame i referohet normave të besimit

Termi *"Et Terbije"* të cilin në gjuhën shqipe e përkthejmë si *"Edukatë",* rrjedh nga rrënja e foljes e cila ka kuptimin e shtimit, ruajtjes, zotërimit dhe pronësisë së një përgjegjësie, e cila zakonisht në kuptim, krijon një lidhje gjinore e përkatësie, sikur në rastet kur themi: رب البيت (i zoti i shtëpisë). Në këtë kuptim përdoret në një shtrirje shumë të gjerë dhe në forma të ndryshme të cilat ndërtojnë kuptime foljore të dëshiruara.

Një nga emrat e bukur të Allahut është edhe emri الرب (Er Rrabu), i cili rrjedh nga kuptimi i së njëjtës folje dhe po ashtu na jep të njëjtën domethënie. Allahu është Zotëruesi, Edukuesi, Sunduesi, Rregulluesi i çdo gjëje, Ai që jep mirësitë, Ai që i shton ato në vazhdimësi.

Në kuptimin e asaj që e thamë, na bëhet e qartë se edukata islame ka objektiva të cilat burojnë nga rrënja e besimit e që lidhen me domethëni-

[10] Halid Hamid el Hazimi, *Usulu-t-terbijjti-l Islamijjeti*, botoi: Daru-l Alemi-l kutubi, f.18.

en e njërit nga emrat më të bukur të Allahut. Karakteret e kësaj edukate synojnë të realizojnë dëshirën dhe vullnetin e Allahut te robërit e Tij. Besimtari duhet ta ketë të qartë se Allahu është Ai që ka vendosur normat e edukatës së Tij dhe se Ai e do zbatimin e tyre në jetë. Një besim i tillë synon realizimin e objektivave mësimore, edukative, shoqërore, politike, ekonomike, ideore, mendore e shpirtërore duke pasur parasysh kujdesin ndaj zhvillimit trupor, zemrës së tij, qenies shpirtërore, sjelljeve në shtëpi, rrugë, në vendet e punës, në fushë, në shoqëri, në shtet dhe në mbarë botën. Kjo nënkupton ngritjen, formimin dhe përgatitjen e njeriut për të realizuar qëllimin e krijimit si udhëheqës në tokë.[11]

Pra, masa e jetësimit të edukatës islame në jetën tonë është tregues se sa ne i praktikojmë mësimet islame, të cilat në parim kanë për qëllim zbatimin e misionit hyjnor. Sjelljet e njeriut janë tregues për masën e ndikimit të besimit, andaj ai duhet të reflektoj në ato me kujdesin dhe përgjegjësinë më të madhe. Këtu qëndron arsyeja kur shumë herë në gjuhën e sheriatit veprimet apo detyrat e besimit quhen "iman" duke identifikuar vetë besimin. Është normale të themi se edhe në fusha tjera, elementë të caktuar identifikojnë origjinën e kjo është një realitet edhe në vlerësimin e trungut të islamit dhe shtrirjes së degëve të tij. Degët e zgjatura kanë bazën te trungu. Me të njëjta rreze veprimi matet edhe edukata islame e cila është treguese e besimit të individit, i cili realisht do të duhej të ishte në relacion të drejtë veprimi me të.

Nevoja për edukatën islame

Edukata islame synon rregullimin e sjelljeve dhe karaktereve të individit me qëllim të realizimit të interesave individuale e shoqërore. Objektivat e saj kanë për qëllim ofrimin e zgjidhjeve për shumë probleme me të cilat ballafaqohen shoqëritë e ndryshme si në të kaluarën po ashtu edhe në të tashmen, e të cilat lidhen me natyrën edukative. Reformat e tilla kërkojnë zgjidhjen në Kuran dhe Sunet, si dy burimet bazë për të gjitha problemet e mundshme, dhe për këtë qëllim, ofrohen praktikat më të mira

[11] Abdulmunim el Hanefi, *Texhel-lijat fi Esmail-lahi-l Husna*, botoi: *Mektebetu-l Medbuli*, Kajro, 1417 h.-1996 e.r., f. 46.

me modele nga jeta e gjeneratave më të vlefshme dhe më të çmuara të umetit. Edukata islame ofron shembullin personal nga jeta e dijetarëve dhe njerëzve të devotshëm të cilët janë të shumtë në këtë umet. Edukata islame është insistuese në ndryshime dhe reforma të cilat synojnë progresin e vazhdueshëm.

Dimensionet e ndikimit të edukatës islame

Edukata islame ka një shtrirje të gjerë, e cila përfshinë të gjitha fushat dhe asnjëherë nuk heq dorë nga ndikimi në të gjitha çështjet e jetës. Islami e ka bërë pjesë të fesë elementin edukativ dhe në momentin që ky element nuk është prezent, atëherë veprimi më shumë ngjanë një formaliteti. Zakonisht elementi edukativ është diçka që shihet dhe vërehet nga të tjerët andaj ka një ndikim të drejtpërdrejtë në vlerësimin e sinqeritetit të individit dhe është tregues për masën e saktë të kryerjes së veprimit. Edhe në teori edhe në praktikë, Islami kërkon nga besimtarët që të gjitha detyrat dhe veprimet t'i kryejnë duke respektuar normat edukative pa bërë përzgjedhjen e tyre në mënyrë selektive. Kryerja e një detyre, cilado qoftë ajo, nuk mjafton nëse nuk u bindet urdhrave të Kuranit dhe Sunetit të cilat në mënyrë ta saktë përcaktojnë detyrat e besimtarëve. Në këtë aspekt, edukata islame përcakton nivelin e vetëdijes së tij si besimtar dhe mbi bazën e kësaj njohje ai zbaton të gjitha obligimet e kërkuara.

Se edukata islame nënkupton kryerjen e të gjitha detyrave pa bërë dallim në mes tyre kemi për argument ajetin kuranor ku Allahu thotë:

لَّيْسَ الْبِرَّ أَن تُوَلُّوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ وَآتَى الْمَالَ عَلَىٰ حُبِّهِ ذَوِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسَاكِينَ وَابْنَ السَّبِيلِ وَالسَّائِلِينَ وَفِي الرِّقَابِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَالْمُوفُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا عَاهَدُوا ۖ وَالصَّابِرِينَ فِي الْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ وَحِينَ الْبَأْسِ ۗ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ صَدَقُوا ۖ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُتَّقُونَ ﴿١٧٧﴾

"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është** (cilësi) **e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e

vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zeqatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun."[12]

Në lidhje me komentin e këtij ajeti, Ibën Kethiri thotë se një burrë kishte ardhur te Ebu Dherri dhe e kishte pyetur: "Ç'është imani?" Ebu Dherri iu përgjigj duke i lexuar këtë ajet derisa arriti në fund. Burri i tha se unë nuk të pyeta se ç 'është mirësia! Atëherë Ebu Dherri i tregoi atij për rastin kur një burrë kishte ardhur te Muhamedi a.s. dhe e pyeti për të njëjtën çështje për të cilën ti më pyete mua, e Pejgamberi a.s. ia lexoi ajetin e njëjtë. Pyetësit nuk i pëlqeu ashtu siç nuk të pëlqeu ty. Atëherë Pejgamberi a.s. duke bërë me shenjë me dorën e tij tha: *"Besimtari kur bënë një punë të mirë, gëzohet dhe shpreson në shpërblimin e saj, ndërsa kur bënë një të keqe mërzitet dhe frikësohet nga dënimi i saj."*[13]

Me rastin e ndryshimit të kibles kategori të ndryshme nga jobesimtarët e së bashku me ta edhe mynafikët, ngritën zërin e refuzimit me qëllim tendence duke përqeshur kalimin nga një drejtim në tjetrin. Ata e bënin këtë me qëllim përfoljeje dhe denigrimi të veprimeve të besimtarëve me në krye Muhamedin a.s.

Në përgjigje të pozicionimit të tyre, Allahu xh.sh. zbriti këtë ajet kuranor me të cilin gjykoi atë që thanë ata, duke u sqaruar se mirësia nuk dëshmohet vetëm me kthimin drejt lindjes apo perëndimit por ajo shprehet duke u përgjigjur në detyrimet e tjera, të sqaruara në vazhdim të ajetit dhe se e tërë çështja ka të bëjë me kulturën dhe edukatën fetare e cila në ju, mbjell besimin dhe bindjen e paluhatshme në Allahun dhe urdhrat e Tij. Besimi i sinqertë dhe i plotë nuk ndalet dhe nuk mjafton me kryerjen e njërës apo disa detyrave cilado qofshin ato, në të kundërtën besimtari matet me masën e bindjes dhe pasimit të asaj që besimi kërkon prej tij. Kjo është tregues sinjifikant i kulturës dhe edukatës së besimtarit në raport me Allahun xh.sh.

---

[12] El Bekare, 177

[13] Ibën Kethir, *Tefsirul Kuranil Adhim*, Bejrut, 1419 h., vëll. 1, f.485.

Përmbyllje

Në përfundim të këtij punimi, mund të konkludojmë se në parim, edukata fetare islame është shumë e rëndësishme dhe këtë për disa arsye, të cilat do t'i cekim në vazhdim:

1. Edukata islame është garantuese e mbjelljes së vlerave të larta në shoqëri, të cilat kanë për produkt reformat shoqërore në të mirë të të gjithëve. Ndërton karaktere mbi bazën e të cilave njerëzit e duan të mirën dhe dinë ta çmojnë atë e në anën tjetër, dinë të dallojnë të keqen dhe të largohen prej saj.
2. Krijon raporte të shëndosha në mes njerëzve të cilët njihen në mes veti mbi bazën e edukatës unike, e cila ka parime të njëjta. Një shembull më të qartë e kemi te përshëndetja islame e cila është unike për mbarë myslimanët, pa marrë parasysh dallimet në mes tyre, ata përshëndeten me selam.
3. Edukata islame ndërton një karakter serioz, ngase besimtari rritet me një edukatë të tillë, andaj ajo për të është diçka e natyrshme dhe e nevojshme. Me udhëzime të tilla, ai mësohet që në vegjëli dhe rritet me to, kështu që ato bëhen të zakonshme. Këtu qëndron arsyeja pse gjejmë një numër të madh hadithesh që flasin mbi nevojën e edukimit të fëmijëve dhe këtë ta bëjmë që në periudhat e hershme të jetës së tyre.
4. Është shumë e rëndësishme që njeriu të jetojë konform disa rregullash dhe të ketë mentalitet të respektimit të tyre. Serioziteti në gjëra të mëdha mësohet duke i respektuar ato të kategorive më të ulëta. Çdo gjë e cila mësohet në vegjëli zë vend në qenien e njeriut dhe në bazë të tyre, ndërton personalitetin e së ardhmes, natyrisht mbi bazën e edukatës së marrë nga parimet e fesë.
5. Edukata fetare krijon një imunitet me të cilin njeriu më lehtë përballon sfidat e jetës dhe ballafaqimin me to. Në jetë, sprovat janë të shumta dhe të ndryshme andaj gjithmonë ekziston rreziku i devijimit nga rruga apo qëndrimi i drejtë. Në shumë raste dështimet e momentit apo humbjet e caktuara mund të paraqesin rreziqe të cilat nuk riparohen lehtë. Edukata islame jep përgjigje të duhur me të cilat njeriu fshin lotët dhe ndal dridhjet e zemrës apo edhe rrëshqit-

jen drejt tatëpjetës edhe në situatat më të rënda. Sa të shumta janë ajetet dhe hadithet të cilat na nxisin për durim e maturi, me rastin e sprovave dhe dhimbjeve të mëdha, duke na bërë të qartë se Allahu është Ai që jep shpërblimin më të lartë, duke treguar se është me ta si në dhimbje, ashtu edhe në shpërblim. Këto fakte besimtari i mëson me kohë, ngase i ka pjesë të kulturës e të cilat i ka marrë nga edukata islame.

6. Mësimet islame japin përgjigje në çështje të thella, të cilat mendja e njeriut nuk mund t'i përthekojë. Fenomeni i jetës dhe vdekjes, jeta në botën tjetër dhe ndodhitë në të, paraqesin një sfidë për mendjen e lirë e cila me limitet e saj nuk mund të jap një përgjigje të duhur. Besimtari i edukuar mirë, çështjet e tilla i ka të qarta, ngase i ka mësuar në periudhat e ndërtimit të karakterit të tij dhe atë qysh në periudha të hershme të jetës së tij.
7. Mendimi pozitiv është një faktor shumë i rëndësishëm i cili ofron zgjidhje edhe atëherë kur të shtyrë nga e keqja mund të godasim dikë, ndoshta edhe pa faj e pa mëkat. Mendimi pozitiv i jep jetës një impulsi të duhur, për të gjykuar drejt e mbarë pa u ngutur në vlerësime, që për bazë mund të kenë hamendjen dhe akuzat e pa argumentuara, e të cilat mund të bëhen shkaktarë për raporte jo të mira njerëzore. Shumë herë, për një sjellje jo aq me peshë e cila mund të mos kishte vëmendjen e duhur, mund të mbetemi pa dashurinë e të afërmeve tanë, duke shkaktuar prishje dhe ftohje të raporteve, pothuajse për asgjë. Prandaj, përfillja e normave të edukatës islame, ndërton mendimin pozitiv me një diametër shumë të gjerë veprimi.

Literatura:

- El Bejheki, *Es Sunen El Kubra,* Shtëpia botuese: *Darul kutub el ilmije*, Bejrut- Liban, 2003.
- Muhamed Munir Mursi, *Et Terbijetu-l islamijje-Usuluha ve tetavvuruha fil biladi-l arabijjetii*, Shtë pia botuese: Alemul Kutubi, Kajro, 2009.
- El Kurtubi, *El Xhamiu li Ahkami-l Kuran,* botoi, *Muessesetu er-Rrisale*, Bejrut- Liban 2006.
- Fahrudin Er Rrazi, *Et Tefsiru-l Kebir,* botoi: *Darul Fikër,* Bejrut- Liban viti 1981.
- El Buhari, *El Xhamiu-s-Sahih,* botoi: *Daru Tavk en nexhat,* Bejrut, 1422 h.
- Ebu Davudi, Bejrut, 2010..
- Tirmidhiu, Kajro, 1975
- Musnedi i Imam Ahmedit, Rijad, 2013.
- Ibën Haxher el Askalani, *Fet'hul Bari,* botoi: *Daru-r-Rrejjan li-t-turath,* Kajro, 1987.
- Mikdad Jalxhin, *Et-Terbijjetu-l ahlakije el Islamije,* botoi: *Daru-l Alemi-l kutubi,* Rijad, 2002.
- Halid Hamid el Hazimi, *Usulu-t-terbijjti-l Islamijjeti,* botoi: *Daru-l Alemi-l kutubi,* Rijad, 200٠.
- Abdulmunim el Hanefi, *Texhel-lijat fi Esmail-lahi-l Husna*, botoi: *Mektebetu El Medbuli,* Kajro, 1417 h.-1996 e.r.
- Ibën Kethir, *Tefsirul Kuranil Adhim,* Bejrut, 1419 h.

Dr. Sulejman OSMANI

RELIGIOUS EDUCATION AND ITS REFLECTION ON THE INDIVIDUAL AND THE SOCIETY

(Summary)

Religious (Islamic) education is a constituent which ennobles the actions and behaviour of the believers and determines them. It shows the measure in which the educational element, which is based on the fundamental sources of Islam (the Qur'an and the Sunnah), is applied.

Such actions can be observed in the behaviour and character of the individual and the society.

It is obvious that Islam cannot achieve its objective to influence life if religious education, as a set of universal values, does not have the necessary influence on the trends of life. The education, aspired by Islam, represents a constant influence, which in a systematic way moves towards processes which are life-fulfilling exerting necessary influence on the slightest details.

سليمان عثماني

التربية الدينية وآثارها لدى الفرد والمجتمع

(خلاصة البحث)

التربية الإسلامية تُعتبر عنصرا يكرس أعمال وسلوك المؤمن ويحددها. وإذا نظرنا إلى الواقع، فهي مؤشر على مدى تنفيذ العنصر التعليمي القائم على المصادر الأساسية للإسلام والقرآن وسنة محمد صلى الله عليه وسلم. يتم تحديد مثل هذه الإجراءات في السلوكيات وشخصية الفرد وكذلك سلوكيات المجتمع.

ومن هذا المنطلق، فمن الواضح أن الإسلام لا يمكن أن يحقق أهدافه في تأثيره في الحياة إذا لم يكن للتعليم الديني الإسلامي كمنظومة للقيم العالمية له التأثير المناسب على مسارات الحياة. إن التربية التي يسعى إليها الإسلام تمثل تأثيراً ثابتاً الذي يُحرك بشكل منهجي نحو عمليات تُكمل الحياة من خلال تحقيق التأثير الصحيح حتى في أدق التفاصيل.

Prof. asoc. dr. Isa MEMISHI

TRANSKRIPTIMI I ALFABETIT ARAB ME ALFABETIN E GJUHËS SHQIPE

Abstrakt

Transkriptimi synon të rindërtojë shqiptimin origjinal të fjalëve, duke përdorur alfabetin e një gjuhe tjetër, kurse transliterimi synon të prezantojë formën origjinale të grafemave të tekstit origjinal me grafemat e gjuhës së synuar, në rastin konkret me grafemat e gjuhës shqipe. Transkriptimi dhe transliterimi po përjetojnë rritje të ndjeshme për shkak të ndikimit gjuhësor gjithnjë e më shumë të internetit dhe nevojave eksponenciale në fushën e rikthimit të informacioneve ndërgjuhësore. Kjo dukuri është veçanërisht për gjetjen e transkriptimit adekuat të emrave të personave, vendeve, kompanive, organizatave, etj. Por, këto subjekte kanë një numër formash, varësisht nga gjuhët dhe vendet. Rasti i transkriptimit të alfabetit arab ilustron këtë situatë komplekse dhe këtë shumëllojshmëri. Në këtë artikull, ne do të paraqesim shkurtimisht vështirësitë teorike dhe praktike që lindin gjatë transkriptimit të alfabetit arab me karaktere të alfabetit të gjuhës shqipe, si dhe zgjidhjet e mundshme që mund t'i zgjidhin këto vështirësi.

Fjalët kyçe: *Transkriptimi, alfabeti arab, transkriptimi fonologjik, transkriptimi praktik*

Me termin *transkriptim* nënkuptojmë përfaqësimin e shkrimit burimor të një gjuhe në një gjuhë tjetër të synuar, në atë mënyrë që të pasqyrojë shqiptimin e gjuhës së origjinalit, e shpeshherë duke injoruar korrespondencën e grafemave.

Transkriptimi dhe transliterimi po përjetojnë rritje të ndjeshme për shkak të ndikimit gjuhësor gjithnjë e më shumë të internetit dhe nevojave eksponenciale në fushën e rikthimit të informacioneve ndërgjuhësore. Kjo dukuri është veçanërisht për gjetjen e transkriptimit adekuat të emrave të personave, vendeve, kompanive, organizatave, etj. Por, këto subjekte kanë një numër formash, varësisht nga gjuhët dhe vendet. Rasti i transkriptimit të alfabetit arab ilustron një situatë mjaft komplekse dhe me shumëllojshmëri.

Me transkriptim synohet që të rindërtohet shqiptimi origjinal duke përdorur alfabetin e gjuhës tjetër, kurse me transliterim synohet që të prezantohen në formën origjinale grafemat e tekstit të origjinalit me grafemat e gjuhës së synuar, në rastin konkret me grafemat e gjuhës shqipe.

Për të ardhur deri te këto synime, ka sisteme fonologjike të transkriptimit dhe grafema standarde të transliterimit. Këto sisteme standarde konvencionale janë të shumta dhe komplekse. Sa më i madh të jetë dallimi mes gjuhës së tekstit dhe gjuhës së synuar, aq më kompleks është edhe sistemi.

Për transkriptimin e alfabetit arab ka disa standarde, si EI (1960), ISO. R ISO / R 233 (1961) OKB i hartuar nga grupi i ekspertëve të Kombeve të Bashkuara, e që i dedikohet emrave gjeografikë, (1972), ISO 233 (Organizata Ndërkombëtare për Standardizimi, 1984), dhe ALA-LC (Shoqata e Bibliotekave, 1991).

Pra, siç shihet ekzistojnë transkriptime, për të cilët mund të thuhet se janë standardizuar në shumë shkolla të studimeve orientale. Në mesin e tyre është edhe sistemi DMG ose ZDMG, shkurtesë e *Deutsche Morgenländische Gesellschaft*, apo *Zeitschrift der Deutschen Morgenländischen Gesellschaft*, revistë e Shoqatës së Orientalistëve Gjermanë.

Komuniteti shkencor përdor dy nga këto standarde: standardin ZDMG (tabela nr.3) dhe standardin e miratuar nga Enciklopedia e Islamit (EI), botimi i parë 1913-1938 dhe botimi i dytë 1960-2005.

Sistemi i transkriptimit EI (tabela nr.2), pra i Enciklopedisë Islame është identik me sistemet në vijim:

- BGN [1] i miratuar në vitin 1946;
- PCGN [2] i miratuar në vitin 1956;
- UNGEGN[3] i miratuar në vitin 1956;
- IGN [4] i miratuar në vitin 1973.
- ADEGN [5]. Ky sistem ndryshon nga sistemi UNGEGN vetëm në transkriptimin e bashkëtingëllores ظ . Derisa sistemi UNGEGN këtë bashkëtingëllore e transkripton ẓ, sistemi ADEGN e transkripton me dyshkronjëshin dh. Këtë mënyrë të transkriptimit të bashkëtingëllores ظ e kam propozuar edhe gjatë transkriptimit të alfabetit arab me alfabet të gjuhës shqipe.
- IJMES. [6]

Sistemi *DMG* (tabela nr.3) i transkriptimit të alfabetit arab zbatohet edhe nga këto institucione:

- DIN 31635 (Deutsches Institut für Normung, 1982);
- Hans Wehr transliteration [7] (1961, 1994)
- EALL[8], sistem i transkriptimin të Encyclopedia of Arabic Language and Linguistics;

---

[1] BGN - United States Board on Geographic Names është një organ federal që vepron në kuadër të Sekretariatit të Brendshëm të Shteteve të Bashkuara, që ka për qëllimi të krijojë dhe të mbajë përdorimin uniform të emrave gjeografikë.

[2] PCGN është organ këshillëdhënës për Qeverinë Britanike mbi politikat dhe procedurat për shkrimin e drejtë të emrave gjeografikë për vende dhe veçoritë e tyre jashtë Mbretërisë së Bashkuar

[3] UNGEGN - United Nations Group of Experts on Geographical Names është ekip i ekspertëve pranë Kombeve të Bashkuar, i cili merret me shkrimin e emrave gjeografikë kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky këshill çdo pesë vjet mbanë Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Standardizimin e Emrave Gjeografikë, e që për transkriptimin e emrave gjeografikë të botës arabe përdor transkriptimin e dhënë në tabelën nr. 2.

[4] Instituti i Informacionit Kombëtar Gjeografik dhe Pyjor.

[5] Ky sistem i transkriptimit është propozuar nga delegacioni arab pranë Kombeve të Bashkuara në Konferencën për standardizimin e emrave gjeografikë në vitin 2002 në Berlin.

[6] International Journal of Middle East Studies.

[7] Ky sistemi i transkriptimit të alfabetit arab është zbatuar në fjalorin e Hans Wehr.

[8] Departamenti për Studime të Gjuhëve dhe Letërsisë së Azisë Lindore në Universitetin e Pittsburghut.

- ISO International standard ISO 233, është një sistem për transkriptimin e alfabetit arab.

Ky standard ISO 233-2 është plotësuar në vitin 1993. Ky standard për dallim nga standardi ZDMG ka shtesë edhe transkriptimin e mbaresës së emrave të gjinisë femërore e ashtuquajtur *tāu-l-merbūta*. Kjo mbaresë është transkriptuar me ẗ.

Karshi dy tipave të transkriptimit kemi edhe transkriptimin e alfabetit arab të cilin e zbatojnë gjuhët e ndryshme evropiane, që për alfabet kanë alfabetin latin. Ne, me këtë rast, karshi dy versioneve që në një mënyrë apo tjetër janë pranuar nga shumë shkolla të studimeve orientale, disa shkolla të tjera, për transkriptimin e alfabetit arab gjithmonë kanë marrë parasysh edhe karakteristikat e gjuhës së tyre. Për të ilustruar këtë, do të prezantojmë transkriptimin e alfabetit arab që përdoret në publicistikën e gjuhës spanjolle dhe italiane. (tabela nr. 4 dhe nr. 5). Duke u mbështetur në përvojat e këtyre gjuhëve mund të shohim edhe një version që kemi propozuar për transkriptimin e alfabetit arab me alfabetin e gjuhës shqipe.

Me transkriptimin fonematik, në këtë rast, nënkuptojmë vetëm transkriptimin fonologjik, i cili si i tillë transmeton vetëm vlerat fonematike të fonemave arabe. Fokusi i transkriptimit fonematik është në shqiptim. Pra, në rastin e transkriptimit fonematik të fjalës رَمَؤا në transkriptimin fonematik e transkriptojmë *remev* duke lënë anash *elifin.* Por, nëse synohet një transkriptim i plotë, atëherë përdoret transkriptimi fonetik, e që do të thotë, fjalët transkriptohen të plota, ashtu siç janë edhe të shkruara në gjuhën arabe. Ilustrimi i lartcekur do të duhej transkriptuar *remew'* .

Për dallim nga transkriptimi fonematik, transkriptimi fonetik transmeton në mënyrë precize shqiptimin e formave të një gjuhe, e që do thotë të gjitha vlerat fonetike, pra transmeton variantet e fonemave me nuancat e shqiptimit. Andaj është më se e qartë që gjatë transkriptimit fonetik duhet përdorur edhe shenja të veçanta shtesë, me të vetmin qëllim që në mënyrë më specifike të diferencohen vlerat e shqiptimit. Gjatë transkriptimit fonetik ilustrimet vihen në kllapa katrore.

Karshi standardeve ndërkombëtare të lartcekura për transkriptimin fonematik të alfabetit arab në gjuhët që përdorin alfabet e tyre me bazë të

alfabetit latin, ka edhe modifikime të ndryshme duke iu përshtatur natyrës së një gjuhe të caktuar.

Standardet e lartcekura prezantojnë transkriptimin shkencor me vlera internacionale. Gjithashtu këto sisteme, sipas pjesës dërmuese të arabologëve, në mënyrën më besnike prezantojnë grafinë arabe. Sistemi në fjalë praktikon përdorimin e simboleve me shenja diakritike shtesë. I njëjti është pranuar si standard edhe nga *Encyclopedia of Arabic Language and Linguistics*. Edhe ky transkriptim nuk është plotësisht fonematik. Në disa raste *hemzeja* e quajtur *hemzetu-l-vaṣli*, nuk transkriptohet.

Edhe transkriptimi fonematik jo gjithmonë është transliterim i plotë, siç kemi rastet: *elifi* në raste të caktuara nuk transkriptohet, siç pamë edhe më lartë me rastin رَمَوْا *remev*, e jo *remevʾ* , e kur *elifi* shënon zanoren *ā* transkriptohet, si: دَعَا *deā. Elifi* si mbaresë pavarësisht se a është *ʾ lifu-l-memdūde*, *ʾ elifu-l- meqṣūre apo ʾ lifu-l-kaṣīre*, ai transkriptohet si zanore ***ā***. Siç kemi rastet:

هُنَا	بَنَى	هَذَا
hunā	*benā*	*hādhā*

Marrë parasysh që ky prezantim, kryesisht u dedikohet opinionit të gjerë publicistik shqiptar, jam përpjekur që në një masë t'i përshtatet edhe natyrës së gjuhës shqipe, edhe pse për mbështetje kryesore kam pasur sistemin ZDMG.

Nëse me transkriptim nënkuptojmë përfaqësimin e shkrimit burimor të një gjuhe në një gjuhë tjetër të synuar, në atë mënyrë që pasqyron shqiptimin e gjuhës së origjinalit, atëherë transkriptimi duhet të përfaqësojë alfabetin e gjuhës arabe duke e transkriptuar me alfabetin e gjuhës shqipe dhe gjithmonë duke u bazuar edhe në mënyrën e shqiptimit të leksikut të gjuhës shqipe, të huazuar nga gjuhët orientale, apo siç njihen orientalizma. Nisur nga ky fakt, mendoj së është më se e domosdoshme që disa fonema të alfabetit arab të prezantohen me fonema të alfabetit të gjuhës shqipe.

Mjaft gjuhë evropiane, për një transkriptim sa më praktik, kanë bartur edhe veçantitë e gjuhëve të tyre, siç kemi rastin me gjuhën spanjolle, italiane dhe gjuhë të tjera.

Sistemi ZDMG, sipas mendimit tim, do të përdorej vetëm gjatë transkriptimit të emrave të autorëve arabë dhe citimit të veprave apo punimeve të tyre, në botimin e punimeve nëpër revista shkencore apo monografi, katalogimi i veprave të gjuhës arabe nëpër biblioteka, etj.

Mendoj se gjithë ato fonema të alfabetit shqip, të cilat janë të përafërta me morfemat e alfabetit arab, mund të transkriptohen me fonema të gjuhës shqipe, siç kemi rastin me fonemat:

ث	ج	ذ	ش	ي
th	xh	dh	sh	j

Bashkëtingëllorja velare ق (*k*) e arabishtes zakonisht transkriptohet me bashkëtingëlloren qiellzore *q* të shqipes, por nisur nga fakti se mjaft bashkëtingëllore të arabishtes, nëpërmjet huazimeve nga gjuhët orientale, janë ngulitur në leksikun e gjuhës shqipe, andaj edhe transkriptimi i velares ق të arabishtes mendoj se do të ishte më e natyrshme të transkriptohet me bashkëtingëlloren velare *k* të shqipes, kurse bashkëtingëllorja velare ك të transkriptohet me bashkëtingëlloren qiellzore ***q***. Sa për të arsyetuar këtë fakt kemi mjaft huazime që në gjuhën shqipe bashkëtingëllorja velare ك e arabishtes shqiptohet me qiellzoren ***q.*** *Qerim* nga **كَرِيم;** *Qemal* nga **كَمَال** ; *qemane* nga **كَمَان** ; *qemer* nga **كَمَر**; *Qerbela* nga **كَرْبَلاَء** ashtu siç kemi edhe *Kuran* nga **قُرْآن** , kabul nga **قَبُول** , *kible* nga **قِبْلَة** , *kalem* nga **قَلَم** , etj.[9]

Karshi njohjes së alfabetit të gjuhës arabe, respektimit të traditës së shkrimit të huazimeve në gjuhën shqipe nga gjuhët orientale, e me theks të veçantë nga gjuha arabe, duhet pasur kujdes edhe në rregullat e drejtshkrimit dhe drejt leximit të gjuhës arabe.

[9] I të njëjtit mendim edhe Abdurrahman Hukić, Anali, V.4. No 5-6, 1978.

Alfabeti arab

Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë rreth transkriptimit të alfabetit arab, mendoj që duhet sqaruar disa çështje që, sipas mendimit tim, duhet pasur kujdes gjatë transkriptimit.

Alfabeti arab është me origjinë semite, që lëshon rrënjë nga alfabeti aramit.[10] Tani një alfabet me këto karakteristika të transkriptohet me një alfabet me bazë alfabetin latin, siç kemi rastin me alfabetin e gjuhës shqipe, paraqet një sfidë në vete.

Alfabeti arab ka gjithsej 28 konsonante, është alfabet konsonantit (tabela nr.6), që do të thotë, përjashtuar *elifin,* të gjitha konsonantet tjera të alfabetit arab paraqesin vetëm tinguj, pa zanore. Marrë parasysh këtë karakteristikë të alfabetit arab, njohja e gramatikës së gjuhës arabe gjatë leximit të një teksti, është më se e domosdoshme.

Në praktikat e transkriptimit fonologjik, ilustrimet e transkriptuara medoemos vihen mes kllapave të pjerrëta: /*zurtu zemīlī*/ "e kam vizituar mikun tim". Mirëpo, meqë me këtë rast do të flitet ekskluzivisht rreth transkriptimit fonologjik, do të mjaftohemi vetëm duke i veçuar ilustrimet me *italik.*

Ky prezantimin nuk mëton të jetë shterues, por është vetëm një përpjekje modeste për të prezantuar një transkriptim të mundshëm të alfabetit arab me alfabet të gjuhës shqipe, andaj me këtë rast do të prezantohet vetëm transkriptimi fonologjik. Me këtë, kemi për qëllim që sado pak të vihet një rregull në publicistikën shqiptare gjatë transkriptimit të emrave, titujve të veprave, pjesë të një teksti, apo çfarëdo qoftë.

Duke parë laramaninë, për të mos thënë çrregullimin e plotë gjatë transkriptimit të emrave apo titujve të veprave në publicistikën tonë, shpresoj që me këtë prezantim, do të kontribuoj që sadopak të vihet një rregull në këtë drejtim apo të paktën të hapet një debat rreth kësaj çështjeje.

Për të qenë sa më konkret gjatë tekstit në vijim, mendoj që së pari të prezantohet një version i mundshëm i transkriptimit të alfabetit arab me alfabetin e gjuhës shqipe duke u mbështetur në transkriptimet e sipërshë-

[10] Janković, Srđan, Arapski izgovor, Sarajevë, 1987, f. 50.

nuara, pa mos lënë anash natyrën e alfabetit të gjuhës shqipe dhe traditën e shkrimit të huazimeve orientale në gjuhën shqipe:

Transkriptimi i alfabetit të gjuhës arabe me alfabetin e gjuhës shqipe							
ا (ء)[11]	ʾa	د	d	ض	ḍ	ك	q
ب	b	ذ	dh	ط	ṭ	ل	l
ت	t	ر	r	ظ	ẓ	م	m
ث	th	ز	z	ع	ʿa	ن	n
ج	xh	س	s	غ	g	ه	h
ح	ḥ	ش	sh	ف	f	و	w
خ	ẖ	ص	ṣ	ق	k	ي	j

Mbaresa karakteristike e emrave/mbiemrave të gjinisë femërore, e quajtur *tāu-l-merbūta* (ة) nuk prezantohet si pjesë e alfabetit arab. *tāu-l-merbūta* pavarësisht se si mbaresë dallon në grafi ngaت (***t***) në transkriptimin fonematik, për shkaqe praktike, transkriptohet me konsonantin *t*, pra njëjtë sikur konsonanti ت .

Transkriptimi i zanoreve të alfabetit arab:

ـَ	ـِ	ـُ	ـا	ـي	ـُو
a (e)	i	u	ā	ī	ū
دَرَسَ	خَرَجَ	ضَرَبَ	كِتَاب	إِيمَان	ذُو
derese	ẖarexhe	ḍarebe	kitāb	īmān	dhū

Zanoret në alfabetin e gjuhës arabe nuk janë pjesë e alfabetit, por ato shprehen nëpërmjet shenjave diakritike *el-harekāt* (**الحركات**) të cilat vihen mbi ose nën bashkëtingëllore. Procesi i vënies së vokaleve ***ḥaraqāt*** **حركات** në normat gramatikore të gjuhës arabe quhet *teshqīl* **تشكيل**

[11] *Elifi* (ا) nuk është konsonant i pavarur, por zakonisht është bartës i hemzes (ء).

Zanoret e gjuhës arabe janë: (ـَ) *fetha* **فتحة**, (ـِ) *kesre* **كسرة** , (ـُ) *ḍamme* **ضمة**.

- *Fetḥa* ـَ *e/a,*[12] shkruhet me një vizë sipër bashkëtingëllores, e që do të thotë se pas bashkëtingëllores sipër së cilës qëndron *fetḥa,* duhet shqiptuar zanoren *e* apo *a*, varësisht se cila bashkëtingëllore është bartëse e *fetḥas*: **ضَ** - ḍa; **رَ** – re, **بَ** - be, **ضرَبَ** *ḍarebe*; **طَرَدَ** *ṭarede*.
- *Kesre* ـِ *i,* shkruhet me një vizë nën bashkëtingëllore, e që do të thotë se pas bashkëtingëllores nën së cilën qëndron *kesre-ja,* duhet shqiptuar zanoren *i*: ـِهـ-hi, يَ – je: هِيَ hije.
- *Damme* ـُ **,** shkruhet sipër bashkëtingëllores, e që do të thotë se pas bashkëtingëllores sipër së cilës qëndron *ḍamme,* duhet shqiptuar zanoren *u:* هُ *– hu,* وَ-ve: هُوَ *huve.*

Karshi këtyre tri shenjave diakritike që prezantojnë tri zanoret ***e*** (***a***), ***i***, ***u*** ka edhe disa shenja të tjera diakritike.

Shenja në formë të një rrethi të vogël (ْ) i cili shkruhet mbi bashkëtingëllore, quhet *sukūn. Sukūni* është shenjë diakritike që vihet në fund të rrokjes së mbyllur.

نَعَمْ	قِفْ	قُلْ	أَنْتِ	تَرْحِمْ	تَحْتَ
neʾam	qif	kul	ʿenti	terxhim	teḥte

- Në transkriptimin e rrokjes së mbyllur, nuk ka nevojë të përdoret theksi, siç e hasim shpeshherë në praktikat tona, pra thjesht duhet transkriptuar si çdo rrokje e mbyllur:

أَمْجَد عَابِد	أَدْهَمْ	نَوْم	عَيْنِي	كَسْلاَن
ʾEmxhed ʿĀbid	ʾEdhem	nevm	ʿajnī	keslān

[12] *Fetheja* transkriptohet (shqiptohet) me zanoren ***e*** atëherë që bartëse e saj është njëra nga bashkëtingëlloret në vijim: ي ، و ، ن، م ، ل ، ك ، ف ، ش ، س ، ز ، ر ، ذ ، د ، ج ، ث، ت، ب، ء kurse me zanoren ***a*** transkriptohet (shqiptohet) kur bartëse e saj është njëra nga bashkëtingëlloret: ه، ق ، غ ، ع ، ظ ، ط ، ض، ص ، خ، ح .

- *Tenvini* (التَّنْوِينُ) është shenjë diakritike e veçantë, e cila vjen në fund të emrave në të tri rasat: në emërore, në gjinore dhe në kallëzore. Është shenjë diakritike që simbolizon pashquarsinë. *Tenvini* realizohet duke dyfishuar vokalin e shkurtër dhe shqiptohet duke përfunduar me - *n* - pas zanores përkatëse.

ـٌ = -un		ـٍ = -in		ـً = -en	
كِتَابٌ	kitābun	دَرْسٍ	dersin	دَفْتَرًا	defteren

Me përjashtim të emrave që mbarojnë me *hemze* dhe me *tāʾ u-l-merbuṭa,* tenvini në rasën kallëzore shoqërohet me *elif.* Ky elif nuk shqiptohet, por shkruhet. Tenvini shkrihet sipër bashkëtingëllores para *elifit*, edhe pse shpeshherë shkruhet sipër *elifit.*

Tek emrat që përfundojnë me *tāʾ u-l- merbuṭa* shkruhet sipër saj.

مَدْرَسَةٌ	مَدْرَسَةً	مَدْرَسَةٍ	صُورَةٌ	صُورَةً	صُورَةٍ
medresetun	medreseten	medresetin	Ṣūretun	Ṣūreten	Ṣūretin

- Ndër shenjat tjera diakritike është edhe *elif medd* آ (ʾā) e që është rezultat i bashkimit ا + أ, e që rezulton me një ʾā.

آدَم	آزَرَ	القُرْآن	نَشَآ
ʾĀdem	*ʾāzere*	*El-Kurʾān*	*ʿneshʾā*

- Bashkëtingëlloret geminate në alfabetin arab shkruhen në atë mënyrë duke u shtuar *teshdidin*, i cili shkruhet mbi bashkëtingëllore. Gjatë transkriptimit prezantohet duke e përsëritur bashkëtingëlloren e cila është e vokalizuar me teshdid, mu ashtu siç kemi edhe rastin e geminatës së gjuhës shqipe ***rr***.

حَتَّى	مُسَمَّى	مُدَرِّس	مُحَدِّث	مُحَرَّم	شَوَّال
ḥattā	*musemmā*	*muderris*	*muhaddith*	*Muharrem*	*Shevvāl*

- *Elifi i mbishkruar* **الف خنجرية** (') është trashëguar nga drejtshkrimi arkaik i alfabetit arab, e që përdoret në një numër të caktuar fjalësh të zakonshme. Shqiptohet si një *elif* i zakonshëm, por që shkruhet në formë të një *elifi* miniaturë, mbi një bashkëtingëllore të caktuar. Ky elif në asnjë rast nuk shkruhet, me përjashtim të emrit **الله** - *Allah*.

Fjalët që marrin këtë *elif* janë:

هَذَا	*hādhā*	"ky"	لَكِنْ	*lākin*	"por"
هَذِهِ	*hādhihi*	"kjo"	لَكِنَّ	*lākinne*	mirëpo
هؤُلَاءِ	*hāʾulāi*	"ato"	إِلٰهٌ	*ʾIlāhun*	Zot
هَكَذَا	*hākedhā*	"kështu"	الله	*Allah*	Allah
هَهُنَا	*hāhunā*	"ja këtu"	الرَّحْمَنُ	*ar-Rahmānu*	"i Mëshirshmi"
ذَلِكَ	*dhālike*	"ai"			

- Bashkëtingëllorja ل (l) e pasuar me *elif* formojnë ligaturën لا(lā) *Lām elif*. Kjo ligaturë ka dy forma: **لا** kur është në pozicion të nistores dhe **ـلا** në pozicion të fundores. Duhet pasur kujdes që ligatura *Lām elif* nuk lidhet me bashkëtingëlloren në vijim, sepse *elifi* është një nga ato bashkëtingëllore që nuk lidhet me bashkëtingëlloren vijuese.
- Grafia e *hemzes*

Ndonëse *hemzeja* është një ndër konsonantet më të vonshme të alfabetit arab,[13] e sipas disa studiuesve, është edhe më e vonshme se shenjat diakritike që prezantojnë zanoret e shkurtra. Mu për këtë shkak edhe shkrimi i kësaj konsonante ka hasur në mjaft hamendësime rreth rregullave të shkrimit të saj. Kjo edhe ka qenë arsyeja që shkrimi i saj është

[13] Janković, op.cit. f. 63.

mjaft kompleks dhe i larmishëm, me katër mënyra të shkrimit të këtij konsonanti.

Hemzeja shkruhet me ا *elif*, me و *vāv*, me ي *ja* dhe vetmas, pa ndonjë bartës.

Rregullat universale të standardizuara rreth shkrimit të ء *hemzes* janë si më poshtë:

***a**. Shkrimi i ء hemzes në pozicion nistor.*

- Hemzeja në pozicionin nistor gjithmonë shkruhet me elif. Mbi elif shkruhet sa herë që pas saj pason zanorja **e** (**a**), **u,** kurse poshtë elifit shkruhet atëherë kur pas sajë pason zanorja **i**.

أَمَلَ	أَ	أُرْسِلَ	أُنْظُرْ	إِمْرَأَةٌ	إِنْ
ʾ emel	*ʾ a ?*	*ʾ ursile*	*ʾ unẓur*	*imrʾ etun*	*ʾ in*

***b**. Shkrimi i ء hemzes në pozicionin mesor.*

Hemzeja në pozicionin mesor mund të shkruhet në katër variante të mundshme.

- **b**.1. *Hemzeja* shkruhet me konsonantin ي ***j*** atëherë kur pas saj pason zanorja **i** e shkurtër apo e gjatë ***ī***, apo atëherë kur *hemzes* i paraprin konsonanti ي ***j***:

بِئْسَ	بِئْرٌ	ضَابِئَةٌ	مَجِيئَةٌ	مَشِيئَةٌ	بَدِيئَةٌ
biʾ se	*biʾ retun*	*ḍābiʾ etun*	*mexhīʾ etun*	*meshiīet*	*bedīʾ etun*

Duhet pasur kujdes se *hemzeja* te fjalët që përfundojnë me *hemze* në çastin kur marrin një mbaresë, atëherë marrin pozicionin mesor: **شَيْئُكَ** *shejʾ uke* nga **شَيْءٌ** *shejʾ un;* Ka luhatje nga rregulli i sipër-shënuar, siç kemi rastin në vijim: **هَيْئَةٌ** dhe **هَيْأَةٌ** *hejʾ etun*.

b.2. *Hemzeja* shkruhet me konsonantin و ***v*** atëherë kur gjendet mes zanores ***u*** dhe ***e*** (***a***), pavarësish se cili prej këtyre vokaleve qëndron para apo pas *hemzes*:

بَؤُوحٌ	فُؤَادٌ	ثُؤَاج	مَثْؤُوطٌ	ثُؤْلُولٌ	رُؤُوسٌ
be ʾ ūḥun	*fu ʾ ādun*	*thu ʾ āxhun*	*meth ʾ ūṭun*	*th ʾ lūlun*	*ru ʾ ūsun*

b.3. *Hemzeja* shkruhet me *elif* ا atëherë kur gjendet në pozicion mes dy zanoreve ***e*** (***a***) apo mes zanores ***e*** (***a***) dhe një konsonanti:

سَأَلَ	فَأْرٌ	مَفْأَرَةٌ	فَأَى	حِدْأَةٌ	إِفْتَأَلَ
s ʾ ele	*fe ʾ run*	*mef ʾ eretun*	*fe ʾ ā*	*ḥid ʾ etun*	*ʾ ifte ʾ ale*

c. *Shkrimi i hemzes në pozicionin final*

Shkrimi i *hemzes* në pozicionin final varet se cili konsonant apo cila zanore i paraprinë. Nëse *hemzes* i paraprinë zanorja e shkurtër ***i****, atëherë* hemzeja shkrihet me konsonantin ***ي j***. Në rastin kur *hemzes* i paraprinë zanorja ***u*** e shkurtër, atëherë shkruhet me konsonantin ***و v***, e nëse *hemzes* i paraprinë zanorja **e** (**a**) e shkurtër, atëherë shkruhet me ا *elif*.

مُنْشِئٌ	يُخْطِئُ	إِمْرُؤٌ	جَرُؤَ	بَدَأَ	قَرَأَ
munshi ʾ un	*juẖṭi ʾ u*	*ʾ imru ʾ un*	*xheru ʾ e*	*bede ʾ e*	*kare ʾ e*

Hemzeja në pozicionin final shkruhet e pashoqëruar me asnjërin nga tri konsonantet e lartcekura, atëherë kur asaj i paraprinë një zanore e gjatë apo një konsonant:

هَنَاءٌ	مَسَاءٌ	آبَاءٌ	شَيْء	مَلَأٌ	سُوءٌ
henā ʾ un	*mesā ʾ un*	*ʾ ābā ʾ un*	*shej ʾ e*	*mele ʾ un*	*sū ʾ un*

Parimet të përgjithshme të transkriptimit të alfabetit arab

a. bashkëtingëlloret و dhe ي sipas tabelës së lartshënuar na paraqiten si bashkëtingëllore të mëvetme ***v*** dhe ***j*** :

وَضْعَ	عِوَضٌ	دَلْوٌ	يَدٌ	حَيْلٌ	طَحْيٌ
veḍ ʿ a	*ʿ iveḍun*	*delvun*	*jedun*	*hajlun*	*ṭaḥjun*

b. bashkëtingëlloret **و** dhe **ي** në funksion të bashkëtingëlloreve kompensative te zanoret e gjata ***ū*** dhe ***ī*** :

أُولَى	صُورَة	ذُو	إِيمَان	جِيلٌ	فِي
ūlā	*ṣūre*	*dhū*	*īmān*	*xhīlun*	*fī*

ء *hemzeja* pavarësisht se në çfarë pozite të jetë, në fillim, në mes apo në fund të fjalës, qoftë me *elif* apo pa të, transkriptohet me zanoret e shqipes, varësisht se me cilin vokal është e vokalizuar:

أَ	إِ	أُ	آ	ئِى	ئُو
a (e)	*i*	*u*	*ā*	*ī*	*ū*

Sipas një parimi të përgjithshëm, të cilin duhet ndjekur gjatë transkriptimit është që teksti apo shprehja të dallohen me *italik.* p.sh. *ḥuve fī l-bejt.*

Gjatë transkriptimit të nyjës shquese shpeshherë hasim që nyja shquese ال (*el*) pjesërisht të transkriptohet si pjesë e fjalës, e cila i paraprinë emrit (mbiemrit) të shquar. Mendoj se mënyra më prezentative e nyjës shques, gjatë transkriptimit, do ishte që nyja shquese në togfjalësh të ndahet me një vizë mes dy përbërësve, gjithmonë duke iu përmbajtur rregullave të fonetikës së gjuhës arabe. Sistemi i transkriptimit të ZDMG në vend të vizës ndarëse ka përdorur apostrofin.[14]

[14] Die Transliteration der arabischen Schrift, LEPZIG, 1935, f. 16.

Vokali i fundit zakonisht nuk transkriptohet qoftë kur një fjalë është e vetme, apo si përbërës i dytë i togfjalëshit:

المُدَرِّس	الطَّالِب	اَلْبَيْت	مِنَ الْبَيْت	بَابُ الْبَيْتِ	بَيْتُ الطُّلَّاب	رَئِيسُ الْحُكُومَة
el-muderris	*aṭ- ṭālib*	*El-bejt*	*mine-l-bejt*	*bābu-l-bejt*	*bejtu-ṭ-ṭul-lāb*[15]	*reīsu-l-ḥuqūme*

Edhe pse shikuar sipas rregullave të gjuhës arabe transkriptimi i saktë i kontekstit do të duhej të ishte: *mine-l-bejti, bābu-l-bejti, bejtu-ṭ-ṭullāb, reīsu-l-ḥuqūmet.*

Gjatë transkriptimit të nyjës shquese ال (*el*) tek emrat duhet t'i përmbahemi këtyre parimeve:

a. Nyja shquese tek emrat që fillojnë me njërën nga shkronjat e hënës transkriptohet e plotë:

القُرْآنُ	القَمَرُ	العِلْمُ	دَارُ العُلوم	حُرُوف القَمَرِيّة	المِجْلِسُ
el-Kurānu	*el-kameru*	*el-ʿ ilmu*	*Dāru-l ʿ ulūmi*	*ḥurūfu-l-kamerijjet*	*al-mexhlisu*

b. Nyja shquese tek emrat që fillojnë me njërën nga shkronjat e dielli transkriptohet njëjtë sikur te grupi i konsonanteve të hënës, por në këto raste konsonanti ل (***L***) nuk shqiptohet, por konsonanti vijues, pas nyjës shques asimilohet në konsonantin vijues:[16]

الدَارُ	السُؤالُ	الرِّزْقُ	عَيْنُ الشَّمْس	جَبَلُ النُور	كَتِابُ التَّبْيِين	فِي الطَّرِيقِ
ed-ddaru	*es-suʾ āl*	*er-rizku*	*ʿ Ajnu-sh-shems*	*Xhebelu-n-nūr*	*Qitābu-t-tebjīn*	*fi-ṭ-ṭarīki*

[15] Duhet pasur kujdes që bashkëtingëlloren **ل** (***l***) kur është e shoqëruar me *teshdīd*, duhet ndarë me vizë për të mos u ngatërruar me bashkëtingëlloren e ll të gjuhës shqipe.

[16] Këtë parim e respekton edhe sistemi i transkriptimit ZDMG, Die Transliteration der arabischen Schrift, LEPZIG, 1935, f. 13.

Nisur nga ilustrimet e lartshënuar shihet se nyja shquese tek emrat në togfjalësh që atyre u paraprinë përbërësi që përfundon me zanore, atëherë këta dy përbërës ndahen me një vizë (-).

c. Hemzetu-l-vaṣlu

Hemzetu-l-vaṣli nuk transkriptohet me ʾ tek emri إِبْنُ *ibnu* e jo ʾibnu.

Emrat e përveçëm të përbërë, të cilët fillojnë me emrin *ibn* shkruhen me germë të madhe:

إِبْنُ يَقْظَان	إِبْنُ رُشْدِ	إِبْن سِنَا	إِبْن خَلْدُون
Ibn Jekẓan	*Ibn Rushdi*	*Ibn Sīnā*	*Ibn Ḫaldūn*

Kurse i njëjti emër kur ndodhet mes dy emrave, do me thënë i shkruar pa *elif*, atëherë transkriptohet *bin*, si për shembull: ʿUmer bin al-Ḫaṭab

d. *Hemzetu-l-vaṣli* nuk transkriptohet në rastet kur fjala që i paraprinë përfundon me zanore, p.sh.:

كَتَبْتُ الْكِتَاب	يَوْمَ اعِتْقَالِهِ	فِي انْتِظَارٍ	كَتَبَ الرِّسَالَةَ
qetebtu-l-qitābe	*jevme ʿ tikālihi*	*fī-ntiẓārin*	*qetebq-r-risālete*

Elifu-l-meqsūre transkriptohet me zanoren ***ā***:

حَتَّى	مَضَى	كُبْرَى	يَحْيَى	مُسَمَّى	مُصْطَفَى
ḥattā	*meḍā*	*qubrā*	*jaḥjā*	*musemmā*	*muṣṭafā*

Elifu-l-meqsūre derisa vjen në fund të fjalës shkruhet me bashkëtingëlloren ***ى*** (***j***) dhe shqiptohet si zanore ***ā*** , por nëse fjala që përfundon me *elifu-l-meqsūre* merr ndonjë mbaresë, atëherë shkruhet me ***ي*** (***j***) dhe shqiptohet (transkriptohet).

عَلَى	عَلَيْنَا	عَطَى	عَطَيْنَا
ʿ *alā*	ʿ *alejnā*	ʿ *aṭā*	ʿ *eṭejnā*

Mbaresa ـِى tek emrat si:

القَاضِى	المُفْتِى
al-kāḍī	*al-muftī*

Emrat e përveçëm të përbërë gjatë transkriptimit i hasim në disa mënyra, pra varësisht nga synimi i transkriptimit në gjuhën e synuar. Rregullat e transkriptimit na obligojnë që t'i përmbahemi standardit universal të transkriptimit edhe të këtyre emrave.

عَبْدُ المجِيد	ذو القَرْنَين	أَبُو جَهْلٍ	صَاحِبُ السَعَادَةِ
ʿ *Abdu-l-Mexhīd*	*Dhū-l-karnejn*	ʾEbu Xhehlin	Sāḥibu-s-seʿāde

Sipas rregullave të gjuhës shqipe mbaresat gjatë lakimit i merr emri i dytë, kështu që emri i parë gjithmonë duhet të transkriptohet në emëroren, kurse rasa e emrit të dytë varet nga pozita e tij në fjali. Ja disa ilustrime:

عَبْدُ الرَّحْمَن	عَبْدُ العَزِيز	عَبْدُ الكَرِيم
ʿ *Abdu-r-Rahman*	ʿ *Abdu-l-* ʿ *Azīz*	ʿ *Abdu-l-Qerīm*

Këtë parim duhet respektuar për emrat e përbërë arab, të cilët nuk kanë gjetur një shtrirje të gjerë në gjuhen shqipe, kurse emrat, bazuar në përditshmërinë e përdorimit të tyre në gjuhën shqipe iu janë përshtatur rregullave të gjuhës shqipe, si emrat:

عَبْدُ الله	عَبْدَ الْعَزِيز	عَبْدِ السَّلاَم
Abdulla	*Abdulazizin*	*Abduselamit*

Një dukuri mjaft e shëmtuar, për të mos thënë edhe e çoroditur, është edhe transkriptimi i emrit Muhamed në formën Mohamed, siç e hasim

shpeshherë në shtypin tonë, kur dihet se ky emër te shqiptarët ka qenë dhe ende vazhdon të jetë ndër emrat më të përhapur.

Bashkëtingëllorja *tā ʾ u-l- merbuṭa* ka vetëm dy pozicione në shkrimin e saj, pozicionin e shkruar vetmas (ة) dhe pozicionin e shkruar në fund të fjalës (ـة).

Shqiptimi i bashkëtingëllores *tā ʾ u-l- merbuṭa* varet nga pozita e saj në fjali.

Bashkëtingëllorja *tā ʾ u-l- merbuṭa* në të shumtën e rasteve, kur vjen në fund të fjalës nuk shqiptohet, apo shqiptohet ***h***;

مَدِينَة	خَلِيفَة	أُسَامَة	لَطِيفَة
Medīne	*ẖalīfe*	*ʾ Usāme*	*leṭīfe*

Janë disa emra që mbarojnë me *tā ʾ u-l-merbuṭa* që shqiptohet edhe në fund të fjalës edhe kur ai emër përdoret i vetëm:

مُشَاة	قَنَاة	حَيَاة
mushāt	*kanāt*	*ẖajāt*

Kur *tā ʾ ul-l-merbuṭa* vjen në fund të emrit, i cili është përbërës i parë i togfjalëshit emëror (*muḍa ʿ af*) atëherë *tā ʾ u-l-merbuṭa* shqiptohet:

مَدِينَة الرَّسُول	قِيَادَةُ الجَامِعَة	مَدْرَسَة المِدِينَة	جَامِعَة القَاهِرَة
Medīnetu-r-Resūl	*Kijādetu-l-xhāmi ʿ a*	*Medresetu-l-medīne*	*Xhāmiatu-l-Kāhire*

Në rastet kur fjala e cila mbaron me *tā ʾ u-l- merbuṭa* merr një mbaresë atëherë ajo shkruhet në formën e bashkëtingëllores ت - ***t.***

مُدِيرُ المِدْرَسَة	مُدِيرُ المِدْرَسَتِنَا	رَئِيسُ الجَامِعَة	رَئِيسُ الْجَامِعَتِنَا
mudīru-l-medrese	*mudīru-l-medresetinā*	*reīsu-l-xhāmia*	*reīsu-l-xhāmi ʾ atinā*

Mbaresa e mbiemrave të prejardhur në gjuhën arabe ***يّ j*** gjatë transkriptimit shpeshherë shkruhet e dyfishuar, por ka raste kur ajo nuk dyfishohet.

أَحْمَدِيَة	حَنَفِيَة	مَدَنِيَة
ʾ aḥmedij(j)e	*ḥanefij(j)e*	*medenij(j)e*

Drejtshkrimi i gjuhës arabe nuk njeh germë të madhe dhe germë të vogël, andaj gjatë transkriptimit, drejtshkrimi i germës së madhe duhet t'i përshtatet drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Gjatë transkriptimi të një folje të gjuhës arabe medoemos duhet të transkriptohet edhe vokali i fundit, për dallim nga emri. P.sh:

ضَرَبَ \ يَضْرِبُ	فَعَلَ \ يَفْعَلُ	صَامَ \ يَصُومُ
ḍarabe / jeḍribu	*feʿale / jefʿalu*	*ṣāme / jeṣūmu*

Transkriptimi i kontekstit

Me transkriptim të kontekstit nënkuptojmë transkriptimin e një pjesë të tekstit, qoftë edhe një fjali.

Fjalët e shkruara të bashkëngjitura me parafjalë apo me lidhëza që shkruhen të bashkëngjitura me fjalën në vijim i transkriptojmë duke i ndarë me një vizë ndarëse:

لِزَمَنٍ آخَر	لَهُمْ
li-zemenin ʿāḫar	le-hum

Transkriptimi i zanores së rastit dhe i gjitha zanoreve të tekstit:

بَلَغَ إِلَى بَيْتِ اللهِ	سَكَنَ جَارُهُ فِي الْمَدِينَةِ
belegaʿ ilā bejti-l-lahi	*seqene xhāruhu fī-l-medīneti*

TABELAT

Tabela nr.1

Sistemi i transkriptimit fonetik							
ا (ء)[17]	aː (ʔ)	د	d	ض	dˤ , ðˤ	ك	k
ب	b	ذ	ð	ط	tˤ	ل	l
ت	t	ر	r	ظ	zˤ , ðˤ	م	m
ث	θ	ز	z	ع	ʔˤ	ن	n
ج	ʤ , ʒ , g	س	s	غ	ɣ	هـ	h
ح	ħ	ش	ʃ	ف	f	و	w , uː
خ	x	ص	sˤ	ق	q	ي	j , iː

Tabela nr.2

Sistemi i transkriptimit EI							
ا (ء)	ʾ	د	D	ض	ḍ	ك	q
ب	b	ذ	dh	ط	ṭ	ل	l
ت	t	ر	R	ظ	ẓ	م	m
ث	th	ز	Z	ع	ʿ	ن	n
ج	j	س	S	غ	gh	هـ	h
ح	ḥ	ش	sh	ف	f	و	w
خ	kh	ص	ṣ	ق	k	ي	y

[17] *Elifi* (ا) nuk është konsonant i pavarur, por zakonisht është bartës i hemzes (ء).

Tabela nr.3

Sistemi i transkriptimit DMG ose ZDMG							
ا (ء)	ʾ	د	D	ض	ḍ	ك	k
ب	b	ذ	ḏ	ط	ṭ	ل	l
ت	t	ر	R	ظ	ẓ	م	m
ث	ṯ	ز	Z	ع	ʿ	ن	n
ج	ǧ	س	S	غ	ġ	ه	h
ح	ḥ	ش	Š	ف	f	و	w
خ	ḫ	ص	ṣ	ق	q	ي	y

Tabela nr.4

Sistemi i transkriptimit të alfabetit arab në gjuhën spanjolle[18]							
ا (ء)	ʾ	د	d	ض	ḍ	ك	k
ب	b	ذ	ḏ	ط	ṭ	ل	l
ت	t	ر	r	ظ	ẓ	م	m
ث	ṯ	ز	z	ع	ʿ	ن	n
ج	ŷ	س	s	غ	g	ه	h
ح	ḥ	ش	š	ف	f	و	w
خ	j	ص	ṣ	ق	q	ي	y

[18] https://books.google.com/books?id=FE8w5YF7650C&pg=PA53#v=onepage&q&f=false

Tabela nr.5

Sistemi i transkriptimit të alfabetit arab në gjuhën italiane							
ا (ء)[19]	ʾ	د	d	ض	ḍ	ك	k
ب	b	ذ	ḏ	ط	ṭ	ل	l
ت	t	ر	r	ظ	ẓ	م	l
ث	ṯ (th)	ز	z	ع	ʿ	ن	k
ج	ǧ	س	s	غ	ġ (gh)	ه	h
ح	ḥ	ش	š (sh)	ف	f	و	w
خ	ḫ (kh)	ص	ṣ	ق	q	ي	y

Tabela nr. 6

Sistemi i konsonanteve të gjuhës										
bashkëtingëlloret e zhurmshme							sonantet			
pëlcitëse			Frikative		afriaktive		nazale	laterale		vibrante
	të zëshme	të pazëshme	të zëshme	të pazëshme	të zëshme	të pazëshme				
bilabiale	**b (ب)**						**m (م)**		**w (و)**	
labidentale				**f (ف)**						
interdentale			**ḏ (ذ)**	**ṯ (ث)**						
"velare			**ẓ (ظ)**							
dentale	**d (د)**	**t (ت)**								
"velare	**ḍ (ض)**	**ṭ (ط)**					**n (ن)**	**l (ل)**		
alveolare			**z (ز)**	**s (س)**						
"velare				**ṣ (ص)**						**r (ر)**

[19] *Elifi* (ا) nuk është konsonant i pavarur, por zakonisht është bartës i hemzes (ء).

palatale				**ṡ (ش)**	**ğ (ج)**				**y (ي)**	
velare		**K(ك)**	**ġ (ج)**	**ḫ (خ)**						
uvulare		**q(ق)**								
faringale		**ʾ (ع)**		**ḥ (ح)**						
glotale		**ʿ (ء)**		**h (ه)**						

Përfundim

Nga e gjithë kjo që u tha më sipër, sipas mendimit tim, gjatë transkriptimit të alfabetit arab me alfabetin e gjuhës shqipe, duhet të përqendrohemi në këto pika kryesore:

Tekstit apo shprehja i (e) transkriptuar të dallohen me italik;

Bashkëtingëllorja velare ق (k) e arabishtes të transkriptohet me bashkëtingëlloren velare k të shqipes, kurse bashkëtingëllorja velare ك të transkriptohet me bashkëtingëlloren qiellzore q;

Bashkëtingëlloret geminante në alfabetin arab të shkruhen në atë mënyrë duke e përsëritur bashkëtingëlloren e cila është e vokalizuar me teshdid, mu ashtu siç kemi edhe rastin e geminantës së gjuhës shqipe rr;

Fetheja të transkriptohet me zanoren e, kurse me zanoren a të transkriptohet sa herë që bartëse e saj është njëra nga bashkëtingëlloret emfatike;

Emrat e përveçëm të përbërë t'i transkriptojmë duke iu përmbajtur standardit universal të transkriptimit edhe të këtyre emrave;

Gjatë transkriptimit të nyjës shquese ال (el) në togfjalësh ta ndajmë me një vizë mes dy përbërësve, gjithmonë duke iu përmbajtur rregullave të fonetikës së gjuhës arabe;

Fjalët e shkruara me parafjalë apo me lidhëza, të bashkëngjitura me fjalën në vijim duhet t'i transkriptojmë duke i ndarë me një vizë ndarëse.

Isa MEMISHI

THE TRANSCRIPTION OF ARABIC SCRIPT USING THE ALBANIAN ALPHABET

(Summary)

Transcription aims at reconstructing the original pronunciation of words using the alphabet of another language, whereas transliteration aims at presenting the original form of graphemes of the original text with those of the target language (in this case with the graphemes of the Albanian language).

Transcription and transliteration are experiencing a boom due to the ever-increasing linguistic influence of the internet and the exponential needs in the field of interlinguistic communication. It is mainly due to the need to find the adequate transcription of the names of people, places, companies, organizations, etc. Yet, these subjects have a number of forms, depending on the languages and places. The transcription of Arabic script illustrates the complexity of the situation.

In this paper we will briefly present the theoretical and practical difficulties that arise during the transcription of Arabic script using characters of the Albanian alphabet as well as possible ways to solve these difficulties.

عيسى ميميشي

ترجمة (نطق) الأبجدية العربية بالأبجية الألبانية

(خلاصة البحث)

يهدف النسخ إلى إعادة بناء النطق الأصلي للكلمات باستخدام الأبجدية بلغة أخرى ، في حين تهدف الترجمة الصوتية إلى تقديم الشكل الأصلي لرسومات الحروف الأصلية مع الرسوم للغة المستهدفة ، في هذه الحالة مع رسوم حروف الأبجدية للغة الألبانية.

تشهد عمليات النسخ والترجمة الصوتية نمواً كبيراً بسبب التأثير المتزايد على الإنترنت والاحتياجات الأساسية في مجال استرجاع المعلومات المتبادلة. هذه الظاهرة مهمة خاصة لإيجاد النسخ الكافي لأسماء الأشخاص والبلدان والشركات والمنظمات، إلخ. لكن هذه الموضوعات لها عدد من الأشكال، اعتمادًا على اللغات والأماكن. توضح حالة كتابة الأبجدية العربية بأحرف الأبجدية للغة العربية هذا الوضع المعقد وتنوعه.

في هذه الورقة ، سوف نقدم باختصار الصعوبات النظرية والعملية التي تنشأ أثناء نسخ الأبجدية العربية مع أحرف الأبجدية للغة الألبانية ، وكذلك الحلول الممكنة التي يمكن أن تحل هذه الصعوبات.

Mr. Ekrem MAQEDONCI

DISPOZITAT KLASIKE DHE BASHKËKOHORE RRETH ALKOOLIT

Abstrakt

Nuk ka dyshim se njëra prej çështjeve e cila vazhdimisht ka zgjuar kureshtje tek myslimanët, anë e kënd globit, është edhe çështja e alkoolit. Kjo për faktin se me kalimin e kohës, kanë lindur edhe çështje të reja që ndërlidhen me të, ngase alkooli sot nuk përdoret vetëm për pije e dëfrim, siç ka qenë e zakonshme në kohët e vjetra, mirëpo përdoret edhe në shumë çështje të tjera. Sot pothuajse nuk mund të gjesh barnatore e që në sirtarët e saj të mos gjendet alkooli, si materie për pastrimin plagëve të ndryshme. Nuk mund të gjesh shitore ushqimore e që në sirtarët e saj të mos ketë çokollata dhe ëmbëlsira të ndryshme që pjesë përbërëse të tyre të mos e kenë alkoolin, ashtu siç rrallë mund të hasësh ndonjë parfum e të mos e ketë alkoolin si pjesë përbërëse të tij. Nisur nga kjo, është shumë e natyrshme që një besimtarë të interesohet për qëndrimin juridik islam rreth këtyre çështjeve. Andaj është e udhës, që lexuesve t'u ofrohen njohuri bazike rreth përdorimit të alkoolit në industrinë e sotme ushqimore dhe kimike, sepse këto dispozita, janë të një rëndësie të veçantë, sa i përket besimit dhe jetës së një besimtari bashkëkohorë.

Fjalët kyçe: *alkooli, norma, dispozita, masa ndëshkuese, tjetërsimi i alkoolit, pastërtia, papastërtia, ushqimi etj.*

Çfarë synohet me alkool ose pije alkoolike?

Kur përmendet alkooli ose pijet alkoolike, për kohërat e mëhershme, zakonisht është për qëllim vera e prodhuar nga hurma dhe rrushi[1]. Kjo për faktin se në ato kohëra, shumë prej llojeve të pijeve alkoolike që sot janë në treg, as nuk kanë ekzistuar. Ndërsa sot, pijet alkoolike prodhohen pothuajse prej çdo fryti dhe janë të llojllojshme. Dihet se sipas normave sheriatike, si pije alkoolike llogariten të gjitha ato pije që janë dehëse, pa marrë parasysh origjinën e prodhimtarisë së tyre, qofshin ato nga llojet e drithërave, siç është gruri, elbi, thekra e të ngjashme, apo nga llojet e pemëve, si molla, dardha, hurmat, rrushi etj.

Ne në këtë temë, kemi për synim alkoolin në përgjithësi, dhe jo vetëm verën klasike, prandaj do të mundohemi që sado pak, të hedhim dritë rreth normave të përgjithshme të alkoolit, si ato klasike, ashtu edhe ato bashkëkohore.

Dispozitat dhe normat e alkoolit

Këtu kemi për qëllim rregullat ose dispozitat e përgjithshme të alkoolit, disa prej të cilave janë klasike, (por me shumë rëndësi për ta ditur normën e tyre), e disa të tjera janë bashkëkohore, me të cilat preokupohemi pothuajse çdo ditë. Dhe, meqë këto rregulla ndërlidhen drejtpërsëdrejti me jetën e besimtarit, është e nevojshme të dihet norma e tyre, që i përkasin lejueshmërisë apo ndalesës së tyre në praktikë. Ndër këto dispozita, do të veçonim më kryesoret:

1. Në kushte të rëndomta, pijet alkoolike janë të ndaluara

Me unanimitet të të gjithë juristëve islamë, pirja e pijeve dehëse apo përdorimi i tyre, pa ndonjë arsye, konsiderohet haram.[2] Kjo ndalesë ka ardhur për faktin se pijet dehëse nuk janë të shëndetshme as për anën fizike e as për atë psikike të njeriut. Si rrjedhojë, përdorimi i tyre është në kundërshtim të drejtpërdrejtë edhe me vetë parimet islame. Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

---

[1] Dr. Muhamed Ravas Kalaxhij, *Mu'xhemu lugatul-fukahai* f. 179.

[2] *El-Hidaje Sherh Bidajetul-Mubtedi'ë,* vëll. 3, ff. 393-402

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

"O ju të cilët keni besuar, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës *(për fall)* ***janë vepra të ndyta të shejtanit, pra largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar".*** *(El-Maide, 90).*

Ndërsa Muhamedi a.s. në një hadith thotë: كُلُّ مُسْكِرٍ خَمْرٌ، وَكُلُّ خَمْرٍ حَرَامٌ *"Çdo pije që dehë konsiderohet verë-alkool, dhe çdo alkool- verë është haram"*[3].

Nga ky hadith, shohim qartë se i Dërguari i Allahut, i ka ndaluar të gjitha llojet e pijeve dehëse, duke eliminuar çdo lloj dyshimi apo keqinterpretimi se e vetmja pije dehëse që ndalohet është vera e njohur me emrin *"el-hamr"*!

Ndalesa e alkoolit nuk ndërlidhet me ndonjë masë a sasi të caktuar, ngase ajo është e ndaluar, pa marrë parasysh sasinë e saj, qoftë pak apo shumë. Pejgamberi a.s. në një hadith thotë: *"Çdo pije, shumica e së cilës dehë, edhe pakica e saj është haram."*[4] Andaj nuk pranohen justifikimet e askujt në ditët tona, se nëse njeriu pi në atë masë sa nuk e dehë vetën, nuk është e ndaluar, ngase nga hadithi shumë qartë kuptohet se alkooli ndalohet në tërësi, si shumica ashtu edhe pakica e tij.

2. Urtësia e ndalesës së alkoolit dhe e pijeve dehëse

Sheriati islam i ka kushtuar rëndësi të veçantë mendjes së njeriut dhe ruajtjes së saj, ngase nga mendja buron çdo vepër e tij, pozitive dhe negative. Andaj përdorimi i pijeve që shkaktojnë humbjen e vetëdijes dhe mendjes së njeriut, është i ndaluar, sepse përbën rrezik për atë që konsumon alkoolin po në të njëjtën kohë edhe për shoqërinë që bashkëjetojnë me atë person. Sot jemi dëshmitarë se qindra aksidente fatale në trafik, dhuna familjare, apo edhe vrasje, ndodhin pikërisht si rezultat i pirjes së alkoolit.

[3] Transmeton Imam Muslimi në Sahihun e tij, nr. (2003).

[4] Transmeton En-Nesaiu në *Sunen* me nr. (5607). Hadithi dhe është i gradës 'sahih' që nënkupton se mund të argumentojmë me të.

Andaj, në ndalimin e alkoolit ka një urtësi jashtëzakonisht të madhe, në radhë të parë, ruajtja e mendjes së njeriut dhe e harmonisë së tij jetësore[5].

3. Mohimi i normës së alkoolit konsiderohet dalje nga feja

Mohimi i normës së ndalimit të alkoolit-verës, konsiderohet dalje nga feja, ngase po mohohet një normë e cila është ligjësuar e normuar me argumente të prera nga Kurani dhe Suneti i Pejgamberit a.s. Rëndom, sipas dijetarëve të shkencave islame, çdo person i cili mohon normat fetare të argumentuara me argumente të prera sheriatike, konsiderohet jobesimtar[6]. Në lidhje me këtë ndalim të pijeve alkoolike, juristët islamë nuk kanë asnjë mospajtim. Andaj, përdoruesi i alkoolit pa ndonjë urgjencë dhe arsyetim madhor, konsiderohet mëkatar, ndërsa mohuesi i kësaj norme, konsiderohet si i dalë nga feja.

4. Alkooli dhe pijet e ngjashme lejohen të përdoren vetëm në raste të jashtëzakonshme

Sipas dijetarëve myslimanë, alkooli ose pijet e ngjashme dehëse, lejohen të përdoren vetëm në raste të jashtëzakonshme, dhe atë vetëm kur jeta e njeriut është në rrezik, nëse nuk ka pranë vetes ndonjë lëng apo pije tjetër pos verës. Ky rast është imagjinuar, për raste ekstreme, kur besimtari nuk ka zgjedhje tjetër, si p.sh. nëse i ka mbetur diçka në fyt dhe nuk mund ta gëlltisë atë, dhe pranë vetes nuk ka ujë apo ndonjë lëng tjetër jodehës, përveç verës apo alkoolit. Në këtë rast i lejohet ta përdorë alkoolin, për ta evituar rrezikun e humbjes së jetës nga ngulfatja me ushqim. Rast tjetër i imagjinuara, është nëse një mysliman është në udhëtim nëpër shkretëtirë dhe nuk gjen asnjë pije tjetër për ta eliminuar etjen dhe rrezikun për jetë. Vetëm në këto dy raste lejohet përdorimi i tij, konform një rregulli të fikhut i cili thotë: الضرورات تبيح المحظورات - *"Në raste të jashtëzakonshme, gjërat e ndaluara bëhen të lejuara."*[7]

---

[5] Dr. Vehbe Zuhajli, *El-Fikhu-l-Islamij*, (Libër i botuar për student nga Universiteti i Damaskut në vitin 2002), f. 119.

[6] *Bedaiu-s-Senai* (5/497).

[7] *Sherh El-Kavaidu-l fikhije*, f. 185.

5. Ndalohet përdorimi i pijeve alkoolike për ndonjë interes material

Në asnjë mënyrë, nuk lejohet përdorimi i pijeve alkoolike për ndonjë interes apo fitim material, siç është bartja, shitja, shërbimi, prodhimi, blerja etj,[8] ngase Pejgamberi s.a.v.s. në një hadith të transmetuar nga Enes ibën Maliku r.a. thotë: *"I ka mallkuar i Dërguari i Zotit dhjetë persona për shkak të pijeve alkoolike: atë që e shtrydh-punon, atë për të cilin shtrydhet-punohet, atë që e pi dhe atë që e bartë-transporton, atë për të cilin bartet-transportohet, atë që i shërben të tjerët, atë që e shet, atë që ushqehet nga pijet alkoolike, atë që e blen dhe atë për të cilin blihet."*[9]

Andaj, duhet të kenë kujdes, sidomos punëtorët dhe tregtarët, të cilët tregtojnë me mallra ushqimore, që pijet e tilla të mos i posedojnë, e as të mos i servojnë për të tjerët, për të arritur ndonjë interes material, ngase një gjë të tillë e ka ndaluar Zoti xh.sh. dhe siç shihet qartë e ka mallkuar edhe Pejgamberi s.a.v.s. Rëndom, një çështje që mallkohet nga i Dërguar i Zotit, nuk mund të ketë bereqet në të.

6. Ekzekutimi i dënimit për pijet dehëse

Nëse një mysliman, i moshës madhore, i mençur psikikisht dhe i vetëdijshëm se pija e tillë është e ndaluar fetarisht, pi pije të tilla alkoolike, pa ndonjë presion ose arsye, mbi të ekzekutohet masa ndëshkuese e përcaktuar sheriatikisht që quhet "El-Haddu".

Pasi të jetë vërtetuar nëpërmjet dëshmitarëve ose përmes pohimit të vetë besimtarit se ai ka pirë pije dehëse alkoolike, atëherë mbi të ekzekutohet ndëshkimi i paraparë me norma të Sheriatit.[10]

Kjo masë dënuese është ligjësuar për t'i çrrënjosur këto pije dehëse nga shoqëria dhe për ta ndaluar këtë ves të shëmtuar të humbjes së vetëdijes. Sipas unanimitetit të juristëve islamë, çdo njeri i cili pi pije dehëse, duhet të sanksionohet për këtë vepër penale, duke u goditura publikisht

---

[8] *El-Hidajeh Sherh Bidajetul-Mubtedi'ë* (3/393-402)

[9] Transmeton Tirmidhiu nr. (1925). Po ashtu, këtë hadith e transmetojnë edhe të tjerët dhe sipas dijetarëve, ky hadith është i saktë për t'u argumentuar me të.

[10] *El-Lubab fi sherhi-l-Kitab* (1/564-565)

me shkopinj, duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit a.s.: *"Ai i cili pi pije dehëse ndëshkojeni atë me të rëna me shkopinj."*[11]

Mirëpo, ky hadith nuk ka specifikuar numrin e të rënave për atë që pi pije dehëse, gjë që ka sjellë pak divergjenca në mesin e juristëve myslimanë, se, sa duhet të jetë numri i të rënave me shkop, për personin e dehur. Pas shumë diskutimeve nga ana e tyre, mund të themi se mendimi më i zgjedhur është ai i medhhebit hanefij dhe i shumicës së juristëve islamë se, ai i cili pi pije dehëse, duhet të *dënohet me 80 të rëna me shkopinj*.

Këta juristë, mendimin e tyre e mbështesin në faktin se, Omeri r.a. në kohën e tij i kishte tubuar sahabët për t'i konsultuar rreth masës ndëshkuese ndaj atij që pi pije alkoolike, meqë kjo masë ndëshkuese nuk ishte përmendur në Kuranin fisnik. Në mesin e atyre sahabëve ishte edhe Aliu r.a. i cili tha: *"Mendoj se duhet ta dënosh atë me tetëdhjetë të rëna, sepse, nëse ai pi pije dehëse, dehet, e kur dehet, nuk di se ç 'flet, e nëse nuk di se ç 'flet, ai mund edhe të shpifë, e dënimi për shpifje është tetëdhjetë të rëna."*[12]

Juristët islamë janë të pajtimit se aplikimi i dënimit nuk mund të bëhet gjatë kohës që personi është i dehur, por zbatimi i dënimit bëhet pasi t'i kalojë dehja. Kjo bëhet për faktin se personi në fjalë duhet të pyetet pse ka pirë pije dehëse, a ka pasur ndonjë urgjencë (nevojë të domosdoshme) apo diç të ngjashme, sepse në të kundërtën, dehja e pamundëson një sqarim të gjendjes në mënyrë të mirëfilltë.

Urtësia e zbatimit të kësaj norme sheriatike mbi personin që ka pirë alkool, është që ai ta ndjejë dhe përjetojë dënimin, si fizikisht, me të rëna, ashtu edhe psikikisht, duke e përjetuar ndjenjën e turpit para gjykatësit dhe para të gjithë myslimanëve.

7. Shkatërruesi i verës ose alkoolit nuk obligohet me kompensim

Për shkatërrimin e verës nuk ka kompensim, nëse ajo ka qenë pronë e ndonjë besimtari mysliman, ngase vera te besimtarët nuk konsiderohet

[11]Transmeton En-Nesaiu në *Sunenin* e tij nr. (5661). Sipas dijetarëve, hadithi është i gradës që mund të argumentojmë me të.

[12] Transmeton *Ed-Darekutnij* në *Sunen;* Shafiiu në *Musned dhe* Imam Maliku në *Muveta;ë,* etj.

mall i vlefshëm dhe i lejuar për t'u poseduar. E nëse ka qenë pronë e ndonjë pasuesi të librit (ndonjë hebreu ose krishteri), sipas dijetarëve të medhhebit hanefij dhe atij malikij, duhet të kompensohet, ngase ata alkoolin e konsiderojnë mall të vlefshëm dhe sipas tyre, të lejuar për përdorim[13]. Kjo për faktin se besimtarit në esencë i ndalohet ta posedojë një pije të tillë, andaj edhe nuk mund të kërkojë kompensim për diçka, të cilën e ka të ndaluar ta posedojë.

8. Norma e ndyrësirës së alkoolit

Sipas të gjithë juristëve islamë, vera-alkooli konsiderohet ndyrësirë, por ka divergjenca në mes tyre nëse konsiderohet ndyrësirë e rëndë lëndore apo ndyrësirë e rëndë kuptimore.

Sipas dijetarëve të katër medhhebeve, në fetvatë kryesore të tyre, alkooli apo vera konsiderohet ***ndyrësirë e rëndë lëndore.***[14] Çështja e ndyrësirës së verës sipas tyre është e ngjashme me çështjen e urinës, kështu që nëse petku i namazliut stërpiket me masë më shumë se një dërhem nga alkooli-vera, atëherë nuk lejohet namazi me atë petk. Këta dijetarë mendimin e tyre rreth kësaj çështjeje e mbështesin në ajetin kuranor ku Allahu xh.sh. e ka quajtur alkoolin ***"vepër e ndyrë e shejtanit"*** në ajetin e 90 të sures *El-Maide*, në të cilin thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

"O ju të cilët keni besuar, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës *(për fall)* ***janë vepra të ndyra të shejtanit, pra largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar."***

Po ashtu është argumentuar edhe me një hadith të Muhamedit s.a.v.s. që transmetohet nga Ebi Tha'lebete, të ketë thënë: E pyeta Pejgamberin a.s.: ***"O i Dërguar i Zotit, ne jetojmë në një vend ku ka pasues të librit*** *(pjesëtarë të feve të tjera)****, a lejohet të ushqehemi nga enët e tyre?" E ai***

[13] Shih: *El-Mevsuatu-l-Fikhije* 5/25

[14] Po aty, 5/27

tha: "Mos u ushqeni nga enët e tyre, përveç nëse nuk gjeni të tjera, atëherë pastroni ato dhe hani prej tyre."[15].

Përkrahësit e mendimit (se alkooli është ndyrësirë lëndore), kanë thënë: "po të mos ishte alkooli apo vera, e ndyrë, Pejgamberi a.s. nuk do të kishte urdhëruar që enët e ithtarëve të librit të pastrohen nga alkooli, para se të ushqehemi prej tyre." Mirëpo karshi këtij mendimi, kemi edhe mendimin tjetër të Imam Rebiatu err-Rrej (mësuesi i Imam Malikut), Imam El-Muzeniut nga shafiitët, Imam Shevkaniut, Lejth ibën Sad, Davud Edh-Dhahirij etj., se alkooli është ***ndyrësirë kuptimore***[16]. Këta dijetarë e komentuan ndryshe ajetin kuranor të sures *El-Maide*, duke thënë se, përmendja e alkoolit në të njëjtin ajet, bashkë me bixhozin, idhujt dhe hedhjen e shigjetës (për fall) vetvetiu nënkupton se ai është ndyrësirë kuptimore, ngase bixhozi, idhujt apo edhe hedhja e shigjetës dihet fare mirë se janë ndyrësira kuptimore e jo lëndore.

Po ashtu janë argumentuar edhe me një hadith të transmetuar nga Enesi r.a. ku thotë:

> *"Isha duke u shërbyer mysafirëve në shtëpinë e Ebu Talhas, dhe pija e tyre atë natë ishte vera. Në ato momente Muhamedi a.s., kishte urdhëruar dikë që të thërriste "Vëni re, alkooli u ndalua", atëherë Ebu Talha më tha: "Dil dhe derdhe alkoolin, pastaj dola dhe e derdha krejt alkoolin, (e derdhën edhe tjerët) saqë alkooli rridhte nëpër rrugët e Medinës."*[17]

Këta dijetarë argumentojnë me këtë hadith duke thënë se, po të ishte alkooli ndyrësirë lëndore, Muhamedi a.s. nuk do kishte urdhëruar që ai të derdhej rrugëve të Medinës, ngase është e ndaluar që ndyrësira të derdhet në rrugët ku njerëzit qarkullojnë .

9. Norma e përdorimit të parfumeve me përbërje alkoolike

Meqë u sqarua dilema rreth faktit nëse alkooli është apo jo ndyrësi fizike, atëherë është fare lehtë të kuptohet edhe norma e përdorimit të parfumeve me përbërje të alkoolit. Sipas atyre dijetarëve që alkoolin e

[15] Hadithin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

[16] Shih: *El-Mevsuatu-l-Fikhije* 5/27

[17] Transmeton Buhariu me nr. 2332.

konsiderojnë ndyrësirë lëndore (dhe ata përbëjnë shumicën e juristëve islamë nga katër medhhebet) nuk lejohet përdorimi i atyre parfumeve, nëse gjatë përdorimit nuk i nënshtrohet tjetërsimit në materie tjetër, ngase nëse nuk tjetërsohet konsiderohet ndyrësirë dhe pastaj si e tillë e bënë të ndytë edhe petkun e besimtarit, gjë që është e ndaluar sheriatikisht.

Kurse sipas mendimit tjetër, (e të cilët e përfaqësojnë një grup i dijetarëve që janë pakicë karshi mendimit të parë) të cilët e konsideruan alkoolin si ndyrësirë kuptimore e jo lëndore, lejohet përdorimi i parfumeve të tillë, ngase prekja apo stërpikja e petkut me parfum të tillë, nuk e bënë të ndytë petkun, e as nuk shkakton dehje apo ndonjë dëm tjetër tek ai person.

10. Norma e përdorimit të alkoolit për shërim dhe pastrim të plagëve

Për pastrimin e plagëve ose mbytjen e baktereve dhe mikrobeve në plagë, zakonisht përdoret alkooli medicinal. Dallimi mes alkoolit medicinal dhe atij natyror qëndron në atë se, alkooli medicinal përpunohet artificialisht, duke kaluar nëpër procese kimike dhe përbërjet e tij janë shumë të forta, saqë nëse njeriu e pi alkoolin medicinal, mund të vdesë prej tij, prandaj ky alkool përdoret vetëm për çështje mjekësore e jo për pije.

Por siç u cek edhe me lartë, në parim ndalohet alkooli, pa marrë parasysh llojit të tij, ngase transmetohet një hadith nga Ibën Mesudi r.a. të ketë thënë: *"Vërtetë Zoti nuk e ka bërë shërimin tuaj në gjëra të cilat i ka ndaluar."*[18]

Megjithatë, juristët islamë e kanë lejuar përdorimin e alkoolit medicinal (e kurrsesi atij konsumues) për shërim, për pastrimin e plagëve dhe mbytjen e mikrobeve në lëkurë, por e kanë kushtëzuar me këto dy kushte:

- Mund të përdoret, vetëm nëse nuk ka barëra zëvendësuese që e luajnë të njëjtin rol në shërim; dhe
- Rekomandimi për përdorimin e alkoolit medicinal, të jetë nga mjeku i specializuar, besimtar, i cili ia ka frikën Zotit xh.sh., dhe respekton besimin e pacientëve të tij.[19]

[18] Transmeton Imam Buhariu dhe të tjerët.

[19] Shih *El-Fikhu-l-Islami ve edil-letuhu* 9/440

Andaj, duke parë rëndësinë e këtij alkooli dhe rolin e tij për pacientët, juristët islamë e lejuan përdorimin e tij. Muhamed Reshid Rida thotë: *"Rreth alkoolit medicinal mund të thuhet: Ky lloj alkooli është një materie ose substancë e pastër në vetvete dhe pastrues për plagët. Është shtyllë prej shtyllave të farmacisë dhe mjekimit medicinal ngase është pjesë përbërëse e shumë barërave të tjera. Ndalimi i këtyre barërave për myslimanët, bënë që ata mos të avancojnë në shumë shkenca të ndryshme, në të cilat të tjerët kanë avancuar, si në shkencën e kimisë, farmacisë, mjekësisë etj. Po ashtu, nëse e ndalojmë këtë alkool, kjo mund të ndikojë në vdekjen e shumë njerëzve të sëmurë dhe të lënduar, ose në vonimin e shërimit të tyre..."*[20]

Këtë (lejueshmërinë e këtij alkooli në mjekësi) e ka potencuar edhe *"Akademia e Fikhut"* pranë *Rabitatul-Alemil-Islamij*.[21]

11. Tjetërsimi i alkoolit në materie tjetër

Tjetërsimi i alkoolit në materie tjetër është një prej çështjeve që ka zgjuar interesimin më të madh te dijetarët islamë, ngase logjikisht, me tjetërsimin e tij tjetërsohet edhe norma e tij. Andaj, pas analizimit nëse shikojmë mendimet e juristëve islamë, i gjejmë këto konkluza:

a) Tjetërsimi i alkoolit në uthull

Sipas unanimitetit të juristëve islamë, të të katër medhhebeve, lejohet tjetërsimi i alkoolit në uthull, me kusht që ky tjetërsim i alkoolit të ketë ndodhur vetvetiu, pa ndërhyrjen e dorës së njeriut në këtë proces. Uthulla e tillë është e lejuar për përdorim dhe ushqim, ngase Muhamedi s.a.v.s. në një hadith thotë: *"Sa ushqim i mirë është uthulla."*[22]

Ndërsa, nëse alkooli tjetërsohet në uthull me ndërhyrjen e punës së njeriut në të, si p.sh. hedhja e ndonjë materieje për tjetërsimin e tij, kjo është e lejuar, sipas dijetarëve të medhhebit hanefij dhe atij malikij. Lejueshmërinë e tyre për tjetërsimin e qëllimshëm të alkoolit

[20] Shih: Fetave Muhamed Reshid Rida, 4/1631.

[21] Shih: http://www.islamtoday.net/bohooth/artshow-32-4626.htm, nga vendimi i mbledhjes së Rabita-s, më 20.05. 2012.

[22] Transmetojnë Muslimi dhe Ebu Davudi.

në materie tjetër-uthull e mbështesin në hadithin e lartpërmendur dhe në faktin se motivi i ndalesës së alkoolit (dehja), në këtë rast ka ndryshuar, dhe me ndryshimin e motivit ndryshon edhe norma, nga harami në hallall.

Mirëpo një gjë të tillë e kanë konsideruar të ndaluar juristët shafij dhe hanbelij, duke u argumentuar në hadithin e Enesit r.a., i cili thotë:

"Është pyetur i Dërguari i Zotit për alkoolin, a lejohet të shndërrohet në uthull, e ai ka thënë: jo".

Një argument tjetër për këtë ndalim, sipas tyre është edhe rasti kur Pejgamberit a.s. i kishte zbritur urdhri për t'u ndaluar nga alkooli, e ai i kishte urdhëruar shokët e tij që ta derdhnin atë dhe thonë: "Po të ishte lejuar tjetërsimi i tij, nuk do t'i kishte urdhëruar për ta hedhur, por për ta tjetërsuar."[23]

b) Tjetërsimi i alkoolit me zjarr

Nëse ndodh që alkooli të jetë tjetërsuar nga ndikimi i nxehtësisë së zjarrit, saqë në të, më nuk ka mbetur diçka nga cilësitë e tij, si shija, era apo ngjyra e tij, e rrjedhimisht, nuk ka mbetur në të asnjë efekt dehës, në këtë rast, sipas juristëve hanefij (me përjashtim të Ebu Jusufit) dhe disa juristëve të medhhebeve tjera, ky alkool i tjetërsuar, nuk konsiderohet i ndyrë, ngase i ngjason meselesë paraprake, tjetërsimit të alkoolit në uthull.

Mirëpo në anën tjetër, juristët e medhhebit shafiij dhe hanbelij, në fetvatë kryesore të tyre, një gjë të tillë e ndalojnë, ashtu siç e ndalojnë edhe tjetërsimin e tij në uthull, nëse bëhet me ndërhyrjen e punës së njeriut në të, duke justifikuar mendimin e tyre se alkooli në esencë është i ndaluar, e rrjedhimisht ndalohet edhe tjetërsimi i tij.[24]

[23] Është bërë verifikimi i hadithit më parë.

[24] Shih: Punimin nga Muhamed Err-Rrukij të botuar në revistën mujore "Da'vetul-Hak" në Rabat, prill 1998, linku: http://www.habous.gov.ma/daouat-alhaq/item/8309.

12. Përzierja e alkoolit në gjërat ushqimore dhe efekti i tij në klasifikimin normativ islam

Në parim, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve klasikë, duke përfshirë këtu edhe Imamët e mëdhenj, e sidomos atyre të cilët nuk pranuan tjetërsimin e alkoolit në materie tjetër, edhe pas përpunimit me zjarr ose përzierjes së tij me materie tjetër, ndalohet çdo lloj ushqimi që në të është përzier ndonjë dozë e alkoolit.

Këta dijetarë japin fetvatë e tyre se, përdorimi i alkoolit është i ndaluar në çdo formë a mënyrë, përderisa besimtari nuk shtrëngohet nga ndonjë nevojë e madhe ose urgjencë, dhe nuk ka dyshim se ky mendim është më afër devotshmërisë dhe është kapje për më të sigurtën, nga dispozitat sheriatike Islame.

Andaj duhet ta kuptojmë se, në kushte të rëndomta duhet të largohemi nga alkooli në tërësi, dhe nuk duhet ta përziejmë atë me ushqimet tona. Mirëpo për fat të keq, në kohën tonë bashkëkohore, shumë prej kompanive prodhuese të ushqimeve, e shtojnë alkoolin në këto ushqime, si përbërje aromatizuese, ose edhe si përbërje konservuese të atyre ushqimeve, në mënyrë që ai ushqim ta ruajë freskinë e tij për një kohë sa më të gjatë. Kjo sprovë bashkëkohore na detyron ne që të hulumtojmë dhe të sqarojmë thelbësisht, rreth normës së konsumimit të atyre ushqimeve që në përbërje të tyre kanë alkool.

E për ta sqaruar këtë çështje sa më mirë, patjetër duhet ta bëjmë edhe detajizimin për mënyrën e përgatitjes së atyre ushqimeve, ngase nëse shikojmë mënyrën e përgatitjes së tyre, gjejmë se ato ushqime mund të përzihen me alkool në dy mënyra: ose para përpunimit ose pas përpunimit të tyre. Kështu që:

a) Nëse alkooli-vena i shtohet ushqimit pa qenë i transformuar në procese kimike, dhe ai ushqim nuk vlohet apo zihet, në mënyrë që të tjetërsohet, pa dyshim se mbetet në suazat e ndalueshmërisë, dhe të ushqyerit me një ushqim të tillë është rreptësishtë i ndaluarharam, ngase bashkë me ushqimin, ne konsumojmë edhe me alkoolin, pa ndryshuar asgjë nga materia e tij.
b) Nëse në atë ushqim, është shtuar një përqindje e alkoolit, dhe i është nënshtruar zjarrit dhe tjetërsimit, me ç'rast është tjetërsuar

dhe nuk ka ruajtur asnjë nga vetitë apo veçoritëe tij, siç janë: ngjyra, era apo shija, atëherë të ushqyerit me atë lloj ushqimi është i lejuar, sipas atyre dijetarëve të cilët kanë konsideruar se përpunimi-shndërrimi i alkoolit me vlim a zierje, e bënë atë të konsiderohet materie e pastër dhe e lejuar. Kjo normë e lejueshmërisë, në kushte dhe kondita të tilla është konstatuar edhe nga dijetarët e shkollës juridike hanefite, të cilët konsiderojnë se tjetërsimi i alkoolit në materie tjetër, me anë të zjarrit, e bënë atë të pastër dhe të lejuar, siç u sqarua më lartë. Juristi i famshëm hanefit- Imam Kasaniu në Bedaiu-s-Senai'[25] thotë": "Nëse materia e ndytë (alkooli) tjetërsohet me zjarr-vlim apo zierje, dhe ndryshon në tërësi cilësitë e tij, nuk konsiderohet më e ndyrë, ngase norma ndryshon me ndryshimin e gjendjes së saj, ngjashëm siç ndryshon norma e alkoolit me tjetërsimi e tij në uthull". Këta juristë mbrojnë mendimin e tyre duke vënë theksin se, lejueshmëria nuk ka të bëjë me alkoolin në këtë rast, mirëpo me një materie të tjetërsuar, e cila pas tjetërsimit në asnjë mënyrë nuk mund të quhet më alkool, ashtu siç nuk mund të quhet uthulla e tjetërsuar nga alkooli, alkool.

c) Ndërsa nëse alkooli-vena i shtohet ushqimit pas përfundimit të tij, vetëm si "materie aromatizuese" një gjë e tillë është është e ndaluar, dhe ushqimi i tillë është haram për t'u ngrënë, ngase alkooli në këtë rast nuk ka ndryshuar asgjë nga vetitë e tij, qoftë të ngjyrës, erës apo shijes së tij.

Konkluzë

Në fund, duhet vënë theksin në një porosi, e cila tashmë ka dalë edhe si konkluzë nga të gjitha akademitë juridike të botës islame, se përdorimi i alkoolit në ushqime duhet të shmanget maksimalisht, me porosi që mundësisht, të mënjanohet në tërësi, e nëse jo, atëherë të paktën, ai të përdorët vetëm në suaza të domosdoshmërive dhe situatave përjashtuese, sepse kjo përputhet më parimet dhe normat juridike islame në përgjithësi.

Megjithatë, Zoti e di më së miri!

[25] *Bedaiu-s-Senai* 1/243,. Ngjashëm me Imam Kasanin thekson edhe Ibn Abidin në *Hashijen* e tij, 1/209.

Literatura e shfrytëzuar:

- Sahihul-Buhariu, Muhamed bin Ismail ebu Abdullah el Buhari, (Dar Tavku-n-Nexhat), 2001
- Sahihul-Muslimi, El-Imam Ebul Hasen Muslim bin el Haxhaxh el Kushejrij, En-Nejsaburi , (Dar Tavku-n-Nexhat), 2001
- Sunen En-Nesaij, Ebu Abdurrahman Ahmed bin Shuajb el-Harasani en Nesaij, Shtëpia botuese (Muessesetu-Rrisaleh), Bejrut 2001.
- Sunen Ebu Davud, Ebu Davud Sulejman ibnul Eshath, bin Ishak, bin Beshir, bin Shedad ss-Sexhistani, (El-Mektebetul-Asrije), Bejrut.
- Sunen Et-Tirmidhij, Muhamed bin Isa Et Tirmidhij, (Darul-Garb El-Islamij), 1998.
- Sunen Ed-Darekutnij, Ebu Hasen Alij bin Muamer bin Dinar el Bagdadij ed-Darekutnij, (Muessesetu Rrisaleh), Bejrut, 2004.
- Musned Esh-Shafi'ij, Ebu Abdallah, Muhamed bin Idris bin Shafi el Kureshij el Mekij, (Darul-Kutub el Ilmijeh), Bejrut, 1980
- Muveta'ë Malik, Malik bin Enes bin Malik bin Amir el Asbahij, (Muessesetu Zajid bin Sulltan lil-Eamal El-Hajrijeh), Ebu Dhabj, 2004
- Mu'xhemu lugatul-fukahai, Dr. Muhamed Ravas Kalaxhij, Shtëpia botuese: (Dar En-Nefais), Bejrut, 1996
- El-Hidajeh Sherh Bidajetul-Mubtedi, Burhanudin El-Merginani, (Darul Erkam bin Ebil-Erkam), Bejrut.
- El-Fikh El-Islamij, Dr.Vehbe Zuhajli (Libër i botuar për student nga Universiteti i Damaskut në vitin 2002).
- El-Fikh El Islamij ve edil-letuhu, Prof. dr. Vehbe Zuhajli, (Darul-Fikr), Damask, 2008.
- Fetava Muhamed Reshid Rida, dr. Salahudin el Munxhid. (Pa vend dhe vit botimi).
- Bedaiu-s-senai fi tertibi-sh-sherai, Imam Alaudin Ebu Beker el Kasani, (Dar Ihjau-t-turath el-arabij), Bejrut, 2000.
- Sherh El Kavaidu-l fikhije, Ahmed Bin Shejh Muhamed Ez Zerka, (Darul-Kalem), Damask, 2007.
- El-Lubab fi sherhi-l-Kitab, Abdul-Ganij El-Gunejmi El-Mejdani, (Darul-Kuba), Damask, 2003
- El-Mevsuatu-l-Fikhije, Ministria e Vakëfeve në Kuvajt.

Web faqe:

- http://www.habous.gov.ma/daouat-alhaq/item/8309.
- www.islamtoday.net/bohooth/artshow-32-4626.htm

Mr. Ekrem MAQEDONCI

TRADITIONAL AND CONTEMPORARY PROVISIONS ON THE USE OF ALCOHOL

(Summary)

An issue which has constantly been the object of heated debate among Muslims throughout the world is that of alcohol. This is due to the fact that alcohol is no longer used only as a drink, as was the case in the past, but has many other uses as well. Nowadays, there is almost no drugstore that does not sell alcohol, which is used for medicinal purposes. There are almost no food stores that do not sell food items which contain alcohol. There are almost no perfumes, which do not contain alcohol.

Due to this, it is not surprising that people want to know the provisions of Islamic law on this issue. Thus, we will try to provide some basic information about the use of alcohol in the food industry as well as other industries considering the fact that these provisions are of a special importance to believers.

أكرم ماتشيدونتسي

أحكام تقليدية ومعاصرة حول المسكر (الخمر)

(خلاصة البحث)

ليس هناك شك في أن قضية المسكر هي إحدى القضايا التي أثارت الفضول باستمرار لدى المسلمين في جميع أنحاء العالم. هذا يرجع إلى حقيقة أنه مع مرور الوقت، نشأت قضايا جديدة ، حيث أن الكحول اليوم لا يستخدم فقط للشرب والتسلية ، كما كان شائعًا في العصور القديمة ، ولكنه يستخدم في العديد من القضايا الأخرى أيضًا.

وفي عصرنا الحاضر، يمكننا القول أنه لا توجد صيدلية تقريبًا ولا يتواجد في أدراجها الكحول لاستخدامه المختلف مثل استخدامه في تنظيف الجروح المختلفة. بل لا يمكنك العثور على محلات البقالة ولا توجد في أدراجها على أنواع مختلفة من الشوكولاتة والحلويات التي تحتوي على نسبة من الكحول كجزء من مكوناتها، كما لا يمكن أن تجد عطرا لا تحتوي على الكحول كجزء لا يتجزأ منه .

ونظرا إلى ما سبق فمن الطبيعي جدًا أن يهتم المسلم بالحكم الشرعي من هذه القضايا. لذلك يُنصح بتزويد القراء بالمعرفة الأساسية حول تعاطي الكحول في صناعة المواد الغذائية والكيميائية الحالية ، لأن هذه الأحكام لها أهمية خاصة فيما يتعلق بإيمان المؤمن المعاصر وحياته.

Sadik MEHMETI

IXHÂZETNÂMETË E HAXHI SHERIF EF. AHMETIT

Abstrakt

Në këtë punim merren në shqyrtim dy ixhâzetnâme (diploma) në gjuhën arabe, të cilat në vitin 1944, myderrizi i Medresesë "Pirinaz" të Prishtinës, Ahmet ef. Ajeti (Mardoçi), ia kishte dhënë studentit të tij, më vonë dijetarit islam, ndër më të shquarit në Kosovë dhe jo vetëm, në gjysmën e dytë të shek. XX, - Haxhi Sherif ef. Ahmetit (1920-1998). Ixhâzetnâmetë janë diploma, të cilat u janë dhënë studentëve pasi mbaronin me sukses medresenë dhe me të cilat, ata fitonin të drejtën për t'u dhënë mësim të tjerëve. Ixhâzetnâmetë e Haxhi Sherif efendiut u përkasin dy llojeve të këtyre dokumenteve: e para është ixhâzetnâme e përgjithshme, për të gjitha lëndët dhe disiplinat e tyre që janë mësuar ('amme), kurse e dyta është e veçantë vetëm për një vepër (hâssa). Këto ixhâzetnâme, përveç aspektit historik, diplomatik, filologjik etj., janë të rëndësishme për të njohur më mirë veprimtarinë e Medresesë "Pirinaz" të Prishtinës në dekadat e fundit të saj, si dhe për të plotësuar e saktësuar të dhënat jetëshkrimore të myderrizit tonë, Haxhi Sherif ef. Ahmetit.

Fjalët çelës: *Ixhâzetnâme, medrese, "Pirinaz", myderriz, Haxhi Sherif ef. Ahmeti*

HYRJE

Sikurse dihet, medresetë në të kaluarën kanë qenë të vetmet institucione për arritjen e shkollimit të mesëm dhe të lartë fetarë islam. Në Kosovë kanë vepruar shumë medrese të këtij lloji, numri i të cilave me kalimin e kohës është zvogëluar, aq sa në vitin 1948 me urdhër të pushtetit të asaj kohe, janë mbyllur të gjitha medresetë tradicionale që kishin vepruar me dekada dhe shekuj në hapësirat tona.

Edhe në Prishtinë, qysh para vitit 1566, sipas studiuesit N. Krasniqit, ka punuar *Medreseja e Ket'hyda Besharet Beut*[1], kurse sipas studiuesit turk C. Baltaci, kjo medrese u themelua në vitin 1575.[2] Sipas këtij të fundit, myderriz i saj më 1575 ishte emëruar Dervish Mehmet efendiu që paguhej 20 akçe në ditë, e pas tij në këtë pozitë vjen Muhjiddin efendiu me 20 akçe në ditë, i emëruar më 1587 dhe pas tij Muslihuddin efendiu i emëruar më 1589.[3] Në vitin 1582 e këndej në këtë medrese dihet se kanë dhënë mësim edhe dijetarët e shquar të kohës, si Husamuddin *"Levhi"* efendiu[4], Ibrahim efendiu, Abdullah efendiu i biri i Abdylkerimit, asistenti i tij Abdylkadir efendiu, Mustafa efendiu etj.

Në të vërtetë, ndër medresetë më aktive në shek. XIX dhe në gjysmën e parë të shek. XX, jo vetëm në Prishtinë por edhe në Kosovën mbarë,

---

[1] Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare,* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017, f. 232.

[2] Cahid Baltaci, *Osmanli Medreseleri (XV-XVI Yüzyillarda),* vëll. 1, M.Ü. Ilâhiyat Fakültesi Vakfi Yayinlari, nu. 198, Stamboll, 2005 kapitulli i pestë, f. 159-492.

[3] Cahid Baltaci, *Osmanli Medreseleri...,* po aty, 172-173.

[4] *Hysamidin "Levhi" Prishtina,* është poet dhe dijetar i shquar i periudhës osmane të shek. XV-XVI. Emri i tij është Hysamidin. *"Levhi"* është pseudonim me të cilin u bë i njohur. Ishte nga Prishtina dhe vëllai i poetëve dhe shkencëtarëve *"Nuhi"* dhe *"Azmi"*. Merrej me tesavuf (misticizëm). Një kohë të gjatë u gjend në shërbim të Merkez efendiut. (Sami Frashëri, *"Kamus Al-A'lam"*, vëll. IV, f. 3149, dhe vëllimi VI, f. 4010). Ka qenë muteveli (mbikëqyrës) i vakëfit dhe imam i mëhallës së Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë. Ka qenë bashkëkohës dhe mik i dijetarit tjetër nga Prishtina, Pir Mehmet ef. Prishtina. Kjo dëshmohet me vakufnamenë e shënuar në doreshkrimin e veprës *"Sherh râhati el-kulûb",* të Pir Mehmet ef. Prishtinës që ruhet në Arkivin e Kosovës. Më gjerësisht: Sadik Mehmeti, *Doreshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008, ff. 123-130.

ishte Medreseja "Pirinaz"[5], e cila gjendej në oborrin e xhamisë me të njëjtin emër. Kjo xhami është ndërtuar në shek. XV nga sadriazemi i sulltan Selimit dhe të birit të tij sulltan Sylejmanit, *Pirinazir pasha*, i cili e kishte origjinën nga viset tona.[6] Nuk dihet se kur është ndërtuar medreseja, por mendohet se e ka nisur punën aty nga mesi i shek. XIX. Sipas studiueses M. Bećirbegović, kjo medrese do ta ketë nisur punën në fillim të gjysmës së dytë të shek. XIX.[7] Kurse në një dokument të vonshëm të vitit 1943, thuhet se kjo medrese ka nisur punën nga viti 1873.[8] Megjithatë, data e ndërtimit të xhamisë, sipas së cilës është quajtur kjo medrese, si dhe data e themelimit të Medresesë "Pirinaz" dhe aktiviteti i saj në dekadat e para mbetet një çështje për t'u ndriçuar.

Medreseja "Pirinaz", ka pasur dy dhoma për studentë dhe ders'hanen, e cila si ndërtesë ka qenë e ndarë nga dhomat e banimit të studentëve, ndërsa në mes të secilës nga këto dy dhoma ka ekzistuar një korridor dhe secila dhomë e ka pasur oxhakun e saj. Edhe pse medreseja ka qenë e ndarë, megjithatë, së bashku me xhaminë dhe tyrben përbënin një kompleks unik.[9]

Në këtë medrese, në bazë të dokumenteve dhe ixhâzetnâmeve të kohës, dimë se kanë dhënë mësim myderrizë të njohur nga Prishtina, të cilët kishin kryer studimet e tyre në Prishtinë dhe në Stamboll dhe kishin marrë ixhâzet te dijetarë të shquar të kohës, disa prej të cilëve do t'i përmendim në vazhdim, por që biografia e të cilëve nuk është ndriçuar deri më sot dhe që gjithsesi mbetet një punë për t'u bërë në të ardhmen.

---

[5] Në dokumentet e kohës, sidomos në ato osmane, kjo medrese përmendet me emrat *"Piri Naziri",* që është më e saktë, pastaj *"Pirinazir" e"Pirinazër"*, por meqë është bërë e njohur me emrin popullor *"Pirinaz",* edhe ne u përcaktuam. Më gjerësisht për veprimtarinë në dekadat e fundit të Medresesë "Pirinaz", shih: Sadik Mehmeti: *"Medreseja Pirinaz e Prishtinës",* zëri i botuar në: Fjalori Enciklopedik i Kosovës - Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, vëll. II, Prishtinë, 2018, f. 1078; I njëjti, *Medreseja "Pirinaz" në Prishtinë dhe aktiviteti i saj 1935-1945,*"Buletin i Fakultetit të Studimeve Islame", nr. 2, Prishtinë, 2012, ff. 255-277.

[6] Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare...,* po aty.

[7] Madžida Bećirbegović *Prosvjetni objekti islamske arkitekture na Kosovu,* në: "Starine Kosova", nr. VI-VII, Prishtinë, 1972-1973, f. 86.

[8] Arkivi i Kosovës, *Bashkësia e Fesë Islame-Zyra e Vakëfit Prishtinë 1943,* k. 37.

[9] Madžida Bećirbegović, *Prosvjetni objekti...*, po aty, f. 86.

Për dallim nga disa medrese të tjera, kjo shkollë veproi edhe pas largimit të Perandorisë Osmane nga Kosova. Për njëfarë kohe (1927-1929), kur u mbyll me pretekst se po përgatiste ithtarë të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, punoi edhe në Podujevë[10]. Pas kësaj, u hap përsëri në Prishtinë dhe punoi deri në vitin 1948, kur u mbyll së bashku me të gjitha medresetë e tjera ekzistuese në atëkohë.

Medreseja "Pirinaz" ka nxjerrë një numër të madh të studentëve me ixhâzet që vinin nga Prishtina dhe trevat përreth. Këtu e ka marrë ixhâzetnâmenë edhe *alimi, hoxha, myderrizi, përkthyes i Kuranit, botuesi, pedagogu, veterani i arsimit*, *Haxhi Sherif ef. Ahmeti*[11].

[10] Abdulla R. Vokrri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941), Prishtinë, 1990. f. 197.

[11] *H. Sherif (Bahtijar) ef. Ahmeti*, lindi në Gumnasellë të Lypjanit. Mësimet e para i mori në vendlindje, për t'i vazhduar në Medresenë e Ferizajt dhe atë të Prizrenit, ndërsa u diplomua në Medresenë e njohur "Pirinaz" të Prishtinës (1944) ku mori ixhâzetnâmenë para myderrizit të njohur Ahmet ef. Mardoçi. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ndoqi Kursin Pedagogjik, në Prizren (1945), e Pejë (1950). Punoi si mësues fillimisht në fshatin Banullë e më vonë edhe në Gadime e Sllovi. Më 1956 u emërua imam në xhaminë e fshatit Gllogoc të Lypjanit ndërsa më 1965, emërohet pedagog në Medresenë e Mesme "Alaudin" të Prishtinës, ku ligjëroi lëndët: Akaid (Apologjetikë) e Filozofi Islame deri më 1985. Ka qenë edhe drejtor i Medresesë (1970-1984). Më 1985 emërohet Myfti i Prishtinës me rrethinë, detyrë të cilën e kreu deri në pension (1990). Me themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë (1992), angazhohet ligjërues i lëndës së Akaidit-Apologjetikës Islame (1992-1994). Është iniciues, themelues dhe drejtues i periodikut islam në gjuhen shqipe në Kosovë, "Buletini Informativ" (1968), "Takvimi/Kalendari" (1970), "Edukata Islame" (1971), të cilën përveç që e themeloi edhe e drejtoi dhe e redaktoi deri më 1987. Është autor i dhjetëra shkrimeve, studimeve dhe artikujve nga fusha e apologjetikës islame, komentimit të Kuranit, moralit islam dhe nga islamologjia. Ka përgatitur pesë dispensa për nevojat e nxënësve në medrese dhe studentëve në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Gjithashtu, ka përgatitur doracakët fillestarë për njohurit themelore të fesë islame "Ilmihalin", "Jasini Sherifin", "Mevludin". Ka përkthyer dhe ka komentuar Kuranin fisnik (1988). Ndërroi jetë në Prishtinë më 14 prill 1998 Ramadan Shkodra, *"Ahmet, Myderriz Sherif (1920-1998)",* zëri i botuar në: Fjalori Enciklopedik i Kosovës - Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, vëll. I, Prishtinë, 2018, f. 25-26; si dhe *"Haxhi Sherif ef. Ahmeti -jeta dhe vepra (1920-1998)"*, përmbledhje kumtesash të sesionit shkencor mbajtur në Prishtinë më 17 prill 2010, botuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010.

Ixhâzetnâmetë

Në hyrje të këtij punimi u tha se medresetë, kanë qenë të vetmet institucione të mësimit të lartë. Natyrisht, ka pasur dallime mes tyre, si për nga programi dhe rangu, po ashtu edhe për nga vendi se ku gjendej medreseja dhe kush jepte mësim në të. Pas kryerjes së medresesë është fituar diploma, respektivisht leja *(ixhâze),* me të cilën studenti i cili e ka kryer atë, të ketë të drejtë t'i mësonte edhe të tjerët.

Para se të bëjmë fjalë se çka është në të vërtetë ixhâzetnâmeja e gjejmë me vend të theksojmë dy gjëra:

E para, faktin se studentët në medresetë e kohës, pra edhe në atë "Pirinaz" të Prishtinës, janë regjistruar pasi të kenë përfunduar shkollën fillore (mektebin), ose në periudha të mëvonshme, edhe shkollën e ulët të mesme (rushdijen)[12], dhe *e dyta,* çdo student ka qenë i regjistruar në një medrese, por me lejen e myderrizit të tij, ligjëratat ka mundur t'i ndiqte edhe te një apo disa myderrizë të tjerë. Megjithatë, myderrizi kryesor nga i cili studenti ka marrë diplomën, rëndom ka qenë ai, tek i cili ka dëgjuar ligjëratat e nivelit të lartë. Kjo na jep të kuptojmë se deri në ixhâzet, studentit përveçse i duhej të përvetësonte shumë lëndë dhe tekste, ai kalonte edhe nëpër duart e disa myderrizëve, por vetëm te njëri, tek ai më kryesori dhe më me autoritet, e merrte ixhâzetnâmenë, që mund të ishte e përgjithshme për të gjitha shkencat *('âmme)* ose e veçantë vetëm për një *(hâssa).*[13] Me të marrë ixhâzetnâmenë, *softe-ja* ose *talebe-ja*[14], siç quheshin asokohe studentët, mbaronte studimet dhe më të fitonte licencën për t'i mësuar edhe të tjerët.

Sipas orientalistit, T. Dizdari, *Ixhâzet-i,* nga arabishtja *ixhâzet* **(اجازة)** "është autorizimi, certifikata (diploma) më të cilën një student në teologjinë myslimane autorizohet për të dhënë mësime dhe për të predikuar

---

[12] Jašar Redžepagić, *Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918 godine,* Priština, ZNUKM ,1968, f. 156.

[13] Haso Popara, *Idžazetname u rukopisima Gazi Husrev-begove biblioteke*, në: "Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, knjg. XXV-XXVI, Sarajevë, 2007, f. 5.

[14] Fjala *"softa"* është me prejardhje nga persishtja *"suhte"*, që d.m.th. *"i djegur, i dashuruar pas dijes",* kurse fjala *"talebe"* është njëjësi i *"tul-lâb"*, që rrjedh nga arabishtja, që d.m.th. *"kërkues i dijes"*. Ziya Kazıcı, *Islâm medeniyeti ve müesseseleri tarihi,* M. Ü. Ilâhiyât Fakültesi Vakfı Yayınları, Nu: 191, Istanbul, 2011, f. 383.

mbasi të ketë kryer medresenë; italisht: *laurea*. Ixhâzeti iu akordohej talebeve (studentëve) të medresesë pas provimit të pjekurisë në mësime. Ka marrë ixhâzet, është me ixhâzet: i diplomuar për të hyrë në radhën e myderrizëve, hatibëve, vaizave (predikatarëve)"[15].

Kurse sipas studiuesit dhe orientalistit H. Kaleshi, - i cili është edhe i pari ndër ne që këto dokumente i ka vështruar nga aspekti diplomatik, - ixhâzetnâmetë dhe hilâfetnâmetë bëjnë pjesë në grupin e atyre dokumenteve të veçanta arabe dhe kanë karakter të dokumenteve shpirtërore dhe jo të dokumenteve gjyqësore. Të parat janë diploma, që u janë dhënë studentëve pasi të kenë kryer medresenë, kurse të dytat, pra hilâfetnâmetë, po ashtu, janë diploma që u janë dhënë shejhëve të teqeve, për të kryer detyrën e shejhut.[16]

Ixhâzetnâmetë nuk janë shkruar në një letër, por në formë broshure, respektivisht fletoreje. Ato fillojnë me *invokacionin (tahmîd)*, i cili është mjaft i gjatë. *Invokacioni*, që d.m.th. dokumenti, fillon me formulën "*Bismil-lâhi rr-Rrahmâni rr-Rrahîm" (Me emër të Allahut të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotit!).* Në vazhdim, gati një faqe e më shumë, i drejtohen falënderimet Allahut xh.sh. Përmbajtja e invokacionit është në harmoni me përmbajtjen e dokumenteve: shpreh falënderimin Allahut xh.sh., i Cili gjithçka përthekon me diturinë e Tij, dhe i Cili dijetarit ia ka zbukuruar gjoksin me biluret shkencore, dhe se diturisë së Tij nuk i ik asgjë, as në qiej dhe as në Tokë, etj.[17]

Më tutje, vazhdon *ekspozicioni*, i cili fillon me shprehjen *"emmâ ba'd" - "e pastaj"*. Kjo pjesë po ashtu është e gjatë, më e gjatë se e para (invokacioni), dhe flet me ajete dhe hadithe të përzgjedhura vetëm për vlerat e shkencës dhe të dijetarëve.[18]

---

[15] Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, AIITC, Tiranë, 2008, f. 431.

[16] Dr. Hasan Kaleši, *Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji*, Prishtinë, 1972, f. 43. Kjo vepër është përkthyer në gjuhën shqipe nga Ismail Rexhepi dhe është botuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës: Dr. Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra vakëfnore në gjuhën arabe në Jugosllavi*, Prishtinë, 2010.

[17] Po aty.

[18] Po aty.

Pjesa në vazhdim e ekspozicionit është pjesa më e rëndësishme e ixhâzetnâmesë. Në të përmendet emri i studentit që merr diplomën dhe çka ka studiuar.

Pas kësaj pjese, myderrizi që jep diplomën, tregon se kush këtij ia ka dhënë diplomën *(kemâ exhâze lî)*, natyrisht, krahas të gjitha epiteteve për profesorin e vet, pastaj kush ia ka dhënë diplomën profesorit të tij *(kemâ exhâze lehu)* dhe kjo vazhdon edhe me tutje gjithnjë deri te kalifi i katërt i myslimanëve 'Ali b. Ebû Tâlibi r.a.. Në këtë zinxhir gjejmë emrat e shumë dijetarëve dhe kolosëve islamë.

Ixhâzetnâmeja përfundon me këshillat që profesori ia jep studentit në lidhje me shkencën, devotshmërinë, dashurinë ndaj studentit, harmonizimin e fjalëve dhe veprave etj. Pjesa e fundit është lutje për Muhamedin a.s., familjen dhe shokët e tij.[19]

Dhe në fund fare, pason shënimi dhe vula e vënë nga vetë myderrizi që e jepte ixhâzetnâmenë.

Ixhâzetnâmeja e parë e Haxhi Sherif efendiut

Haxhi Sherif efendiu me të kryer studimet në Medresenë "Pirinaz", sikurse u tha, kishte marrë dy ixhâzetnâme njëkohësisht, njëra ishte e përgjithshme, pra për të gjitha disiplinat bazike dhe ato ndihmëse të shkencave tradicionale dhe racionale që ishin mësuar asokohe në atë medrese (të cilat do t'i përmendim në vazhdim), dhe e dyta ishte e veçantë për një vepër të caktuar. Dhe megjithëse ato paraqesin një tërësi të vetme, ne do t'i trajtojmë si të veçanta.

Këto dy dokumente, janë të periudhës së fundit të veprimtarisë së Medresesë "Pirinaz" të Prishtinës dhe janë të rëndësishme për shumë arsye. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, arrijmë të njohim emrat e disa profesorëve që kanë dhënë mësim në këtë medrese, pastaj lëndët dhe disiplinat që janë mësuar, dhe, ajo më kryesorja, përmes tyre njohim dhe arrijmë të gjurmojmë lidhjet mes mësuesve dhe studentëve brez pas brezi, si dhe të hulumtojmë rrugët se si shkencat islame kanë ardhur deri te ne.

[19] Po aty.

Gjithashtu duke lexuar e studiuar këto ixhâzetnâme bindemi se jo rastësisht, studentët e dalë nga kjo medrese, më vonë janë bërë ndër bartësit kryesor të arsimit islam në gjysmën e dytë të shek. XX, sepse në formimin e tyre intelektual do të kenë ndikuar dhe lënë gjurmë disa myderrizë të shquar vendor në Prishtinë.

Ixhâzetnâmeja e parë e Haxhi Sherif efendiut, sikurse të gjitha dokumentet e tjera të këtij lloji, është e shkruar në gjuhën arabe, me shkrimin *"nes'h",* të trashë, jo i bukur dhe jo shumë karakteristik për ixhâzetnâmetë. Është e shkruar në formë fletoreje dhe ka formatin e shkrimit 16x8 cm. Fletorja ka gjithsej 30 faqe, prej tyre 23 janë të ixhâzetnâmesë së parë dhe 7 të ixhâzetnâmesë së dytë.

Në ballë dhe përreth saj shkruan:

اجازت نامه

ماشاء الله لا حول و لا قوة الا بالله العلى العظيم

Më pastaj, vjen *"Besmeleja",* e përreth saj në shtylla shkruan:

بسم الله الرحمن الرحيم

حمدا لله تعالى واقتداء الكتاب المجيد

Më tutje, si rëndom për këto dokumente, pason *"hamdeleja"* (f. 1-3) dhe *"salvelja"* (f. 4), dhe më pastaj (f. 4) tregohet se kush është myderrizi i cili po e jep dhe po e lëshon këtë ixhâzetnâme. Aty shkruan se profesor i kësaj medreseje, pra edhe i Haxhi Sherif efendiut tonë, është *Ahmeti i biri i Ajetit të birit të Arifit* nga Prishtina.

سبحانك توجهنا الى جنابك و قصدنا نحو بابك يا مجيب كل مسؤل ...فصل عليه صلاة وسلم تسليما و تتم له ما يجب لشانه تبجيلا وتكريما ... و بعد فيقول العبد الضعيف ... احمد بن ايت بن عارف البرشتنوى ...

Në të vërtetë, myderriz Ahmet ef. Ajeti, në këtë dokument, sipas rregullit, i jep edhe disa të dhëna për veten e tij, e që janë me rëndësi për ne. Ai tregon se nga kush ka mësuar dhe te kush e ka marrë ixhâzetnâmenë.

Sipas kësaj, kuptojmë se Ahmet ef. Ajeti, për njëfarë kohe *("nahve mines-sinîn")* ka qenë student në Prishtinë i myderrizit *Sabit ef. Prishtina*[20], nga i cili ka mësuar gramatikën, sintaksën dhe një pjesë nga logjika[21], kurse më pastaj ka ndjekur studimet te myderrizi me plotë epitete *Haxhi Hamdiu i biri i Ibrahimit i biri i Hysenit nga Prishtina*, tek i cili ka mësuar logjikën, jurisprudencën islame, retorikën, poetikën, stilistikën, etimologjinë, letërsinë, disiplinat kryesore dhe ato ndihmëse të shkencave tradicionale dhe ka përfunduar me apologjetikën, dhe më pastaj ka marrë ixhâzetnâmenë e përgjithshme në mënyrë gojore dhe me shkrim për disiplinat bazike dhe ato ndihmëse për të gjitha lëndët *tradicionale* dhe *racionale*[22].

Për Ahmet ef. Mardoçin dimë edhe se ka lindur në vitin 1873 dhe se me vendimin nr. 1843/32, datë 20 tetor 1932, të Ulema Mexhlisit të Shkupit është emëruar myderriz i dytë në Medresenë "Pirinaz", kurse nga viti 1941 e deri më 1948 kur u mbyll kjo medrese, ka qenë myderriz i parë dhe drejtor i saj. Ka nxjerrë disa ixhâzetlinj.[23]

---

[20] Mendojmë se fjala është për Sabit "Nu'man" efendiun, i cili, sipas sâllnâmeve të Vilajetit të Kosovës, për vitet 1879-1882, 1896, 1901, kishte qenë mësues i parë dhe drejtor në shkollën e mesme të ulët (rushdije) të Prishtinës, dhe njëkohësisht edhe myderriz në Medresenë "Pirinaz". Shih: *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova,* Def'a, 1, 1879, dhe *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosva,* 1882/3, f. 45; *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova,* , 1314 (1896), Üsküp, f. 183; *Sâlnâme-i Vilayet-i Kosova*, 1318 (1900/01).

[21] ...فحصلت فى بلدنا نحو من السنين و حضرت المجلس العلم الفاضل الكامل ثابت افندى الپرشتنه وى وقرات منه الصرف والنحو ونبذا من المنطق...

Shih: *Ixhâzetnâmeja e Haxhi Sherif ef. Ahmeti*, f. 8. Origjinali i kësaj ixhâzetnâme ruhet tek pasardhësit e myderrizit, një kopje të së cilës në vitin 2010 na kanë dhënë në shfrytëzim, për se i falënderojmë botërisht, si dhe *Ixhâzetnâmeja e Ali Riza efendiut i biri i Mustafasë të birit të Ademit nga Keqekolla e Prishtinës*, lëshuar në vitin 1938 nga myderrizi Haxhi Hamdi ef. Ibrahimi, f. 3-6. Origjinali i kësaj ixhâzetnâmeje ruhet te nipi i Ali Riza efendiut, Izet Hoxha nga Prishtina, i cili një kopje të saj ma ka vënë në dispozicion, përse i jam mirënjohës përjetësisht.

[22] ثم حضرت المجلس العالم... الحاج حمدى ابن ابراهيم بن حسين الپرشتنه وى... و حصلت منه المنطق الى اخره والفقه والمعانى والبيان والبديع وقرات منه الوضع والاداب ونبذا من المنقول ونبذا من الفروع والاصول حتى انتهيت بالاستعاذة الى العقائد العضدية فاستجزت من ذالك الفاضل الكامل فاجازنى اجازة ملفوظة ومكتوبة فى جميع اجازته اصولا وفروعا عقلية ونقلية...

[23] Shih: Arkivi i Kosovës, *Fondi Bashkësia e Fesë Islame,* Zyra e Vakfit Prishtinë, 1952.

Kurse për Haxhi Hamdi ef. Ibrahimin (Gërçina) (vd. më 1941) dimë se ka marrë mësime në lëndën e gramatikës dhe një pjesë të sintaksës në Prishtinë te *Abdullah efendiu i biri i Sylejmanit nga Prishtina*[24], më pastaj ka mësuar sintaksën, jurisprudencën islame, logjikën, retorikën dhe metaforën te *Mevlana Ali efendiu i biri i Ali el-Haskojviut*[25], pastaj ka vazhduar po në Prishtinë te dijetari *Sabit efendiu* ku ka mësuar letërsinë dhe etimologjinë e fjalës në gjuhën arabe *('ilmi adâb ve 'ilmi ved'i)*, dhe më pastaj ka vajtur në Stamboll për t'i plotësuar studimet dhe ka marrë mësim nga *Adem "Nuri" i biri i Mustafasë të birit të Nezirit nga Gjakova*[26], dhe i ka përfunduar me ixhâzet te *Mustafa efendiu* i njohur si *Avdo Misli Hoxha*.[27]

Po meqë rëndësia e ixhâzetnâmeve qëndron në faktin se ato japin shënime për myderrizët brez pas brezi, atëherë nga ixhâzetnâmeja e Haxhi Sherif ef., mësojmë se Avdo Misli Hoxha i përmendur ka marrë ixhâzetin te *Haxhi Iljasi i biri i Muratit të birit të Sylejmanit po nga Prishtina*[28], e ky nga nga *Hafîz Aliu i biri i Muhametit të birit të Abdullah el-Birgeviut*, e ky nga *Mustafâ ibn Muhammed ibn 'Abdullâh Bâbâ Kal'avî*, i njohur si *Xhezâirlî Hoxha*, e ky nga '*Abdurrahîm ef. Ternova i njohur si Myfti zâde*, dhe kështu me radhë deri te hasreti '*Ali ibn Ebû Tâlibi r.a*., e ky nga *Pejgamberi a.s.,* e ky nga *Xhibrili a.s.*.

---

[24] Biografia e këtij myderrizi nuk na është e njohur.

[25] Biografia e këtij myderrizi nuk na është e njohur. Fakti se këtu quhet me epitetin "Mevlana" tregon se ka qenë shumë i respektuar dhe i shquar në kohën e tij. Në origjinal: المولانا على افندى ابن على الحصكوى Shih: Ixhâzetnâmenë e *Ali Riza efendiut*, f. 6.

[26] *Adem "Nuri" Gjakova* (1846-1914), mësimet e para i mori tek i ati Haxhi Shej Musai në Gjakovë, ku kreu edhe medresenë. Studimet e larta i vazhdoi në "Fatih" të Stambollit, ku mori edhe ixhâzetnâmenë te profesori i këtij universiteti Haxhi Iljaz ef. Prishtina. Ka punuar si pedagog në shumë shkolla të Stambollit dhe rrethinës së tij dhe ka fituar thirrjet akademike të kohës. Përveç veprimtarisë arsimore, është marrë edhe me krijimtari letrare dhe ka shkruar poezi dhe traktate nga doktrina e sufizmit. Nënshkruhej me pseudonimin "Nûrî". I përkiste rendit Rifai. Vdiq në vitin 1914. Më gjerësisht shih: Sadik Albayrak, *Son Devir Osmanlı Uleması*, cilt 1, Stamboll 1996, f. 156-157.

[27] Biografia e këtij myderrizi nuk na është e njohur. Në origjinal: مصطفى افندى المشتهر بآوده مثلى خواجه

[28] Për këtë profesor të Universitetit "Fatih" të Stambollit me prejardhje nga Prishtina nuk kemi të dhëna.

Është me rëndësi të theksojmë këtu edhe faktin se në Ixhâzetnâmenë e Haxhi Sherif efendiut për shkencën e hadithit përmenden posaçërisht edhe veprat/tekstet të cilat i ka mësuar ai, dhe ato janë:

1. *Gjashtë përmbledhjet kryesore të fushës së traditës (el-kutubs-sitte)*: Buhariu, Muslimi, Ibn Maxhe, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu;
2. Vepra *"Mesâbihu es-sunneh",* e autorit Hysein b. Mes'ûd el-Ferrâ el-Begevî esh-Shâfi'î (vd. 516/1112 ose 510/1117)[29];
3. Vepra *"esh-Shifâ bi ta'rîfi hukûk el-Mustafâ"*, e autorit kadiut Ebû 'l-Fadl 'Ijâd b. Mûsâ el-Jahsubî (vd. 544/1149)[30], e cila ka të bëjë me përmbledhje hadithesh për jetën e të Dërguarit të Zotit, Muhamedit a.s., dhe për obligimet e myslimanëve për ta respektuar atë;
4. Vepra "*Meshârik el-envâr 'alâ sihâh (sahâjih) el-âthâr"*, e autorit Ebû 'l-Fadl 'Ijâd b. Mûsâ el-Jahsubî (vd. 544/1149)[31], dhe e cila është fjalor i haditheve të Muhamedit a.s. në veprën *"El-Muvetta'ë"* të Imam Malikut, në veprat (sahihajni) *"El-Xhâmi' es-Sahîh"* të Buhârîut dhe *"El-Xhâmi' es-Sahîh"* të Muslimit.

Silsilnâmeja e myderrizëve se kush kujt i ka dhënë ixhâzet deri te Haxhi Sherif efendiu, brez pas brezi (pra duke e lexuar nga poshtë lartë), duket kështu:

[29] Kasim Dobraća, *Katalog arapskih, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 2000, f. 281.

[30] Po aty, f. 295-296.

[31] Po aty, f. 295.



Fundi i ixhâzetnâmesë së Haxhi Sherif efendiut, përveç lutjeve ka edhe verifikimin pa shenja diakritike, si dhe myhyrin/vulën e myderrizit, që tregon se Haxhi Sherif ef. ixhâzetnâmenë e ka marrë më datën 10 shaban të vitit 1363, që korrespondon me datën 31 korrik 1944:

الحمد لله اولا واخرا والصلاة والسلام على رسولنا محمد و على اله واصحبه اجمعين و بعد فيقول العبد الفقير المحتاج الى شفاعة رسوله احمد بن آيت بن عارف البرشتنوى قد وقع الاجازة و حرر ذالك فى اليوم العاشر من شهر شعبان المعظم لسنة ثلاث و ستين و ثلثماه و الف بعدالهجرة من ارسل رحمة للعالمين حمدا لله تعالى

(مهر: أحمد آيت سنه ١٣٣٠)

"Falënderimi i takon Allahut fillim e mbarim, salatet dhe selamet qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin a.s., për familjen e tij dhe për shokët e tij në përgjithësi. Më tutje, robi i ngratë dhe i nevojshëm për shefatin e të Dërguarit të Zotit, Ahmeti i biri i Ajetit të birit të Arifît nga Prishtina, thotë se dhënia dhe lëshimi i kësaj ixhâzetnâmeje ka ndodhur në ditën e 10 të muajit shaban të vitit 1363 pas hixhretit të atij (Muhamedit a.s.-SM) që është dërguar mëshirë për botët.
Faleminderit Allahut të Madhëruar!
(Vula: Ahmet Ajeti, viti 1330/1912)



Faksimile e faqes së parë dhe të dytë
të Ixhâzetnâmesë së parë të H. Sherif efendiut



Faksimile e faqes së fundit të Ixhâzetnâmesë së parë të H. Sherif efendiut

Ixhâzetnâmeja e dytë

Ixhâzetnâmeja e dytë, Haxhi Sherif efendiut i është dhënë vetëm në saje të suksesit dhe përvetësimit që kishte treguar për një vepër të veçantë, pra për veprën *"Delâilu 'l-Hajrât"* që përmban lutje dhe salavate për Pejgamberin a.s., e autorit Ebû 'Abdullâh Muhammed b. Sulejmân el-Xhezûlî (vdiq më 870/1465).[32]

Edhe kjo ixhâzetnâme është në gjuhën arabe dhe është shkruar nga e njëjta dorë. Vjen në vazhdim të së parë dhe ka gjithsej 7 faqe.

Para "besmeles", "hamdeles" dhe "salveles", në krye të saj shkruan:

اجازت نامه من دلائل الخيرات

الحمد لله الذى هدانا لهذا اى الى دلائل الخيرات و الصلاة و السلام على من بالصلاة عليه تتم الصالحات ...

Edhe kjo diplomë, Haxhi Sherif efendiut, i është lëshuar po nga i njëjti profesor i medresesë "Pirinaz" të Prishtinës, pra *Ahmet ef. Ajeti*, e këtij ia kishte lëshuar *Haxhi Hamdi ef. Ibrahimi*, e ky nga *Adem "Nuri" Gjakova*, e ky nga *Haxhi Ymer ef. Janjevi nga Janina* asokohe *myderriz në medresenë "Mahmudije" në Medinën e Ndritshme*[33], e ky nga *Mevlana Ali "Fikri" i biri i Bajramit nga Gjakova*[34]... e kështu me radhe deri tek autori i veprës *Abû 'Abdullâh Muhammad b. Sulejmân el-Xhezûlî el-Magribî* (vdiq më 870/1465).

---

[32] Emri i plotë i veprës është *"Delâ'il el-hajrât ve shevâriku el-envâr"*. E ka shkruar Ebû 'Abdullâh Muhammed b. Sulejmân el-Xhezûlî (vdiq më 870/1465). Shih: Fehim Nametak, *Katalog arapskih, turski, perzijskih i bosanskih rukopisa, svezak četverti*, London - Sarajevo, 1999, f. 42.

[33] Biografia e këtij myderrizi nuk na është e njohur.

[34] Për *Ali "Fikri" Gjakovën*, enciklopedisti ynë Sami Frashëri, në *"Kâmûs Al-'alâm"*-in e tij (f. 143), në zërin *"Shqiptarët",* shprehet me konsideratë të thellë dhe e rendit në mesin e shqiptarëve të mëdhenj, ku thotë: *"Kombi shqiptarë ka dhënë njerëz të mëdhenj, si p.sh. Ali efendi Gjakovën dhe Hoxha Tahsinin, të cilët vdiqën tash vonë, pastaj edhe shumë shqiptarë që u dalluan me zgjuarsinë dhe dituritë e tyre të cilët ishin të barabartë me ata të universitetit të Athinës dhe Romës..."*. Ali ef. Gjakova, sipas kësaj që thotë S. Frashëri se *"...Ali efendi Gjakova dhe Hoxha Tahsinin, të cilët vdiqën tash vonë...",* duhet të ketë jetuar në shekullin e XIX dhe të ketë vdekur diku afërsisht në dekadën e tetë të këtij shekulli. Hoxha Hasan Tahsini dihet se ka vdekur në vitin 1881.



اجازت نامه دلائل من الخيرات

بسم الله الرحمن الرحيم

الحمد لله الذي هدانا لهذا اي
الى دلائل الخيرات والصلوة
والسلام على من بالصلوة
عليه تتم الصالحات
وعلى آله وصحبه وازواجه
الطاهرات صلاة دائمة
ما دامت السموات فان
اولى الثناء في جميع الآلاء
بعد حمد الله تعالى الصلوة
على النبي صلى الله تعالى
عليه وسلم ولها كيفيات
شتى فيما ورد من الآثار



عن والده السيد محمد
عن مؤلفه ابي عبد الله
محمد ابن سليمان
المغربي لا زالت
عليه اثار سحائب
الصلوات والتسليمات
ما دامت السموات
سبحان ربك
رب العزة
عما يصفون
وسلام
على المرسلين
والحمد
لله رب
العالمين

الحمد لله اولا واخرا والصلاة والسلام
على رسولنا محمد وعلى اله واصحابه اجمعين
وبعد فيقول العبد الفقير المحتاج الى شفاعة
رسوله احمد بن ... بن عارف الرستوي
قد وقع الاجازة وحرر ذلك في اليوم العاشر
من شهر شعبان المعظم لسنة ست وستين
وثلثماه والف بعد الهجرة من ارسل رحمة
للعالمين
حامدا
لله
تعالى

Faksimile e faqes së parë dhe dy të fundit të Ixhâzetnâmesë së dytë të H. Sherif efendiut

Fundi i ixhâzetnâmesë, përveç lutjeve, ka edhe verifikimin dhe vulën e myderrizit njëjtë si në ixhâzetnâmenë e parë:

الحمد لله اولا واخرا والصلاة والسلام على رسولنا محمد و على اله واصحبه اجمعين و بعد فيقول العبد الفقير المحتاج الى شفاعة رسوله احمد بن آيت بن عارف البرشتنوى قد وقع الاجازة و حرر ذالك فى اليوم العاشر من شهر شعبان المعظم لسنة ثلث و ستين و ثلثماه و الف بعدالهجرة من ارسل رحمة للعالمين

حمدا لله تعالى

(مهر: أحمد آيت سنه ١٣٣٠)

"Falënderimi i takon Allahut fillim e mbarim, salatet dhe selamet qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin a.s., për familjen e tij dhe për shokët e tij në përgjithësi. Më tutje, robi i ngratë dhe i nevojshëm për shefatin e të Dërguarit të Zotit, Ahmeti i biri i Ajetit të birit të Arifit nga Prishtina, thotë se dhënia dhe lëshimi i kësaj ixhâzetnâmeje ka ndodhur në ditën e 10 të muajit shaban të vitit 1363 pas hixhretit të atij (Muhamedit a.s.-SM) që është dërguar mëshirë për botët.
Faleminderit Allahut të Madhëruar!
(Vula)

Sipas kësaj diplome, për sa i përket transmetimit të veprës "*"Delâilu 'l-hajrât",* vargu i myderrizëve brez pas brezi, është kështu: *Sherif ef. Ahmeti - Ahmet ef. Ajeti - Haxhi Hamdi ef. Ibrahimi - Adem "Nuri" Gjakova - Haxhi Ymer Janina - Ali ef. Bajrami-Gjakova - (...) e deri tek autori i veprës Ebû 'Abdullâh Muhammed b. Sulejmân el-Xhezûlî.*

Përfundim

Meqenëse në vendin tonë, sikurse u tha, numri i medreseve ishte i madh, atëherë, pa dyshim se edhe numri i ixhâzetlinjve dhe i dokumenteve të tilla duhet të ketë qenë i madh. Ndonëse një numër i madh i ixhâzetnâmeve është humbur, prapë se prapë dokumente të tilla gjenden nëpër arkiva të institucioneve dhe të personave privat, pasardhës të ulemave të hershëm.

Këto dokumente kanë vlerë të madhe për studimin e medreseve dhe përcaktimin e vendit se ku ato kanë ekzistuar dhe po ashtu ato ofrojnë të dhëna edhe për lëndët që janë ligjëruar dhe myderrizët që kanë dhënë mësime në to.

Ixhâzetnâmetë meritojnë një studim të veçantë dhe janë shumë me rëndësi për historinë, zhvillimin dhe rritën e arsimit në vendin tonë.

Ixhâzetnâmetë e Haxhi Sherif ef. Ahmetit ndërkaq, janë me interes edhe për arsye të tjera, sepse ato i janë lëshuar njërit prej studentëve më të mirë të medresesë "Pirinaz" të Prishtinës.

Haxhi Sherif ef. Ahmeti përmes myderrizit të tij, Ahmet ef. Ajetit, lidhet me shumë dijetarë të tjerë shqiptarë dhe të botës islame, e përmes tyre lidhet edhe me kolosët e shkencave islame.

Haxhi Sherifi është hallka që i lidh brezat pasixhâzetlinj me ata ixhâzetlinj, përfshirë edhe brezat tonë që kemi qenë nxënës dhe studentë të tij.

Këto ixhâzetnâme ndihmojnë në plotësimin dhe saktësimin sa më të mirë të jetëshkrimit të myderrizit Haxhi Sherif efendiut.

Si të tilla, ixhâzetnâmetë, përfshirë edhe këto të alimit, hoxhës, myderrizit, përkthyesit të Kuranit, botuesit, pedagogut, veteranit të arsimit - H. Sherif ef. Ahmetit, pasi të jenë hulumtuar, tubuar dhe mbledhur, duhet të arkivohen, të digjitalizohen, të ruhen, të studiohen, të botohen dhe të trajtohen si dokumente me rëndësi historike dhe me vlerë të ruajtjes së përhershme.

Burimet dhe literatura:

A. Burimet:

1. Arkivi i Kosovës, *Bashkësia e Fesë Islame-Zyra e Vakëfit Prishtinë 1943*, k. 37.
2. Dizdari, Tahir N.. *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, AIITC, Tiranë, 2008.
3. Dobraća, Kasim. *Katalog arapskih, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 2000.
4. Frashëri, Sami. *"Kâmûs al-A'lâm"*, vëll. IV, f. 3149, dhe vëllimi VI, f. 4010.
5. *Ixhâzetnâmeja e Ali Riza efendiut i biri i Mustafasë të birit të Ademit nga Keqekolla e Prishtinës*, 1358H/1938 (dorëshkrim).
6. *Ixhâzetnâmeja e Haxhi Sherif ef. Ahmetit*, 1363H/1944, (dorëshkrim).
7. Kaleši, Hasan. *Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji*, Prishtinë, 1972, f. 43.
8. Mehmeti, Sadik. *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008.
9. Nametak, Fehim. *Katalog arapskih, turski, perzijskih i bosanskih rukopisa, svezak četvrti*, London - Sarajevo, 1999.
10. *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova,*1314H (1896 M) - 1318H (1900/01 M).

B. Literatura:

1. Albayrak, Sadik. *Son Devir Osmanlı Uleması*, cilt 1, Stamboll 1996.
2. Baltaci, Cahid. *Osmanli Medreseleri (XV-XVI Yüzyillarda)*, vëll. 1, M.Ü. Ilâhiyat Fakültesi Vakfi Yayinlari, nu. 198, Stamboll, 2005 kapitulli i pestë, f. 159-492.
3. Bećirbegović, Madžida. *Prosvjetni objekti islamske arkitekture na Kosovu,* në: "Starine Kosova", nr. VI-VII, Prishtinë, 1972-1973.
4. *"Haxhi Sherif ef. Ahmeti -jeta dhe vepra (1920-1998)",* përmbledhje kumtesash të sesionit shkencor mbajtur në Prishtinë më 17 prill 2010, botuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010
5. Kaleshi, Hasan. *Dokumentetet më të vjetra vakëfnore në gjuhën arabe në Jugosllavi*, Prishtinë, 2010.
6. Kazıcı, Ziya. *Islâm medeniyeti ve müesseseleri tarihi,* M. Ü. Ilâhiyât Fakültesi Vakfı Yayınları, Nu: 191, Istanbul, 2011.

7. Krasniqi, Nehat. *Zhvillimi i kulturës shqiptare me bdikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare,* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017*,* f. 232.
8. Mehmeti, Sadik. *"Medreseja Pirinaz e Prishtinës",* zëri i botuar në: Fjalori Enciklopedik i Kosovës - Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, vëll. II, Prishtinë, 2018, f. 1078.
9. Mehmeti, Sadik. *Medreseja "Pirinaz" në Prishtinë dhe aktiviteti i saj 1935-1945,*"Buletin i Fakultetit të Studimeve Islame", nr. 2, Prishtinë, 2012.
10. Popara, Haso. *Idžazetname u rukopisima Gazi Husrev-begove biblioteke*, në: "Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, knjg. XXV-XXVI, Sarajevë, 2007.
11. Redžepagić, Jašar. *Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918 godine*, Priština, ZNUKM, 1968.
12. Shkodra, Ramadan. *"Ahmeti, Myderriz Sherif (1920-1998)",* zëri i botuar në: Fjalori Enciklopedik i Kosovës - Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, vëll. II, Prishtinë, 2018, f. 1078;
13. Vokrri, Abdulla R.. *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941),* Prishtinë, 1990.

Sadik MEHMETI

HAXHI SHERIF EF. AHMETI´S IJAZAHS

(Summary)

In this paper we will analyze two ijazahs (certificates) in the Arab language, which were issued in 1944 by Ahmet ef. Ajeti (Mardoçi), the muderris of the "Pirinaz" Madrassa in Prishtina, to Haxhi Sherif ef. Ahmeti (1920-1998), a student of his, who was to become one of the most distinguished Islamic scholars in Kosova and further in the second half of the XX century.

An ijazah is a certificate issued to students upon the successful completion of their education, authorizing them to teach others.

The first certificate issued to Haxhi Sherif ef. Ahmeti was a general one authorizing him to transmit all the subjects of knowledge acquired during his education (‘amme), whereas the second to interpret a specific work (hâssa).

Apart from having a historical, diplomatic and philological importance, these certificates are also important to better know the activity of the "Pirinaz" Madrassa in Prishtina during the last decades of its work as well as to complete the biographical data on Haxhi Sherif ef. Ahmeti.

صادق مهميتي

إجازات الشيخ شريف أحمدي

(خلاصة البحث)

تتناول هذه الدراسة بالتحليل إجازتين (شهادة) باللغة العربية واللتان منحهما الشيخ العلامة أحمد آيتي (ماردوتشي) أستاذ ومدرس في المدرسة الشرعية "بيريناز" عام ١٩٤٤، لتلميذه حينها. والذي أصبح فيما بعد عالما جليلا من أبرز العلماء الشيخ أحمد شريفي(١٨٢٠-١٩٩٨) في النصف الثاني للقرن العشرين.

"الإجازة" هي الشهادات التي تم منحها للطلاب بعد أن أكملوا بنجاح التعليم الشرعي في المدرسة الدينية، والتي من خلالها حصلوا على الحق في تعليم الآخرين.

وتنتمي إجازات الشيخ شريف أحمدي إلى النوعين، الأولى إجازة عامة لجميع المواد والتخصصات التي يتم تدريسها ("عامة")، والثانية خاصة فقط لتخصص معين (خاصة).

هذه الإجازات، بالإضافة إلى جانب من الجوانب التاريخية والدبلوماسية واللفظية ، هي مهمة في فهم نشاط المدرسة الشرعية "بيريناز" في بريشتينا في عقودها الأخيرة ، وكذلك لملء وتصحيح المعلومات حول السيرة الحياتية للشيخ العلامة الشريف أحمدي.

Driton ARIFI

FRAKSIONI I KURANISTËVE
(Hulumtim analitik rreth fraksionit që konteston argumentimin me Sunetin e Muhamedit a.s.)

Abstrakt

Roli i Sunetit në Islam, si burim i dytë i Sheriatit është i pakontestueshëm, por kohëve të fundit, një numër i të ashtuquajturve "studiues", kanë bërë përpjekje të pareshtura që ta relativizojnë, e madje shpeshherë edhe ta kontestojnë atë. Të tillët, për të krijuar një ambalazh dekorativ për ideologjinë e tyre, e quajtën vetveten *kuranistë* ose ithtarë vetëm të Kuranit (أَهْلُ الْقُرْآنِ أَوْ الْقُرْآنِيُّونَ). *Kuranistët* dhe idetë e tyre, pra janë subjekt i shtjellimit të këtij punimi analitik. Këtu, pos tjerash, do të bëhet përpjekje që ato ide e pikëpamje të fraksionit *kuranist* t'i artikulojmë saktësisht, ashtu siç i kanë dëshiruar protagonistët e tyre, duke iu referuar librave të vetë autorëve të këtij fraksioni. Pastaj, të tillat domosdoshmërish duhet t'i vendosim edhe në sintezën e perceptimeve të kulluara islame, për të parë pikë prerjet dhe antagonizmat e qarta që këto ide i kanë në raport me argumentet kredibile islame.

Fjalët kyçe: *Kuran, Sunet, kuranistë, fraksion, argument*

Nocioni *kuranistë* dhe arsyeja e emërtimit të këtij fraksioni me këtë emër

Nëse do të bënim një tentim për të bërë një shtjellim të shkurtër etimologjik të shprehjes "القُرْآنِيُّونَ" - *"El Kuranijjune",* në gjuhën arabe, atëherë duhet të theksojmë se ajo në aspektin gjuhësor është atribues në shumës, që shpreh përkatësinë, ngase emrit "القُرْآنُ"- "Kuran", i është bashkangjitur në fund bashkëtingëllorja "يّ" - *"Ja*-un" me *teshdid*-përforcues, e cila quhet ndryshe "*Ja*-un e përkatësisë", që i bie se me këtë nocion po emërtohet diçka që i përket ose i takon Kuranit. E meqë është fjala për grupacion ose fraksion, atëherë, atyre mund edhe t'u themi *kuranistë,* respektivisht ithtarë vetëm të Kuranit. Duhet theksuar që në fillim se, kriter i konsekuencës së një grupi ndaj parimeve islame, ose specifikisht ndaj Kuranit, nuk është emërtimi me të cilin ata e kanë emërtuar vetveten, apo që kanë dëshirë t'i atribuohen atij, por esenciale dhe mbi të gjitha, janë idetë, pikëpamjet dhe bindjet që ata i kanë shpalosur vazhdimisht në ligjërimet, debatet apo edhe në shkrimet e tyre.

Në përpjekje për t'i definuar kuranistët si fraksion, dijetari i njohur *Muhamed el Eshkar* thotë:" *Në mesin e myslimanëve lindi një grupacion që veten e emërtuan (القُرْآنِيُّون- kuranistët), e të cilët pretendojnë se Sheriati islam nuk merret nga asnjë tjetër burim, përveçse nga Kurani fisnik, dhe ata nuk e shohin të nevojshme fare që të mbështeten në Sunetin e Muhamedit a.s.."*[1]

Po ashtu, hulumtuesi i njohur islam, *Ahmed Hashim,* përderisa bën përshkrimin dhe kontekstualizimin e emërtimit të tyre (القُرْآنِيُّون - *kuranistët),* thotë: *"Ata e quajtën vetveten kuranistë, ngase pretenduan se duhet të mjaftohemi vetëm me atë që ka ardhur në Kuran, e në fakt, këta janë vetëm vazhdimësi e paraardhësve të atyre injorantëve që u përpoqën ta minimizonin rolin e sunetit profetik të Muhamedit s.a.v.s.. Përgënjeshtrimi që ata i bëjnë sunetit* (në tërësi) *është përgënjeshtrim edhe për vet Kuranin fisnik.*"[2]

---

[1] Muhamed el Eshkar, *Ef'alu er Rresul ve delaletuha alel ahkami esh sher'ijjeti* (1/21). Bot. i gjashtë, Err-Rrisaletu. Viti 2003. Bejrut.

[2] Ahmed Umer Hashim, *Menhexhu ed-difa'i ani-l Hadithi-n-Nebevijj,* Bot. Ministria e Vakëfeve të Egjiptit. 1987, Kajro, f. 144.

Siç vërehet nga këto përshkrime, del në pah fakti se ata emërtohen si kuranistë ose nganjëherë edhe si *pasues të Kuranit*, sepse i tërë pretendimi dhe strumbullari ideologjik i tyre, ka si pikënisje, kinse mbështetjen vetëm në Kuran, duke bërë tentativë të hapur për mohimin e argumentimit me Sunetin e Muhamedit a.s. në jurisprudencën islame.

Kuranistët sot njihen si fraksion që mohojnë Sunetin e Muhamedit s.a.v.s. si burim i normave dhe i dispozitave sheriatike islame.

Ajo që duhet patjetër të theksohet, është fakti se ky fraksion nuk shpreh ndonjë lojalitet ndaj ndonjërit prej fraksioneve të mëhershme të devijuara islame, qofshin ata shiitët, havarixhët apo ndonjërit prej tarikateve sufiste. Rëndom, të tillët pretendojnë se kanë dalë nga gjiri sunit i Ymetit islam. Ata shpërfaqin diskursin e tyre me petkun e konsekuencës ndaj mësimeve kuranore dhe nuk pranojnë për vetveten se kanë ndonjë kundërthënie me të.

Gjeneza dhe historiku i themelimit të këtij fraksioni

Si raste individuale e të izoluara, gjatë gjithë historisë islame, pothuajse që nga koha e shpalljes së Kuranit, kishte persona që bënin kontestimin e argumentueshmërisë së Muhamedit s.a.v.s., mirëpo ata asnjëherë nuk u llogaritën si grupacion apo fraksion me peshë, e as që u emërtuan më ndonjë emërtim të veçantë. Me ta u morën dijetarët e kohës, duke qartësuar qëndrimin islam karshi tyre, por ndikimi i tyre ishte i zbehtë dhe nuk u shfaq ndonjë zhurmë e madhe nga pretendimet e tilla.

Ndërsa, hulumtimi ynë ka të bëjë më *kuranistët* si fraksion-shkollë ideologjike, të cilëve u njihen idetë, por edhe themeltarët e saj të vërtetë.

E në këtë rrafsh, duhet theksuar se *kuranistët* si fraksion në vete, shfaqen në skenën e botës islame, diku kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. Ideologët e parë të kësaj fryme vinin nga disa rajone të Indisë. Të gjithë hulumtuesit islamë që iu qasën historikut dhe gjenezës së themelimit të fraksionit *kuranist*, pajtohen se rolin kyç dhe themeltar në formimin ideologjik të këtij fraksioni e kishte Sejjid Ahmed Khan. Ai kishte lindur në Nju Delhi të Indisë, në vitin 1817 dhe kishte vdekur në

vitin 1897[3]. Ahmed Khan kishte bërë disa studime e hulumtime rreth Kuranit dhe Sunetit, që ishin sipërfaqësore dhe tendencioze dhe kishte sjellë disa mendime e konkluza të cilat binin në kundërshtim të hapur me një mori normash e dispozitash, të konstatuara thuajse unanimisht nga dijetarët sunitë, disa prej të cilave do t'i marrim në shqyrtim në pikat vijuese të këtij punimi.

I ndikuar thellësisht nga Ahmed Khan, ishte edhe Abdullah el Xhekralevij**,** i cili për dallim nga inspiruesi i tij, kishte njohuri dhe studime hulumtuese pak më të thella rreth Islamit, por që në vijim të karrierës, për shkak të paaftësisë gjuhësore dhe asaj shkencore, hasi në vështirësi në gjetjen e përputhshmërisë në mes të kuptimit të disa haditheve, që sipas tij dukeshin kontradiktore. Më pas, ai doli me qëndrimin e tij të habitshëm duke hedhur poshtë tërë argumentueshmërinë e Sunetit profetik duke thënë: "Kurani është i vetmi burim që është i shpallur nga Allahu te Muhamedi s.a.v.s., ndërsa burimet tjera pos tij, siç është Suneti, nuk llogariten si inspirim prej Zotit."[4] Ky i fundit, madje njihet si themelues zyrtar i këtij fraksioni duke i quajtur ithtarët e tij "**أَهْلُ الذِّكْرِ و القُرْآنِ - *Ithtarët (praktikuesit) e dhikrit dhe të Kuranit".*** Këta dy bashkëideologë, gjetën përkrahës në vendet e tyre (Indi e Pakistan), por fatkeqësisht edhe në botën arabe.

Shkaqet e themelimit të këtij fraksioni

Shfaqjes së këtij fraksioni i kanë paraprirë disa shkaqe:

1. Injoranca dhe mosgatishmëria për t'iu qasur mirëfilli e thellësisht burimeve islame. Përveç kësaj, neglizhimi i rolit të gjuhës arabe dhe leksikologjisë së bujshme të saj, ishte indikacion i qartë se ata nuk kishin kurrfarë përgatitjeje profesionale. Kjo vërehet te disa prej figurave të kësaj ideologjie dhe del në pah se një pjesë e tyre nuk ishin fare studiues të fushave islame, por më shumë u qaseshin

[3] Dr. Xhemal Ahmed Haxhir, *El Kuranijjun el arab ve mevkifuhum mine-t-tefsir.* Bot. Daru-t-Tefsir. Bot i parë, Xhedë, 2015, ff. 81-85; Shih: H. A. R. Gibb dhe Louis Massignon, *Vixhetu-l Islam,* ff. 119-125. Pa vend dhe vit botimi.

[4] *Mahmud Mezruah, Shubuhatu-l kuranijjin havle-s-Sunneti-n-Nebevijjeti,* f. 440. Pa vend dhe vit të botimit

atyre në formë margjinale, andaj edhe informacionet rreth tij i kishin të varfra.

2. Rënia nën ndikim të orientalistëve dhe ideve të tyre. Kjo gjë që i ka bërë ata t'i përqafojnë shumë prej ideve orientaliste, me ose pa vetëdije, e ndonjëherë të sjellin ide edhe më kontradiktore sesa vetë idetë dhe mendimet e orientalistëve rreth disa çështjeve islame.
3. Dëshira për shpërfaqje dhe dalje në skenë, sepse vetëm sjellja e ideve "reformiste dhe inovative", me të cilat do t'i "mahnitnin" masat e myslimanëv, do t'u mundësonte atyre të arrinin famë dhe autoritet.[5]
4. Bindja e disa prej tyre, se myslimanët janë të ndarë e të përçarë në grupacione e fraksione të shumta, pikërisht nga vetë hadithet e Muhamedit s.a.v.s., ose konceptimi dhe interpretimi i gabuar e i keq i tyre. Andaj, nisur nga ky koncept akuzues dhe fajësues për hadithin profetik, ata mendojnë se rruga e unifikimit të myslimanëve duhet të kalojë nëpërmes anulimit të tërësishëm të argumentueshmërisë së hadithit profetik.
5. Heqja e petkut hyjnor nga Suneti profetik dhe mveshja e atij petku shenjtërues ndaj logjikës së tyre njerëzore. Të tillët mohojnë argumentueshmërinë me Sunet, ndërsa çuditërisht pranojnë interpretimin e ajeteve, vetëm në bazë të logjikës e dhe racionalitetit të tyre. Absurde dhe gjithsesi kontradiktore duket ideja që njeriu të pretendojë për vetveten se ditka të interpretojë një ajet nga Kurani më mirë sesa që e bëri vetë ai të cilit iu shpall ky Libër - Muhamedi a.s.

[5] Xhemal Ahemd Haxhir, *El Kur'anijjun el arab ve vevkifuhum mine-t-Tefsir,* Bot. Daru-t-Tefsir, bot. i pare, Xhedë, 2015, ff. 167-195.

Figurat bashkëkohore më eminente të fraksionit kuranist

Ani pse kjo frymë zë fillin e saj në Indi, ajo vazhdoi zhvillimin e saj për të gjetur shtrirje edhe në botën arabo-islame dhe gjithandej nëpër vendet ku jetojnë e veprojnë myslimanët. E nga figurat bashkëkohore më eminente në botën arabe, që klasifikohen ideologjikisht si *kuranistë*, llogariten:

1. ***Ismail Ed'hem*** (një studiues me origjinë turke, por që ka lindur dhe ka jetuar në Aleksandri të Egjiptit), i cili në shkresën e tij të ashtuquajtur "*Min Mesadir et Tarih' el Islamijj* **- Prej burimeve të historisë islame",** ka shpalosur shumicën e ideve të tij "inovative e reformuese", ku ndër të tjera thotë: "Pas një hulumtimi që kam bërë, kam arritur në një rezultat se, hadithi që është transmetuar te ne, është i trilluar me shumicë. Po ashtu jeta dhe sireja e Muhamedit a.s. në të shumtën e rasteve përbëhet nga rrëfimet (e pakonfirmuara), kështu që burimi i vetëm që mund të mbështetemi në të dhe që mund të merret për argument për ngjarjet historike, është Kurani fisnik."[6]

   Ky libërth u ballafaqua me një kundërpërgjigje të ashpër dhe të fuqishme shkencore nga dijetarët e Az'harit asokohe, por megjithatë autori këmbëngulte në qëndrimet e tij, dhe asnjëherë nuk zmbrapsej përballë kritikave që i drejtoheshin atij.
2. ***Prof. Ahmed Emin*** (hulumtues egjiptian), është autor i librit: *"Fexhru-l Islam* - Agimi i Islamit", i cili ndër të tjera kishte në thelb të studimit hadithin profetik të Muhamedit a.s. dhe përafërsisht sjell të njëjtat konkluza sikur të dr. Ismail Ed'hem.[7]
3. ***Dr. Ahmed Subhi Mensur,*** (një hulumtues egjiptian) që llogaritet si lider dhe ideolog frymëzues për të gjithë *kuranistët* bashkëkohorë. Ai është autor i librit *"El Kur'anu ve kefa masdaren li-t-teshri'l Islamijj-* ***Kurani, mjafton që vetëm ai të jetë burim i normave sheriatike",*** dhe i disa librave të tjerë të këtij profili ideologjik. Ai këtë

[6] Dr. Ismail Ed'hem, *Min mesadir et tarih' el Islamijj,* Bot. Salahuddin el Kubra. Bot. i pare, 1936, Kajro, f. 4.

[7] Dr. Mustafa Es Sibaijj, *Es Sunnetu ve mekanetuha fi et teshri'l Islamijj,* Bot. Darul Verrak, Bot. i parë. Bejrut, 2000, f. 266.

libër e ndanë në disa kapituj, dhe secili prej këtyre kapitujve i rrëfen në vetvete pikëpamjet përjashtuese e mohuese që autori ka ndaj argumentueshmërisë së Sunetit të Muhamedit s.a.v.s.

Ai në kapitullin e parë që e ka emërtuar "Kurani fisnik është libri i vetëm për myslimanin", në kuadër të tij, i rendit edhe nënkapitujt vijues:

a) Nuk ka Zot tjetër pos Allahut, dhe s'ka libër për myslimanin pos Kuranit, librit të Allahut.

b) Besimtari mjaftohet me Allahun për Zot dhe me Kuranin për libër.

c) Kurani është e vërteta rreth së cilës nuk ka dyshime, ndërsa çdo gjë tjetër pos tij është e dyshimtë, e ne nuk duhet t'i pasojmë dyshimet.

ç) Shpallja e vetme e shkruar që i është shpallur Muahmedit s.a.v.s. janë ajetet dhe kaptinat kuranore dhe asgjë tjetër pos tyre.[8] Shihet qartë që nga emërtimi i kapitullit, pastaj edhe nënkapitujve, se autori, nuk beson fare në argumentueshmërinë e hadithit profetik. Këtë e bënë të qartë haptazi dhe pa kurrfarë hezitimi.

4. Dr. Muhamed Shahrur[9] (një studiues me origjinë siriane), e i cili për dallim nga protagonistët e tjerë të kësaj fryme, nuk kishte bërë ndonjë studim "akademik" rreth Islamit, ngase ai ishte i specializuar në inxhinieri mekanike. Ndonëse "studimet" e tij ndaj Islamit llogariten vetëm si margjinale, megjithatë për çudi, të tillat punime gjejnë përkrahje në mesin e bashkëideologëve të tij. Në anën tjetër, vërejmë se mendimet e tij, të publikuara në disa prej librave voluminoz të tij, janë shqyrtuar, analizuar e kritikuar nga një numër i madh i dijetarëve islamë bashkëkohorë. Dr. Shahrur pretendon se myslimanët që nga koha e sahabëve e deri më sot, ende nuk kanë arritur të kuptojnë thelbin e mesazhit hyjnor-Kuranit. Ai bënë për-

[8] Dr. Ahemd Subhi Mensur, *El Kur'anu ve Kefa...* Pa vit dhe vend të botimit. f. 5. (Marrë nga faqja zyrtare e "Ithtarëve të Kuranit": http:.ahl-alquran.com/arabic).

[9] Muhamed ed Diib Shahrur, ka lindur në Damask të Sirisë në vitin 1938, studioi në Moskë për inxhinieri, pastaj në Dublin të Irlandës i vazhdoi studimet e tij të masterit dhe doktoratës në Inxhinieri Mekanike.

> pjekje që fjalët, veprimet dhe aprovimet e Muhamedit a.s. t'i kontekstualizojë brenda hapësirës dhe kohës kur ai jetoi. Madje tentoi që në një mënyrë edhe t'i dehyjnizojë ato, duke thënë se Muhamedi a.s. megjithatë mbetet thjesht një njeri, sa herë që nuk fliste-lexonte ajete nga Kurani.[10]

Lista e këtyre ideologëve *kuranistë* nuk është edhe aq e shkurtër, por natyra e punimit nuk përballon dot listimin e të gjithëve, apo apostrofimin e të gjitha ideve "inovative e reformuese" të tyre.

Megjithatë, parimet dhe fryma ideologjike e të gjithëve është pothuajse një dhe unike. Ata thjesht dëshirojnë që interpretimet e tyre rreth Kuranit fisnik, t'i bëjnë pa kthyer kokën në fjalët dhe veprimet e Muhamedit a.s.. Kjo pikënisje dhe ky kriter që ata e vendosën, duke mos marrë fare për bazë Sunetin e Muhamedit a.s., si burim të dytë sheriatik dhe si interpretuesi më i denjë i Kuranit, u linte hapësirë që të sillnin interpretime e konkluza rreth ajeteve kuranore, të cilat jo rrallë herë, rastisnin të ishin dëgjuar për herë të parë tek myslimanët. E për habi, të tillat konkluza, nuk është se kanë të bëjnë me ndonjë tematikë dytësore ose krejtësisht të repor rëndom sillen rreth atyre dispozitave që përbëjnë kornizën fondamentale të praktikimit të Islamit, që nga koha e shpalljes e këtej.

Platforma ideologjike e fraksionit kuranist dhe idetë thelbësore të tyre

Cilido hulumtues që bënë një studim ndarazi dhe ekskluziv për ndonjërën prej figurave kyçe të kësaj fryme ideologjike, do të vërejë se ata, ani pse kanë dallime, madje shpeshherë edhe përmbajtjesore ideologjike, megjithatë kanë disa pika kyçe rreth të cilave pajtohen unanimisht. E meqë në një trajtesë të këtillë, është e pamundur të adresohen të gjitha pikëpamjet e tyre, ngase të tillat janë shumë, këtu do të ndriçohen vetëm ato që kanë të bëjnë me përkufizimin e tyre argumentues vetëm me Kuran. Adresimi dhe apostrofimi përgjithësues ndaj këtyre pikave unifikuese në

[10] Dr. Muhammed Shahrur, *Nahve usulin xhedideh li-l Fikhi-l-Islamijj*. Bot. El Ehali. Bot. i parë,. Damask, 2000, ff. 61-65.

mes tyre, na mundëson të shohim pamjen e pastër të perceptimeve të tyre rreth Islamit, dhe rrjedhimisht pas kësaj mund të përvijohet e kristalizohet edhe platforma e tyre ideologjike në tërësi. Kështu, ndër pikat themelore në të cilat pajtohen shumica e ithtarëve të frymës kuraniste, janë këto:

- "Na mjafton libri i Allahut" sepse ai është referencë e vetme kredibile e argumentuese në perceptimin e drejtë të Islamit.
- Mosbindja në atribuimin dhe adresimin e hadithit tek Muhamedi a.s. duke akuzuar kështu shumicën e sahabëve për shpifje dhe trillim të një numri të madh të haditheve dhe mveshjen e tyre, të Dërguarit a.s.
- Suneti i Muhamedit a.s. absolutisht nuk është shpallje e as inspirim nga Zoti (është thjesht fjalë njerëzore), (madje sipas tyre) nuk ka qenë burim ligjvënieje as në kohën e profetit.
- Suneti i Muhamedit a.s. ka prodhuar vetëm ndasi e përçarje në mesin e myslimanëve, andaj duhet anashkaluar në argumentim.
- Të gjykuarit në bazë të Sunetit, nënkupton edhe bërje shok Allahut në gjykim. Allahu është i vetmi Ligjvënës e Gjykatës, e jo i Dërguari i Tij.

Kur ne i shqyrtojmë këto qëndrime konceptuale të tyre, rreth çështjeve parimore e fondamentale në Islam, atëherë s'gjejmë arsye për t'u habitur nëse ndonjëri prej tyre, fjala vjen, e mohon obligueshmërinë e mbulesës së femrës myslimane, nuk beson në miraxhin-rrugëtimin qiellor të Muhamedit a.s., apo vjen me ndonjë mendim edhe më të çuditshëm se këto të kësaj natyre.

Këto qëndrime, në fakt, llogariten ajka e pikëpamjeve të shumicës së *kuranistëve* si fraksion, të proklamuara nëpër librat e tyre. Këto qëndrime, sigurisht që kanë nevojë të analizohen në optikën e argumenteve kredibile islame, për të parë konsekuencën dhe qëndrueshmërinë kundrejt atyre argumenteve.

Pikëpamjet e *kuranistëve* në dioptrinë e argumenteve hyjnore e logjike

Një mysliman sunit, pasues i Sunetit të Muahmedit a.s., kur i dëgjon për herë të parë këto pikëpamje, sigurisht që e ndien në vetvete se gjendet përballë një "fryme të re" të perceptimit të Islamit. Këtë frymë ai më herët nuk e ka njohur e as nuk e ka përjetuar. Ai krejt çiltër e pafajësish kërkon sqarime bindëse rreth këtyre pikëpamjeve nga ata, ose eventualisht kundërpërgjigje të argumentuar kundrejt tyre.

Të shtyrë nga përgjegjësia fetare e morale, këtë mision e morën përsipër shumë prej dijetarëve islamë anekënd botës islame, të cilët publikuan libra, punime, shkrime e replika, në kohën e duhur, dhe atë vazhdojnë ta bëjnë këtë edhe sot, kundër qëndrimeve të tilla, e të cilat u promovuan në emër të ideve inovative dhe reformuese.

Meqë *kuranistët* pretendojnë se janë konsekuentë ndaj Kuranit, e jo ndaj ndonjë burimi tjetër, atëherë argumentet nga Kurani, janë tejet efikase në kristalizim të qëndrimit shkencor islam kundrejt tyre. Nga të tillat ajete kemi fjalët e Allahut:

> ***"Betohem në Zotin tënd, se ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, përderisa mos të marrin ty*** *(o i Dërguar)* ***për gjykatës- arbitër, për ato mospajtime që ekzistojnë në mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dëshpërimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht."*** *(En Nisa'ë, 64).*

Ajetet kuranore nuk kanë zbritur që të veprohet sipas tyre vetëm për kohën sa ishte gjallë i Dërguari i Allahut, ose që ai të merret për gjykatës vetëm në të gjallë të tij, porse ato kërkojnë nga ne që Muhamedin a.s. ta marrim si gjykues edhe pas vdekjes së tij, duke vepruar me fjalët dhe porositë e tij deri në Ditën e Kiametit, meqë pas tij, nuk pati e as nuk do të ketë të dërguar tjetër nga Allahu..

Pastaj ajeti: ***"…atë që ua jep i Dërguari, atë merreni, e atë çka ua ndalon, lëreni dhe ruajuni*** *(mos i kundërshtoni)* ***Allahut, sepse Allahu, me të vërtetë, dënon ashpër."*** *(El-Hashr, 7).*

Pastaj: ***"Kush i bindet Pejgamberit, ai iu ka bind Allahut. E kush zmbrapset*** *(mos u brengos),* ***se Ne nuk të kemi dërguar ty që të jesh rojtar i tyre".*** *(En Nisa'ë, 80);*

Pastaj ajeti: ***"O ju besimtarë, binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit, e mos i çoni kot*** *(shkatërroni)* ***veprat tuaja!"*** *(Muhamed, 33);*
- "Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që ka zgjedhur *(në dynja)* ***e pastaj e fusim në xhehenem. Sa përfundim i keq që është ai për ta."*** *(En Nisa'ë, 115).*

Në një mori ajetesh të ngjashme , kërkesa për nënshtrim, bindje e respekt ndaj Allahut, përcillet menjëherë me kërkesën për bindje e respekt edhe ndaj të Dërguarit të Tij a.s. Madje respekti ndaj të Dërguarit, cilësohet nga Allahu i Madhërishëm se është respekt edhe për vetë Atë. Kështu që, ato këto dy kërkesa vijnë të pandara dhe në cilindo version interpretues nuk mund të sillet konkluza për tejkalim të argumentimit me Sunetin e Muhamedit a.s.

Ajete tyë tilla, që përcjellin të njëjtin mesazh, ka shumë në Kuranin fisnik, dhe kumbojnë fuqishëm përballë tendencave që të përkufizohet argumentimi i normave islame vetëm në Kuran. Ai që nuk merr për bazë argumentuese edhe Sunetin, i tilli doemos vjen në kundërshtim me ajetet e sipërpërmendura, të cilat kërcënojnë me përfundim të keq.

Këtë e ka paralajmëruar edhe vetë i Dërguari i Allahut a.s., kur kishte dhënë instruksionet e veta se si duhet vepruar në raste të tilla. Transmeton Mikdad el Kindij, se kur i Dërguari i Allahut, na i ndaloi disa gjëra, e në mesin e tyre edhe mishin e gomarit të butë (shtëpiak) na tha: *"Është shumë afër që të vijë koha kur njeriu do të qëndrojë i shtrirë në kolltukun e tij, dhe kur e dëgjon duke u transmetuar ndonjë hadith, thotë: Në mes nesh e jush e kemi Librin e Allahut, atë që e gjejmë në të, të lejuar, e lejojmë, e atë që e gjejmë në të, të ndaluar, e ndalojmë! Por ju dijeni se atë që ua ndalon i Dërguari i Allahut, është e njëjtë sikurse ajo që ua ka ndaluar Allahu."*[11]

I Dërguari i Allahut s.a.v.s., ishte shumë i qartë kur i përcolli këto porosi, të cilat synonin që fjalët, veprimet dhe aprovimet e tij, që janë të konfirmuara se burojnë nga ai, të merren si bazë argumentuese në dispozitat islame.

[11] Këtë hadith e evidenton Tirmidhiu në *Sunenin* e tij (nr. 2664); Ibën Maxhe në *Sunen* (nr.12); Hakimi në *El-Mustedrek* (nr.1/109).

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë: *"I gjithë ymeti im Ditën e Gjykimit do të hyjë në Xhenet, përveç atij që refuzon (nuk do)!"* I thanë shokët e tij: "E kush është ai që nuk do (që të hyjë në xhenet) o i Dërguar i Allahut?". Ai u përgjigj: "*Kush më bindet e më respekton mua do të hyjë në Xhenet, e kush më kundërshton, i tilli veç ka refuzuar."*[12] Ajeti i sipërpërmendur e ndërlidhi hyrjen e njeriut në zjarr, me kundërvënien ndaj të Dërguarit të Allahut, ndërsa ky hadith, e konstaton mos hyrjen në xhenet për atë që nuk i bindet dhe e kundërshton atë.

Pastaj, po mos të ishte Suneti i Muhamedit a.s., bazë argumentuese, si do të mund të arsyetoheshin tërë ato rrugëtime të gjata, që bënin dijetarët në të kaluarën, e të cilat shpesh herë zgjasnin me muaj, vetëm për të arritur deri te një njeri që posedonte në memorien e tij një hadith të konfirmuar nga Muhamedi a.s. Kështu kishin vepruar edhe disa prej sahabëve, pas vdekje së Muhamedit a.s., të cilët rrugëtonin për të shkuar te njëritjetri për këtë mision kaq fisnik.

Transmetohet nga Abdullah ibën Akil ibën ebi Talibi se e ka dëgjuar Xhabir ibën Abdullahun r.a. të ketë thënë: "E kam blerë enkas një deve dhe kam rrugëtuar me të, një muaj, derisa kam shkuar në Sham, për shkak të një hadithi që kam dëgjuar se e dinte njëri prej njerëzve atje. E kur kam arritur atje, e kam marrë vesh se ai që e dinte këtë hadith ishte Abdullah ibën Unejs el Ensariu. Pas përqafimit me të i thashë: "Kam dëgjuar se ti e di një hadith të Muhamedit s.a.v.s. që flet për *kisasin* (hakmarrjen dhe kompensimin për dëmtimet fizike që janë bërë në jetën e kësaj bote) që do të bëhet në mes njerëzve në Ditën e Gjykimit. Kisha frikë se do vdisje ti ose do vdisja unë, e të mbetej ky hadith pa u transmetuar."[13]

- Sahabët sikur e parandienin ardhjen e një kohë kur njerëzit do të justifikonin qëndrimet e tyre të çuditshme, duke u argumentuar me ajete

---

[12] Hadithin e evidenton Buhari në *Sahih* (7280), pastaj Imam Ahmedi në *Musned* (nr. 8729), Ibn Hibbani në *Sahih* e të tjerë. Hadithi klasifikohet si i saktë - i verifikuar.

[13] Këtë ngjarje e rrëfen Imam Ahmedi në *Musned*, Buhariu në *Edebu-l Mufred*, e të tjerë; Shih: El H'atiib El Bagdadij*, Er-Rrihletu fi talebi-l Hadith*, Bot. Darul Kutub El Ilmijje. Bot. i parë. Bejrut, 1975, ff.110-112.

përgjithësuese e duke ua kthyer shpinën haditheve të Muhamedit a.s. Transmetohet se Ebu Hurejre r.a. ka thënë: "Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, do të vijë një kohë, kur disa njerëz, do të jenë tubuar në një ndejë, dhe kur dikush prej tyre ua citon hadithet e Muhamedit a.s., atëherë do të ngrihet një prej tyre e do të thotë: "Ne kurrsesi, nuk i pranojmë këto hadithe, ne marrim vetëm prej Kuranit. E ata në të vërtetë nuk veprojnë me asnjë harf-shkronjë të Kuranit."[14]

- Po ashtu transmetohet nga Hasen el Basriu se ka qenë ulur te sahabiu i nderuar, Imran bin Husejni r.a. teksa ky u ligjëronte disave që ishin ulur rreth tij, e njëri prej atyre që ishin ulur iu drejtua atij duke i thënë: "Mos na fol neve me asgjë tjetër pos me Kuran!" E Imrani iu drejtua atij duke thënë: "Afrohu më pranë!" E kur u afrua, i tha atij: "Çfarë mendon, sikur ti dhe shokët e tu të mbështeteshin vetëm në Kuran, a do ta kuptonit se namazi i drekës ka katër rekate, i ikindisë, katër rekate, i akshamit, tri, në dy prej të cilave duhet të lexosh doemos diçka nga Kurani. Çfarë mendon sikur të mbështeteshit ti dhe shokët e tu vetëm në Kuran, a do ta gjeje diku në të, se tavafi rreth Qabesë ka shtatë rrotullime, pastaj sa'jivrapimi në mes të Safasë dhe Mervës ka shtatë vrapime. O ju popull, merreni këto gjëra nga ne sepse pasha Allahun nëse se bëni këtë do të devijoni."[15] Thjesht, bëhet e qartë nga Imrani r.a. se pa Sunetin e Muhamedit a.s. është e pamundur të kuptohen normat detajuese të Islamit.

Madje edhe në kohën e Imam Ebu Hanifes, derisa në mexhlisin e tij citohej hadithi i Muhamedit s.a.v.s. hyri njëri prej banorëve të Kufës dhe iu drejtua atyre duke thënë: *"Lini ato hadithe!" Imam Ebu Hanifja e qortoi atë duke i thënë: "Sikur mos të ishin hadithet (Suneti), asnjëri prej nesh nuk do ta kuptonte Kuranin..."*[16]. Imam Ebu Hanifja ishte i prerë në qëndrimin e tij se, kuptimi i Kuranit është i pamundur pa ndihmën e haditheve të Muhamedit a.s.

Këto fjalë të atyre që jetuan me Muhamedin a.s., ose jetuan afër kohës së tij, na rrëfejnë qartazi për rrezikshmërinë e anashkalimit të vepri-

[14] El Asfahanij, *El Huxhxhe ala bejani el Mehaxh-xheh* (2/531). Bot. i Parë. Daru Err Rrajeh. 1990. Rijad.

[15] El Bagdadijj , *El Kifaje fi Ilm err Rrivaje* (1/83). Bot.i parë. Daru El Huda. Kajro, 2002.

[16] El Irakijj, *El Mustah'rexh ale-l Mustedrek*, ff. 51-52.

mit me Sunetin profetik, pavarësisht nën cilin pretekst, justifikim apo interpretim bëhet ky anashkalim.

Suneti profetik në fakt e kristalizon panoramën e bukur të legjislacionit islam, e bënë atë të aplikueshëm në jetë, dhe shmang mundësitë që të keqinterpretohet në bazë të tekeve, tendencave apo prapavijave ideologjike, sektare apo fraksioniste nga kushdo qoftë.

Në fakt, heqja e Sunetit nga rangu i argumenteve dhe burimeve kredibile sheriatike, në cilën do kohë që ajo ndodhë, vetëm se i hapë rrugë të gjithë atyre që për synim kanë që Islami të ngjyroset me *"izma"* të ndryshëm, të cilat për burim kanë mendjen njerëzore e jo shpalljen hyjnore. Kjo prirje, me ose pa vetëdije, duket se ka tentativë që Islamit t'i hiqet, ose së paku t'i zbehet petku hyjnor, i cili e ka ruajtur atë në natyrën e tij hyjnore, dhe me të cilin dëshiroi ta mbështillte Ligjvënësi Suprem gjer në kataklizëm.

Si mund të perceptohet logjikisht fakti se, Libri të cilin ua lexonte Muhamedi a.s. shokëve të tij, ajetet e të cilit në shumicë janë të përgjithësuara, e jo të detajuara për aplikim, që vetëm të tillat të merren të sakta e të vërteta, ndërsa forma e jetësimit të tyre, dinamizmit dhe aplikimit në jetë nga bartësi i atij libri, Muhamedi a.s., të jenë jokredibile, të pabazuara apo subjekt i kontestimit nga myslimanët?!

Pastaj, ku do të mbeteshin tërë ato kontribute, si dhe tërë ajo literaturë gjigante e shkruar nga ana e dijetarëve të hadithit, usuli fikhut, e të fikhut dhe shkencave të tjera islame, që përbëjnë thesarin më të madh e më të çmueshëm të myslimanëve. Ata e kishin preokupim kryesor të tyre se si ta konfirmojnë saktësinë dhe autenticitetin e atyre haditheve nga Muhamedi a.s., pastaj si t'i kuptojnë mirëfilli ato dhe në fund si t'i jetësojnë ato në jetën e tyre praktike.

Allahu i Madhëruar kur e ka zbritur Kuranin dhe kur ka garantuar ruajtjen e tij nga ndërhyrjet njerëzore, në të vërtetë Ai e ka garantuar edhe sqarimin dhe jetësimin besnik të tij, nga ana e Muhamedit a.s.. Përndryshe, a thua çfarë rëndësie do të kishte ruajtja e Kuranit si libër, nëse porositë e tij do të mbeteshin vetëm ngjyrë në letër, larg jetësimit të tyre. Pastaj, cili nga njerëzit, qoftë edhe nga sahabët, apo cilido brez tjetër, do të arrinte të kuptonte formën reale të praktikimit të Kuranit, po mos të

ishte Muhamedi a.s. i cili e bëri të mundshme këtë praktikim të mirëfilltë, në të gjitha sferat jetësore. Absurdet e tilla, mund t'i pranojë vetëm mentaliteti meskin dhe tendencioz i *kuranistëve* si fraksion, e jo edhe ai i kuranorëve (pasueseve të vërtetë të Kuranit), të cilët e pranuan Kuranin si libër, dhe e besuan edhe interpretimin dhe jetësimin e tij nëpërmjet fjalëve, veprave dhe aprovimeve të Muhamedit a.s..

Përfundim

Nëse saktësia e pikëpamjeve të fraksioneve do të vlerësohej vetëm në bazë të emërtimeve dhe nominimeve që protagonistët e tyre ia bëjnë vetvetes ose ideologjisë së tyre, atëherë të vërtetën absolute do ta monopolizonin të gjithë ata, që do të arrinin të përzgjidhnin për vetveten e tyre ndonjë emër që në anën e jashtme bartë konsekuencë apo ndjekje të përpiktë ndaj parimeve islame. Por, në konceptin islam çështjet duhet të shihen në esencën e konceptit bazik mbi të cilin ata i ndërtojnë teoritë dhe qëndrimet e tyre.

Andaj, pas një përpjekjeje hulumtuese brenda literaturës dhe mendimeve të fraksionit *kuranist,* mund të konkludojmë se:

- Që nga periudha e pasvdekjes së Muhamedit a.s. e deri më sot, pati individë, të cilët dëshironin suprimimin e argumentueshmërisë së Sunetit profetik, dhe mos marrjen për bazë të tij, në nxjerrjen e normave islame. Kjo ideologji më herët nuk kishte përreth vetes një strukturë organizative dhe asnjëherë nuk u quajtën si fraksion me emërtimin *kuranistë*. Si shkollë ideologjike, strumbullar i ideologjisë së tyre është anashkalimi ose zbehja e rolit të Sunetit, në argumentimin sheriatik.
- *Kuranistët*, ani pse dallojnë në mendime, megjithatë kanë një strukturë të veçantë ideologjike, andaj si të tillë edhe mund të trajtohen si një fraksion i ndarë nga fraksionet e tjera ideologjike islame. Mirëpo, emërtimi i tyre si *Pasues të Kuranit* ose *kuranistë,* nuk i amniston qëndrimet e tyre devijante, e as nuk i bënë ata më konsekuentë ndaj Kuranit fisnik, në raport me të tjerët, të cilët nuk e bartin këtë emërtim.

- Protagonistët e kësaj vije fraksioniste, gjithnjë paraqiten nën petkun e reformatorëve të fesë dhe të atyre që dëshirojnë rishikimin e tërësishëm të burimeve të Sheriatit islam. Ata ia japin vetes të drejtën që të thyejnë jo rrallë herë konsensusin e dijetarëve të mëhershëm myslimanë edhe në ato tema të cilat nuk i nënshtrohen fare ndryshimit, në bazë të vendit, traditës dhe kulturës së rajoneve myslimane. Fatkeqësisht, shtrirja e gjeografike e tyre, sot është bukur e gjerë dhe ka fare pak vende myslimane që nuk janë ballafaquar me këto qëndrime të devijuara të *kuranistëve*, ani pse numri i ithtarëve të këtij fraksioni ende është i paktë.

Për fund, mund të themi se qëndrimet e tilla do të mbesin edhe më tutje subjekt kritike e studimi nga studiuesit islamë, sepse mendimet e tilla dëmtojnë rëndë Islamin si fe hyjnore, e cila iu shpall njerëzimit, si feja e parë, e vetme dhe e fundit, duke e përmbyllur këtë cikël të revelatave të mëhershme, me Kuranin famëlartë, si Libër të garantuar nga çdo ndryshim. Njëkohësisht, nëpërmjet këtij libri të shenjtë, i jepen kompetenca hyjnore të Dërguarit tonë - Muhamedit a.s., që të bëjë sqarimin dhe interpretimin meritor të tij, tek masa e gjerë e popullit apo Ymeti, sepse pa sqarimin nga ana e tij, ne nuk do të ishim në gjendje, të detajizonim shumicën e normave sheriatike.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Muhamed el Eshkar, *Ef'alu-r-Rresul ve delaletuha ale-l ahkami-sh-sher'-ijjeti* . Bot. i gjashtë, Err Rrisaletu. Viti 2003. Bejrut.
2. Ahmed Umer Hashim, *Menhexhu-d-difa'i ani-l Hadithi-n-Nebevijj*. Bot. Ministria e Vakëfeve të Egjiptit. 1987. Kajro.
3. Dr. Xhemal Ahmed Haxhir, *El kuranijjune-l arab ve mevkifuhum mine-t-Tefsir.* Bot. Darut Tefsir. Bot i parë. 2015. Xhedë.
4. H. A. R. Gibb dhe Louis Massignon, *Vixhhetul Islam.* Pa vend dhe vit botimi.
5. Mahmud Mezruah*, Shubuhatu-l kuranijjin havle-s-Sunneti-n-Nebevijjeti* . Pa vend dhe vit të botimit.
6. Dr. Ismail Ed'hem, *Min mesadir et tarih' el Islamijj* . Bot. Salahuddin el Kubra. Bot. i parë.1936. Kajro.
7. Dr. Mustafa es Sibaijj, *Es Sunnetu ve mekanetuha fi-t-teshri'il Islamijj*. Bot. Darul Verrak. Bot. i parë.2000. Bejrut.
8. Dr. Ahmed Subhi Mensur, *El Kur'anu ve kefa.* Pa vit dhe vend të botimit. *(Libri është marrë nga faqja zyrtare e "Ithtarëve të Kuranit", http:.ahl-alquran.com/arabic*
9. Dr. Muhammed Shahrur, *Nahve Usulin xhedideh li-l fikhi-l Islamijj* (fq.61-65). Bot. El Ehalij. Bot. i parë. 2000. Damask.
10. El Asfahanij*, El Huxhxhe ala bëjani-l Mehaxh-xheh* (2/531). Bot. i Parë. Daru Err Rrajeh. 1990. Rijad.
11. El H'atiib El Bagdadij*, Err Rrihletu fi talebi-l Hadith*. Bot. Darul Kutub el Ilmijje. Bot. i parë. Viti 1975. Bejrut.
12. El Bagdadijj, *El Kifaje fi Ilm err Rrivaje*. Bot. i parë. Daru El Huda. 2002. Kajro.
13. Imam Tirmidhiu , *Es Sunen et Tirmidhijj*.
14. Imam Buhari, *Sahihu-l Buhari* dhe *Edebu-l Mufred*.
15. Imam Ebu Davud, *Sunenu Ebi Davud.*
16. Imam Hakem, *El Mustdrek ala es Sahihajn*.
17. Imam Ahmed ibën Hanbel, *El Musned*.
18. El Imam el Irakijj, *El Mustah'rexh ale-l Mustedrek.*

Mr. Driton ARIFI

QUR'ANISTS VERSUS THE QUR'AN

(Summary)

The role of the Sunnah in Islam, as the second source of the Shariah, is indisputable. Yet, recently, a number of so-called researchers have made constant efforts to relativize or even dispute it. The latter, in order to make their ideology more acceptable, did their utmost to call it by a name, which in the minds of a number of narrowminded Muslims, would be quite meaningful, giving their ideas sufficient space for consideration and deliberation.

They called themselves Qur'anists or followers of the Qu'ran (أَهْلُ الْقُرْآنِ أَوْ الْقُرْآنِيُّونَ). Qur'anists and their ideas are the object of study of this analytical paper. Among others we will try to express their views precisely, referring to books written by authors belonging to this fraction. Later on, we will compare these views with credible Islamic arguments.

دريتون عريضي

القرآنيون مقابل القرآن

(بحث تحليلي حول الفريق الذي يطعن في دليل السنة النبوية للرسول محمد صلى الله عليه وسلم)

(خلاصة البحث)

إن دور السنة في الإسلام المصدر الثاني للشريعة هو أمر لا يمكن إنكاره ، ولكن في الآونة الأخيرة ، بذل عدد من "العلماء" المزعومين جهودًا متواصلة لتقليل أهميتها، بل وغالبًا ما يطعن فيها.

لقد قام هؤلاء الذين قاموا بإنشاء حزمة زخرفية لإيديولوجيتهم بحذر شديد من تسمية أنفسهم باسم قد يكون له أهمية كبيرة ، نظرًا للفكر القاصر لدى الطبقة العامة من المسلمين، ومن ثم ليس مستبعدا إعطاء مساحة واسعة لأفكارهم من التقدير والمناقشة .

لقد أطلقوا على أنفسهم اسم "القرآنيين" أو "أتباع القرآن" (أهل القرآن أو القرآنيون).وبالتالي فإن "القرآني" وأفكارهم هي موضع التحليل في هذا العمل التحليلي.

هنا ، من بين أمور أخرى ، سيتم بذل جهود لتوضيح تلك الأفكار والآراء للفريق"القرآنيين" بالضبط كما تناولها المدعون منهم، مشيرا إلى كتب مؤلفي هذا الفريق، ويجب بالضرورة أن نضعها في ميزان التصورات الإسلامية الخالصة لنرى النقاط الواضحة والاختلافات الواضحة التي تملكها هذه الأفكار مع الحجج الإسلامية الموثوقة.

Feti MEHDIU

BRENGAT E REXHEP VOKËS* - NJË SHEKULL PAS VDEKJES SË TIJ

Në përkujtim të njëqindvjetorit të vdekjes së Rexhep Vokë Tetovës, parapëlqeva të marrë në shqyrtim disa nga brengat e Rexhep Vokës, të cilat janë aktualisht të pranishme në mesin e bashkëkombësve të tij.

Rexhep Vokë Tetova,[1] është njëri nga autorët e kësaj periudhe i cili ka qenë i anashkaluar nga studiuesit, sidomos ata shqiptarë. Ky injorim ndaj tij ishte rezultat i paragjykimit se meqë ka përdorur alfabetin me bazë arabe,[2] nuk ishte patriot shqiptar. Këtë fakt e theksoi qartë akademiku, profesor Idriz Ajeti në vitin 1985, kur u shpreh se: *"Kundrejt kësaj*

---

* Rexhep Vokë Tetova është autor i fillim shekullit njëzet, i cili botoi veprat: "Ilmihali Mufassal", "A-Beja shqip" dhe "Mendime", por opinioni shqiptarë, për shkak të alfabetit me bazë të atij arab, deri tash nuk e njohur.

[1] Në veprat që i botoi, vazhdimisht e përdori "Kalkandelenli". Kalkandelen Tetova, kurse me "li", që tregon përkatësinë**: i, e,** Tetovës, duhet thënë tetovari**.** Kështu identifikohej Rexhep Voka.

[2] Disa studiues këtë e quajnë alfabet osman, disa arabo- urk, disa turko-osman...etj., por emërtimi më i saktë është të përdorim emërtimin "alfabet arab", për shkak se 28 shkronjat, që i përdor gjuha arabe i kanë përdor edhe autorët tjerë turq, persianë, shqiptarë, boshnjakë.... etj. Persianët dhe turqit atij alfabeti i kanë shtuar vetëm 3(tri) shkronja, nga e njëjta bazë - arabe. Ai intervenim 3 me 28, nuk është i denjë për t`iu prezantuar shqiptarëve si autorësi në alfabet. Koha do të vlerësojë më objektivisht përpjekjet E R. Vokës dhe të sulltan Abdulhamitit për rrethanat kur po lindte një shtet kombëtar shqiptar dhe një alfabet i gjuhës shqipe, i ngjizur pikërisht në Stamboll nga elita shqiptare e asaj kohe.

trashëgimie gjuhëtarët shqiptarë e të huaj, ... kanë mbajtur qëndrim, në mos përbuzës, indiferent po sigurisht."[3]

Nëse kemi parasysh rrethanat historike, ky është një nga shtyllat e historisë së arsimit kombëtar. Voka, këtë epitet e meriton me plot gojën. Është periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, një moment kur nacionalizmi ishte në kulmin e përpjekjeve për të mbizotëruar në tërë fushat e zhvillimeve shoqërore, politike, fetare, kulturore, diplomatike, etj. Duhet të kemi në konsideratë edhe funksionin që ushtronte Rexhep Voka. Ishte myfti i Vilajetit të Manastirit, njërës nga katër njësitë shtetërore (vilajetet) që përbënin shtetin shqiptar (Arnautlluk).[4]

Zhvillimet historike kalojnë nëpër faza dhe nëpër shtigje të ndryshme që është shumë vështirë të kuptohen drejt në kontekst tjetër kohor dhe shoqëror. Madje shumë herë kuptohen gabimisht. Kërkojnë investim të madh intelektual që ato të vështrohen, të analizohen e të vlerësohen në kontekstin kur janë zhvilluar ato ngjarje.

Për rastin konkret të Rexhep Vokës, duhet pas parasysh se gjuha shqipe, në kohën e tij - viti 1900-1912, nuk kishte alfabet të konsoliduar. Në kohën e tij përpiloheshin abetare të gjuhës shqipe, shkruheshin doracakë në gjuhën shqipe për masat e popullit, të cilin e përfaqësonin. Nuk duhet harruar niveli i arsimimit të atyre masave dhe kapaciteti i tyre për të përcjellë zhvillimin dhe thyerjet historike që ndodhnin në fillim të shekullit XX, jo vetëm për shqiptarët.

Mungesa e kësaj qasje nga studiues të ndryshëm, në rastin e Vokës, bëri që ky të jetë figurë e anatemuar gati për një shekull. Pas botimit të veprave: **"Elif-baja shqip",**[5] **"Mendime"**[6] dhe **"Arnavutça mufassal ilmihal"**[7] dhe pas pjesëmarrjes së tij në Kongresin e Dibrës,[8] që i kushtohej

[3] Dr. Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes, II,* Prishtinë, 1985, fq. 167.

[4] Shih hartat dhe dokumentet tjera historike të fundshekullit 19 dhe fillim shekulli 20; Feti Mehdiu, *Vilajeti i Manastirit në Kamusu-l-a`lam*, Gjurmime Albanologjike - seria e shkencave historike, nr. XIII, 1983, Prishtinë.

[5] "Elif - baja shqip", Istanbul, 1327 h. (1909). Viti 1327 hixhri fillon në janar 1909. Disa studiues gabimisht e kanë shënuar si viti 1910.

[6] *Mendime,* 1327 h. (1909)

[7] *Arnavutça mufassal ilmihal,* Istanbul, 1328 h. (1910)

[8] Arian Kadiu, *Katër kongreset kombëtare për alfabetin e shqipes*, Tiranë, 2016, fq. 49-78.

alfabetit të gjuhës shqipe, deri në vitin 1990, emri i tij përmendej vetëm në konotacion negativ.[9]

Rexhep Voka në Kongresin e Dibrës e kishte kundërshtuar ashpër qëndrimin e Glisha (Gligorije) Elezoviqit. Elezoviqi përfaqësonte elementin joshqiptarë në këtë Kongres.[10]

Hasan Kaleshi qysh në vitin 1957 dhe 1969 hapi sinjalin për ta studiuar veprën e Rexhep Vokës.[11] Edhe Islam Islami, në vitin 1972 ka afruar kontribut të çmueshëm për këtë figurë të historisë së kulturës shqiptare-islame, por pa i njohur sa duhet veprat e Vokës.[12] Është dhënë gabimisht viti i botimit i veprës "Mendime", si vit 1328 h. Madje edhe ky është paraqitë të ketë qenë viti 1907.[13]

Pas vitit 1991, pas publikimit të veprës "Mendime" të transkriptuar,[14] që e botoi Këshilli i Bashkësisë Islame i Tetovës,[15] fillon qasje e re ndaj veprës dhe figurës së Vokës. U organizua një promovim i veprës "Mendime", u publikuan një varg artikujsh ku trajtohej më gjerësisht dhe më thellësisht koncepti intelektual i Rexhep Vokës. Këto kontribute ishin nxitur dhe mbështetur në veprën "Mendime" - Tetovë, 1991, që u kurorëzua me veprën e dr. Vehbi Bexhetit, "Rexhep Voka dhe vepra e tij".[16]

---

[9] *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe kongresi i Manastirit*, Tiranë, 1972, fq. 124. Edhe studiues tjerë e paraqisnin Vokën si reaksionar dhe kundërshtarë të alfabetit të gjuhës shqipe që u zgjodh në Kongresin e Manastirit.

[10] Arian Kadiu, vep. cit.fq. 77.

[11] Hasan Kaleši, *Prilog poznavanje arbanaske književnosti iz vremena preporoda,* GND, NRBiH, Balkanoloski Institut, Sarajevo, I, knjiga, 1957, str. 352-389; ***Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip të Stambollit,*** Gjurmime Albanologjike, 1, 1969, Prishtinë, f. 77-115. Përkundër kësaj, Rexhep Vokës nuk iu qas asnjë studiues shqiptar.

[12] Krahaso: Islam Islami, *Jeta, puna dhe veprimtaria pedagogjike e Rexhep Vokës,* Dituria, nr. 2-3/1971/72, Prishtinë, fq. 108.

[13] Ibid. Vitet e botimit të veprave të Vokës janë lexuar gabimisht . Duhet të jetë: Ilmihali është botuar në vitin 1328 dhe ky është viti 1910, kurse Mendime është botuar në vitin 1327 (1909).

[14] Rexhep Vokë-Tetova, *Mendime,* Tetovë, 1991/1412, Parathënia, transkribimi dhe përshtatja në gjuhën e sotme shqipe: Dr. Feti Mehdiu,

[15] Shfrytëzoj rastin t`i shpreh falënderimet e mia të sinqerta që realizoi botimin e dy veprave të Vokës: *Mendime dhe Ilmihali mufassal.* Vepra Mendime e Vokës, e përgatitur për shtyp në vitin 1975, priti deri në vitin 1991 në redaksi të revistës Jehona. Me ndihmën e KBI bëhet pronë e opinionit shqiptarë.

[16] Vehbi Bexheti, *Rexhep Voka dhe vepra e tij 1847-1917*, Tetovë, 2001, fq. 166.

Autorit Islam Islami i takon merita që voli e na solli të dhëna nga bashkëkohës dhe nxënës e shokë të Rexhep Vokës, të cilët hulumtuesi i sotëm nuk ka ku e gjen më mulla Muhamet Hysenin, Sabri Hyzeirin, as mulla Mexhitin e as mulla Rushanin me shokë, të cilët në vitin 1971 i kishin shkelë tetëdhjetë pranvera.[17]

Pa dyshim, kontributi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Tetovë dhe i miqve të mi të shtrenjtë, paçin mëshirën e Allahut - prof. Ruzhdi Zeqiri dhe dr. Ismail Nuhiu, që ma siguruan tekstin integral të veprën *Mendime* të Vokës, për lexuesit shqiptarë të kohës sonë është i pakontestueshëm,[18] që Rexhep Voka të hyjë në anale të historisë së kulturës shqiptare. Në vitin 1993, presidenti i Shqipërisë, Sali Berisha e dekoroi me URDHËRIN PËR VEPRIMTARI PATRIOTIKE TË KLASI TË I,[19]; në vitin 1994 përfaqësohet në Leksikonin e shkrimtarëve shqiptarë,[20] në vitin 2008 në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar,[21] ndërsa në vitin 2013 edhe në Enciklopedinë Islame - Islam Ansiklopedisi.[22]

Në burimet e lartpërmendura dalin disa çështje, të cilat mbeten t`i zgjidhin hulumtuesit e veprës dhe jetës së Vokës. Përparësi duhet dhënë veprave: Kujtimet e Kongresit të Dibrës, Manastir, 1909,[23] Arnavutça gramer kitabi, Istanbul, 1911, nëse konstatohet se është vepër e Vokës.[24]

Në këto burime, rastis të ketë edhe ndonjë lëshim që mund të jetë i natyrës teknike, por gjithsesi meriton kujdesin e punonjësit shkencor që trajton veprën e Rexhep Vokë Tetovës. Te vepra e A. Kadiut,[25] në listën e pjesëmarrësve të Kongresit emri i Rexhep Vokës paraqitet disa herë: nr. rendor 54, Rexhep Voka, nr. rendor 217, Rexheb Efendiu, myftiu i Mana-

[17] Islam Islami, ... *Dituria*, nr. 2-3, 1971/72, Prishtinë.

[18] Derisa veprat e Vokës ishin me shkrimin arab - ashtu si i pat botuar autori - studimet rreth këtyre veprave ishin sipërfaqësore.

[19] Republika e Shqipërisë - *Presidenti i Republikës, dekreti nr. 435, dt. 26.1. 1993*.

[20] Hasan Hasani*, Leksikon i shkrimtarëve shqiptarë* 1501-1990, Prishtinë, 1994, s.v., Voka.

[21] *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*, vëllimi 3, Tiranë, 2008, s.v., Voka.

[22] *Islam Ansiklopedisi*, 43. Cilt, Istanbul, s.v., Voka.

[23] Hasan Hasani, vep. Cit.

[24] *Islam Ansiklopedisi*, cilt. 43, Istanbul, 2013, s.v. Voka. Prof. Kaleshi ka shpreh tjetër mendim për këtë vepër. Shih: Gjurmime Albanologjike, nr. 1, 1969, Prishtinë.

[25] Arian Kadiu, vep.cit.

stirit, nr. rendor 294, Rexhep Voka. Këso përsëritje ka edhe me emra të tjerë, si nr. 133- Hafëz Sherif Langu, nr. 258-Hafëz Sherif Palikuqi, nr. 131- Hafëz Mehmet Kodra, nr. rendor 187- Hafëz Mehmet Kodra.[26] Te FESH, vëllimi 3, kur radhiten veprat e Rexhep Vokës, mungon vepra *Arnautça mufassal Imihal,* përkundër faktit se kjo vepër është botuar në vitin 1996 në Tetovë, e transkriptuar nga Llukman Elmazi dhe redaktuar nga Feti Mehdiu.[27] Edhe te punimi i Islam Islamit ka mangësi të ngjashme, që ka mundësi të evitohen.

Njerëzit që marrin përgjegjësi para popullit të vet, qoftë vetëm edhe të një segmenti në shoqëri, sikur që është pozita e myftiut, duhet të jenë sikur figura e Rexhep Vokës. Ata nuk kanë kohë të mendojnë se ditët e fundit të jetës mund t'i kalojnë duke shitur lule rrugëve, siç ndodhi me myftiun e Manastirit-Rexhep Vokën.[28]

Rexhep Voka, ashtu si e kishte kuptuar detyrën e tij ashtu edhe veproi.

Për Vokën brenga kryesore ishte ngritja, arsimimi i masave të popullit "me din e me dije", në "gjuhën e vet". Ai është shumë i qartë: *"Nuk asht pa në tarihe[29] e në jetë nji milet xhi asht parue e asht naltzue pa këndue në gjuh të vet."*[30] Prandaj ai për ta kursye popullin e vet nga grackat që mund t'u afrojnë rrethanat, u la dy vepra: *Arnavutça mufassal Ilmihal* dhe *Mendime.*

Ai shprehu pikëpamjet dhe brengat e veta dhe vazhdimisht ngriti zërin për një qeverisje të popullit pa ia cenuar identitetin e formuar me shekuj, brenda kritereve e kornizave të kohës së vet, *me din e me dije,* pa pretendime për tjetërsim.

Gjatë shekullit pasvokian janë dhënë vlerësime kuturu edhe për të, duke e trajtuar brezin e Vokës si analfabet.

---

[26] Ibid.

[27] Rexhep ef. Voka , *Mufassal Ilmihal,* Tetovë, Bashkësia Islame, 1996. (Ilmihali i Rexhep Vokës në gjuhën e sotme).

[28] Ky konstatim është prezantuar edhe në Islam Ansiklopedisi.

[29] Histori.

[30] *Mendime*, Tetovë, 1991, fq. 15. Krahaso sot vrapin e disa profesorëve që sigurojnë grada shkencore me botime në gjuhë të huaja, madje edhe në adresa të dyshimta e fiktive. (Koha ditore, 10 dhjetor, 2017, Prishtinë.

Voka dhe brezi i tij nuk ishin analfabetë. Ata që kishin kryer studime në qendër të sulltanatit Osman, që e njihte bota e qytetëruar, dhe shërbeheshin me gjuhën e me shkrimin zyrtar të gjysmës së Azisë dhe tërë Ballkanit, nuk ishin analfabetë. Ishin elitë e popullit të vet sepse zotëronin alfabetin e dytë në botë,[31] por jo atë cirilik.

Në kohën kur vepronte Rexhep Voka zhvillohej një luftë e ashpër mes dy frymëve: njëra *pseudo kombëtare* dhe tjetra *pseudo fetare*. Të dyja këto vepronin nën maskën e fetares apo nën maskën e kombëtares. Ishte mbjellë një frymë, në kundërshtim me parimet që përfaqësonte Myftiu Voka. Ky mbështetej në Kuran, se duhet dije, për dije të shkosh edhe në Kinë, kurse fryma tjetër plasonte idenë se dija duhej të jetë patjetër në gjuhën e kombit, në këtë rast vetëm shqip. Nuk përfillej fakti se, të paktën prej se dihet për historinë e shqiptarëve këta ishin shkolluar në gjuhën latine, gjuhën greke dhe në fazën paravokiane dhe vokiane, në gjuhën turke, të periudhës osmane. Kjo është një gjuhë që ka përvetësuar alfabetin arab, alfabet i librit të shenjtë islam, Kuranit. Përqendrimi i "pseudonacionalistëve" ishte kundër shkronjave arabe, përkundër përpjekjeve të hafëz Ali Korçës, që t'u tregojë se:

Shkronjat fe nuk kanë,
Mjet për t'u marrë vesh janë.

Përkundër kësaj, valët e jetës vazhdonin marshin krejt ndryshe. Pasojat e atyre valëve i ka përjetuar edhe brezi im, kur njëra anë apelonte *"mos shko në shkollë se prish fenë",* tjetra me veprime praktike nëpër shkolla *"me ujë e me bonbone"* ua prishte nxënësve agjërimin e Ramazanit.

Në këso rrethanash veproi myftiu i Manastirit, Rexhep Vokë Tetova dhe ai këto brenga i shprehu dhe i sqaroi më së miri në veprën e tij me vetëm 16 faqe, Mendime.[32]

Kam shkëput, për këtë rast, vetëm disa nga ato brenga të Vokës, të cilat gjithnjë sipas mendimit tim, vazhdojnë ta përcjellin popullin e Vokës.

---

[31] Filip Hiti**,** *Istorija arapa,* Sarajevo, 1967.

[32] *Mendime, Tetovë, 1991.*

Thirrja e Rexhep Vokës:
O burra! O bijë, mirë ta dini ***që feja e dija***
janë ***si dy fletë*** *për njerëzinë nga Perendija*[33]

Sigurisht është rezultat i frymës euforike të kohës së tij, fillimi i shekullit XX, kur për çdo mangësi e mossukses në administrim të shoqërisë faji i hidhej fesë. Për çdo të keqe që ndodhte fajtor ishte feja, prandaj duhej ndarë fenë nga dija. Nëse këtë e përkthejmë në rrethanat e sotme do të thotë shmangie e komponentës edukative nga ajo arsimore.[34]

Ndarja e fesë nga dija për Vokën ishte ndjellakeqe, fuste frymë kaotike në sistem edukativo-arsimor, sepse ai te feja shihte virtyte të mira.

Shprehja e Vokës: "...dy fletë për njerëzinë nga Perendija" nuk janë fletë libri të faqosura me numra një e dy dhe mund t'i ndash njërën prej tjetrës, pa asnjë pasojë, se mund t'i blesh në librari, por janë dy fletë "... nga Perendija", për fluturim. Janë krah, flatra, pa të cilat nuk mund të fluturohet. Këto dy fletë (krahë) janë: "për njerëzinë nga Perendija".

Nuk i prodhon fabrika e letrës as fabrika e aeroplanëve, prandaj autori i "Mendimeve" arrin në konstatimin e tij, se: "një njeri që nuk ka fe e dije...të vdektë dije"[35], ngase si pasojë e mos fluturimit sigurisht vdes. Voka e kishte brengë shpëtimin e popullit të vet nga ato gracka.

"Një njeri që nuk ka fe e dije...të vdektë dije", një shprehje figurative që kërkon analizë të hollësishme dhe të thellë, në mënyrë që të kuptohet se sa është i vlefshëm njeriu që nuk i ka kultivuar këto *"dy fletë"* që ia ka dhënë *Perëndia.*

Ajo *"fleta",* krahu për fluturim, që i referohet dijes, e brengoste Vokën, sepse populli i tij nuk e kishte në "gjuhën e vet".[36]

Ai u bënte me dije bashkëkombësve të vet se: *"Nuk ka në histori asnjë shembull, e në jetë, që një popull është përparuar dhe është ngritur pa mësuar në gjuhën e vet".* Nuk ka se si të jetë më i qartë koncepti i Vokës lidhur me ngritjen e shkallës së arsimit dhe të edukimit të popullit

[33] *Mendime*... fq. 24.

[34] Edukimi nëse ndahet nga arsimi, nënkupton këputjen e njërës "fletë, njërit krah".

[35] *Mendime,* Tetovë, 1991, fq. 24.

[36] Ibid. fq. 15.

shqiptar në fillim të shekullit XX, dhe ai e kishte vlerësuar se *dija ka përparësi në raport me shkrimin, dhe kjo duhej arrit* në "gjuhën e vet".

Kjo bindje e kishte nxit të bëj një alfabet, i cili për kohën e tij ishte më lehtë të përvetësohet për të lexuar libra. Voka afroi vetëm një alternativë me grafinë arabe, por nuk ishte i pari e as i vetmi që vepronte kështu.

Shprehja e Vokës se një kategori e caktuar e njerëzve: "s'dallon dot prej bagëtive", është shprehje që e gjen edhe në suren *El-En'am,* në Kuran. Nga udhëheqësit, sikur Voka, është e pritshme që të flasin në frymën e burimeve islame, sado që mund të duken të rënda ato kualifikime. Ata nuk i lejojnë vetes të bien në grackat ideologjike të kamufluara nën maska të ndryshme, veçmas të ideologjive që shërbenin për ndërtimin e platformës ateiste, të kamufluar me filozofinë iluministe. Ai u shpreh shumë qartë: *"një njeri që shikon vetëm të hajë e të pijë, e nuk mundohet të fitojë virtyte të mira dhe të mësojë fe e dije s'dallon dot prej bagëtive, përveç se me haje e pije.*[37]

Edhe brenga tjetër e Vokës, një cilësi njerëzore (që nuk e gjen te kafshët), është shqetësuese edhe aktualisht, sepse:

Mundohemi dit për ditë
Njani tjetrit sytë me ia qit.[38]

Rexhep Voka, si një njeri i pajisur me fe e me dije, aq më shumë si një myfti, i cili bartë përgjegjësin më të madhe para Krijuesit, insiston që të mbjellë te bashkëkombësit e vet frymën që e ka mësuar në Kuran për Ehlu-l-kitabët: pasuesit e librave të shenjtë: *Tevrat, Ingjil,* sepse edhe këto, krahas Kuranit, kanë burim të përbashkët hyjnor.

Këtë frymë e kultivonin edhe rilindësit e tjerë shqiptarë që vazhdimisht e përsërisnin myslimanë e të krishterë, Perëndia na ka bërë.

Voka brengosej edhe nga dallimet me indikacione përçarëse që i shihte në mesin e bashkëkombësve të tij. Ishte i bindur se janë farë e huaj e mbjellë te shqiptarët, për të krijuar grupacione fetare dhe gjuhësore, sipas ideologjive dhe krahinave dhe për ta nëpërkëmbur fenë e kombin, prandaj

[37] *Mendime*, Tetovë, 1991, fq. 24.
[38] Ibid. fq. 26.

ky ngulte këmbë: *"Të mos thomi se ky është mysliman e ky tjetri i krishterë, jo toskë jo gegë." s*e të gjithë jemi... *një fis e një farë.*[39]

Ndjesinë që kishte Voka ndaj brezit që vjen, e që e shprehte kur bënte thirrje te prindërit e tyre"... *që të ndërtojnë kasolle me kashtë veç le të mësojnë*..." sepse "... djemtë tanë... kujt t'i teket i merr nëpër këmbë" dhe shpërthente: *"Ku jeni o krerët e Shqipërisë? E fikët veten dhe i koritët varret e emrat e prindërve tanë!*[40]

Brengat e Rexhep Vokë - Tetovës, edhe një shekull pas vdekjes së tij, nuk janë shëruar tërësisht.[41]



[39] Mendime, Tetovë, 1991, fq. 30.

[40] Ibid., fq. 26.

[41] Aktualiteti veprës Mendime e Rexhep Vokë Tetovës, Dituria Islame, nr. 50/1993, Prishtinë, f. 40-42.

Neve na mbetet edhe një brengë shtesë. Brenga jonë mbetet prezantimi i plotë i tëra veprave të Myftiut të Manastirit: Kalkandelenli Rexhep bin Nuredin Vokës.

Hapi i parë është shumë i mundshëm, ribotimi i veprave të tij: *Elif baja apo A-beja shqip, Mendime, Arnautça mufassal Ilmihal.* Hapi i dytë mbetet hulumtimi për veprat e Vokës: Kujtimet e Kongresit të Dibrës, 1909, Manastir[42] dhe Arnavutça gramer kitabi.[43] Gjithashtu pjesëmarrja e tij në Kongresin e Dibrës, duhet trajtuar objektivisht.

"Elif - baja shqip", një tip abetareje për fëmijë të klasës së parë[44] tek sapo është bërë pronë, në duar të studiueseve.[45] "Elif - baja shqip" e Rexhep Vokës e ka kohën të jetë pjesë e monografisë për Abetaret e gjuhës shqipe.

Është edhe një çështje e cila meriton të trajtohet. Kjo është laramania e përdorimit të identitetit personal të autorit Voka në botimet e deritashme që del si pasojë e njohurive jo të mjaftueshme rreth alfabeteve semitlatin dhe i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Në veprën e parë të tij që del me shkronja (latine) të gjuhës shqipe qëndron: *Rexhep Xhevdi bin Nuredin Voka,*[46] te vepra Arnavutça Mufassal Ilmihal doli Xhaudi bin Nuredin Voka. Në Islam Ansiklopedisi, e gjejmë Xhydi.[47]

Te forma Xhaudi, është fjala për zbatimin e një rekomandimi që del nga drejtshkrimi i gjuhës shqipe, ku thuhet: shkronja **(w)** e anglishtes duhet të prezantohet me **u.**[48] Kjo ka fut huti edhe te shumë emra të proveniencës semite. Ky është një gabim që duhet korrigjuar pa diskutim. Ndërkaq për format Xhudi dhe Xhavdi, ndihmë të vlefshme mund të afrojnë famil-

[42] Kështu e përmend Hasan Hasani në Leksikonin e shkrimtarëve...

[43] Shih fusnotën 23. Veprën e Vokës *Arnavutça gramer kitabi,* nuk e kam pas në dorë.

[44] Në veprat tjera përdorte Rexhep Xhudi bin Nuredin Voka, kurse te kjo vepër shënon vetëm *Rexhep bin Nuredin Voka ,* gjë që kërkon një shpjegim.

[45] Rexhep Vokë Tetova, A-BEJA SHQIP, Tetovë, 2018, fq. Transkriboi dhe përgatiti për shtyp Feti Mehdiu, botoi Myftinia e Tetovës.

[46] Rexhep Voka, Mendime, 1991, botoi Myftinia e Tetovës, Tetovë.

[47] Krahaso botimet konkrete.

[48] Shih më gjerësisht: Feti Mehdiu, *Drejtshkrimi i disa emrave arabë në gjuhën shqipe*, Gjuha shqipe, nr. 1, 1984, Prishtinë; *Emrat arabë dhe drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, nr. 19, Prishtinë, 2001, f. 333-340;

jarët dhe bashkëfshatarët e Vokës, të cilët e dinë çfarë emrash ka pas, apo edhe sot mund të ketë, në Shipkovicë, Xhevdi apo Xhudi.[49] Punë që mund të zgjidhet lehtë dhe të zbatohet lehtë.

Çka mund të bëhet sot nuk duhet lënë për nesër. Kjo duhet sqaruar nga arsyeja se janë shpreh mendime që *"Xhudi apo Xhavdi",* Voka i ka përdorë si pseudonime, diçka e paarsyeshme, por nëse e ka pas këtë funksion, është me interes që hulumtuesit e rinj të gjejnë arsyet.

Si përfundim i tërë kësaj do të thosha:

Për t'i dalë borxhit, për t'ia dhënë hakun Rexhep Vokës, u takon institucioneve me kompetencë profesionale shkencore e kulturore, pa injoruar vullnetin e gatishmërinë e askujt, që në krye të një shekulli pas vdekjes, të investojnë konkretisht në veprat e Rexhep Vokës për një botim kritik meritor. Me këtë mbyllen shtigjet e paragjykimeve dhe manipulimeve me emrin dhe autoritetin e myftiut të Manastirit, Rexhep ef. Vokë Tetovës.

Mund të bëhen tre vëllime: **"Elif-baja shqip", "Mendime"** dhe **"Ilmihali shqip".** Ose mund të bëhet një botim i ngjeshur, të tria veprat në një vëllim. Por të bëhet si e meriton Voka, si figurë e shquar e Rilindjes Kombëtare, jo vetëm në sferën islame.

Nga veprat e Vokës, vetëm "Ilmihali" i përket fushës islame.

"Elif - baja shqip", "Mendime" dhe "Kujtimet e Kongresit të Dibrës" apo ndonjë tjetër, nuk janë me çdo kusht islame! Nëse ato studiohen nga kompetentët e fushave filologjike, filozofike, historike, teologjike, politike, diplomatike, etj., sjellin freski dhe ngjallin interesimin e studiuesve të ri.

Ky edhe është qëllimi kryesor i angazhimit tim për këtë figurë dhe për këtë përvjetor. Koncepti i Myftiut të Manastirit, nga shekulli i kaluar, Rexhep ef. Vokës edhe sot nuk është zbehur.

[49] **Y** ose **U**, *Xhudi* apo *Xhydi*, është çështje e harmonisë vokale, nuk paraqet deformim të veçantë.

Feti MEHDIU

THE CONCERNS OF REXHEP VOKA – A CENTURY AFTER HIS DEATH

(Summary)

Rexhep Vokë Tetova was one of the most distinguished figures of the end of the XIX and the beginning of the XX century. He was unjustly ignored and anathematized by scholars, in particular Albanian scholars. This was due to the wrong assumption that he was not an Albanian patriot because of his use of Arabic script. The above-mentioned was best confirmed by academician Idriz Ajeti, who stated: "Albanian and foreign linguists have shown indifference if not contempt towards his work".

Rexhep Voka was an important figure in the history of our national education. He fully deserves this title. Voka was the mufti of the Vilayet of Manastir, which was one of the four vilayets comprising Arnavutluk (Albania). His main concern was the advancement and education of the masses with religious and other knowledge in their own language. His main works are *Arnavutça mufassal Ilmihal* and *Opinions.*

فتحي مهديو

هموم رجب فوكا – بعد قرن وفاته

(خلاصة البحث)

رجب فوك تيتوفا ، هو أحد ألمع الشخصيات في أواخر القرن التاسع عشر وبداية القرن العشرين ، والتي تم تجاهلها بشكل لا مبرر له وتمت مهاجمته من قبل العلماء ، وخاصة الألبان. كان هذا التجاهل نتيجة للتحامل الذي كان منذ أن استخدم الأبجدية العربية. وقد أوضح الأكاديمي البروفيسور إدريس آيتي هذه الحقيقة بوضوح في عام ١٩٨٥ ، عندما قال: "اتخذ ضد هذا الميراث اللغويون الألبان والأجانب ، ... موفقا ، إن لم يكن حقيرًا ، كان غير مبال بالتأكيد".

كان رجب فوكا ، أحد أركان تاريخ التعليم الوطني. إن رجب فوكا يستحق هذا الوصف بكامل الفم. بالإضافة إلى كونه مفتي في ولاية منستير ، وهي واحدة من وحدات الدولة الأربع (ولاية) التي شكلت الدولة الألبانية (أرناوتلوك) ، كان الشاغل الرئيسي لديه هو رفع مستوى التعليم وتثقيف الجماهير من الناس "بالدين وبالعلم" و بـ"لغتهم الخاصة". لذلك ، لتجنيب شعبه من المزالق التي يمكن أن تجلبها له الظروف الجيوسياسية ، لقد ترك مؤلفين بعنوان "الأرناؤطية علم حال" و"الخواطر".

Nuridin AHMETI

MONUMENTET ISLAME NË PRIZRENIN E MITRUSH KUTELIT TË VITI 1943

Abstrakt

Prizreni, një nga qytetet historike shqiptare, është trajtuar nga shumë pena të diplomatëve, udhëpërshkruesve, vrojtuesve e kalimtarëve të huaj, si: G. V. Hahn, baroni Nopça, Mis E. Durham, I. Jastrebov etj., të cilët kanë shkruar rreth monumenteve kulturore të këtij qyteti. Vargut të këtyre përshkrimeve për Prizrenin, në vitin 1943, i shtohet edhe një ese e shkruar nga shkrimtari ynë i njohur Mitrush Kuteli, me titull "Në Prizren, midis të vdekurve e të gjallëve", i shkruar në muajin maj, të '43-tës. Për vrojtimet dhe të dhënat e Mitrush Kutelit për Prizrenin dhe trashëgiminë kulturo-historike të tij, kemi shfletuar të dhëna nga literatura përkatëse e autorëve shqiptarë dhe mbi këto hulumtime do të japim përgjigje, se cila është sot gjendja e varrezave dhe trashëgimisë kulturo-historike të këtij qyteti, të cilën e përshkruan shkrimtari M. Kuteli. A janë ruajtur ato këngë sot në këtë qytet, të cilat i shkruan shkrimtari në vitin 1943 etj.

Falët kyçe: *Prizreni, varreza, zonja, zonjusha, xhami, teqe, kisha, mysliman, katolik*

PRIZRENI DHE MONUMENTET E TRASHËGIMISË SIPAS PËRSHKRIMIT TË VITIT 1943

"Po të jetë se vini në Prizren - për do-një punë më të kthjelltë se kontrabanda - mbasi të keni shijuar bukuritë pa shoq të këtij vendi të qetë edhe gazet e jetës të të gjallëve, mos harroni të vizitoni edhe banesat e të vdekurve".

Hyrje

Fjalitë e vendosura në ballë të këtij shkrimi, janë rreshtat me të cilët Mitrush Kuteli[1] e nis përshkrimin e tij për qytetin e Prizrenit, për banorët dhe për bukuritë e tij, siç thoshte ai, "të pa shoq", të titulluar "*Në Prizren, midis të vdekurve e të gjallëve",* të shkruar në muajin maj të vitit 1943.

Na ka rënë të shohim disa versione të këtij shkrimi të publikuar, në disa gazeta e portale, megjithatë e kemi vënë re se ato janë të paplota. Prandaj, ne për këtë kontribut shkrimor, jemi mbështetur në artikullin e botuar në revistën " Jeta e Re", në Prishtinë, në vitin 1995,[2] në të cilën, mendojmë, se është versioni i plotë dhe i pari i shpërndarë te masa e gjerë e lexuesve në Kosovë.

Sikurse kuptohet edhe nga vetë titulli, autori M. Kuteli, na jep të kuptojmë se për dallim nga udhëpërshkruesit e tjerë, ky në një pjesë të madhe i ka përshkruar edhe varrezat e këtij qyteti dhe gjendjen e tyre.

Ka disa arsye pse ne kemi menduar t'i bëjmë një vështrim më të zgjeruar këtij shkrimi:

E para, është nga të vetmit shkrimtarë që për nga besimi nuk është mysliman, por monumentet e këtij besimi i trajton pa ngarkesa ideologjike.

---

[1] Mitrush Kuteli *(Dhimitër Pasko 1907-1967)*- Shkrimtar, ekonomist, kritik letrar, përkthyes, folklorist. Lindi në Pogradec. Kreu shkollën e mesme tregtare në Selanik, u diplomua për ekonomi në Bukuresht, ku edhe mori titullin doktor i shkencave. Është marrë me shkrime, ka punuar në Bankën e Shtetit. Është ndër themeluesit e Lidhjes së Shkrimtarëve në Shqipëri. Në vitet 1947-49 ishte i burgosur politik. Disa nga veprat e tij janë: "Net Shqiptare", "Ago Jakupi e të tjera rrëfime", "Tregime të moçme shqiptare" etj. Vdiq në Tiranë më 1967. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 2*, ASHSH, Tiranë, 2008, f. 1429.

[2] Mitrush Kuteli, "Në Prizren, midis të vdekurve e të gjallëve", *Jeta e Re*, nr. 5, Prishtinë, 1995, f. 661-667.

E dyta, është shkrimtari i parë shqiptar, që deri në këtë kohë, shkruan një shkrim, kaq përmbledhës dhe me shumë të dhëna interesante për qytetin e Prizrenit.

E treta, për këtë qytet kanë shkruar edhe udhëpërshkrues e diplomatë të huaj para këtij shkrimi, si: G. V. Han, Nopça, E. Durham, Jastrebovi, etj., por jo në stilin dhe formën e M. Kutelit.

Duke lexuar informacionet që jep për këtë qytet në këtë shkrim M. Kuteli, posaçërisht për trashëgiminë kulturo-historike, kemi hulumtuar se ku gjenden ato objekte sot dhe në çfarë gjendje janë ato objekte e varreza të cilat i përmend M. Kuteli, a gjenden dhe sot në këtë qytet apo jo etj.

Të vdekurit dhe të gjallët e Prizrenit

E veçanta e përshkrimit të M. Kutelit për Prizrenin është se ai merret shumë me varret, monumentet mbivarrore të këtij qyteti, posaçërisht ato nishane të periudhës osmane. Ai ka lëvizur nga një pjesë në pjesën tjetër të qytetit për të parë sa më shumë varre dhe për të marrë sa më shumë informacione. Kjo ndoshta është edhe ajo më thelbësorja, që e dallon këtë përshkrim, prej përshkrimeve të tjera të diplomatëve e udhëpërshkruesve të huaj, të cilët kanë shkruar për Prizrenin ndër vite. Shkrimi i M. Kutelit nuk ka lënë anash as të gjallët e këtij qyteti, informacionet për të cilët janë interesante.

Nga leximi i shkrimit të M. Kutelit për Prizrenin, ne e kemi konceptuar në disa fusha duke filluar nga:

Varrezat/nishanet

E potencuam edhe më lart dhe kjo del e kuptueshme dhe nga vetë titulli i shkrimit. Lexuesi e kupton fare lehtë edhe kur e lexon nga fillimi e deri në fund këtë shkrim. Shkrimtari duke përshkruar gjendjen e varrezave në Prizren, njëkohësisht tregon një pjesë të historisë së këtij qyteti, gjendjen e tij sociale etj.

Duhet potencuar se në këtë vit, pikërisht në muajin prill të vitit 1943, d.m.th., një muaj para se të vinte në Prizren dhe ta shkruante këtë shkrim,

M. Kuteli shkruan edhe një shkrim tjetër për mbishkrimet mbivarrore të varrezave të Tiranës të titulluar *"Vargje mbi gurë varesh"*.[3]

Njerëzit, të cilët shëtisin në Prizren mbi tokë, sipas M. Kutelit, janë vetëm një pikë ujë në det, krahasuar me ata që janë nën dhe. Elementi shpirtëror është evident tek autori i shkrimit, sepse, sipas tij, të vdekurit *"atje ku janë e ku s'janë, e ndjejnë çapin tonë e në kanë do-një gas, në mënyrën e tyre, po di se shpirti ynë del, nga këto parakalime për në banesën e fundit, më i platitur, më i njerëzishëm e mbase më i larguar nga kotësirat e tokës"*[4]- çfarë nënkupton se autori e ndjente parakalimin nëpër varrezat dhe nuk ishte vetëm një kalim i thjeshtë.

Sado që qyteti i Prizrenit ka varreza të shpërndara gjithandej, autori është i vetëdijshëm për këtë gjë se nuk mund t'i vizitojë të gjitha varrezat aq sa janë, por ai prapë do të bëjë atë aq sa ishte e mundur dhe se shumica prej varrezave janë të zhdukura sot: *"Është fort i rëndë të vizitosh gjithë varret e një qyteti kaq të madh e kaq të vjetër, se janë të shumtë e të përhapur. Dhe shumë gjysma janë zhdukur. Po ne bëjmë sa mundim"*[5] - shkruante M. Kuteli.

Por, të habit përshkrimi që ky autor, pa kurrfarë ngarkese, e jep me aq kujdes, pa dallime religjioze.

Objekt i shkrimit të M. Kutelit për varrezat e myslimanëve në Prizren janë nishanet e periudhës osmane në oborrin e Xhamisë së Bajraklisë, ku shkrimtari, duke vështruar oborrin e kësaj xhamie, konstaton se: *"Është një oborr dhe në oborr ka disa varre të vjetër zonjash e zotërinjsh, nga të fuqishmit e një kohe. Tani, kur asnjë dorë nuk zgjatet t'i përkujdese, as varret as qoshkun që aty pranë, pllakat e mermerta kanë rënë poshtë, ku i shkel këmba dhe i bluan koha..."*.[6]

---

[3] Mitrush Kuteli, "Vargje mbi gurë varesh", *Shënime letrare*, ShB, Grand Prind, Tiranë, 2007, f. 400-405.

[4] Mitrush Kuteli, "Në Prizren...", f. 661.

[5] *Po aty*.

[6] *Po aty*.

Varrezat në oborrin e Xhamisë së Bajraklisë[7]

Sot, këto varreza dhe një pjesë e gurëve të cilat i përmend M. Kuteli gjenden në oborrin e kësaj xhamie. Por, ato monumente mbivarrore për të cilat flet shkrimtari: *"Duhet të kenë më shumë kujdes adekuat institucional. Edhe si fëmijë e mbaj në mend këtë grumbull të monumenteve mbivarrore në Xhaminë e Bajraklisë, por sot janë të renditura dhe në një gjendje më të mirë"*[8]*,* kujton prizrenasi Luan Koçbashliu.

[7] Fotot e ilustruara, pjesa e konsiderueshme, janë të marruara drejtpërdrejtë në teren, nga databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës (www.dtk.rks-gov.net) dhe nga Fondi i fototekës së Nexhmedin Ramadanit.

[8] Informatë nga Luan Koçbashliu(1950), arkeolog, bashkëpunëtor profesional në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren nga vitet 1975 deri më 2015, Prizren më 04. 4. 2017.

Grumbull monumentesh mbivarrore në oborrin e Xhamisë së Bajraklisë

Kur jemi te varrezat myslimane, autori ynë i përshkruan edhe disa varre të tjera, por pa na treguar se në ç'vend gjendeshin ato. Sikurse do ta shpjegojmë më vonë, ne mendojmë se ato varre që kishte parë M. Kuteli janë varret e teqesë së "Halvetive", apo teqeja e "Saraçhanës", siç njihet në Prizren të cilat gjenden edhe sot. Shkrimtari shkruan se *"Sgjatim kryet në një dritore. Brenda varre - janë gjashtë - me kësula e çallma të rënda përsipër. Në një të ndarë të dytë të tjera vare, me merhama përsipër. Shkon një njeri. Pyes e më përgjigjet: Varret e para janë varre jabanxhinjsh, miq të teqesë që i arriti vdekja aty. Varret e tjera janë të baballarëve të teqesë, dyke filluar me Sheh Osmanin, dhe pas tij, Sheh Ahmeti, Sheh Sinani e katër të tjerët".*[9]

Grumbull monumentesh mbivarrore në Teqenë e Saraçhanes

Sipas M. Kutelit: *"Varret e reja, të sotmet, të Prizrenit janë përtej, në hyrjen e qytetit. Që t'arrijmë atje mbajmë krahun e djathtë të lumit..., ja aty, më të djathtë, një fushë e madhe me varre, varret e myslimanëve. Rrasa të rrepta prej guri të hirtë. Shumica pa kryeshkrime. Disa që kanë,*

[9] Mitrush Kuteli, "Në Prizren...", f. 662.

janë arabisht".[10] Në fakt, ato varreza të cilat i përshkruan M. Kuteli edhe sot janë në atë vend, të rrethuara dhe të mbajtura mirë.

Ndërsa, varret e teqesë[11] janë të rrethuara dhe gjenden brenda objektit të kësaj teqeje, të gjithë ata emra të cilët i përmend M. Kuteli. Varret e reja në hyrje të Prizrenit, të cilat përmenden nga M. Kuteli, janë pothuajse në atë vend. Një pjesë e këtyre varrezave, që llogariten si më të vjetra, aty ekziston edhe një tyrbe e njohur si "Tyrbja e Karabash Efendisë"[12] dhe vizitohet nga qytetarët e Prizrenit me rrethinë me fillim të çdo muaji maj.

M. Kuteli gjithashtu, tregon se ka një moskujdesje ndaj këtyre monumenteve mbivarrore osmane dhe shpreh shqetësimin se në këtë gjendje çfarë janë vështirë se do t'i përballojnë kohës. Fatkeqësisht, parashikimet e M. Kutelit kanë rezultuar të sakta, ngase pjesa dërrmuese e monumenteve mbivarrore osmane, të asaj kohe, sot nuk gjenden.

Mënyra e përshkrimit të monumenteve mbivarrore osmane nga M. Kuteli, është e vështirë ta gjesh edhe një tjetër, që përafërsisht ka bërë një vështrim të tillë. Dhe jo rastësisht, këto vargje të thurura me mjaft mjeshtëri, janë vënë edhe si moto të punimeve shkencore nga studiuesit tanë sot.[13] Domethënë se, edhe sot e kësaj dite, për studiuesit e orientalistikës dhe njohësit e kësaj kaligrafie, vargjet në fjalë mbeten lapidare.

Këtyre vargjeve u shtohet vlera edhe më shumë kur dihet se janë shkruar nga një njëri që nuk e njihte osmanishten, por shpreh brengën e tij pse nuk di ta lexojë këtë shkrim dhe brenga bëhet edhe më thellë te shkrimtari, kur shprehet se ndoshta kurrë nuk do ta mësojë këtë lloj shkrimi për ta lexuar. M. Kuteli, kur ballafaqohet me këtë shkrim të monumenteve mbivarore të Xhamisë së Bajrakut në Prizren, pa hezitim shprehet: *"Do dëshëroja fort të lëçit mishkrimet, me nj'ato fantastike kaligrafi arabe, që asnjë nga alfabetet e rigjide evropiane nuk mund t'iu afrohet nga*

---

[10] *Po aty,* f. 663.

[11] Alban Dobruna, *Rendi Halveti te shqiptarët gjatë shekullit XX,* (Punim i doktoratës në dorëshkrim), QSA-IH, Tiranë, 2015, f. 84-87.

[12] Shpresa Siqeca, "Vende kulte të ritit islam në Prizren (Tyrbet e varret e shenjta)", *Gjurmime albanologjike-SSHFE*, nr. 25, IAP, Prishtinë, 1996, f. 181.

[13] Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, AK, Prishtinë, 2008, f. 7.

bukurija. Po nuk di, dhe jam i dëshpëruar se ndofta nuk do di kurrë. Megjithkëto më pëlqen t'i vështronj e t'i prek me gishtrinj. Sepse më duket se kur i prek me gishtrinj këto veprat e artit skulptural, i afrohesh shpirtit të artistit që i punoj".[14]

[14] Mitrush Kuteli, "Në Prizren...", f. 661-662.

Nishane në haremin e xhamisë së Emin Pashës

Xhamitë

Ndër xhamitë e njohura monumentale, të cilat kanë edhe historinë e tyre, dhe u kanë përballuar furtunave politike, nëpër të cilat ka kaluar qyteti i Prizrenit, janë edhe "Xhamia e Sinan Pashës" dhe "Bajrakli Xhamia", apo e njohur ndryshe edhe si "Xhamia e Gazi Mehmet Pashës".

Xhamia e Sinan Pashës u ndërtua më 1615/16 nga Sofi Sinan Pasha, origjina e të cilit ishte nga Luma,[15] ndërsa Xhamia e Bajraklisë është ndërtuar nga Gazi Mehmet Pasha në vitin 1574. Në këtë xhami i ka zhvilluar punimet edhe Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1878.[16]

---

[15] Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në gjuhen arabe në Jugosllavi*, (Përktheu nga serbokroatishtja Ismail Rexhepi), DI, Prishtinë, 2012, f. 311-319.

[16] Parim Kosova, "Objektet fetare islame në shërbim të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit", *Mesazhet e Lidhjes së Prizrenit në raport me realitetin shqiptar sot*, (Përmbledhje kumtesash nga tryeza shkencore-Prizren, 12 qershor 2007), DI, Prishtinë, 2010, f. 169-187.

Xhamia e Sinan Pashës dhe xhamia e Gazi Mehmet Pashës

Dy xhamitë e lartcekura, sot janë në gjendje të mirë, janë rinovuar dhe janë në listën e monumenteve të mbrojtura nga shteti, gjenden jo shumë larg njëra-tjetrës, bukurinë arkitektonike e të cilave e ka përvetësuar edhe shkrimtarin M. Kuteli, kur thotë se: *"Afër Xhamisë të Sinan Pashës, e të shkojmë ngadalë, nëpër disa rrugë shumë të ngushta e të drethuara (mua këto më pëlqejnë më shumë se rrugët monotonisht të drejta, të hapura me litar, të qyteteve të rinj) gjer te xhamia e Bajrakliut. Përpara kësaj xhamie me minare çuditërisht të hollë, si fije kallmër...është mirë të rish disa orë këtu në oborrin e Bajrakliut (dhe unë pata ndenjur, shumë radhë) se uji i çezmave dhe shushëllimi i vijës të preh, po ne sot kemi për të bredhur më".*[17]

M. Kuteli, jo vetëm se bënë vizita në monumente islame, siç edhe e përshkruan më lartë, por ky dijetar, ndihet mirë kur është në oborrin e një xhamie. Për më tepër, në xhaminë e Bajraklisë, përball bukurive që autori i sheh në oborrin e kësaj xhamie, ai preferon të qëndroj disa orë, sepse një vizitë kalimthi për një dijetar si M. Kuteli, në një monument të trashëgimisë kulturore, siç është xhamia, për shkrimtarin është e pamjaftueshme. Por, këtij monumenti, ajo që ia shton edhe më shume hijeshinë është *"uji i çezmave dhe shushëllimi i vijës"*. Po që se sot do të shkosh dhe ta vizitosh këtë monument të kulturës shqiptare në Prizren dhe qëndron në këtë oborr për disa orë, e sheh se shkrimtari ynë M. Kuteli, ka pasur shumë të drejtë dhe sa aktuale qëndrojnë fjalët e tij të shkruara dikur.

[17] Mitrush Kuteli, "Në Prizren...", f. 559-662.

Çezmat dhe minarja e Xhamisë së Bajraklisë

Teqetë

Qyteti i Prizrenit, në kuadër të pasurisë së trashëgimisë kulturo-historike ka edhe teqetë, nga të cilat, edhe sot e kësaj dite, disa sosh qëndrojnë. Kjo pasuri nuk ka mundur t'i ikte as M. Kutelit i cili shkruan: *"Sa qetësi në oborr! Një shatrivan, me ujë të kulluar, nën një pjergull. Një trëndafil i çelur, një zog që këndon....,varret e para janë varre jabanxhinjsh, miq të teqesë që i arriti vdekja aty. Varret e tjera janë të baballarëve të teqesë, dyke filluar me Sheh Osmanin, dhe pas tij, Sheh Ahmeti, Sheh Sinani e katër të tjerët".*[18] Hulumtimet tona na rezultojnë se teqeja e përmendur nga autori, është teqeja e tarikatit "Halveti" në Prizren, e njohur edhe ndryshe edhe si " Teqeja e Saraçhanes". Kjo teqe sot gjendet në qendër të qytetit prapa hotelit "Theranda" dhe sipas studiuesit N. Krasniqi është themeluar në vitin 1713 nga Sheh Osman Baba[19], emër i cili përmendet edhe nga M. Kuteli në përshkrimin e tij. Mund të thuhet se, sot kjo teqe është ndër më të vizituarat në Prizren.

[18] *Po aty,* f. 662.

[19] Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike*, IAP, Prishtinë, 2011, f. 203; Kadri Halimi, *Trajtime dhe studime etnologjike*, IAP, Prishtinë, 2000, f. 107-108; Metin Izeti, *Kllapia e tesavufit*, BFI-FSHI, Shkup, 2004, f. 145-146.

Oborri i Teqesë së Saraçhanes

Urat dhe mullinjtë

Qyteti i Prizrenit njihet në të kaluarën për një zhvillim ekonomik dhe se në këtë qytet janë ushtruar disa zeje të kohës, janë të njohura esnafet e Prizrenit dhe veprimtaria e tyre e dendur.[20] Gjithashtu, gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, Prizreni ishte i njohur edhe për eksportin e disa prodhimeve vendore, sidomos eksporti i drithërave zinte vendin e parë.[21] Eksporti i drithërave është edhe një tregues se ky produkt edhe është përpunuar në këtë qytet dhe se njëri nga ato vende ku janë përpunuar drithërat janë edhe mullinjtë, të cilët atëkohë janë vënë në lëvizje me anë të ujit. Meqë, Lumëbardhi kalonte përmes këtij qyteti, atëherë edhe mullinjtë, ishin ndërtuar pranë këtij lumi. Se mullinj ka pasur edhe pas Luftës së Dytë Botërore në këtë qytet, këtë e ruajnë në kujtesën e tyre edhe disa

[20] Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX),* ASHRPSH-IH, Tiranë, 1973, f. 107, 116.

[21] Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare,* ASHRPSH-IH, Tiranë, 1984, f.280.

banorë të kësaj ane. Sot, fatkeqësisht, në rrjedhën e Lumëbardhit, në qytetin e Prizrenit, nuk e ekziston ndonjë i tillë.

Por, në vitin 1943, M. Kutelit mullinjtë e shumtë me disa gurë në këtë qytet, ia kanë tërhequr vëmendjen, së bashku me ujin e "shkumëzuar" - siç e quan ai. Gjithashtu, urat e shumta mbi Lumëbardhë e deri te ura e fundit me drunj. Të gjitha këto, ai i përshkruan në këtë mënyrë: *"Ja, të kalojmë së bashku urën e gurtë me harqe venetike..., mos qëndroni fort këtë radhë në urat për të vështruar ujët e shkumbëzuar që rrjedh poshtë e as mullijt e shumtë. Pa fjalë se këta janë më të mirë, se ai i Xha Brahos të Shkumbanices. Kanë nga pesë e gjashtë gurë. Arrijmë ne ura e fundit-urë e drunjtë. Duhet t'a kalojmë".*[22] Ndërsa, sipas studiuesit H. Kaleshi në shekullin XIX, i cili i referohet Salnamesë (vjetarit) të vitit 1892, Prizreni kishte 5 ura materiali të fortë[23] dhe 125 mulli të cilët gjithë vjetin punojnë.[24]

Ekzistencën e mullinjve e potencojnë edhe disa nga të intervistuarit tanë që thonë se, prej hyrjes në Prizren nga Marashi e deri te rrjedha e Drinit të Bardhë ka pasur shumë mullinj, por tash ekziston vetëm një dhe njihet si "Mulliri i Tabakhaneve",[25] d.m.th. emri i tij është sipas lagjes ku ka ekzistuar dhe ku është sot ky mulli, por jashtë funksionit.

Duhet theksuar se "Ura e Gurit", simboli i Prizrenit, e rindërtuar, dhe disa ura të tjera, ekzistojnë edhe sot në Prizren gjatë rrjedhës së Lumëbardhit, por nuk ka urë prej druri. "Ura e Gurit" është prej monumenteve nën mbrojtjen shtetërore dhe është ndërtuar në fund të shekullit XV apo në fillim të shek. XVI.

---

[22] Mitrush Kuteli, "Në Prizren...", f. 661, 663.

[23] Hasan Kaleshi, "Shënime nga e kaluemeja e Prizrenit gjatë periodës turke", *Perparimi*, nr. 7-8, Prishtinë, 1961, f. 506.

[24] Hasan Kaleshi, "Vilajeti i Prizrenit II", *Perparimi*, nr. 3, Prishtinë, 1967, f. 277.

[25] Informatë nga Luan Koçbashliu(1950), arkeolog, bashkëpunëtor profesional në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren nga vitet 1975 deri më 2015, Prizren më 04. 4. 2017.

Ura e Gurit - në sfond xhamia e Sinan Pashës

Rrugët

"Sbresim, si pa qëllim, nëpër arabeskun e rrugëve të qytetit të cilin Zoti e dhuroj me ujra shumë..., nëpër disa rrugë shumë të ngushta e të drethuara (mua këto më pëlqejnë më shumë se rrugët monotonisht të drejta, të hapura me litar, të qyteteve të rinj)".[26] Edhe nga periudha e sundimit osman, por edhe më herët shkruhet për rrugët dhe oborret e shtëpive të ngushta të këtij qyteti,[27] në fakt, pjesa e vjetër e qytetit edhe sot ka rrugë të ngushta dhe disa prej tyre të shtruara edhe me kalldrëm. Sa u përket ujërave të shumta që i përmend M. Kuteli, studiuesit potencojnë se në shekullin XIX qyteti i Prizrenit kishte 150 çezme.[28]

[26] Mitrush Kuteli, "Në Prizren...", f. 661-662.

[27] Grup autorësh, *Kosova dikur dhe sot*, EP, Prishtinë, f. 931.

[28] Hasan Kaleshi, "Vilajeti i Prizrenit II...", f. 277.

"Pavarësisht ngushtive të rrugëve të qytetit, këto më pëlqejnë më shumë se rrugët monotonisht të drejta, të hapura me litar, të qyteteve të rinj" - shkruante M. Kuteli.

Përfundim

Kur flasim për trashëgiminë dhe kujdesin tonë ndaj saj, për trashëgiminë kulturo-historike të Prizrenit në veçanti dhe në hapësirën shqiptare në përgjithësi me disa përjashtime, shqetësimi i M. Kutelit, prore tingëllon shume aktual, kur thotë *"i shkel këmba dhe i bluan koha..."*. Është fakt se deri sot një pjesë të madhe të trashëgimisë, jo vetëm islame të Prizrenit, por edhe të qyteteve tjera, e ka shkelur dhe po e shkel vazhdimisht këmba, po e tret koha në mungesë të një përkujdesjeje adekuate institucionale.

M. Kuteli, edhe kur flet për varrezat, të vdekurit, për ujin dhe natyrën, zonjushat dhe zonjat, pothuajse në çdo përshkrim e përmend Zotin.

Përshkrimi i monumenteve mbivarrore, trashëgimisë kulturore etj., janë të trajtuara, pa paragjykime. Ky përshkrim duhet të jetë edhe një model për intelektualin e sotëm shqiptar, se si duhet shikuar e kaluara shpirtërore e materiale e vendit të tij, pa dallime religjioze.

Monumentet mbivarrore, të përmendura nga M. Kuteli, të cilat janë ruajtur deri në ditët e sotme, por edhe të tjerat të ngjashme për nga vjetërsia dhe vlerat kulturore etj., do të duhej që, sa më parë, nga institucionet përkatëse të merren masa dhe të futen në listën e objekteve të mbrojtura nga shteti.

Shkrimtari, sado që është shkolluar jashtë kufijve të Shqipërisë, ishte njoftuar edhe me kultura të tjera, ballkanike e evropiane, megjithatë ajo tradicionale e vendit të tij mbetet e admiruara, qoftë veshja, trashëgimia kulturo-historike, folklorike etj. Ai herë-herë shpreh brengën e tij se si e kaluara po humbet përballë dallgëve të kohës.

Për mendimin tim, ky përshkrim i qytetit të Prizrenit nga ana e M. Kutelit, është nga përshkrimet më të mira që u shkrua deri në këtë kohë nga një shkrimtar shqiptar, është panorama më e mirë që autori ia ka ofruar lexuesit për Prizrenin, bukuritë e tij, pasurinë materiale dhe shpirtërore.

Nuridin AHMETI

ISLAMIC MONUMENTS IN MITRUSH KUTELI´S PRIZREN IN 1943

(Summary)

Prizren is a town of great historical importance. A lot has been written about it by many diplomats and foreign travellers who had been there (G. V. Hahn, baron Nopça, E. Durham, I. Jastrebov). The latter highlighted different aspects of the town of Prizren.

Among the writings describing this town, there is a beautiful essay which contains very interesting information about it, written by our well-known writer Mitrush Kuteli, in May 1943, called "In Prizren, among the dead and the living".

We have compared the observations and the information presented by Mitrush Kuteli on this town and its cultural-historical heritage with the situation nowadays. Consequently, we can present the state of cemeteries and the cultural-historical heritage in this town nowadays.

نور الدين أحمدي

الآثار الإسلامية في بريزرن و ميتروش كوتيلي ١٩٤٣

(خلاصة البحث)

تمت وصف مدينة بريزرن، وهي إحدى المدن الألبانية التاريخية ، عدة مرات من قبل الدبلوماسيين والزوار والرحالة الأجانب والمارة من أمثال: Baron ، GV Hahn Nopaca، الآنسة E. Durham ، I. Jastrebov وما إلى ذلك ، والذين كتبوا وألفوا مشيرين إلى جوانب مختلفة لهذه المدينة.

ولكن تمت إضافة إلى هذا الوصف لمدينة بريزرن ، في عام ١٩٤٣، مقال مكتوب بجمالية عالية، بإحساس خفي وباهتمام كبير من كاتبنا المشهور ميتروش كوتيلي ، بعنوان "في بريزرن ، بين الموتى والأحياء "، والمؤلف في مايو عام ١٩٤٣ .

من أجل الدراسات الاستقصائية وبيانات المؤلف ميتروش كوتيلي حول بريزرن وتراثها الثقافي والتاريخي ، قمنا بفحص بيانات من الأدبيات ذات الصلة من المؤلفين الألبان وعلى ضوء هذه البحوث سنقدم الإجابة حول حالة المقابر والتراث الثقافي والتاريخي لهذه المدينة، التي وصفها الكاتب ميتروش كوتيلي. هل تم الحفاظ عليها اليوم في هذه المدينة ، والتي كتبها الكاتب في عام ١٩٤٣ وهلم جرا.

Filip HITTI

EMIRATI OMEJAD NË SPANJË

Ikja dramatike[1]

Në vitin 750, abasidët, pasi përmbysën dinastinë Omejade,[2] erdhën në pushtet. Vetëm një nga kjo dinasti, Abdurrahman ibën Muavije[3], nipi i Hashimit, kalifit të dhjetë të Damaskut, shpëtoi nga duart e tyre. Në atë kohë, Abdurrahmani ishte vetëm 20 vjet dhe për pesë vjet brodhi i maskuar nëpër Palestinë, Egjipt dhe Afrikën Veriore. Shpëtimi i tij disa herë nga sytë e zgjuar të spiunëve abasidë, përbënë një nga episodet më dramatike në analet e historisë arabe. Ikja e tij filloi nga një tendë beduinësh, në bregun e djathtë të lumit Eufrat, në të cilin Abdurrahmani kërkoi strehim.

Një ditë, befasisht, u lajmëruan flamujt e zi abasidë, në afërsi të kësaj tende. Abdurrahmani së bashku me vëllain e tij 13 vjeçar kërcyen në lum. Vëllai i tij, duke qenë notues i dobët dhe duke iu besuar premtimeve të ndjekësve, u kthye nga gjysma e lumit, por më pas u ekzekutua, ndërsa,

---

[1] Filip Hitti, Istorija arapa, Bot. II, Sarajevë, 1973; (Ky punim vazhdon nga Edukata Islame, Nr. 111, vit. 2016).

[2] Shih, Istorija arapa, f. 205-316

[3] Është deformuar nga kronistë të vjetër krishterë në Benemavgius.

Abdurrahmani vazhdoi të notonte derisa arriti në bregun e kundërt të lumit.

Derisa me vështirësi depërtoi në rrugën e tij drejt jugut, atij në Palestinë iu bashkua edhe liridashësi i tij i besueshëm dhe i aftë, Bedriu. Në Afrikën Veriore, me mund të madh i shpëtoi vdekjes nga dora e udhëheqësit, Jusuf el Fikriut. Duke u endur nga fisi në fis, nga qyteti në qytet, pa miq e pa të holla, ky i dëbuar, më në fund arriti në Ceutë (755). Dajallarët e tij ishin berberë dhe nisur nga ajo afërsi, ata i ofruan strehim. Nga aty, Bedriun e dërgoi përtej ngushticës për të biseduar me çetat siriane nga Damasku dhe Kinesrini, të cilat ishin vendosur në Elvir dhe Jaen.

Shumë udhëheqës, të cilët më herët ishin mbrojtësit e dinastisë omajade, me gëzim e pritën rastin për t'u tubuar nën udhëheqjen e njeriut, në emrin e të cilit të gjithë sirianët u betuan. Sirianët i përfituan jemenasit për çështjet e tyre, jo aq për atë, që këta të fundit e donin Abdurrahmanin, por për atë që ata e urrenin udhëheqësin e tyre, titullarin Jusuf. Anija u dërgua për ta bartur udhëheqësin e ri. I gjatë, i hollë, me tipare të ashpra dhe me flokë të buta e të zeza, ky pasardhës i Benu Umejëve, i përshkuar me frymën avanturiste dhe i udhëzuar në traditën më të mirë të familjes së tij, së shpejti u bë sundues në një situatë mjaft të komplikuar. Sundimtari Jusufi, në përpjekje për ta kënaqur pretendentin e ri, i ofroi dhurata të shumta dhe premtime, përfshirë këtu edhe dorën e vajzës së tij. Qytetet jugore, njëra pas tjetrës, filluan t'ia hapin dyert e tyre, pa kurrfarë rezistence. Arhidona, ku ishin vendosur repartet e Jordanit, provinca e Sidonit, në të cilën jetonte reparti palestinez dhe Sevila, në të cilën jetonin arabët nga Humusi, të gjithë e pritën krahëhapur trashëgimtarin e fronit mbretëror.

Pushtimi i Kordovës

Derisa Abdurrahmani me ithtarët e tij, po përparonte me shpejtësi kah Kordova, Jusufi shkoi në drejtim të Sevilës. Para fillimit të luftës, është vërejtur se Abdurrahmani nuk e kishte flamurin e tij të luftës. Menjëherë pas kësaj, bajraktari i jemenasve të Sevilës, Ibën Sabbah el Jahsubi, e improvizoi flamurin duke e lidhur turbanin e gjelbër rreth kokës së shigjetës. Thuhet se pikërisht fillim të tillë kishte flamuri omajad në Spanjë.

Më 14 maj 756, në mëngjes, dy ushtritë, duke u gjendur karshi njëra tjetrës, e filluan luftën në brigjet e lumit Gavdalkivivir. Megjithëse shumica e njerëzve në të dyja anët, ishin me kuaj, që në atë kohë ishte e jashtëzakonshme në Andaluzi, Abdurrahmani duke vërejtur se disa ithtarë të tij frikësoheshin se ai mund të dezertonte, kërkoi me ngulm që ta ndërronte kalin e tij me një mushkë plakë, e cila ishte pronë e Ebu Sabahut. Për rezultatin e luftës nuk u prit shumë. Jusufi së bashku me kryekomandantin e tij, shpëtimin e tij e kërkoi në ikje. Në Kordovë u shpallë amnistia e përgjithshme. Për Abdurrahmanin nuk ishte e lehtë të ndalonte plaçkitjen e kryeqytetit dhe të vënte kontrollën e tij bujare mbi pallatin e udhëheqësit të mundur.

Konsolidimi dhe pacifikimi i Spanjës myslimane

Sundimi mbi Kordovën, nuk e tërhoqi domosdoshmrisht sundimin edhe mbi tërë Spanjën myslimane. Në veri, udhëheqësi i arratisur, Jusufi, vazhdonte të nxiste trazira, derisa përfundimisht u vra në afërsi të Toledos. Qyteti u dorëzua në vitin 764. Kryengritjen e jemenasve dhe shiitëve, të cilat i nxisnin agjentët abasidë, kurrë nuk pushuan. Janë dashur afër dhjetë vjet për t'u shtypur kryengritjet berbere. Berberët kurrë nuk ua falën udhëheqësve të tyre arabë, faktin pse e përvetësuan pjesën më të mirë të tokës së nënshtruar. Ndihmësit e mëparshëm të emirit të ri, tashmë u bën armiqtë e tij, andaj edhe ndaj tyre është dashur të ndërmerren masa emergjente. Shehu i Sevilës, flamuri dhe mushka e të cilit ia siguruan fitoren Abdurrahmanit, e humbi kokën në një kryengritje. Një fat të njëjtë, i ndodhi edhe Bedrit, dorës së djathtë të Abdurrahmanit.

Armiqtë e brendshëm kanë pasur aleatët të tyre të jashtëm. Në vitin 761, kalifi abasid, El Mansuri, mori guximin për ta emëruar El Alaë ibën Mugithin për guvernator të Spanjës. Pas dy vjetësh, El Alaut i është prerë koka dhe pasi që i është konservuar në krip dhe kamfur (parfum) u mbështoll me flamur të zi, dhe me vendim të emirit, i është dërguar El Mansurit, derisa ishte në Mekë në haxhillëk. El Mansuri, i cili me një rast e kishte quajtur Abdurrahmanin *"Skifter të fisit Kurejsh"*, tani brohoriti: "Falënderimi i qoftë Allahut, që në mes nesh dhe armikut të tillë, e ka vendosur detin." Për Abdurrahmanin tregohet se e ka përgatitur flotën për ta

marrë Sirinë nga duart e abasidëve, por problemet e brendshme e detyruan të qëndronte në vend.

Thirrja e Karlit të Madh

Në vitin 777, aleanca e rrezikshme e krerëve arab në vendlindje, e udhëhequr nga guvernatori i Barcelonës dhe dhëndri sykaltër i Jusuf el Fikriut, e thirrën Karlin e Madh, të cilin ata mbase e konsideronin si aleat të kalifit abasid, përkatësisht të armikut të natyrshëm të Abdurrahmanit, për t'u bashkuar me ta, kundër emirit të ri në Spanjë. Karli i Madh përparoi nëpër moçalet e Spanjës veriore, deri në Saragosa, por u detyrua të tërhiqet kur qyteti në fjalë, para hundëve të tij ia mbylli dyert dhe armiqtë e brendshëm në vend ia rrezikuan sundimin e tij. Në "kthimin e tij të pikëllueshëm" nëpër grykat e Pirinejeve, ushtrinë franke e sulmuan pas shpine baskët dhe malësorët e tjerë, për çka ajo pësoi humbje të mëdha në njerëz dhe pajisje. Në mesin e komandantëve të cilët u vranë ka qenë edhe Rolandi, fitorja e së cilit u përjetësua në Chanson de Roland (Poema për Rolandin), jo vetëm margaritarë të letërsisë së vjetër franceze, por edhe një nga poezitë më të bukura epike të kohës së mesjetës në përgjithësi.

Emirati i pavarur

Në procesin e nënshtrimit të kundërshtarëve të tij të shumtë, Abdurrahmani formoi një ushtri me disiplinë të lartë dhe të ushtruar mirë nga më tepër se 40.000 plaçkitës berberë, të importuar nga Afrika, në besnikërinë e së cilëve tani mund të mbështetej për ta mbajtur fronin e tij. Ai e dinte se lojaliteti i një trupe të tillë ushtarake, mund të ruhej vetëm me pagesa bujare. Në vitin 757, e ndërpreu hytben-ligjëratën, e cila deri atëherë mbahej në emër të kalifit abasid, ndonëse ai vetë nuk e mori titullin kalif. Ai dhe pasardhësit e tij, deri te Abdurrahmani III, u mjaftuan me titullin e emirit, edhe pse kanë sunduar në mënyrë të pavarur. Nën sundimin e Abdurrahmanit I, Spanja në mënyrë të tillë, ka qenë provinca e parë e cila hoqi prej vetës sundimin e kalifit të pranueshëm islam.

Kur i konsolidoi territoret e nënshtruara dhe në to përkohësisht e vendosi paqen, Abdurrahmani filloi të merrej me punë të kohës së paqes, në të cilat u tregua gjithashtu i madh, sikurse në shkathtësitë luftarake. Ai i zbukuroi qytetet e çifligjeve të tij, ndërtoi ujësjellës, me të cilin furnizoi kryeqytetin me ujë të pijshëm. Filloi të ndërtonte murin rreth qytetit, kurse për vete, jashtë Kordovës, e ngriti Mun'jetu-Rrusafën[4], duke e imituar pallatin e paraardhësit të tij Hishamit në verilindje të Sirisë. Në këtë pallat, ai solli ujin dhe gjithashtu edhe pemë ekzotike, si pjeshka dhe shega.[5]

Dy vjet para vdekjes së tij, në vitin 788, Abdurrahmani i vuri themelet e xhamisë së madhe në Kordovë. Kur u përfundua dhe u zgjerua nga pasardhësit e tij, xhamia e Kordovës u bë si "Qabe e Islamit Perëndimor." Me shumë shtylla të stolisura dhe me oborrin e jashtëm të gjerë, kjo godinë monumentale, është shndërruar në katedrale krishtere, me rastin e rimarrjes nga ana e Ferdinandit III, në vitin 1236, por megjithatë, deri më sot, ajo ka mbetur e njohur me emrin "La Mezquita" (xhamia). Përveç xhamisë, kryeqyteti është mburrur edhe me urën në Gvadalkviri, e cila më vonë ishte vazhduar në shtatëdhjetë harqe. Interesimi i themeluesit të regjimit omejad, nuk është kufizuar vetëm në të mirat materiale të popullit. Ai në mënyra të ndryshme është përpjekur për të krijuar një tip nacional, nga arabët, sirianët, berberët, numigjanët, arabët spanjoll dhe gotët, detyrë mjaft e vështirë dhe e pashpresë. Në më tepër se një kuptim, ai i vuri themelet e lëvizjes shpirtërore, e cila nga shekulli IX-XI, e bëri Spanjën islame, njërën nga sy qendrat e kulturës botërore.

Dinastinë të cilën e themeloi Abdurrahmani I, historianët arab e quajnë El Dahil (ardhëse). Ajo ka sunduar 275 vjet (756-1031). Ngritjen më të lartë të saj, e arriti nën udhëheqjen e emirit të tetë, Abdurrahmanit IV (912-961). Në realitet, sundimi i Abdurrahmanit shënoi zenitin e epokës arabe në Gadishull. Gjatë tërë sundimit të dinastisë së omejadëve, Kordova ka qenë kryeqytet dhe ka përjetuar madhështi të jashtëzakonshme, si konkurrent perëndimor i Bagdadit.

---

[4] Do të thotë, park, kopsht.

[5] Hurmat e para i kanë sjellë fenikasit, arabët i sollën lloje të reja, të cilat ata i shumonin duke i mbëltuar (me filiza) ndërsa kultura e hershme është bazuar në tërësi në kultivimin e hurmave me anë të farës.

Kalifati omajad filloi të dobësohej pas vdekjes së sunduesit të talentuar El Haxhib el Mensur (1002), i njohur si "Bizmarku i shekullit të dhjetë" dhe ndoshta burrështetasit më të madh dhe komandantit të Spanjës arabe, ndërsa ky sundim ka përfunduar në vitin 1031. Në rrënojat e tij u ngritën mbretëritë e vogla dhe principata të shumta, prej së cilave shumica kanë qenë vazhdimisht të gatshme për luftë, njëra kundër tjetrës, dhe në fund të gjithë ata iu nënshtruan fuqisë më të fortë të krishterëve vendas, sidomos atyre në veri. Me rënien e Granadës 1492, u zhdukë përgjithmonë edhe gjurma e fundit e sundimit mysliman në Gadishullin Iberik.

Sjellja me të krishterët

Detyra kryesore e Abdurrahman ed Dahilit edhe më tutje ka qenë pacifikimi i tokës dhe zgjidhja e problemeve të ndërlikuara, të cilat dilnin nga karakteri i dyfishtë i banorëve, të krishterëve dhe myslimanëve, si dhe i zilisë në mes myslimanëve të vjetër arab dhe myslimanëve të kthyer të rinj, spanjoll. Nga fillimi, politika së cilës i janë përmbajtur pushtuesit arab ndaj nënshtetasve të tyre, nuk ka ndryshuar shumë nga politika, të cilën ata a zbatonin në vende të tjera të nënshtruara. Tatimi personal (xhizja) e detyrua si obligim vetëm për të krishterët dhe hebrenjtë. Gratë, fëmijët, pleqtë, të verbëritë, murgjit dhe të sëmurët nga sëmundjet kronike, ishin të përjashtuar nga tatimi. Tatimi i tokës (haraçi), i cili në projekt hipte në njëzetë për qind nga të ardhurat, gjithashtu është mbledhur nga këta dhimmij (raje), mirëpo ndryshe nga tatimi personal, në të nuk ka ndikuar ndërrimi i fesë së tatim obliguesit. Toka e fituar në luftë, bashkë me pasurinë e tokës së kishave dhe të aristokratëve, të cilët kishin ikur nga Spanja në kohën e luftës, ka qenë e konfiskuar dhe e ndarë ndërmjet disa-pushtetarëve. Nga ky konfiskim i tokave, një të pestën e merrte në pronësi shteti, i cili nga punuesit arkëtonte vetëm një të tretën e të korrurave. Një sasi e caktuar e tokave shtetërore më vonë u ndanë si feude, ndërmjet sirianëve dhe arabëve, të cilët ishin sjellë për t'i shuar kryengritjet. Fjalia *"Nuk ka skllavërim në Islam"*, nuk është praktikuar në mënyrë detyruese në skllavin kur është bërë mysliman. Bashkësitë e krishtera, nuk kanë qenë të penguara në kryerjen e obligimeve të tyre fetare dhe u janë vërë ligjet e tyre kishtare dhe gjykatësit vendor, juridiksioni i së

cilëve, natyrisht se nuk është shtritë në ato raste në të cilat kanë qenë të përzier myslimanët, si dhe në kundërvajtjet e bëra kundër fesë islame.

Prandaj, në përgjithësi, okupimi mysliman i Spanjës nuk i ka ngarkuar me kurrfarë barre të padurueshme banorët vendor. Në një pikëpamje, siç thotë Dozi: "Okupimi arab, madje ka qenë përfitim për Spanjën." Ai e theu fuqinë e grupeve të privilegjuara, ndër të cilat kanë qenë aristokracia dhe kleri, e përmirësoi gjendjen e klasës së skllaveve dhe iu dha pronarëve të krishterë të drejtat e tyre, siç është tjetërsimi i pasurisë, në çka nuk kanë pasur të drejtë nën sundimin vizigot.

Renegatët në ushtri

Edhe përkundër të gjithave, të krishterët shpejtuan në islam. Në rajonet kodrinore dhe fshatare, ata iu përmbaheshin idealeve të vjetra nacionale dhe kulturës nacionale, ndërsa në qytete jo. Si neo-mysliman, ata për vete e përbënin klasën shoqërore, të cilët arabët e quanin Muvel-ledun (njëjës, muvel-led, përvetësim, pranim), ndërsa spanjollët Muladies. Me kalimin e kohës, këta të kthyer të rinj, u bën pjesa më e pakënaqur e banorëve. Radhët e tyre kanë qenë të plotësuara, kryesisht nga fermerët dhe njerëzit e lirë, si dhe pasardhësit e tyre, të cilët kishin punuar tokën ose kishin punuar me mëditje. Disa prej tyre edhe pse e shprehnin islamin, ishin "krishterë të fshehtë", mirëpo të gjithë e dinin mirë ligjin e qartë dhe të pamëshirshëm të arratisjes nga islami, i cili përcaktonte dënim me vdekje. Myslimanët arabë nuk kanë vepruar me këta Muvel-ledë, si të barabartë me vetveten, edhe pse disa prej tyre kanë qenë me prejardhje aristokrate. Deri në fund të shekullit të parë, pas okupimit, këta u bënë shumicë e banorëve në shumë qytete, në të cilat ata ishin të parët që rrëmbyen armët kundër rendit të pranuar.

Trazirat qytetare

Periferia jugore e Kordovës, e cila quhej Er-Rrebed, ka qenë kryesisht e banuar me myslimanë të cilët nga banorët e krishterë kanë qenë renegatë. Disa prej tyre kanë qenë nën ndikimin e studentëve dhe profesorëve të teologjisë dhe jurisprudencës (fakihëve). Të tillë ka pasur afër katër mijë

në qytet. Derisa ka sunduar Hishami I (788-796), djali i devotshëm dhe i vyeshëm i Abdurrahmanit, nuk kanë ekzistuar shkaqe të drejtpërdrejta për trazira. Mirëpo, gjatë sundimit të pasardhësit të Hisham el Hakemit i (796-829), i cili ka qenë i shfrenuar dhe i dhënë pas gjahut, situata ndryshoi. Kritikat nuk ishin të drejtuara vetëm ndaj El Hakemit mendjelehtë, por kishin të bënin edhe me truprojat e tij, të përbërë kryesisht nga zezakët dhe mercenarët të tjerë të huaj, të cilët nuk dinin arabisht (nga kjo rrjedh ofiqi i tyre El-hurs, memec). Trazirat filluan kur një ditë emirin, duke kaluar rrugëve, masa e sulmoi me gurë, me lejimin e njëanshëm të teologëve. Shtatëdhjetë e dy prijës, për të cilët më vonë u vërtetua se janë përzier në komplotin për rrëzimin e El Hakemit, kanë qenë të kapur dhe të gozhduar në kryq. Në kuartin e renegatëve, pandërprerë ndërroheshin kryengritjet, të cilat arritën kulmin në vitin 814, me një grusht shtet serioz, nën udhëheqjen e një berberi. Masa e zemëruar e mbyllën El Hakemin në pallat, por në fund, kalorësia e tij arriti t'i mposhtë kryengritësit. Të gjithë banorët kanë qenë të urdhëruar që në afat prej tri ditësh të evakuohen nga Spanja, ndërsa kuarti u rrafshua me tokë. Askujt në atë vend nuk i është lejuar të ndërtojë më.[6] Tetëqind familje gjetën strehim në Marok, sidomos në qytetin Fes, të cilën në atë kohë Idrizi II, pasardhës i Aliut r.a., e ndërtoi për kryeqytet të vetin. [7] Pesëmbëdhjetë mijë të tjerë zbarkuan në Aleksandri. Refugjatëve u shkoi për dore që udhëheqjen e qytetit ta mbajnë në duart e veta, deri në vitin 827, kur një komandant i ushtrisë së kalifit El Me'mun i detyroi të ikin. Për vendbanimin e ri, të dëbuarit e zgjodhën Kretën, ku një pjesë e saj ende i takonte Perandorisë Bizantine. Ata e nënshtruan tërë siujdhesën dhe udhëheqësi i tyre e themeloi dinastinë, e cila ka sunduar Kretën, derisa nuk u pushtua nga grekët në vitin 961.

[6] Si kujtim me këtë ngjarje sensacionale, El- Hakemi e ka marrë llagapin Er-Rebed (paralagje) Ibnul - Abbar, Hulle, fq. 38.

[7] Kuarti në të cilin u vendosën ata ende quhet Idvetul - Endelus, bregu i Andalusianëve.

Masakra në hendek

Duhet theksuar se disa myslimanë spanjollë kanë qenë aleatë të çmueshëm të arabëve dhe kanë lejuar të jenë të shfrytëzuar kundër bashkëfshatarëve të tyre të mëhershëm. Kështu ka qenë rasti me Amrus ibën Jusufin, të cilin El Hakemi në vitin 807, e emëroi për guvernator të Toledos, "qytetit krenar mbretëror" [8], i cili në sytë e banorëve të nënshtruar vendor ka qenë qyteti më i rëndësishëm edhe në pikëpamje politike dhe kishtare. Toledo nën sundimin mysliman ka qenë jo i qetë, renegatët dhe të krishterët kanë qenë vazhdimisht në kryengritje. Për nder të vizitës së trashëgimtarit të fronit, katërmbëdhjetë vjeçar, Abdurrahmanit, djalit të El Hakemit, Amrusi me sugjerimin e El Hakemit përgatit gosti, në të cilën i thirri qindra toledasë të famshëm. Në oborrin e kështjellës së re të sapondërtuar të tij, shtrihej hendeku i gjatë, nga i cili është nxjerrë dheu për ndërtimin e kësaj kështjelle. Përballë hendekut, Amrusi e kishte vendosur xhelatin. Posa të hynin mysafirët në oborr, shpata menjëherë do të binte në qafë të tyre. Kufomat kanë qenë të hedhura në hendek. Shumë vite pas kësaj masakre në hendek, Toledo kryengritëse ka qenë qytet i qetë, por të tjerat qytetet si p.sh. Merida, edhe më tej u rebeluan deri me sundimit e Abdurrahmanit I, luftëtarit energjik të bashkimit omejad spanjoll dhe përfaqësuesit të flaktë të muzikës dhe astronomisë. [9]

Si emir, Abdurrahmani II (822-852), i cili më vonë u quajt "El Evsat"[10], ka shkëlqyer nën ndikimin e katër personaliteteve, një gruaje, një shërbëtori (të kastruar), një teologu dhe një këngëtari. Gruaja ka qenë bashkëshortja e dashur e tij, sulltanesha (mbretëresha) Taruba, intrigante e vërtetë. Shërbëtori ka qenë robi i talentuar i tij, Nasri, oborrtar mbretëror, i biri i një spanjolli dhe mik i mbretit. Teologu nuk ka qenë askush tjetër pos berberit, udhëheqësi i masakrës së renegatëve në Korodovë, Jahja ibn

[8] Urbs Regia, të Isidor Pacensisë "Del Chronicion" në Espana sagrada: theatro geographiea - historiea de la iglesia de Espana, bot. Fr. Henrique Florez, vol. VIII, fq. 366.

[9] Emirët Omajadëve të Kordovës: 1. Abdurrahmani I (756-788), 2. Hishami I (788-796), 3. Hakemi I (796-822), 4. Abdurrahmani II (822-852), 5. Muhamedi I (852-886), 6. El- Mundhiri (886-888), 7. Abdullahu (888-912), 8. Abdurrahmani III (912-929), ndërsa kalifë 929-961.

[10] Do të thotë i mesmi, ngase ka ardhur në mes Abdurrahmanit II dhe Abdurrahmanit III.

Jahjau (vdiq në vitin 849) nga fisi Masmud, nxënës i imam Malik ibën Enesit, nga Bagdadi dhe njeri përgjegjës për futjen e shkollës juridike malikite në Andaluzi. [11]

Kjo shkollë u përforcua saqë njerëzit e atjeshëm zakonisht flisnin: "Ne dimë vetëm për librin e Allahut dhe për përmbledhjen e Malikut, Muvettain.[12] Këngëtari ishte një tenor persian, Zirjab[13], i cili ka qenë i lindur në Bagdad. Zirjabi ka qenë ndër ata muzikantë, të cilët e zbukuronin oborrin mbretëror të Harun Reshidit dhe djemve të tij. Ai, aty u dallua jo vetëm si artist, por edhe si shkencëtar dhe poet, dhe në atë mënyrë ka nxitur xhelozinë e mësuesit të tij Is'hak el Mevsiliut, dhe për këtë arsye ka ikur më së pari në veriperëndim të Afrikës. Duke dëshiruar që Kordovën ta bëjë Bagdad të dytë, Abdurrahmani, i cili mbante oborr mbretëror luksoz dhe i imitonte salltanatet e tepruara të Harunit, doli vetë me kalë nga kryeqyteti, për ta pritur këngëtarin e ri. Prej tij, ai ka marrë çdo vit nga 3000 dinarë dhe ka fituar pronë në Kordovë në vlerë të 40.000 dinarëve. Ai së shpejti i la nën hije të gjithë muzikantët e tjerë në vend. Përveç asaj që ia përshkruanin, ai i dinte përmendësh fjalët dhe melodinë e 10.000 këngëve. Njësoj sikur edhe muzikantët e tjerë, ai pretendonte se xhini ia tregonte në ëndërr. Zirjabi është dalluar si poet origjinal, si astronom dhe si gjeograf. Aq më tepër, ai u tregua, spiritual dhe argëtues, saqë shumë shpejtë u bë figura më e popullarizuar në shoqërinë më të lartë të asaj kohe, madje edhe si modelist. Deri atëherë janë bartur flokët e gjata, të ndara në ballë, ndërsa tani i shkurtonin në ballë. Deri atëherë uji është pirë nga enët metalike, ndërsa tani me gotë qelqi, disa ushqime në mesin e së cilave shpargu, nuk kanë qenë të popullarizuara, ndërsa tani ajo u bë më e dashura, sepse ashtu ka dashur Zirjabi.

[11] Maliku sipas Hallikanit, Jahjan e ka quajtur "njeri të urtë" (akël) të Andaluzisë, ngase ka qëndruar ne vend të vet për ta dëgjuar ligjëratën e imamit derisa elefanti kalonte rrugës, kurse të gjithë nxënësit tjerë kanë vrapuar për ta parë.

[12] Makdisi fq. 238.

[13] Pers, zer "gold + ab "ujë" llagapi i Ebu el Hasan Alije bin Nafije, Ikd, vol. III, fq. 241, e quan Zirjabin skllav të zi.

Konkurrimi për vdekje martire

Para fundit të sundimit të Abdurrahmanit, studimi i gjuhës, i letërsisë, fesë dhe hapja e institucioneve të tjera të pushtuesve, kanë qenë aq të fuqishme, saqë një numër i madh i qytetarëve të krishterë u arabizuan, edhe pse në realitet nuk ishin të islamizuar. Të flakëruar nga shkëlqimi i civilizimit arab dhe të vetëdijshëm për inferioritetin e tyre në arkitekturë, poezi dhe në shkencë, të krishterët shumë shpejt filluan t'i përshtaten mënyrës së jetesës arabe. Imituesit e tillë, u bënë shpejtë të shumtë në numër, aq sa ata tashmë e përbënin klasën e veçantë shoqërore me ermin Mozarapi.[14] Spanja ka qenë vendi i fundit evropian, i cili ka kaluar në krishterëm. Disa vise fshatare të saj, ende kanë qenë pagane në kohën e pushtuesve mysliman, ndërsa arabizmi i tyre vizigot, ngjasonte me krisologji në doktrinën myslimane. Një shkrimtar bashkëkohor i krishterë, vajtonte pse laikët e krishterë po largoheshin nga veprat e etërve latinë, ngase janë helmuar me oratorinë arabe. Flitet se në vitin 724, Ivani, peshkopi i Sevilës, e ka reviduar përkthimin arab të Biblës për nevojat e të krishterëve të arabizuar dhe maurëve.

Si reaksion i kësaj tendence të arabizimit, tani shfaqet lëvizja e çuditshme ndërmjet fanatikëve të krishterë të Kordovës. Rezultat i kësaj lëvizje ka qenë vdekja e vetë dëshirueshme martire e një numri të konsiderueshëm të burrave dhe të grave. Udhëheqësi shpirtëror i lëvizjes ka qenë një prift asket, Eulogije, të cilin e ka ndihmuar miku i pasur dhe më vonë biografi i tij Alvaro. Asgjë më shumë nuk ka mundur t'i kristalizoj ndjenjat e lëvizjes sesa ekzekutimi i një prifti të Kordovës, me emrin Perfekt, në muajin Ramazan, për shkak se kishte sharë Muhamedin dhe e kishte mallkuar Islamin. Të udhëhequr nga peshkopi i Kordovës, populli menjëherë e shpalli të shenjtë Perfektin dhe filluan t'i përshkruanin mrekullitë. Ata flisnin se, a nuk është ai që para ekzekutimit të tij ka profetizuar vdekjen e drejtpërdrejtë të Nasrit, oborrtarit të kastruar dhe mbikëqyrësit të ekzekutimit. Duket se Nasri ishte besatuar me Tarubën për ta helmuar burrin mbretëror të saj. Tarubja donte që t'ia siguronte arritjen në fron djali të saj Abdullahut në dëm të Muhamedit (më të madhit ndër katër-

[14] Nga arab. *musta'rib*, njeriu që ka pranuar gjuhën arabe dhe zakonet.

dhjetë e pesë djemve të Abdurrahmanit), të cilin e kishte lindur një tjetër grua. Abdurrahmani e mori vesh për planin dhe kur Nasri ia solli gotën e qelqit, duke deklaruar se në të gjendet ilaç i mrekullueshëm, sundimtari e urdhëroi që ai ta shijonte i pari atë.

Pak pas rastit të Prefektit, një prift me emrin Isaak u paraqit para kadiut me arsyetimin se dëshiron të kalojë në Islam dhe filloi ta mallkonte tmerrësisht Muhamedin. Edhe atij, sikur Perfektit i është prerë koka dhe shpejtë edhe ai u shpall i shenjtë. Atëherë filloi gara. Kleri dhe laikët bënin gara në blasfemi (fyerje) të Islamit, ngase me siguri prisnin që t'i arrinte dënimi i pashmangshëm, për të cilin ata e dinin mirë. Në këtë mënyrë 11 veta e pësuan vdekjen si "martirë", në afat të shkurtër prej dy muajsh.

Flora dhe Eulogjija

Me sugjerimin e Abdurrahmanit, peshkopët me ngurrim mbajtën një mbledhje, të cilët përkundër protestës së Eulogjisë, ua ndaluan të krishterëve nga tani që pretendonin një lloj të tillë vdekjeje të shenjtë. Mirëpo kjo nuk solli fare dobi. Në fund erdhi në rend e reja e bukur, ithtarja e Eulogjisë, Flora, vajza e nënës së krishtere dhe e babait mysliman. Bashkërisht me murgeshën Marie, e cila ishte motra e një prifti të ekzekutuar më herët, Flora iu nënshtrua sprovave dhe e fyeu Pejgamberin, dhe për këtë shkak, një kadi nga mëshira, vetëm e futi në burg. Tani Eulogjije, i cili gjithashtu ka qenë i burgosur dhe ka kultivuar dashuri të pastër e të papërlyer ndaj Florës, e përdori tërë mjeshtërinë e tij të oratorisë së bindjes, për ta trimëruar vajzën e dashur dhe shoqen e saj, sepse filluan të luhateshin në martirizimin e zjarrtë të tyre për të shkuar në litar. Vajzat martire, nuk deshën që publikisht t'i tërheqin fyerjet dhe u dënuan me vdekje martire, më 24 tetor 851. Kjo dëshirë krishtere për vetëflijim, nuk pushoi derisa nuk e likuidoi edhe vetë Eulogjinë, peshkopin e atëhershëm të Kordovës, në vitin 859, Muhamedi I (852-886), i cili inauguroi politikën e reprezaljeve të rrepta. Një lloj të tillë të vdekjes martire e gjetën 44 persona.

Kryengritjet në krahina

Ka pasur mjaft trazira edhe të llojeve të tjera, në realitet jo ashtu fantastike, por për këtë me karakter më serioz. Në rend të parë, as Muhamedi, as dy djemtë e tij trashëgimtar, El Mundhiri (886-888) dhe Abdullahu (888-912) nuk përfaqësonin traditën më të mirë të tolerancës, e cila e karakterizonte dinastinë omejade. Përveç kësaj, vinin edhe vështirësitë e zakonshme të tjera përcjellëse të ardhjes në fron, i cili sipas praktikës së dinastive myslimane, i takonte më të vjetrit ose më të afërmit anëtar të familjes sunduese. Pas qeverisjes e cila nuk zgjati as dy vjet të plota, El Mundhirin, me nxitjen e trashëgimtarit të tij, e helmoi me thikë. Ndërkohë vazhduan revolucionet e muaveledëve dhe mozarabëve në të gjitha viset e sunduara, dhe shumë shtete të vogla e shpallën pavarësinë e tyre nën drejtimin e berberëve ose myslimanëve spanjollë. Lëvizjet e tilla separatiste, vazhdimisht i kanë preokupuar emirët omejadë, deri në fillim të shekullit të dhjetë.

Në jug, shteti i vogël kodrinor, Regio,[15] me kryeqytetin Arhidon, në vitin 873, lidhi marrëveshje me Muhamedin, i cili praktikisht e pranoi pavarësinë e tij, me pagesën e haraçit vjetor. Banorët më shumicë kanë qenë spanjollë të islamizuar. Në moçalet e veriut, me Aragonën e pavarur ka udhëhequr Benu-Kasi, familje e vjetër vizigote. Familja Benu-Kasi ka qenë e shekullit të nëntë, ajo ia bashkoi vetit Saragosën, Toledon dhe qytete të tjera të rëndësishme kufitare, si dhe bëri aleancë me fqinjët e saj në perëndim me mbretërit e Leonës. Nëpër gjithë territorin rreth qytetit të Toledos, qyteti i cili ka qenë më shpesh në gjendje trazirash sesa të paqes, fisi berber Benu Shennun, në krye me bandat plaçkitëse, digjnin dhe vrisnin. Në Sevilë e cila ishte si qendër kryesore e kulturës romake në kohën e vizigotëve, ka pasur banorë me prejardhje romake dhe gotike, ka qenë rebeluar fisi Benu Haxhxhaxh. Këta sundues të Sevilës dhe rrethi i tyre, sipas gjinisë femërore mbaheshin me prejardhje nga Sara, mbesaë e një viigoti dhe gruas së një arabi. Historiani Ibnu el-Kutijje, gjithashtu ka qenë pasardhës i Sarës. Në jugperëndim të Galicisë, renegati i guximshëm nga Merida dhe Badajoza, Abdurrhaman ibni Mervan el-Xhilliki e formoi

[15] Ar. Rejjë, të cilën Ibnu Haldun, në mes tjerash e bën qytet dhe e ngatërron me Malagën (vol. IV, fq. 132-134) Malaga ka qenë kryeqyteti i mbretërisë Regio, nën vizigotët edhe pas sundimit të Abdurrahmanit III, Shif: Idrisi, fq. 28.

principatën e pavarur nga e cila me ndihmën e Alfonozit III, mbretit të Leonës dhe aleatit të natyrshëm të të gjithë kryengritësve kundër sundimit arab. Në këndin jugperëndimor të siujdhesës, të cilën sot e përfshinë Algarva[16] portugeze, e përforcoi sundimin e vet edhe një renegat para përfundimit të sundimit të Muhamedit. Në juglindje Murcija (ar. Mursija) nën sundimin e një princi renegat u çlirua nga sundimi arab. Mirëpo prej të gjithë kryengritësve më i rrezikshmi dhe më i pamposhturi ka qenë një person i quajtur Omer ibnu Hafsun.

Ibnu Hafsun

Omeri ka qenë pasardhës mysliman i një aristokrati vizigot. Duke filluar karrierën e tij të ndritshme rreth vitit 880, si organizator i një bande hajdutësh me qendër në kështjellën e vjetër në kodrën Babastro (Monte Babastro).

Omeri, pasi që një kohë shërbeu në ushtrinë shtetërore në Kordovë, me ndihmën e malësorit Elvirë (Ilbire) u ngrit deri në pozitën e komandantit ushtarak të jugut spanjoll, kundër pushtetit mysliman. Kryengritja e tij ka tërhequr vëmendjen e tre emirëve, Muhamedit, El-Mundhirit dhe Abdullahut. Për të krishterët e jugut dhe të pakënaqurit, Omeri për një kohë të gjatë u bë luftëtar i nacionaliteteve të shtypura. Për arabët ka qenë "mallkim dhe blasfemi". Pas ndryshimit të madh të fatit, atij i shkoi për dore ta izolonte Kordovën dhe hyri në bisedime me sunduesit abasid dhe aglebit të Afrikës, me qëllim për ta emëruar për guvernator të Spanjës. Kur planet e tij ambicioze nuk patën sukses, rreth vitit 899, filloi të predikonte fenë e të parëve të tij, të cilën e fshehu kohë të gjatë në zemër, duke marrë për vete emrin Samuel. Shumë herë Samueli e ka tronditur deri në themele fronin omejad. Pushteti i pasardhësit të Abdurrahmanit I, ka qenë i rrezikuar, të cilin me pikëllim e vajtoi për një përtëritës.[17]

Përktheu nga gjuha boshnjake,
Hajrullah Hoxha

[16] Nga ar. El-gurb, perëndim.

[17] Filip Hitti, *Istorija arapa,* Bot. II, Sarajevë, 1973.

VEPËR ORIGJINALE NGA FUSHA E HADITHIT SI NGA PIKËPAMJA STILISTIKE ASHTU EDHE NGA ANA TEMATIKE

Kompleti "Islami nëpërmjet hadithe 1-7" botoi: Kryesia e Çështjeve Fetaretë Turqisë në bashkëpunim me Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës)

Pas Kuranit famëlartë, si bazament i çdo shkence dhe njohurie fetare, Syneti i Pejgamberit a.s., i cili përfshin thëniet, veprat dhe pëlqimet e të Dërguarit të Allahut, është baza e dytë në të cilën mbështetemi për të sqaruar e shtjelluar çështjet e fesë sonë islame. Pa Synetin e Resulullahit s.a.v.s., vështirë se do të arrinim të depërtonim në kuptimet shumëdimensionale të Kuranit Fisnik, andaj pikërisht, duke iu referuar këtij parimi, dijetarët myslimanë, me zellin, dashurinë dhe seriozitetin më të madh, u janë qasur studimeve shumëdisiplinare të shkencave të hadithit, duke na ofruar materie të bollshme studimore të kësaj fushe, për të pasur një perceptim sa më real rreth tyre.



Në vazhdën e këtyre përpjekjeve fisnike, për ta përçuar tutje mesazhin e thesarit profetik ndër brezat e Ymetit islam, është edhe vepra që sot po e promovojmë "*Islami nëpërmjet hadithe"* e përkthyer në gjuhën shqipe, e cila është e veçantë, për nga aspekti i përfshirjes, infrastrukturës, përmbajtjes dhe metodologjisë së ndjekur gjatë përpilimit të saj.

Kjo vepër është fryt i punës së tetëdhjetë e nëntë autorëve, të fushës akademike nga Republika e Turqisë, nën përkujdesjen e DIJANET-it - Kryesisë për Çështje Fetare. Në këtë vepër madhështore 7 vëllimëshe, janë paraqitur qëndrimet, sjelljet dhe porositë e Pejgamberit a.s., për çdo fushë dhe segment që ka të bëjë me jetën dhe sjelljet e njerëzve në këtë botë.

Hadithet e sjella në këtë vepër, kapin fusha të ndryshme, ndërkohë që edhe komentet e tyre janë përvijuar me një gjuhë të zakonshme dhe të kuptueshme për njeriun e kësaj kohe, duke marrë parasysh problemet dhe nevojat e shoqërisë islame në përgjithësi, në periudhën bashkëkohore. Shkurt, vepra në fjalë i dedikohet klasës së mesme të lexuesve, dhe si rrjedhojë nuk është thelluar në probleme të ndërlikuara të shkencës së hadithit.

Për ta kuptuar sa më mirë mesazhin nga kjo vepër madhështore, është mirë që të lexohet me kujdes dhe vëmendje Parathënia-Hyrja, në të cilën është sqaruar deri në detaje, rreth metodologjisë së ndjekur gjatë punës ekipore.

Vepra *Islami nëpërmjet haditheve* përbëhet nga *Mukaddimja-Hyrja,* në të cilën*,* janë shtjelluar në hollësi termet *Hadith, Sunet*, pastaj *historiku i Shkencës së Hadithit*. Në *Mukaddime* është folur gjithashtu edhe për sahabët më të njohur që regjistronin hadithet e Pejgamberit a.s., natyrisht, me lejen dhe pëlqimin e tij.

Një pjesë e meritуar në këtë parathënie i është kushtuar **Epokës së artë të hadithit** dhe librave të parë në këtë sferë, në shekullin e III sipas hixhretit, ku flitet shkurtimisht për *Sahihun* e Buhariut dhe atë të Muslimit, pastaj për *Sunenet*: të Tirmidhiut, Ebu Davudit, Nesaiut dhe Ibn Maxhes. Ndërkohë, që në këtë parathënie flitet edhe për disa nga librat që u shkruan në shek. e IV-t: *El-Munteka* të Ibn Xharudit, *Sherh Meanil Athar* të Tahaviut, *Sunenin* e Darekutnit, *El-Mu'xhemu-s-Sagir, El-Mu'xhemul Evsat*, dhe *El Mu'xhemul Kebir* të Taberaniut, *Mustedrekun* e Hakimit etj.

Po ashtu, në këtë parathënie i është bërë një vështrim edhe kujdesit ndaj veprave të hadithit gjatë periudhës osmane, nëpër Institucionet e veçanta që quheshin *Darul Hadith*, që duke filluar nga ai i par i ndërtuar në Iznik në vitin 1389, në kohën e Sulltan Muratit të I-rë, pastaj në Edrene, 1435, për të vazhduar me të tilla në shumicën e qyteteve të mëdha të Perandorisë në atë kohë., etj.

Vepra në fjalë, ashtu siç theksuam më parë është e ndarë në 7 vëllime me 8 kapituj, dhe në secilin vëllim, janë ndarë tema të veçanta, që prekin fusha të ndryshme të jetës, të raporteve ndërnjerëzore, të mirësjelljes, të obligimeve ndaj Allahut dhe ndaj shoqërisë etj.

Në Vëllimin e I-rë, pas përkushtimit dhe dedikimit që i është bërë të Dërguarit a.s., jepen biografitë e shkurtra të ekipit punues akademik, pason fjala hy-

rëse e kryetarit të atëhershëm të DIJA-NET-it, Dr. Mehmet Gyrmez, i cili në fjalën e tij i përgëzon autorët për kurorëzimin e punës së tyre me këtë vepër përshpirtëse.

Pas Parathënies, e cila siç thamë më parë, përmban Kornizën konceptuale, ajo përmban edhe një Hyrje të shkurtër në të cilën fillohet me *Istiadhen, Besmelen, Hamdelen* dhe *Salvelen,* duke sjellë hadithe për secilën prej këtyre terminologjive dhe pastaj fillon shtjellimi i haditheve. Ky vëllim i ka tre kapituj: *Kapitulli i parë* flet rreth Allahut, Emrave të Bukur të Tij, krijimit të gjithësisë, të engjëjve, xhinëve dhe njeriut, për shpirtin, kohën dhe fenë si udhërrëfim hyjnor. *Kapitulli i dy*të, i kushtohet Dijes, Vahjit/Zbulesës hyjnore, tefsirit, sunetit, fikhut largpamësisë etj., kurse *Kapitull i tretë* flet kryesisht rreth Besimit-Imanit dhe çdo gjë tjetër që ndërlidhet me këtë fushë, si përudhja, respekti ndaj Allahut, Kaderi, munafiklëku, shirku, mësyshi, magjia, falli etj.

Në **Vëllimin e II-të**, përfshihet *kapitulli i katërt*, i cili shtjellon hadithe dhe sqarime të bollshme rreth Ibadeteve në përgjithësi, përfshirë këtu, lutjet, dhikrin, namazin, imamllëkun, kiblen, Haxhin, Umren Ramazanin, agjërimin, kurbanin, sadekatul fitrin, maturinë në adhurime, etj.

Vëllimi i III-të përfshin *kapitullin e pestë*, që flet kryesisht rreth moralit, përkushtimit, frikërespektit, modestisë, egoizmit, hipokrizisë etj.

Në **Vëllimin e IV**-t, i cili përfshin *kapitullin e gjashtë*, shtjellohen hadithe që kryesisht kanë të bëjnë me jetën sociale, për familjen, martesën, jetën private, edukimin e fëmijëve, respektin ndaj prindërve, kujdesin ndaj jetimëve, drejtësinë në udhëheqje, urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, për luftën, paqen etj.

Vëllimi i V-të, i cili është vazhdimësi e *kapitullit të gjashtë*, përfshin të tjera segmente të jetës shoqërore, si fatkeqësitë, durimin, qëndresën, pastaj etikën në tregti, rregullat e tregtisë islame, kamatën, pasurinë publike, kafshët hallall, trashëgiminë, Imunitetin dhe ruajtjen e nderit familjar, betimin, dëshminë, gjakmarrjen, vetëvrasjen, etj.

Në **Vëllimin e VI-të**, i cili përfshin *kapitullin e shtatë,* Flitet për Historinë dhe Qytetërimin, për pejgamberët, për popujt e kaluar, periudhën e injorancës, për Pejgamberin tonë, a.s., për emrat e tij, për mënyrën e të folurit të tij, të veshjes, të etikës, për bashkëshortet dhe fëmijët e tij, si dhe për diversitetin në mes sahabëve.

Ndërsa në **Vëllimin e fundit**, atë **të shtatë,** shohim vazhdimësinë e kapitullit të shtatë, rreth Historisë dhe Qytetërimit (II), teksa në të shtjellohen tematika rreth Israsë dhe Miraxhit, Hixhretit, luftrave të Pejgamberit a.s., çlirimi i Mekës, Haxhi lamtumirës, marrëdhëniet me hebrenjtë e Medinës, me të krishterët, rreth dashurisë për atdheun, për natyrën, ujin, shëndetin, veshmbathjen,

shakatë dhe argëtimin, rreth pikturave dhe skulpturave dhe artit në përgjithësi.

Po në këtë **vëllim** kemi edhe *kapitullin e tetë,* i cili merret kryesisht me Ahiretin dhe jetën e amshuar, rreth vdekjes, jetës së varrit, Kiametit, Shefatit, Xhehenmit, për ta përmbyllur me hadithet rreth Xhenetit dhe rrugëve që shpijnë tek shpërblimi i amshueshëm në këto Xhennete. Krejt në fund të këtij vëllimi, për të ilustruar edhe shkencërisht, gjithë këtë mund të derdhur, vjen edhe literatura e përdorur, duke filluar nga veprat klasike, deri të ato bashkëkohore, gjë që argumenton edhe njëherë se kjo vepër është realizuar sipas standardeve të mirëfillta shkencore.

Në ketë vështrim timin, nga ajo që kam arritur të shfletoj nw kwtw vepër, kam vërejtur se autorët, një kujdes të posaçëm i kanë kushtuar trashëgimisë dhe kulturës së hadithit, e cila trashëgimi përveçqë konsiderohet burim i dytë i fesë, po ashtu ka tretmanin e një thesari islam, sepse mëton, që nëpërmjet haditheve, t'ia përcjellë njeriut të kohës sonë, porosinë e pastër të Islamit. Mbase pikërisht, për këtë arsye, nëpër tema nuk janë përmendur ato njohuritë klasike nga aspekti teknik, në lidhje me përcjellësit (ravitë) dhe zinxhirin e përcjellësve (*senedin*), siç zakonisht jemi mësuar t'i shohim në veprat klasike të Hadithit.

Gjithashtu, në këtë vepër, nuk janë paraqitur problemet akademike të shkencës së hadithit; nuk janë bërë as diskutime në lidhje me shkencat e tefsirit (intepretimi), fikhut (e drejta islame), kelamit (apologjetika islame) dhe tesavufit (mistika islame). Në veçanti, çështjet e fikhut u janë lënë librave të së drejtës islame dhe në vend të mospërputhjeve juridike, janë paraqitur urtësi të caktuara që dalin nga tema të ndryshme.

Në përpilimin e disa temave mund të themi lirshëm se është ndjekur metoda e "intepretimit të hadithit me hadith". Tekstit të një hadithi, madje edhe disa fjalëve që kanë mbetur ndërmjet emrave të përcjellësve, në varësi të vendit, u është dhënë vlera e duhur historike dhe kulturore. Por, duhet të theksojmë se jo te çdo temë janë dhënë të gjitha përcjelljet ekzistuese. Mbase për shkak të kufizimit në lidhje me numrin e faqeve, për çdo temë janë shfrytëzuar afërsisht nga tridhjetë hadithe.

Është treguar një kujdes i posaçëm që këto hadithe të jenë gjithëpërfshirëse për nga aspekti i kuptimit, po njëkohësisht edhe të bartin porositë e hadithevе, të cilat për shkak të kufizimeve që i cekëm, nuk janë shfrytëzuar në tekst. Shohim se hadithet që janë shumë të gjata, e që flasin për disa tema, dhe nuk janë përmendur në tërësi ose që kanë dallime të vogla në raport me tekstet e përmendura më parë, për shkak të tërësisë tematike, janë dhënë vetëm në trajtë referencash.

Nga sa u tha më lartë, mund të themi se vepra *Islami nëpërmjet haditheve* vërtet është një vepër origjinale nga pikëpamja stilistike e temave dhe përmbajtjes.

Para së gjithash, ky studim ekipor nuk është një përmbledhje hadithesh në tema të ndryshme në trajtë të njëpasnjëshme, por një vepër tematike. Në të janë mbledhur të gjitha hadithet në lidhje me një temë dhe janë paraqitur e komentuar në kuadër të një modeli të caktuar: me hyrje, zhvillim, përfundim dhe ide.

Vepra është përpjekur që të pasqyrojë përmes hadithe shoqërinë e parë myslimanë, të strukturuar në kuadër të shëmbëlltyrës, Synetit, jetës dhe sjelljeve të Pejgamberit s.a.v.s.

Studimet që e përbëjnë këtë përmbledhje, për nga aspekti i përmbajtjes, tërësisë dhe metodologjisë janë vlerësuar nga ana e anëtarëve të komitetit të lartë dhe ekspertëve që kanë punuar në kuadër të projektit dhe janë analizuar nëpër platforma të ndryshme. Analiza e teksteve është bërë me qëllim që të ketë një ujdi mes shkrimeve dhe studimeve që janë shkruar nga ana e tetëdhjetë e nëntë autorëve të ndryshëm. Por, përmirësimet që i janë bërë gjatë analizës dhe redakturës përfundimtare të veprës dhe botimi i saj nga ana e Dijanet Ishleri Baskanligi (Kryesia e Çështjeve Fetare Turqisë), nuk mund të jenë arsyetim për lëshimet e mundshme, dhe as nuk e mënjanon përgjegjësinë e stafit akademik që ka punuar në përgatitjen e veprës, që vetvetiu nënkupton se vepra edhe nuk mund të ketë mangësi të caktuara. Edhe kjo vepër ka në konsideratë idenë se të gjitha veprat e tjera të literaturës islame, përveç Kuranit, kanë mangësi dhe si rrjedhojë e kësaj, edhe nga vetë autorët është shprehur se çdo kritikë konstruktive dhe e kuptimtë, është e mirëseardhur.

Kur jemi te botimi i kësaj duhet përgëzuar e falënderuar DIJANET-in e Bashkësisë Islame të Republikës së Turqisë, për këtë dhuratë kaq të çmueshme, e cila u është dedikuar në radhë të parë Imamëve shqiptarë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe kudo që flitet gjuha shqipe, e më pas edhe studentëve dhe studiuesve të shkencës së hadithit ndër shqiptarët.

Po ashtu dëshiroj ta falënderoj edhe ekipin punues në gjuhën shqipe, duke filluar prej përkthyesve, redaktorëve dhe atyre që u përkujdesën që ky punim, të marrë këtë formë, të cilën sot e kemi para Nesh. Unë shpresoj, se në një të ardhme të afërt, kjo vepër, do të jetë objekt studimi edhe nga ana e ekspertëve tanë të lëmit të hadithit, për të dhënë edhe ata opinionet dhe mendimet e tyre rreth saj, për çka besoj se janë të mirëseardhur kurdoherë, me studimet dhe vrojtimet e tyre në faqet e revistave tona fetare e shkencore sic janë "Edukata Islame", "Zani i Naltë". "Hëna e Re" etj.

Sabri Bajgora,
Prishtinë, 21.02.2019

P.S. Fjala e kryeimamit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Sabri ef. Bajgora në promovimin e kompletit "Islami nëpërmjet hadithe 1-7", të mbajtur në Prishtinë më 21 shkurt 2019.

MERHUM

KALOI NË AHIHET REFORMATORI I PERIODIKUT TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS PROF. QEMJAL MORINA 1951-2019

Më 22 shkurt 2019, në Prishtinë, ndërroj jetë pedagogu, publicisti e shkencëtari ynë i shquar, prof. Qemajl Morina.

Profesor Qemajli tërë veprimtarinë e tij jetësore ia kushtoi Bashkësisë Islame të Kosovës, respektivisht institucioneve të saj, në të cilat ka dhënë një kontribut shumë të çmuar, sidomos në veprimtarinë botuese, në periodikun e Bashkësisë Islame, në Fakultetin e Studimeve Islame, si dhe në kultivimin e dialogut dhe mirëkuptimit ndërfetar.

Prof. Qemjal Morina 1951-2019

(Biografi)

Lindi më 1951 në fshatin Hodonovc të Kamenicës. Rrjedh nja një familje me traditë fetare. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë. Si nënënës i medresesë qe ndër më të dalluarit, i përkushtuar në mësime, i qetë dhe i pasionuar pas

leximit të literaturës. Pas përfundimit të medresesë, studimet e larta i vazhdoi në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin "Um Durman" në Sudan, ku edhe diplomoi më 1976, ndërkaq studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Kajros në vitin 1979.

Gjatë studimeve në Kajro, profesor Qemajli tregoi interesim për të kaluarën tonë, duke hulumtuar me zell në Arkivin qendror të Kajros për trajtimin e Lidhjes së Prizrenin në shtypnin egjiptian, të cilin studim, profesori për herë të parë e pati botuar në Konferencën me rastin e 100-vjetorit të kësaj ngjarjeje në vitin 1978. Përgjatë viteve të qëndrimit të tij në Kajro, u thellua në këtp hulumtime për Lidhjen e Prizrenit duke na e lënë si trashëgim veprën e rëndësishme dhe me vlerë "Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian"

Pas studimeve, ai në vitet (1980-1989) ka punuar në Bengazi të Libisë, në detyrën e sekretarit dhe përkthyesit në Ministrinë e Shëndetësisë të Libisë. Më 1990 është punësuar në Kryesinë e Bashkësinë Islame të Kosovës, si bashkëpunëtor profesional për shtyp dhe po atë vit emërohet kryeredaktor i revistës "Dituria islame", në të cilin post qëndroi deri në vitin 1996. Me ardhjen e profesor Qemajlit në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, respektivisht në krye të sektorit për veprimtari botuese nisi një periudhë e re në këtë fushë duke krijuar kushte e premisa për zhvillimin e saj të mirëfilltë.

Ndërsa, që nga momenti kur u vu në krye të revistës "Dituria islame", profesor Qemajli me përkushtimin dhe vizionin e tij, e ngriti revistën në nivele të tjera duke e hapur ndaj shtresës intelektuale të vendit, ndaj të rinjve dhe duke ruajtur me kujdes edhe brezin e parë të autorëve në literaturën islame në gjuhën shqipe.

Me të marrë këtë detyrë, prof. Qemajli iu përvesh punës me përkushtimin më të madh që besimin e dhënë nga Kryesia ta arsyetonte dhe punën ta realizonte sa me më shumë sukses. Nëse vështrojmë me kujdes botimin e revistës "Dituria islame" nën udhëheqjen e profesor Qemajl Morinës, lehtësisht mund të nxjerrim përfundimin se kontributi i prof. Qemajlit qoftë si autor, qoftë si kryeredaktor, qoftë si menaxher dhe orues i kuadrove dhe bashkëpunëtorëve, ndër këto vite dhe sidomos në vitet e nëntëdhjeta, është i jashtëzakonshëm, është determinues, i prekshëm dhe shumëdimensional. Së pari, prof. Qemajli u krijoi hapësirë dhe mundësi kuadrove të reja që të sprovonin veten në fushën e fjalës së shkuar,

dhe në këtë drejtim arriti shumë suksese. Kjo është një meritë e pakontestueshme e prof. Qemajlit. Së dyti, prof. Qemajli me vizonin e tij mbajti afër vetes kuadrin e mëhershëm që kishte drejtuar e kontribuar në shtypin e Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe me këtë ruajti vazhdimësinë dhe kontributin e gjeneratave. Kjo është një meritë tjetër e veçantë e prof. Qemajlit. Një kontribut të çmuar prof. Qemajli ka dhënë edhe në hapjen e "Diturisë islame" për shtresë më të gjerë intelektuale e akademike të Kosovës, të cilët pas rënies së sistemit monist dhe rrethanave të vështira nën okupimin serb, te revista "Dituria islame" gjetën si askund tjetër hapësirën, mundësinë dhe përkrahjen e duhur për t'u kontribuuar shkencës, kulturës, trashëgimisë dhe vendit të tyre, ndërsa te profesor Qemajli gjetën një bashkëpunëtor, bashkëmendimtar e bashkudhëtar të përkushtuar për këtë kauzë.

Ndërkaq, nga viti 2001 deri më 2016 ishte kryeredaktor i Revistës "Edukata islame", e cila që në origjinë qe konceptuar origjinë si revistë fetare islame. Mirëpo, me kalimin e kohës dhe me krijimin e rrethanave të reja, "Edukata islame" do të marrë edhe një dimension tjetër përtej atij fetar, duke u shndërruar në një tribunë të mendimit kulturor, arsimor, historik dhe shkencor.

Kjo u arrit falë kontributeve të shumë autorëve të shquar të dijes dhe shkencës, të cilët me kënaqësi vunë bashkëpunim me "Edukatën islame". Kjo hapje e "Edukatës islame" sidomos vërehet pas ardhjes së profesorë Qemajlit në krye të revistës "Edukata islame", i cili revistës ia ndërroi formatin dhe dizajnin duke i shtuar asaj edhe emërtimin "revistë shkencore" dhe nga këtu "Edukata islame" shndërrohet në revistë *shkencore, kulturore, islame*.

Kontributi i prof. Qemajlit në periodikun e Bashkësisë Islame është i gjerë dhe u përket fushave e disiplinave të ndryshme me interes për islamologjinë, historinë, kulturën, publicistikën e deri te intervistat, reportazhet, kronikat e informatat dhe lajmet e shumta.

Përveç kësaj, profesor Qemajli një kontribut të çmuar ka dhënë në fushën e historisë e kulturës sonë kombëtare, përse ka bërë hulumtime në Londër në Institutin për Studime Orientale (1978), në Arkivin Qendror të Egjipt në Kajro (1976-1977) dhe në Arkivin Kombëtar të Libisë dega në Bengazi (1980-1982).

Ka qenë përfaqësues i Bashkësisë Islame të Kosovës në dosjen e Dialogut ndërfetar "Islamit dhe Krishterimit", gjatë viteve 1998- 2013.

Me shkrime merret që nga viti 1970, dhe ka bashkëpunuar me një numër të konsiderueshëm të revistave shkencore që botohen te ne dhe jashtë, "Takvim-Kalendar", "Rilindja", "Jeta e re", "Përparimi", "Hëna e re", "Dituria islame", "el-Muxhtema", "et-Talib", "err- Rrisaletu", (Sudan), Al-Arab", (Bejrut), "Gllasnik' "Preporod" (Sarajevë) "Drita islame" (Tiranë), Zëri etj.

Ka të botuara këto monografi: Hoxhë Kadri Prishtina- mendimtar islam, Prishtinë (2000), Lidhja shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian (1878-1881), (2007), Glosari i nocioneve fetare (islame, ortodokse, katolike dhe çifute) (2010).

Me gjithë veprimtarinë e shumanshme intelektuale e edukative, profesor Qemajli nuk u tregua asnjëherë indiferent lidhur me zhvillimet shoqërore, sidomos nga vitet e '80-ta e këndej. Në vitet e '90-ta dhe pas suprimimit të subjektivitetit politik të Kosovës, profesori u ndodh përkrah prijësve të bashkësive fetare në Kosovë, duke u bërë pjesë e takimeve me delegacionet e huaja, pjesëmarrës në aktivitete ndërkombëtare, nëpër tribuna në të cilat do ta ngrinte zërin në mbrojtje të kombit të tij. Kurse me penën e tij dhe përmes shkrimeve që i botonte gjithandej në shtypin shqiptar dhe atë të huaj, ai denonconte haptazi dhunën dhe terrorin që po ushtronte pushteti serb jo vetëm në Kosovë, por edhe në Bosnjë, Sanxhak etj. Një kontribut të çmuar prof. Qemajli ka dhënë pa dyshim edhe në Fakultetin e Studimeve Islame të Prishtinës, ku ishte një ndër themeluesit e këtij institucioni, ndër pedagogët e parë shumëvjeçarë deri në pensionim, prodekan dhe drejtues për më shumë se 17 vjet. I pamohueshëm është edhe kontributi i jashtëzakonshëm i profesor Qemajlit në inicimin dhe organizimin e një sërë konferencash, sesionesh shkencore e simpoziumeve në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, pa përmendur këtu pjesëmarrjen e tij gjithandej nëpër botë në këso aktivitetesh. Ka Ligjëruar Gjuhën arabe në Katedrën e Orientalistikës të Fakultetit të Filologjisë (1990-1992), ndërsa që nga hapja e FSI-së në Prishtinë (1992) ligjëron lëndën e Gjuhës arabe, këtu përveç si pedagog kreu edhe detyrën e prodekanit (1992-2011)

R. Shkodra

NDËRROI JETË DREJTORI FINANCIAR I KRYESISË SË BIK-UT, NJËKOHËSISHT EDHE ANËTAR I REDAKSISË SË REVISTËS *EDUKATA ISLAME*, KASIM EF. GËRGURI (1970-2019)

Më 15 mars 2019, në Prishtinë, ndërroi jetë drejtori financiar në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Kasim ef. Gërguri.

Kasim ef. Gërguri (1970-2019)

Kasim ef. Gërguri lindi më 1970 në fshatin Bardh i Madh (Bellaçevc i Madh) të komunës së Fushë Kosovës. Rrjedh nga një familje ma taban të kultivuar fetar. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse medresenë e mesme "Alaudin" në Prishtinë (1988). Studimet i mbaroi në Fakultetin e Sheriatit në Aman të Jordanisë (1997).

Pas studimeve, Kasim efendiu kthehet në atdhe dhe menjëherë angazhohet si imam, hatib e mualim në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, ku u shqua për afërsi me xhematin, për stil të ligjërimit të qartë e të kapshëm si dhe për punën me brezat e rinj. Këtu filloi edhe veprimtaria e tij në Bashkësinë Islame të Kosovës, duke u bërë kështu edhe një nga kolegët dhe

bashkëpunëtorët tanë më të vyeshëm. Më 1998 emërohet arkëtar në Këshillin e Bashkësisë Islame të Prishtinës, detyrë të cilën e kreu me përkushtim e profesionalizëm deri sa e thirri ora e historisë dhe së bashku me shumë djem e vajza tona iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të përmbushur e realizuar kështu edhe një detyrë shtesë ndaj fesë e atdheut.

Pas përfundim të luftës dhe çlirimit të vendit, Kasim efendiu i rikthehet profesionit të tij prej imami, mualimi, hatibi e udhëheqësi në institucionet e BIK-ut, fillimisht të KBI-së së Prishtinës, kurse nga viti 2004 do të udhëheqë Dre jtorinë e Financave në Kryesinë e BIK-ut, ku ka bërë një punë të shkëlqyeshme. Në detyrën e drejtorit të financave, Kasim efendiu një kontribut të çmuar ka dhënë edhe për avancimin e programeve profesione në fushën e financave, trajnimeve dhe përgatitjen e stafit jo vetëm këtu në qendër, po në të gjithë këshillat e BI-së dhe në institucionet e tjera që veprojnë në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai qe i afërt më bashkëpunëtorët, modest me të tjerët, parimor në punë e mbi të gjitha korrekt e bashkëpunues me të gjithë.

Kasim efendiu ka qenë bashkëpunëtor i periodikut islam të BI-së, ka të botuar një sërë studimesh e kontributesh në fushën e akaidit në revistat "Dituria islame", "Edukata islame", "Takvimi" etj. Nga viti 2017, Kasim efendiu ka qenë emëruar anëtar i redaksisë së revistës "Edukata Islame", ku ka dhënë një kontribut në mbarëvajtjen e revistës.

Po ashtu rahmetliu ka marrë pjesë në një sërë konferencash e sesionesh shkencore të organizuara nga BI-ja dhe institucionet simotra. Më 2016 botoi veprën "Akaidi sipas Imam Maturidiut" një studim me vlerë për shkencën e akaidit te ne.

Gjithashtu, një ditë para se të shtrihej në spital për sëmundjen nga e cila vdiq, ai i kishte dhënë dorën e fundit librit "Hytbe – udhëzime metodike", libër ky të cilin ua ka kushtuar imamëve dhe të cilin së shpejti do ta botojë Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës.

R. Shkodra

MJESHTRIT TË MADH TË FJALËS SË SHKRUAR

(Me rastin e kalimit në ahiret të profesor Qemajl ef. Morinës)

Profesor Qemajl Morina filloi të shkruante qysh se kur ishte nxënës në medresenë "Alaudin" në Prishtinë. Ai shkroi vjershën kushtuar ditëlindjes së Muhamedit a.s. (ditës së Mevludit), e cila u botua në numrin e parë të revistës "Edukata islame" në vitin 1971. Në vitin 1978, mori pjesë në Konferencën shkencore me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila u mbajt në Prishtinë. Në këtë konferencë, ai u paraqit me temën "Qëndrimet e shtypit arab ndaj Lidhjes së Prizrenit". Gjithashtu gjatë studimeve të tij post-diplomike në Kajro, ai botoi në gazetën e përditshme "Rilindja" disa shkrime për Mehmet Ali Pashën dhe koloninë shqiptare në Egjipt. Mirëpo, kontributin e madh të tij ai e dha në revistat: "Dituria islame", "Edukata islame" redaktor i të cilave ishte për një kohë, si dhe në "Takvim".

Falë aftësive të tij profesionale, guximit intelektual dhe vizionit të tij largpamës, jo vetëm gjatë kësaj periudhe, por edhe më vonë i pasuroi këto revista me tema të ndryshme aktuale, si autor, studiues, publicist dhe përkthyes i mirëfilltë. Përveç me shkrimet e tij, profesor Morina, revistën "Dituria islame", e pasuroi edhe duke ju dhënë hapësirë të bollshme në faqet e saj shumë intelektualëve dhe akademikëve të njohur për të dhënë kontributin e tyre për çështjet kombëtare në kohën kur mbretëronte terri informativ në Kosovës, ngase në atë kohë, okupatori serb kishte mbyllur mjetet e informimit në gjuhën shqipe.

Gjatë kohës sa ishte kryeredaktor i revistës tjetër "Edukata islame", nga nr. 65 e deri në nr. 111, profesor Morina dha një kontribut jashtëzakonisht të çmueshëm, duke botuar në çdo numër të saj së paku një artikull me përmbajtje shkencore e bashkëkohore. Ai në këtë revistë zgjodhi për anëtarë të redaksisë radhët e intelektualëve të dalluar kosovarë, siç ishin: Akademik Pajazit Nushi, akad. Jashar Rexhepagiç, dr. Ejup Sahiti, etj., të cilët me punimet e tyre shkencore ia ngritën cilësinë dhe vlerën e saj.

Duke u bazuar në kontributin e tij të shumanshëm në fushën e publicistikës islame në gjuhën shqipe, për afirmimin dhe mbrojtjen e fesë, kombit dhe atdheut, me plotë të drejtë mund të themi se, profesor Morina ka qenë një intelektual i mirëfilltë, analist e publicist i dalluar, përkatësisht një mjeshtër i madh i penës, të cilin e karakterizonte urtësia, devotshmëria, modestia, vizionariteti dhe guximi intelektual. Në shkrimet e tij ai ndoqi rrugën e reformuesve të njohur të mendimit islame, siç ishin: Ebu A'la el Mevdudiu, Reshid Rida, Mustafa el Meragi, Muhamed Gazaliu i riu, hafëz Ali Korça, hafëz Ibrahim Dalliu, Hysejn ef. Gjozo, h. Sherif ef. Ahmeti etj.

Si sekretar i redaksisë për veprimtari botuese që isha, kam pasur fatin që me prof. Qemajl Morinën të punoja në një zyre për tetë vjet rresht, deri në shkuarjen time në pension. Ndërsa, bashkëpunimi im me të vazhdoi edhe për dhjetë vjet të tjera, si anëtar i redaksisë së revistës "Edukata islame". Gjithmonë e kemi çmuar dhe respektuar njëri-tjetrin dhe kishim botëkuptime identike. Ai kishte një natyrë të qetë e të urtë, ishte i matur dhe i kujdesshëm si në fjalë ashtu edhe në vepra, kështu që, me gjithë atë periudhë të gjatë të bashkëpunimit me të, nuk më kujtohet asnjë fjalë e vetme e keqe prej tij. Shkurt, çdoherë ishte kënaqësi e madhe të bashkëbisedoje e të bashkëpunoje me të. Ai fliste pak e punonte shumë. Kur lexonte ndonjë vepër ose shtypin ditor, sa herë që haste në ndonjë fjali apo fragment të rëndësishëm, ai e nënvizonte ose e shkruante atë në bllokun e tij të shënimeve. Kur përgatiste ndonjë shkrim a punim të tij, ai i përdorte ato duke e cekur në fusnotë burimin e tyre.

Po e përfundoj këtë shkrim timin të shkurtër në shenjë të vlerësimit dhe të kujtimit të personalitetit dhe veprës së prof. Qemajl Morinës, me

fjalët e tij të shkruara në fund të artikullit "Me rastin e numrit 100 jubilar të revistës Edukata islame", në të cilin ai shkroi*: "Njerëzit vdesin, ngjarjet harrohen, objektet sado të mëdha qofshin ato i shkatërron dhëmbi i kohës. Mbetën vetëm fjala e shkruar, dëshmi e kontributit dhe përpjekjeve të njeriut për kryerjen e misionit të tij në këtë botë kalimtare."*

Zoti i Madhërishëm e mëshiroftë dhe e shpërbleftë profesor Qemajlin me Xhenetin Firdevs!

Hajrullah HOXHA

Përmbajtja

NË KUJTIM TË DY KOLEGËVE
Prof. Qemajl Morina dhe Prof. Kasim Gërguri
(Allahu i pastë mëshiruar) 5

Sabri BAJGORA
MUHAMED MUTEVEL-LI ESH-SHA'RAVI
dhe tefsiri i tij "Havatiri havle-l Kurani-l Kerim" 7

Ejup HAZIRI
AGJËRIMI DHE DISPOZITAT E TIJ 27

Ramadan SHKODRA
BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS PAS LUFTËS
SË DYTË BOTËRORE - (II) Gjendja politike-shoqërore
në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore 47

Sulejman OSMANI
EDUKATA FETARE ISLAME DHE REFLEKTIMET E SAJ
TEK INDIVIDI DHE SHOQËRIA 73

Prof. asoc. dr. Isa MEMISHI
TRANSKRIPTIMI I ALFABETIT ARAB
ME ALFABETIN E GJUHËS SHQIPE..... 89

Mr. Ekrem MAQEDONCI
DISPOZITAT KLASIKE DHE BASHKËKOHORE
RRETH ALKOOLIT 115

Sadik MEHMETI
IXHÂZETNÂMETË E HAXHI SHERIF EF. AHMETIT 131

Driton ARIFI
FRAKSIONI I KURANISTËVE
(Hulumtim analitik rreth fraksionit
që konteston argumentimin me Sunetin e Muhamedit a.s.) 153

Feti MEHDIU
BRENGAT E REXHEP VOKËS -
NJË SHEKULL PAS VDEKJES SË TIJ 173

Nuridin AHMETI
MONUMENTET ISLAME NË PRIZRENIN
E MITRUSH KUTELIT TË VITI 1943 187

Filip HITTI
EMIRATI OMEJAD NË SPANJË..... 207

VEPËR ORIGJINALE NGA FUSHA E HADITHIT
SI NGA PIKËPAMJA STILISTIKE ASHTU
EDHE NGA ANA TEMATIKE..... 221

KALOI NË AHIHET REFORMATORI I PERIODIKUT
TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS
PROF. QEMJAL MORINA 1951-2019..... 227

NDËRROI JETË DREJTORI FINANCIAR I KRYESISË
SË BIK-UT, NJËKOHËSISHT EDHE ANËTAR
I REDAKSISË SË REVISTËS *EDUKATA ISLAME*,
KASIM EF. GËRGURI (1970-2019)..... 231

MJESHTRIT TË MADH TË FJALËS SË SHKRUAR..... 233

Përmbajtja 237